




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT VJETOR

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

**1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2016**



Tiranë, Prill 2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT VJETOR

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2016

Tiranë, Prill 2017

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar deputete dhe deputetë,

Në mbështetje të nenit 63 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, kam nderin që në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes Raportin për veprimtarinë tonë gjatë vitit 2016.

Ky Raport përveç se një përmbledhje e veprimtarive të realizuara nga institucioni ynë vitin e kaluar, është gjithashtu një analizë dhe sintezë e problematikave të evidentuara gjatë vitit 2016, lidhur me situatën e lirive dhe të drejtave të njeriut në vend.

Gjithashtu, raporti reflekton përpjekjet dhe punën që institucioni ynë ka realizuar për të mbrojtur dhe promovuar më tej këto të drejta, duke përfshirë informacion si mbi veprimtarinë e institucionit sipas kompetencave të parashikuara nga ligji, ashtu edhe të dhëna në shifra lidhur me statistikat e ankesave dhe rasteve të trajtuara, si dhe të dhëna për burimet njerëzore, buxhetin dhe infrastrukturën për vitin 2016.

Raporti vjetor 2016, kërkon ashtu si dhe çdo vit, të japë një panoramë dhe të qasjes dhe bashkëpunimit me institucionet e pushtetit vendor dhe qëndror lidhur me kërkesat për shpjegime dhe rekomandimet që Avokati i Popullit ka adresuar.

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

KREU 1

Përmbledhje ekzekutive - Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2016

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit parashikohej në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (miratuar në vitin 1998), ndërsa ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” për funksionimin e institucionit u miratua disa muaj më pas nga Kuvendi i Shqipërisë. ligjin

Në veprimtarinë e tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit. Pavarësia e institucionit është një tipar i garantuar, në radhë të parë tek parashikimi si institucion Kushtetues I pavarur. Avokati i Popullit, ofron opionencë për mirëqeverisje dhe tipar themelor i Avokatit të Popullit është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik.

Nëpërmjet kësaj përmbledhje ekzekutive, kemi si qëllim që të japim një paraqitje përmbledhëse dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve të nxjerra gjatë vitit 2016, si dhe dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve të përgatitura gjatë këtij viti për gjendjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur një sërë arritjesh përse i përket një bashkëpunimi të mirë me median; bashkëpunim të frytshëm me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtare; bashkëpunim të frytshëm dhe rezultate konkrete me Ombudsmanët dhe Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut në nivel rajonal ashtu si dhe në nivel më të gjërë, në rritjen e aksesit dhe besimit të qytetarit tek Institucioni i Avokatit të Popullit duke e parë si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre; krijimi i një profili Institucional proaktiv në identifikimin dhe ndjekjen e çështjeve; konsolidimi i zyrave rajonale.

Aspekt pozitiv ka shënuar bashkëpunimi me institucionet shtetërore sidomos në pranimin e rekomandimeve të adresuara, por mbetet ende sfidë zbatimi i atyre rekomandimeve të pranuar.

Gjatë këtij viti, nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë **trajtuar në total 5512 ankesa**, kërkesa dhe njoftime (*duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve*). në një kohë që në vitin 2015 numri total ka qënë 4203 ankesa. Pra evidentohet një rritje me rreth 1300 ankesa në total. Ankesa, kërkesa, njoftime gjatë vitit 2015 që kanë qënë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit janë 2566 gjithsej. Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 2946 ankesa janë trajtuar në formën e këshillimeve dhe orientimeve mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen.

Për vitin 2016, situata e përgjithshme e ankesave të hyra dhe të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit paraqitet si më poshtë:

- Ankesa pranë Zyrës së Pritjes të Qytetarëve	-	2123
- Ankesa nga Zyrat Rajonale	-	1928
- Ankesa në rrugë postare	-	1008
- Ankesa on-line (<i>Portali, e-mail dhe rrjete sociale</i>)	-	146
- Ankesa me telefon (<i>telefon fix, mobil dhe numrin jeshil</i>)	-	139
- Ankesa nga Ditët e Hapura	-	168

Ankesat e trajtuara për të cilat ka filluar hetim administrativ, të ndara sipas seksioneve, janë:

Seksioni i Administratës	1038 ankesa
Seksioni i Veçantë	687 ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	725 ankesa
Njësia e parandalimit të Torturës	116 ankesa

Gjatë vitit 2016, rezulton **se nga 319 rekomandime të adresuara në total**, nga të cilat janë pranuar 197 rekomandime. Nga 197 rekomandime të pranuar, vetëm 93 prej rekomandimeve të pranuar, kanë gjetur zbatim të plotë. Pra, referuar raportit të rekomandimeve të pranuar me rekomandimet e zbatuara, rezulton se 47.2% e rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim nga institucionet përkatëse.

Lidhur me **rekomandimet pa përgjigje**, evidentojmë **se 70 rekomandime** për vitin 2016, rezultojnë pa përgjigje. Pra, në përputhje me raportin midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit rezulton se 21.9 % e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje.

Lidhur me numrin e kërkesave për informacion, rezulton se për vitin 2016, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **3053 shkresa- kërkesa për informacion**, prej të cilave 158 prej tyre rezultojnë pa përgjigje, ose 5.1% e kërkesave për informacion të adresuara nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse. Në krahasim me vitin 2015, shkrerat drejtuar institucioneve janë rritur nga 2857 në 3053 kërkesa për vitin 2016.

Gjatë vitit 2016, risi ishte funksionimi me kohë të plotë **i zyrave rajonale në 7 prej qendrave më të mëdha administrative**, nga veriu në jug të vendit dhe konkretisht në bashkitë Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Pogradec, Sarandë dhe Dropull. Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit janë pika të rëndësishme kontakti me qytetarët për marrjen e ankesave por njëkohësisht prania e tyre në këto rajone, ka ngushtuar distancën dhe ka afruar institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve.

Gjatë vitit 2016, zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar efikasitet, referuar promovimit të këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë. Një indikator matës që tregon rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra, është numri i ankesave gjithmonë në rritje që në fund të vitit 2016 rezulton të përbëje rreth **35%** të numrit total të ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit të kenë ardhur nga zyrat rajonale.

Përfaqësuesit e Zyrave Rajonale kanë mundësuar për qytetarët këshillimin ligjor dhe orientimin mbi rrugët që duhet të ndjekin për të kërkuar zgjidhjen e problemeve të tyre, do të veçonim: a) ankesat për largime të padrejta nga puna; b) kërkesë për punësim c) mungesë e shërbimeve nga pushteti vendor d) çështje në proces gjyqësor.

Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2016 ka vijuar punën edhe në një *sërë shërbimesh online* në interes të qytetarëve që kanë mundësi aksesit në internet, për të kryer plotësimin e ankesave on-line si dhe adresave zyrtare në rrjetet sociale Facebook dhe Tëiter, si dhe numrit të telefonit të publikut **0689034648** i cili qëndron hapur gjatë 24 orëve, si dhe numrit jeshil **0800 1111**.

Organizimi i “Ditëve të Hapura” nga Avokati i Popullit, komisionerët dhe stafi i institucionit, janë kthyer në një traditë të suksesshme në marrëdhëniet e Institucionit të Avokatit të Popullit me qytetarët, me administratën e pushtetit vendor, drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, si dhe me përfaqësuesit dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel lokal.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë mendime dhe sugjerime i ftuar ose me iniciativën e tij për raporte, projektligje, strategji të cilat janë diskutuar paraprakisht në grupe pune. Gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë proaktive dhe me kërkesë të disa institucioneve vendimmarrëse ka dhënë mendimet dhe sugjerimet e tij lidhur me një sërë projekt ligjesh dhe aktesh të tjera në proces miratimi, si për strehimin, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për të drejtat e fëmijëve, për shërbimet e kujdesit shoqëror, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2016 ka përgatitur 5 raporte të veçanta të cilat pasi janë hartuar, diskutuar me grupet e interesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë depozituar në Kuvendin e Shqipërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit depozitoi 3 kërkesa në Gjykatën Kushtetuese lidhur me 3 ligje, për testimin e punonjësve të shërbimit civil, për ligjin për trajtimin e pronës, dhe për një interpretim të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shpronësimin dhe interesin publik.

Në kuadër të mbështetjes dhe të Projektit Danez, Institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi një sërë aktivitete sensibilizuese, informuese dhe promovuese, konkretisht 7 auditoriume, 4 trajnime për pushtetin vendor, raporte studimore, tryeza të rrumbullakëta me shoqërinë civile, organizimin e ditëve të hapura, botimi i Revistës mujore, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2016 vazhdoi të luajë një rol proaktiv në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe median duke i konsideruar si partnerë tepër të rëndësishëm në punën e tij.

Në shtator të vitit 2016, u realizua një aktivitet ndërkombëtar tepër i rëndësishëm lidhur me flukset migratore dhe të drejtat e tyre. Pikërisht në datat 7 – 8 shtator 2016, institucioni ynë, në bashkëpunim me Shoqatën e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Mesdheut (AOM), Shoqatën e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF), Federatën e Ombudsmanëve të vendeve Ibero – Amerikane (FIO) dhe Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), organizuan për dy ditë me rradhë konferencën e nivelit të lartë “Sfidat e Institucioneve të Ombudsmanit përballë flukseve të përziera migratore”. Znj. Kate Gilmore - zv.Komisionere e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, solli në konferencë mesazhet e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve, të cilat janë para së gjithash dhe mbi të gjitha të drejta të njeriut. Konferenca ndërkombëtare u pasua në një deklaratë të përbashkët, e cila u bë e njohur me emrin **“Deklarata e Tiranës për Migracionin”**.

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit miratoi Rregulloren e Re të institucionit të përgatitur në bashkëpunim me Komisionerët, në përshtatje me ndryshimet e reja legjislative ashtu si dhe në përputhje me metodologjinë e punës, me rregullimet që kanë bërë ndër vite urdhërat e brendshëm, përshtatje me strukturën e re të stafit, etj.

Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare organizon cdo vit një veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Kjo Konferencë është kthyer tashmë në një traditë që mirëpritet si nga shoqëria civile, ashtu edhe nga institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë. Në zbatim të këtij detyrimi, në datën 14 dhjetor 2016, në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, u organizua Konferenca Kombëtare me temë “Ndërthurja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Drejtave të Njeriut – Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në implementimin e tyre”.

Më konkretisht, puna e institucionit të Avokatit të Popullit sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare ka konsistuar në:

Lidhur me strukturën dhe buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit, me miratimin e ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2016”, numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionin e Avokatit të Popullit shkoi nga 51 në 55, ku përfshihej shtimi i numrit të dy komisionerëve (1(një) Komisioner për Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe 1(një) Komisioner në Mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimin të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, si dhe miratimin e dy pozicioneve të reja si pjesë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve.

Një problematikë që ka hasur institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2016 e në vazhdim, është pamundësia e përzgjedhjes së kandidatave për Komisioner pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Kjo për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të kandidatave, gjë që ka krijuar në vazhdimësi një pengesë serioze në përzgjedhjen dhe plotësimin e vendeve vakante për Komisioner. Në gjykimin tonë, kjo problematikë vjen si pasojë e ndryshimeve të ndodhura me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014, të cilat prekën edhe mënyrën e përzgjedhjes së Komisionerëve dhe që në vetvete kanë çenuar edhe funksionimin normal të institucionit.

Pavarësisht sa më sipër, në respekt të nenit 31/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, është rishpalluar në mënyrë të përsëritur, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe shpërndarjes të njoftimit pranë rrjetit të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut apo dhe fakulteteve të Drejtësisë, njoftimi për këto pozicione vakante.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë permanente, ka njoftuar Kuvendin e Shqipërisë për pengesat dhe arsyet e mosrealizimit me sukses të këtij procesi, duke qenë të hapur për çdo sugjerim të mundshëm që mund të ofrohej nga Kuvendi i Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e këtij procesi dhe realizimin e tij në një kohë sa më të shpejtë.

Duke marrë në konsideratë arsyet e dështimit të vazhdueshëm të realizimit në praktikë të procesit të përzgjedhjes, gjykojmë si të nevojshme vlerësimin e mundësisë të ndryshimit të mënyrës së përzgjedhjes së kandidatëve për Komisioner, përmes marrjes së nismave përkatëse ligjore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, mbetet i hapur për të qenë kontributor në ofrimin e zgjidhjeve ligjore, të cilat do të mundësonin lehtësimin e procesit të përzgjedhjes së Komisionerëve dhe shmangien e problematikave të cilat janë bërë pengesë, për realizimin me sukses të këtij procesi.

Si më poshtë një përmbledhje ekzekutive lidhur me problematikat e lirive dhe të drejtave të rezultuara nga trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave dhe i kërkesave të qytetarëve.

Reforma në Drejtësi

Avokati i Popullit ka ndjekur në vazhdimësi procesin e hartimit të reformës në drejtësi dhe paketës ligjore që e ka shoqëruar atë. Institucioni ynë është shprehur i gatshëm për të kontribuar në mënyrë aktive me komente dhe sugjerime, ndërkohë që muajt e fundit, ka treguar gjithë angazhimin e tij për zbatimin me përgjegjshmëri dhe pavarësi të të gjitha përgjegjësive ligjore të parashikuara në paketën e ligjeve të Reformës në Drejtësi për procesin e rivlerësimit kalimtar, për hedhjen e shortit të KED-së, si dhe për ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Bazuar në ligjin nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” - i ndryshuar, përcaktohet se përveç detyrave që i ngarkohen nga ky ligj organik, Avokati i Popullit kryen edhe detyra të përcaktuara në ligje të tjera në fuqi. Më konkretisht, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” si dhe ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar kompetencat që i ngarkohen nga këto ligje dhe më specifikisht: Për verifikimin dhe listimin e kandidatëve që kanë shprehur interesin për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht për Anëtar të Komisionit; Gjyqtar i Kolegjit të Apelimit, si dhe Komisionerit Publik.

Në bashkëpunim të ngushtë dhe monitorim të pandërprerë nga ana e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Avokati i Popullit ka kryer të gjithë procesin që i ngarkohet si kompetencë dhe përgjegjësi ligjore nga ligji nr.84/2016. Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit në këtë kuadër është vlerësuar maksimalisht si në letren e zj. Genoveva Ruiz Calavera të datës 06.04.2017, ashtu edhe në qëndrimet zyrtare të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, ka filluar procedurat dhe është në ndjekje të tyre sa i takon verifikimit të plotësisht të kushteve ligjore dhe listimit të kandidatëve që kanë shprehur interes qoftë nga rradhët e Avokatisë apo Shoqërisë Civile, për anëtarët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Avokati i Popullit në përputhje me nenin 284 pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka monitoruar procesin e zgjedhjes së Anëtarëve të Përkohshëm të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe ka hartuar një raport monitorimi mbi shortin e hedhur për përzgjedhjen e këtyre anëtarëve duke ja përcjellë më tej Kuvendit të Shqipërisë.

Avokati i Popullit duke vlerësuar Reformën në Drejtësi si reformën më të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin cilësor demokratik të jetës shoqërore si dhe vetë demokracisë në vend, ka konsideruar maksimalisht mbarëvajtjen e proceseve që legjislativi në fuqi i ngarkon si përgjegjësi, duke bërë thirrje për një pjesëmarrje dhe mbështetje sa më të gjerë të të gjithë aktorëve dhe faktorëve që ndikojnë pozitivisht në gjithë këtë proces.

Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët. Një sërë çështjesh që shtetasit adresojnë janë pikërisht ato që lidhen me organet e gjyqësorit dhe të prokurorisë, për shkak të një sërë problematikave si korrupsioni, mungesa e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit, vendime të

padrejta, procese gjyqimi të tejzgjatura, mungesa e respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, etj.

Ne mbetemi të mendimit se pa një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të drejtë, Shqipëria nuk do të ndërtojë dot një ekonomi konkurrense që garanton investimet e brendshme dhe të huaja, një politikë të pastër, një jetë të sigurtë për qytetarët e saj, Shtetin e së Drejtës.

E drejta e pronës

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, edhe gjatë vitit 2016 i ka kushtuar vëmendje trajtimit të çështjes së pronave. Situata juridike e parashikuar në ligjin lidhur me trajtimin e së drejtës të pronës është vlerësuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit jo në përputhje me disa parime kushtetuese, vlerësim i cili është pranuar prej Gjykatës Kushtetuese me rastin e dhënies së Vendimit datë 09.11.2016, sipas të cilit është vendosur për shfuqizimin e pikës 3 dhe 5 të nenit 6 të këtij Ligji.

Mosekzekutimi deri më sot i 26 mijë vendimeve të dhëna në vite, me të drejtë kompesimi të pronës së njohur, si dhe mospërfundimi i shqyrtimit të 11 mijë kërkesave të administruara, gjithashtu në vite, nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës (ATP), është tregues i cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe mosrespektim i së drejtës të pronësisë së individit në një afat të arsyeshëm.

Gjithashtu, nga një sërë ankesash është evidentuar mosdërgimi i akteve, vendimeve të prodhuara në vite prej, Agjencisë së Trajtimit të Pronës, dhe jo vetëm, pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas të cilave është vendosur për fitimin njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë. Kjo ka bërë që procesi i regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku ndodhen, të mos ketë përfundur ende sot e kësaj dite.

Vazhdojnë ende të mbeten problematike, mosdorëzimi i vlerës së shpronësimit të pronës, me rastin e daljes së aktit për shpronësim nga ana e pushtetit vendor; mosushtrim i autoritetit ose kontrollit për zbatimin e legjislacionit nga ZRPP ose Ministria e Drejtësisë, duke sjellë kështu praktika dhe zbatim të ndryshëm të legjislacionit në fuqi.

Organet e qeverisjes vendore

Qeverisja Vendore është një nga fushat kryesore të angazhimit publik të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur rol proaktiv si një element thelbësor për një qeverisje të mirë, në mbrojtjen e individit kundër abuzimeve administrative, si dhe forcimin e besimit të publikut në shërbimet që ofron pushteti në nivel vendor dhe rajonal.

Aspekt i rëndësishëm në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, ka qenë ndjekja nga afër e zbatimit të reformës së re administrative dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit nga organet e qeverisjes vendore.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të rregjistruara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit prej 2565 ankesa, rezultojnë se, 555 ankesa janë adresuar ndaj instiucioneve në nivel qarku dhe organeve të Njësisë të Qeverisjes Vendore, të ndara sipas numrit më të madh dhe të drejtave ato paraqiten: për të drejtën e pronësisë; për zgjidhjen e problemit të strehimit; për papunësinë, zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të punonjësve të administratës të pushtetit vendor; për ndërprerjen e ndihmës ekonomike; për mjedis të shëndetshëm; për të drejtat e fëmijëve; për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë personat me aftësi të kufizuar, si dhe një numër i konsiderueshëm i ankesave që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve publike nga bashkitë, mungesën e investimeve në infrastrukturë etj.,

Numrin më të madh të ankesave, e zënë ato për çështjet e pronësisë, objekti i tyre ka të bëjë me veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të qeverisjes vendore, si

dhe KV pranë Prefektit të Qarkut, në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për vlefshmëri të ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Problematika të tjera të evidentuara janë lidhur me zvarritjet e procedurave për konfirmimin tekniko – ligjor dhe plotësimin në kohë të mangësive të konstatuara nga ZVRPP-të në dosjet e subjekteve, zvarritje të kërkesave të individëve nga organet e qeverisjes vendore për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, etj.

Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor

Gjatë vitit 2016 nga institucioni i Avokatit të Popullit, janë trajtuar 200 ankesa të paraqitura nga shtetasit për veprime ose mosveprime të padrejta dhe të paligjshme ndaj organit të akuzës dhe ndaj Gjykatave të të gjitha shkallëve.

Problematika e ankesave të ardhura për shqyrtim në institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë e ndryshme, kryesisht për shkelje të ndryshme të procesit të rregullt ligjor, për ***zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore*** si për çështjet penale ashtu edhe për çështjet civile. Ankesa kanë ardhur edhe ***ndaj vendimeve gjyqësore*** duke ngritur pretendime të ndryshme dhe duke kërkuar nga institucioni ynë prishjen e tyre nga Gjykatat e Apelit apo Gjykata e Lartë, kërkohet që shtetasit të mbrohen nga institucioni ynë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë me arsyetim se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike për të zgjedhur vet një avokat privat për mbrojtje. Duke analizuar rastet e trajtuara nga ana jonë rezultojnë se ankesa kanë ardhur gjithashtu nga persona të tjerë ***të gjykuar dhe të dënuar penalisht në mungesë*** nga Gjykata për vepra të ndryshme penale, duke pretenduar se nga Gjykatat janë kryer dhe lejuar shkelje të ndryshme procedurale në lidhje me njoftimet nga organet e procedimit dhe të gjykimit, etj.

Problematika janë evidentuar edhe në rastet e dënimit të shtetasve për veprat penale të armëmbajtjes pa leje, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila shfuqizoi nenet 55/2 dhe 278/5 dhe 6. Për këtë arsye Avokati i Popullit rekomandoi plotësimin e vakumit ligjor të krijuar.

Ankesa të ndryshme kanë ardhur edhe për një proces të rregullt ligjor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, për të cilat sipas rasteve Avokati i Popullit ka bërë rekomandimet përkatëse.

Në vendin tonë ka një perceptim të gjerë se ***sistemi i drejtësisë është prekur nga fenomeni i korrupsionit dhe ndikimi politik në dhënien e drejtësisë***. Fenomeni i korrupsionit, mungesa e praktikave transparente, tejzgjatja e proceseve gjyqësore, apo mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kanë ndikuar negativisht në perceptimin negativ të publikut ndaj transparencës së gjyqësorit, si dhe ndaj dhënies së drejtësisë në mënyrë profesionale dhe në kohë.

Administrata publike dhe mbrojtja e të drejtës së punës

Reforma në Administratën Publike vijon të mbetet një prej prioritetëve të punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Përmirësimi dhe thellimi i demokracisë në shoqërinë shqiptare, forcimi i demokracisë institucionale, rritja e nivelit të qeverisjes, kërkon që të gjitha institucionet e shtetit të marrin masat e nevojshme, të domosdoshme, institucionale e legjislative, të cilat do të garantojnë në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme liritë, të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2016, kemi trajtuar në total **174 ankesa** me objekt largimet e padrejta nga puna, nga të cilat 44 raste kanë gjetur një zgjidhje pozitive në drejtim të pagesës së efekteve financiare për largime të padrejta nga puna apo në disa raste edhe në drejtim të rikthimit në vendin e mëparshëm të punës. Në 13 raste kemi hartuar edhe rekomandime për marrjen e masave dhe vënien në vend të të drejtës së shkelur ndaj kërkuesve.

Nga një numër ankesash ashtu sikundër kemi evidentuar edhe në raportet vjetore të mëparshme, ka vijuar të ketë ankesa lidhur me vendimet gjyqësore të dhëna në favor të ish-punonjësve, të cilat kanë vështirësi ekzekutimi veçanërisht në rastet kur gjykata është shprehur me vendim për rikthim në detyrë të nëpunësit, për të cilat janë adresuar rekomandimet përkatëse.

Gjithashtu, reformimi i sistemit të shëndetësisë, ka sjellë një numër të konsiderueshëm ankesash lidhur me largimet nga puna, kryesisht në personelin mbështetës, sanitarë, sektorin hotelieri e mbështetës dhe më pak në sektor ndihmës mjekësor nëpër Spitalet Rajonale në vend. Avokati i Popullit në këtë rast i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë marrjen e masave për zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Një çështje tepër e rëndësishme, për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit është investuar gjatë vitit 2016, është testimi i punonjësve të shërbimit civil. Në zbatim të ndryshimeve të nenit 62 të ligjit “Për nëpunësin civil”, është miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civile për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë.

Në gjykimin tonë testimi nuk është mënyra e vetme për fotografimin dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave që ka sot administrata publike. Të gjithë punonjësit e administratës publike kanë për detyrë dhe duhet të kenë fokus qytetarët, me qëllim sigurimin e efektshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë tek çdo nëpunës, pjesë e administratës publike. Një proces i tillë i testimit do të ishte i kundraligjshëm dhe në shkelje të të drejtave të njeriut dhe bie ndesh me një ndër parimet kryesore sikundër është ai i “*sigurisë juridike*”, fakt për të cilin në muajin Mars 2016, kemi paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në të cilën kemi kërkuar: Pezullimin e zbatimit të VKM dhe të nenit 62 të ligjit, si dhe shfuqizimin e tyre si të papajtueshme me Kushtetutën. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën tonë me vendimin nr. 70, datë 07.07.2016.

Që herët gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, marrjen e iniciativës ligjore për hartimin dhe miratimin e një Kodi Evropian të sjelljes së mirë administrative. Por ky rekomandim është refuzuar.

Gjithashtu, në kuadër të numrit të lartë të ankesave për largime nga puna në njësitë e pushtetit vendor, Institucioni i Avokatit të Popullit mori informacion nga 51 Bashki (nga 61 në total), si dhe hartoi një raport të veçantë me të gjithë problematikat që lidhen me zbatimin e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve nga çdo organ i Njësive të Qeverisjes Vendore. Ka rezultuar se janë larguar në total 3059 punonjës, prej të cilëve 319 janë nëpunës civil ose 11% e punonjësve dhe 2740 janë punonjës marrëdhëniet e punës të të cilëve janë rregulluar sipas Kodit të Punës

E drejta e sigurimeve shoqërore

Gjatë vitit 2016 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë depozituar dhe trajtuar 152 ankesa lidhur me të drejtën e përfitimit nga sigurimet shoqërore. Kanë përfunduar shqyrtimin 122 ankesa, ndërkohë që janë në proces shqyrtimi 32 ankesa.

Qytetarët janë ankuar për mosllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, mosnjohjen si periudhë sigurimi të viteve të dënimit me burg ordiner, mospërfitim të kompensimit financiar të energjisë elektrike, mosmarrje përgjigje për kërkesat për pension pleqërie, ulje të masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, mosdhënie të pensionit të posaçëm shtetëror, kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit etj. Në disa raste Avokati i Popullit ka reaguar me rekomandimet përkatëse.

Një nga problematikat e shqyrtuara, që ka patur një numër ankesash si individualisht ashtu edhe në grup, ka qenë ajo e ndërprerjes së pensionit të pleqërisë të punjonjësve që kanë punuar në miniera dhe nxjerrjen debitorë të tyre. Për këtë rast, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Drejtorit të përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për dërgimin e një infomacioni të detajuar lidhur me trajtimin e kësaj problematike tepër imediate dhe kemi sugjeruar faljen e detyrimeve për to, për vetë kushtet specifike në të cilat ndodhet kjo kategori, për të cilën ende nuk kemi një përgjigje.

Strehimi

Gjatë vitit 2016, institucioni i Avokatit të Popullit, ka luajtur rol proaktiv në përcjelljen e mendimeve dhe komenteve për draft-ligjin e ri “*Për Strehimin Social të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe përfshirjen institucionale në të gjithë procesin e konsultimit me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe me aktorë të tjerë në këtë proces, duke filluar që në muajin Shkurt 2016. Vlen për t'u përmendur fakti që të gjithë mendimet dhe komentet e institucionit të Avokatit të Popullit janë përfshirë tashmë në draft-ligjin e ri, i cili së fundi u miratua në Këshillin e Ministrave dhe shpresojmë sa më shpejt finalizimin e tij edhe nga Parlamenti i Shqipërisë.

Dëshirojmë të përmendim përfshirjen në këtë draft-ligj të rekomandimit për njësitë e qeverisjeve vendore që duhet të parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre që, jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit Rom, si dhe hartimin e programeve të reja të strehimit, nëpërmjet dhënies së një bonusi qiraje të financuara 100% nga njësitë përkatëse, për të gjitha familjet përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe pa të ardhura financiare.

Përgjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar në total **144 ankesa** individuale, me objekt mospërbushjen nga ana e organeve përgjegjëse, të objektivës sociale të strehimit, kundrejt familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehit. Në 11 raste kemi adresuar rekomandime drejtuar njësitë të qeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për realizimin e objektivës së strehimit, me qëllim përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave, apo vendstrehimeve alternative, veçanërisht për grupet e cenueshme dhe në pamundësi ekonomike.

Problematikat më të theksuara të evidentuara nga Avokati i Popullit lidhur me strehimin janë: mungesa e zgjidhjes ndaj personave të pastrehë, të cilët janë të varfër dhe nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e pjesës së pasubvencionuar nga pushteti vendor, ose kreditë e buta; strehimi i personave të komunitetit rom të cilat në disa raste janë zhvendosur me forcë nga qendrat e vendbanimit të tyre; zvarritja e procedurave nga strukturat shtetërore, etj.

Mbrojtja e konsumatorit

Për vitin 2016, pranë institucionit tonë janë adresuar **në total 249 ankesa**, të cilat lidhen kryesisht me mbifaturime nga operatorë që ofrojnë shërbime publike (*OSHEE apo Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizime sh.a*) ose edhe me cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre.

Sikundër kemi evidentuar edhe vitin e kaluar një fokus të veçantë kanë marrë ankesat e konsumatorëve familjarë në vështirësi dhe pamundësi ekonomike për pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike, familje të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie, familjet me anëtarë të moshuar pensionistë; familje të komunitetit rom, apo familjet e tjera me individë të papunë, punëkërkues, dhe të përjashtuar edhe nga skema e ndihmës ekonomike.

Disa nga problematikat që janë evidentuar gjatë vitit 2016 janë: mospërfshirja në VKM të disa kategorive që përfitojnë kompensimin me heqjen e fashës për konsumin e energjisë elektrike; ndotjen e ujit të pijshëm në disa zona rurale të Korcës dhe Delvinës; problematika e mbartur ndër vite lidhur me mosrespektimin e kontratës tip të energjisë elektrike nga OSHEE; lidhur me sinjalistikën dhe ndriçimin në rrugë e cila ka qenë në të shumtën e rasteve burim aksidentesh, etj.

E drejta për arsim

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 97 ankesa në fushën e arsimit në përgjithësi. Nga këto, 7 kanë qenë raste me iniciativë të trajtuara nga ana jonë. Nga numri i ankesave të marra në total, për 90 ankesa ka përfunduar shqyrtimi dhe 7 janë ende në shqyrtim.

Problematikat kryesore që ka trajtuar institucioni ynë lidhur me fushën e arsimit kanë qenë të ndryshme, por ato që kanë spikatur më shumë kanë qenë mungesa e mësuesve ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta, kërkesat për punësim, largimet e padrejta, emërimet pa transparencë, segregimi i fëmijëve romë në shkolla të posaçme në Elbasan, mungesa ose pamjaftueshmëria e psikologëve në shkolla etj.

Një nga ankesat dhe problematikë e rëndësishme e një komuniteti të madh fëmijësh është çështja e ngritur nga Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi të cilët ngritën problematikën që: MAS duhet të marrë masa më efektive për zbatimin e Ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, e më konkretisht të nenit 64 pikat 3, 4 dhe 6 sepse ende komisionet nuk arrijnë të vlerësojnë gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në rajonin që mbulon njësitë arsimore vendore, për shkak të kohës së kufizuar që kanë për këtë qëllim.

Gjithashtu, kemi evidentuar se situata e fëmijëve që i përkasin komunitetit romë dhe egjiptian, duke ndjekur klasat e shansit të dytë përbën një shkëlqje të të drejtës së tyre për t’u arsimuar, në një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor, për të cilën kemi adresuar rekomandimin përkatës drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

E drejta për kujdes shëndetësor

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim **92 ankesa në fushën e shëndetësisë në përgjithësi**. Objekti i ankesave kanë qenë zvarritje trajtimi mjekësor për shkak të fluksit në QSUT, kërkesa për kurim jashtë vendit, ankesa për mungesa në medikamente kryesisht në spitalin onkologjik në QSUT, ankesa për mospërfshirje në listat e rimbursimit të medikamenteve kryesisht të moshës së tretë, largime nga puna për shkak të reformës në shëndetësi, mungesë e infrastrukturës, etj. Nga numri i ankesave të marra në total për 85 ankesa ka përfunduar shqyrtimi, ndërsa 7 të tjera janë në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara 40 ankesa janë zgjidhur në favor të qytetarit. Një rast i trajtuar me iniciativë nga institucioni ynë, ka qenë edhe mungesa e skemave të mjekimit për pacientët me HIV-AIDS. Numri i të sëmurëve është i lartë, mbi 700 pacientë të cilët rrezikojnë edhe jetën nga mungesa e paketës së medikamenteve “Antri Rentro Viraleve”. Në përgjigjen e saj drejtorja e QSUT-së sqaron se në bashkëpunim me UNICEF ka filluar furnizimi duke pritur në vijimësi zgjidhje përfundimtare.

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit ka trajtuar dhe ankesën e Shoqatës së fëmijëve dhe të rinjve me diabet, për të cilën i ka kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë zgjidhjen e problematikave të ngritura nga shoqata. Në përgjigjen e saj MSH ja delegoj për zgjidhje Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, si organ kompetent për zgjidhjen e kësaj problematike.

Të drejtat e minoriteteve

Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të vazhdueshme ka adresuar rekomandimin mbi nevojën e plotësimit të kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”.

Aktualisht, mbas punës së grupit ndërinstitucional të ngritur për këtë qëllim, është arritur në hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të bazuar në kontributet e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të sipërcituar, me konsulencën përkatëse edhe të ekspertëve të Këshillit të Europës.

Ky projektligj është një zhvillim pozitiv dhe përfaqëson ndërmarrjen e një nisme të domosdoshme për plotësimin e kuadrit rregullativ ligjor, për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji dhe nisur nga përmbajtja e dispozitave të draftit të paraqitur për të, Avokati i Popullit ka dhënë mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse.

Një ndër raportet e posaçme që Avokati i Popullit ka depozituar pranë Parlamentit Shqiptar, në muajt e parë të vitit 2015 (ende i padiskutuar), është raporti që ka të bëjë me të drejtat e minoriteteve në vend. Çështjet e trajtuara në këtë raport vazhdojnë të mbeten aktuale edhe gjatë vitit 2016. Konkretisht si, nevoja e miratimit të një ligji ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve në përputhje me parashikimet e Konventës kuadër të KiE-së; përmirësimin e kuadrit të ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, fillimin dhe përfundimin e procesit për ratifikimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare; krijimin e kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe komunitetet e tjera, zhvillimin e një censusi mbi bazën e kriterëve dhe standarteve më të mira ndërkombëtare, etj.

Të drejtat e fëmijëve

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve funksionon tashmë, pas rekrutimit të dy ndihmëskomisionerëve me focus kryesor studimin e legjislationit lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijës, si dhe promovimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe të gjithë aktorëve për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2016, ka inspektuar 9 institucione publike të përkujdesit rezidencial për fëmijë. Nga inspektimet e bëra në këto qendra rezultoi se ndaj fëmijëve të institucionalizuar ka pasur raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga stafi dhe zyrtarët përgjegjës për mirëqenien e tyre. Ndaj nga ana e institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore është e nevojshme kryerja e reformave institucionale për përmirësimin e situatës së trajtimit të fëmijëve që rriten nën mbrojtjen e shtetit. Është domosdoshmëri që në këtë proces të përfshihen edhe organizata të shoqërisë civile që kanë mjaftueshëm eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Gjatë vitit 2016, janë kryer një sërë inspektimesh në Institucionet Publike të Përkujdesjes Rezidenciale për Fëmijët në Shtëpi Fëmije dhe Shtëpi Foshnje, në rezultat të të cilave Avokati i Popullit ka nxjerrë dhe rekomandim drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, për hetim të mëtejshëm të çështjeve për të cilat është kryer hetim i pavarur administrativ nga ana e institucionit.

Rekomandimet përkatëse për këto institucione janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë me Raportin e Veçantë “Mbi Nivelin e Respektimit të të Drejtave të Fëmijëve në Institucionet Publike të Përkujdesjes Rezidenciale për Fëmijët në Shtëpi Fëmije dhe Shtëpi Foshnje”

Të drejtat e grave

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit ka patur në vëmendje të veçantë të drejtat e grave, të cilave i ka kushtuar vëmendje jo vetëm në trajtimin e ankesave dhe problematikave të paraqitura, por gjithashtu edhe në përgatitjen e një raporti hije për respektimin e të drejtave të grave.

Në Sesionin e 64 të Komitetit të Eleminimit të Diskriminimit ndaj Grave të OKB u shqyrtua raporti i 4 periodik i Shqipërisë. Avokati i Popullit paraqiti për herë të parë raportin hije për Konventën CEDAE. Komiteti i ka rekomanduar Shtetit Shqiptar të vijojë forcimin e mbështetjes për Avokatin e Popullit, duke i siguruar burimet e nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare me qëllimin e forcimit të vazhdueshëm të funksionit të monitorimit të pavarur, si dhe të sigurimit që rekomandimet e veçanërisht ato që synojnë nxitjen e barazisë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit mbi bazë seksi ose me bazë gjinore, kanë dhënë efektin e duhur.

Një numër i madh i problemeve e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit në Raportin e tij për CEDAE, janë përfshirë në “Vërejtjet përmbyllëse” që ky komitet ka lënë për Shqipërinë, e që do të përbëjnë prioritetet strategjike të punës edhe për Institucionin tonë. Avokati i Popullit ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me UN EOMEN, në përgatitjen dhe lançimin e këtij raporti, si dhe detajimin më pas të një plani pune për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit CEDAE nga shteti shqiptar.

Gjithashtu Avokati i Popullit, ka filluar të evidentojë nëpërmjet statistikave, numrin e grave që i drejtohen institucionit me ankesë/kërkesë, si dhe evidentimin e problematikave që paraqesin ankesat e tyre. Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara (*ankesa, kërkesa, njoftime, inspektime dhe raste me iniciativë*) për vitin 2016 **rezultojnë 652 gra**. Këtu nuk përfshihen rastet të cilat janë këshilluar e që kanë marrë përgjigje drejtpërdrejt nga Drejtoria e Marëdhënieve me qytetarin.

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Gjatë vitit 2016 janë depozituar dhe trajtuar 72 ankesa për këtë kategori. Janë evidentuar një sërë problematikash për personat me aftësi të kufizuar dhe më konkretisht;

- Mungesa e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara. Ndërtesat publike dhe private ashtu si dhe infrastruktura rrugore duhet të jenë të aksesueshme për këto kategori personash, me qëllim që të mos cënohen të drejtat e tyre dhe të ndihen të barabartë me pjesën tjetër të popullsisë. Godinat e reja ose ato të konstruara nuk janë përshtatur, duke shkelur në mënyrë flagrante ligjet e posacme, urdhërat dhe udhëzimet për përshtatshmërinë si dhe kushtet ligjore të dhënies së lejes së ndërtimit. E njëjta situatë është edhe me rrugët urbane dhe rurale.

- Një problematike e ngritur nga disa studentë, të cilët gëzojnë Statusin e të Verbërit dhe ndjekin arsimin e lartë, është **mospërrjashtimi nga pagesa e tarifës shkollore, në një kohë që parashikohet ndryshe në VKM**. Për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe sportit me qëllim përjashtimin nga tarifa shkollore të studentëve të cilët gëzojnë “Statusin e të verbrit” si dhe saktësimin e terminologjisë për statuset e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e akteve të tjera nënligjore

- Një nga problematikat e shqyrtuara ka të bëjë me **kompensimin financiar të personave me aftësi të kufizuar** sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431 datë 08.06.2016 “*Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot* . Gjykojmë se nuk ka pse të lidhet llogaritja e pagesës së aftësisë së kufizuar duke marrë për bazë masën e pensionit social dhe për këtë arsye kemi adresuar një rekomandim Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe rinisë.

- Vazhdojnë të mbeten problematike mungesa e saktësisimit të terminologjisë së përkthyer të Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, konkretisht të nenit 29 dhe 32, lidhur me organizatat e personave me aftësi të kufizuar; lidhur me të drejtën për të përfituar rimbursim për shpenzim në blerjen e vajrave dhe karburantit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, mungesa e rimbursimit të biletës, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin, mungesa e aksesit në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, mosngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore, etj

Të drejtat e komunitetit LGBTI

Komuniteti LGBTI has vështirësi në jetën e përditshme dhe kufizime të të drejtave themelore, të cilat parimisht duhet të gëzohen nga të gjithë qeniet njerëzore pa dallim. Si një vlerësim parësor mbetet ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit në lidhje me çështjen LGBTI. Në Shqipëri personat LGBTI nuk gëzojnë të drejtën e martesës, të bashkëjetesës së njohur ligjërisht, unioneve civile etj. Në rekomandimin e Avokatit të Popullit të datës 22.09.2015, dërguar Ministrin të Drejtësisë, janë kërkuar disa ndryshime në Ligjin nr.9062, Datë 05.08.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”, dhe më konkretisht ndryshimin e neneve 163 dhe 164 në lidhje me “Bashkëjetesën midis dy personave të të njëjtit seks, si dhe kushtet dhe procedurat e regjistrimit, pasojat e regjistrimit, dhe mënyrat e përfundimit të bashkëjetesës dhe marrëdhëniet personale e pasurore ndërmjet bashkëjetuesve, të cilat rregullohen me ligj të veçantë”, e cila vazhdon të jetë një problematikë e pazgjidhur.

Gjatë vitit 2016, Organizatat Kombëtare të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI, në takimet me Avokatin e Popullit ndër problematikat e tjera ngritën dhe shqetësimin në lidhje me çështjen e njohjes së identitetit gjinor.

Vlen për t’u përsëritur nisma e marrë për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 25 Maj 2016, për të cilën Avokati i Popullit ka dhënë mendime në procesin e hartimit të saj.

Mosha e tretë

Nuk është miratuar ende projektligji: “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësisimit të nevojave për moshën e tretë”, të cilën Avokati i Popullit e ka ngritur vit pas viti. Këtë vit Ministria e Mirëqënies Sociale dhe e Rinisë në përgjigjen e kthyer, e konsideronte të mjaftueshme përfshirjen e të moshuarve në disa legjislacione të ndryshme, por pavarësisht kësaj Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë ndërhyrjen në këtë drejtim. Problematikat janë nga më të ndryshmet, duket përfshirë të ardhurat minimale, mungesën e shërbimit të duhur shëndetësor, sidomos atyre që banojnë në zona rurale, masa të ulëta pensioni, si dhe duhet të ketë më shumë qendra rezidenciale dhe ditore për të moshuarit.

Çështja për shpërnguljen me forcë të komunitetit Rom

Një çështje shumë sensitive lidhur me problematikat që shqetësojnë komunitetet e ndryshme Rome në vend, është shpërngulja (dëbimet) me forcë nga vendqëndrimet e tyre komunitare, të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore, ku edhe kanë ndërtuar kryesisht baraka. Këto zhvendosje sikurse na rezultojnë janë situata të përsëritura që kanë ndodhur ndër vite. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme çështjen e zhvendosjes me forcë të komunitetit rom, të vendosur në zonën e liqenit artificial, Tiranë, për të cilën depozitoi dhe një raport të veçantë gjatë vitit 2016 në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2016, nëpërmjet ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit, jemi vënë në dijeni nga përfaqësues të komunitetit Rome të zonës së Sharrës, Tiranë, të vendosur në afërsi të vendit ku përpunohen mbetjet urbane të qytetit të Tiranës, për një paralajmërim verbal që, këtij komuniteti i është bërë për largimin nga ky vendqëndrim, nga punonjës të Bashkisë Tiranë. Shqetësimi i shprehur nga ky komunitet lidhej me faktin se, njoftimi verbal që ju ishte bërë nga ana e punonjësve të Bashkisë Tiranë, nuk iu jepte zgjidhje se çdo të ndodhte më pas me ta, sa i takon kushteve të tyre të jetesës dhe mundësisë për t'u strehuar qoftë edhe në një barakë si vendstrehim. Pas një monitorimi të kujdesshëm dhe kontakteve të vazhdueshme me banorë të komunitetit, si dhe me përfaqësues së Bashkisë Tiranë, rezultoi se çështja është në rrugën e zgjidhjes pas marrëveshjeve që Bashkia Tiranë ka bërë me këta të fundit, ose për trajtimin e tyre me një nga mënyrat e parashikuara nga ana e legjislacionit për trajtimin me bonuse për strehimin social, ose për rikthimin e tyre në vendbanimet e tyre “të origjinës”, duke konkluduar për këtë çështje me bashkitë e tjera në vend.

Një çështje tjetër e filluar me inisiativë është ajo e zhvendosjes së një komuniteti banorësh në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë, për shkak të zbatimit të një projekti për realizimin e një investimi publik, nga ana e Bashkisë Tiranë. Nga të dhënat paraprake të marra në terren nga ana jonë ka rezultuar se, ky komunitet ka patur rreth 72 familje Rome/Egjiptiane, me rreth 341 pjesarë, të cilat prekeshin nga zbatimi i projektit të sistemimit të shtratit të lumit, në zonën e Bregut të Lumit. Pjesa më e madhe e tyre jetonin prej shumë vitesh në këtë zonë në baraka, ndërsa pjesa tjetër jetonte në banesa një katëshe, pa cilësi ndërtimore.

Duke qënë së çështja kishte të bënte me një zhvendosje të detyrueshme të këtij komuniteti, për shkak të zbatimit të një projekti për ndërtimin e një veprë publike kemi theksuar në dy rekomandimet tona për këtë rast¹, se, sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Në përgjigje të rekomandimeve tona, Bashkia e Tiranës na ka informuar se kanë ndërtuar një plan ndërhyrjeje të detajuar për sistemin e familjeve. Por pavarësisht kësaj, kryefjala e rekomandimeve tona në këto raste mbetet zgjidhja përfundimtare në përputhje të plotë me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që komuniteteve Rome dhe jo vetëm, t'i ofrohen zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synojnë dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

Raste të ngjashme kanë ndodhur edhe në një lagje të qytetit të Korçës, për zhvendosjen e 17 familjeve rome, por zgjidhja që jepte Bashkia konsistonte vetëm tek bonus strehimi, një zgjidhje jo afatgjatë dhe jo në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Emigrantët, të huajt dhe të kthyerit

Në kontekstin e situatës së krizës të paprecedentë në hapësirën e gjerë të Mesdheut, si një situatë komplekse problematike dhe sfiduese në shumë aspekte, një rëndësi të veçantë merr trajtimi i funksionit të dyfishtë të Avokatit të Popullit, si mbrojtës dhe promotor i të drejtave të njeriut. Thelbi i punës dhe prioriteti përcaktues i aktivitetit të Avokatit të Popullit, në situatën e krizës së paprecedentë të migracionit, lidhet me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtresave të cënueshme dhe komuniteteve në risk. Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së ka kryer një sërë monitorimesh për masat dhe politikat që po ndërmerren për çështjet e emigracionit, kthimin e shtetasve shqiptarë pas emigrimit më të fundit në vendet e Evropës dhe riintegrimin e

¹ Nr.K1/I2-11 datë 14.06.2016

tyre, si dhe masat e ndërmarra dhe procedurat e azilit, për azilkërkuesit potencialë nga shtetet e tjera, zona aktuale të luftës, në vendin tonë.

Mbi bazën e monitorimeve dhe informacionit të autoriteteteve përgjegjëse shtetërore, kemi konstatuar mungesën e një strategjie kombëtare për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera të Europës, si dhe të një Plan-Veprimi zbatues.

Në tërësinë e rekomandimeve të përgatitura nga Avokati i Popullit për një qasje adekuate ndaj flukseve migratore veçojmë rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme dhe të nevojshme për trajtimin në përputhje me instrumentet kombëtare e ndërkombëtare të flukseve ekzistuese dhe atyre të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri. Ky rekomandim synon të përafrojë maksimalisht frymën ndërkombëtare të solidaritetit dhe standardeve të të drejtave të njeriut në trajtimin e situatës së krizës, me pritshmërinë e trajtimit të gjendjes potencialisht të ndodhshme në Shqipëri. Efektivisht, Shqipëria mbetet në një gjendje ende të papërgatitur në mënyrën e duhur.

Avokati i Popullit në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), nga monitorimi në vijëmbësi në Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe pikave të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin transit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare ka evidentuar një sërë problematikash. Nga inspektimet në qendrat e pritjes e të ndalimit, është vënë re që kapaciteti i tyre në hapësirë dhe në burime financiare e njerëzore është i pamjaftueshëm, jo vetëm për raste të flukseve masive, por edhe për raste të rritjes graduale të numrit të azilkërkuesve, apo të migrantëve të parregullt në një kohë të shkurtër.

Nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, si dhe në pikat e mundshme – kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin tranzit të migrantëve është konstatuar se ka shumë sfida që duhen tejkaluar – qoftë edhe në një kuadër emergjence, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit përgatiti edhe një Raport të veçantë, “Mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit për çështjen e migracionit”, dërguar Kuvendit të Shqipërisë ashtu si dhe paraprirja e tij me Konferencën Ndërkombëtare të zhvilluar në Tiranë mbi flukset migratore.

Të drejtat e personave të paraburgosur dhe të dënuar në I EVP-të dhe Institucionet e paraburgimit

Gjatë vitit 2016 janë paraqitur gjithsej 254 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 203 janë mbyllur dhe 51 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e mbyllura 149 kanë rezultuar të pabazuara në ligj dhe 54 janë zgjidhur në favor të ankesit gjatë shqyrtimit. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzim i kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritje e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritje e procedurës për t'u transferuar në një I EVP tjetër; transferim i padrejtë në një I EVP tjetër.

Nga inspektimet e realizuara nga MKPT, gjatë vitit 2016 është konstatuar se kushtet në disa institucione janë tejet të amortizuara, si psh në I EVP Zahari Krujë, I EVP Sarandë, Tepelenë, Kukës, etj, për të cilat Avokati i Popullit ka rekomanduar mbylljen e menjëhershme të tyre.

Gjithashtu, mbipopullimi mbetet përsëri një problematikë e sistemit tonë penitenciar, 15 – 20 % mbi kapacitet.

Mbetet përsëri e pazgjidhur situata e personave me masa mjekësore, me vendim gjykate, të cilët nuk duhet të qëndrojnë në institucionet penitenciare. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP Krujë etj, në kushte materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesit për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve vijon të mbetet i paligjshëm. Kjo situatë është reflektuar në një sërë rekomandimesh të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ka patur pretendime për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike, në disa I EVP, për të cilat nga pas verifikimeve nga institucioni ynë, i është rekomanduar Prokurorisë fillimi i ndjekjes penale. Gjithashtu, janë evidentuar vonesa dhe mangësi në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me libreza shëndetësore, apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.

Vazhdojnë të mbeten problematike pajisja me produkte bazë të higjenes personale, detergjenteve, etj.

Të drejtat e personave të ndaluar dhe të shoqëruar në organet e policisë

Gjatë vitit 2016 në Institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 163 ankesa, ndaj organit të Policisë së Shtetit. Nëpërmjet ankesave qytetarët kanë paraqitur pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat, ose punonjësit e Policisë së Shtetit. Nga shqyrtimi i ankesave të administruara ka rezultuar se disa prej tyre kanë qenë të bazuara dhe konkretisht për ushtrim dhune fizike, për trajtim jo human, për arrestime ose shoqërime të paligjshme, për mosdhënie të kopjeve të procesverbaleve të kontrollit të banesave, të bllokimit të sendeve apo të dokumentacionit të shoqërimit, si dhe për mosmarrjen e kallëzimeve të bëra nga shtetasit.

Nga hetimi administrativ i rasteve për të cilat nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë provuar shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve kemi konstatuar se disa nga shkaqet e kryerjes së këtyre shkeljeve nga punonjësit e policisë janë mosnjohja e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit, si dhe neglizhenca për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës dhe misionit ligjor.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve, nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve, ndëshkimit dhe shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen.

Gjatë vitit 2016 i jemi drejtuar në 8 (tetë) raste Prokurorisë të Rretheve për fillimin e ndjekjeve penale për: 3 (tre) punonjës të Policisë së Shtetit, 4 (katër) punonjës të Policisë së Burgjeve dhe 1 (një) punonjës të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit.

E drejta për një mjedis të shëndetshëm

Institucioni i Avokatit i Popullit gjatë veprimtarisë së tij i ka kushtuar edhe gjatë vitit 2016 një fokus të veçantë zbatimit me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim që të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standarteve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.

Avokati i Popullit konstaton në vijimësi faktin se problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është edhe mungesa e ndëshkimit apo edhe gjobat mjaft të ulëta për ata individë apo subjekte që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit.

Avokati i Popullit konstaton sërish faktin se ka një sensibilizim në rritje të individëve për të kërkuar reagimin e institucioneve shtetërore për sa u përket çështjeve mjedisore.

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 49 çështje me iniciativë dhe ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë shprehur shqetësimin e tyre për cënim të së drejtës së tyre të ligjshme për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Nga çështjet e sipërcituara, rezulton se pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur për shqyrtim 33 ankesa nga individë apo grupe individësh të ndryshëm, ndërkohe që për 16 çështje Avokati i Popullit ka filluar shqyrtimin me iniciativë.

Në këtë kuadër mund të theksojmë çështjet e iniciuara lidhur me ndotjen alarmante për shkak të hedhjes së mbetjeve urbane dhe inerteve në lumin e Osumit, mungesën e infrastrukturës dhe ndikimit në mjedis për banorët e ish-Kënetës në Durrës, ndotja e mjedisit në fshatin Tapi/Ura Vajgurore, ndotjen e mjedisit nga ujërat e zeza në qytetin e Pogradecit, ndotja e liqenit të Fierzës nga mbetjet e ndryshme urbane, rrezikimi i shëndetit të banorëve të komunitetit rome në Shkodër, në afërsi të Urës së Bunës, si edhe ndotja e mjedisit në kampin e romëve në Shkozë, si pasojë e ndotjes së mjedisit përrreth zonës ku banojnë.

Lidhur me ushtrimin dhe përmbushjen brenda standardeve ligjore të së drejtës për ambient të shëndetshëm, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij të iniciativës për monitorimin e respektimit të standardeve mjedisore në 16 raste të ndryshme, duke konfirmuar në vijim rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së individit nëpërmjet fokusimit në çështjet e mjedisit në të cilin ata jetojnë.

Disa problematika të tjera në fushën e mjedisit janë ndotja e ajrit sidomos në qytetet më të mëdha, ndotja e ujërave në Shqipëri, mbledhja e mbeturinave dhe riciklimi i tyre, prerjet e pyjeve, antenat e telefonive celulare pranë banesave dhe mungesa e monitorimit të ndikimit të tyre në shëndet.

Minimumi jetik

Minimumi jetik nuk është përcaktuar ende sot e kësaj dite në Shqipëri. Avokati i Popullit qysh prej vitit 2012 ka kryer një praktikë të gjatë ndër-institucionale mbi çështjen e llogaritjes së minimumit jetik, por ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje *për fillimin e procesit të studimit dhe shpalljes së nivelit minimal të standartit të jetesës në Shqipëri*, pavarësisht gadishmërisë së shprehur për të filluar punën për këtë çështje.

Nisur nga situata aktuale, kur edhe pranë institucionit të Avokatit të Popullit numri më i lartë i ankesave lidhet me objektivat sociale sikundër janë: punësimi, ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar, masat e pensioneve të pleqërisë etj. mbi pamundësinë e kategorive më vulnerabël të shoqërisë në përballimin e kushteve me minimale të një jetese me dinjitet, prej vitesh kemi kërkuar nëpërmjet rekomandimeve të përsëritura llogaritjen dhe deklarimin e minimumit jetik në vend.

Duke qenë se kërkesa për përcaktimin e minimumit jetik është një domosdoshmëri jetike për shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare, aq më tepër kur vendi ynë synon respektimin e të drejtave të njeriut dhe përqasjen me standardet më të mira ndërkombëtare, gjykojmë si të nevojshëm kryerjen e një raport-studimi mbi këtë çështje shumë sensitive,

Sipas Raportit të Studimit “*Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri*”², minimumi jetik është llogaritur në vlerën prej **16.000/muaj për frymë në Shqipëri** me të dhënat e vitit 2015. Metodologjia që është përdorur lidhet me të dhënat sasiore të disponueshme, statistikat dhe

² “Raport i studimit nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike, “Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri”

informacionet nga burime dytësore, si dhe të dhënat cilësore të përfituara nga konsultat me ekspertë të nivelit të lartë.

Në këtë kuadër, më datë 21.12.2016, i jemi drejtuar me rekomandim Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për marrjen e masave të menjëhershme për përcaktimin e minimumit jetik dhe mbajtjen në konsideratë të ndryshimeve ligjore përkatëse që lidhen me objektivat sociale si dhe Ministrin të Shëndetësisë rishikimin e ligjit nr.10138/2009 “Për Shëndetin Publik”, i ndryshuar, për një shtesë në nenin 15 mbi funksionet e Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim publikimin e nevojës energjetike për kalori në ditë / frymë.

KREU 2

Roli parandalues i Avokatit të Popullit në mbrojtje të shkeljes së të drejtave të njeriut

2.1. Roli parandalues në shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria

- *Aktiviteti i Avokatit të Popullit në Rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës*

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në ushtrimin e detyrave të tij të njohura nga legjislacioni vendas, udhëhiqet edhe nga parime e instrumente të sanksionuara në legjislacionin ndërkombëtar.

- *Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet*

Gjatë vitit 2016, MKPT ka vazhduar funksionimin si një seksion me strukturë multidisiplinare të përbërë nga pesë ndihmës komisionerë, pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë, prej të cilëve tre ekspertë ligjorë, një mjeke psikiatre dhe një psikologe klinike në rolin e drejtueses së mekanizmit.

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së mori pjesë në aktivitetet e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare mori pjesë dhe kontribuoi në disa seminare dhe konferenca.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2016, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta, dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it. Vlen për t'u përmendur këtu pjesëmarrja e MKPT-së në Konferencën e organizuar nga APT në bashkëpunim me OSBE dhe Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), me rastin e 10-vjetorit të zbatimit të OPCAT dhe vlerësimit të efikasitetit të këtij instrumenti të të drejtës nderkombetare, që u zhvillua më Tetor 2016, në Austri. Bashkëpunim tjetër me rëndësi gjatë vitit 2016 ka qenë ai i vendosur me Institucionin e Garantit Kombëtarë të Drejtave të Personave të Privuar nga Liria të shtetit Italian dhe MKPT-në brenda tij, veçanërisht gjatë vizitës studimore të kryer me mbështetjen e Projektit DANIDA në muajin Dhjetor. Gjatë kësaj vizite krahas aktiviteteve të tjera u inspektua Instituti Penitenciar i Capua Vetere ne Rajonin e Napolit.

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptar me vendim

riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të 7 operacioneve të riatdhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorimin e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE, në vendet e origjinës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2016 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend, si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar, si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2016 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

▪ *Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet*

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kryer **90** vizita, nga të cilat **81** vizita monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2016, dhe **9** ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve.

I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen brenda vitit kalendarik 2016 të **69** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.
- Kushtet materiale të personave të trajtuar në institucione, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienë personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara

në rregulloret institucionale dhe specifike të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët, për të kryer telefonata, për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptojnë, për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, për procedurat e punësimit dhe shpërblimet për punën e kryer, për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër, të drejtën e ushtrimit të rriteve fetare, të drejtën për të përfutur ndihmë financiare, etj.)

- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese sipas specifikeve të institucioneve.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Ndryshe nga MKPT-të e tjera, të cilat kryejnë inspektime me përzgjedhje rastësore ose tematike, MKPT-ja shqiptare zgjodhi të ndiqte praktikën më të mirë të viteve të mëparshme të ekzistencës së saj, duke inspektuar së bashku me OJF-të e interesuara në fushë, një pjesë të mirë të institucioneve ku privohet liria e shtetasve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për rastet e pretendimeve për tejkalim të forcës apo ushtrim dhunë ndaj personave të privuar nga liria nga ankesat e marra përmes postës e telefonit apo ankesave nga familjarët, MKPT bashkëpunoi në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

▪ ***Niveli i respektimit të të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare***³

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2016 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përgjatë vitit ka bërë pengesa në ushtrimin e detyrës së ekspertëve të MKPT-së gjatë një hetimi të kryer në I EVP Fier me pengimin dhe dhënien e aksesit për të marrë prova materiale ndaj një rasti të ushtrimit të dhunës fizike ndaj një të dënuar nga punonjës të sigurisë së I EVP Fier. Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2016, u vunë re një sërë problematikash, të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Vazhdimin e konstatimeve lidhur me kushtet materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, I EVP Sarandë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjisllacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbipopullim mbetet një problematikë e sistemit tonë penitenciar me një mesatare vjetore prej 15-20% mbi kapacitet. Vërehet një ndikim në uljen e mbipopullimit prej 5% -10% krahasuar me një vit më parë nga një rishpërndarje më adekuate e të dënuarve/paraburgosurve në I EVP dhe nga rikonstruksioni i I EVP “Jordan Misja”. Megjithatë problematike paraqitej situata në I EVP-të Lezhë, Krujë, Rrogozhinë, Tepelenë, “Jordan Misja”, Drenovë, Durrës,

³ Mbi inspektimet e MKPT-së në Institucionet Penitenciare janë hartuar 20 rekomandime

Vlorë e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, një pjesë e I EVP-ve ka aplikuar shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që kishte sjellë si pasojë cenimin e standardeve të hapësirës jetike për person. Në disa prej I EVP-ve situata paraqitej edhe më problematike, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit ambientet e aktiviteteve të përbashkëta, observimi e izolimi ishin kthyer në ambiente banimi. Ndërkohë, veçanërisht shqetësuese paraqitej situata në seksionin e veçim-observimit të I EVP Rrogzhinë, ku pjesa dërrmuese e personave qëndronin në këtë sektor në kushte degraduese dhe për ta ishte e pamundur realizimi i ajrosjes dhe aktiviteteve sipas parametrave ligjore.

- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP Krujë etj, në kushte materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe raportet kombëtare, nderkombëtare dhe në konferencat rajonale.

Lidhur me situatën tejet serioze në IMP Krujë Avokati i Popullit gjatë 2016 rekomandoi: *Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e këtij institucioni i cili trajton aktualisht të dënuar në kushte tejet degraduese, jo humane, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e standardet ndërkombëtare, si dhe krijimin e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, ku të sigurohet transferimi, sistemimi dhe trajtimi i të gjithë personave me masë “mjekim i detyruar”, që mbahen në I EVP Krujë, sipas parashikimeve të bëra në nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.*

- Pretendime për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga disa punonjës të I EVP Fier, I EVP 313. Ankesat e gjetura të bazuara u pasuan nga rekomandime për fillim ndjekje penale nga organi i Prokurorisë ndaj personave përgjegjës dhe I EVP-ve përkatëse dhe DPB-së për marrjen e masave lidhur me përgjithësimin e këtyre rasteve dhe parandalimin e fenomenit.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në I EVP Lezhë, Lushnje, Tepelenë, Sarandë dhe Rrogzhinë, nuk ofrohej arsimit i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, nuk ofrohej arsimit i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogzhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, “Mine Peza”, e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Përrjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të ri konstruktura, të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penenciar shqiptar.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të I EVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të riteve fetare e

veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatuan probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social, të cilat ndonëse mundohen t'i realizojnë realisht nuk arrijnë t'i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar.

- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP-të e reja si Vlorë, Berat, Fier, Durrës, dhe Elbasan, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me libreta shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha I EVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngohja sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshëm për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.
- Mungesat në dollapë e rafte të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshej kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, Sarandë, Kukës e Tropojë.
- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të I EVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thuajse në të gjitha I EVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

▪ **Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore**

Inspektimet e kryera në njësitë policore kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”,

Manualin e Rregullave të Trajtimit dhe Sigurimit e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, të miratuar me urdhrin nr.763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dhëna gjatë vitit 2015.

Në përgjithësi, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2016 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi.

Përfundim kanë bërë pengesa në ushtrimin e detyrës së ekspertëve të MKPT-së gjatë një vizite monitoruese në Komisaratin e Policisë Devoll, duke vonuar dhënien e aksesit, për të marrë kontaktet dhe shqyrtuar dokumentacionin përkatës.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë u hartuan **44** Raporte monitorimi dhe rekomandime drejtuar institucioneve respektive nga u konstatua sa më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në DPV Tiranë, si dhe në komisaritet ku gjenden ambiente sigurie në varësi të saj. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbiipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia, për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë, në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur, në disa komisaritate. Ankesat e gjetura të bazuara janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës. Avokati i Popullit ka filluar me iniciativë rastin e bërë publik në media për dhunën e ushtruar nga punonjësi i policisë së Komisaritatit Lezhë, A.B, ndaj qytetarit B.K gjatë një konflikti të ndodhur për shkak të detyrës në aksin rrugor Shëngjin-Lezhë, më datë 20.08.2016. Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, në vijim të së cilit janë kryer një sërë veprimesh procedurale.

Veprimet e kryera nga punonjësi i policisë së Komisaritatit Lezhë, ishin të paligjshme dhe binin ndesh me dispozitat ligjore dhe nënligjore, të cilat normojnë veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Gjatë hetimit u konstatua se punonjësi i policisë kishte ushtruar dhunë fizike të panevojshme ndaj qytetarit, në një moment qetësie dhe kur ai ishte vënë në dispozicion të veprimeve të tij. Kjo dhunë fizike është ushtruar në tejkallim të kompetencave gjatë ushtrimit të detyrës, pasi goditja me grusht dhe përplasja e tij në tokë në një moment të befasishëm mund të shkaktonte rrezikimin e jetës së shtetasit dhe për rrjedhojë ka dyshime të arsyeshme e të bazuara se ai ka kryer veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”.

Objekti i veprës penale të mësipërme është marrëdhënia juridike e vendosur për të rregulluar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik, që kanë të bëjë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht nëpërmjet legjislacionit penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, nga Avokati i Popullit iu rekomandua Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Lezhë: **“Fillimi i hetimit, për veprën penale “Kryerja e**

veprimeve arbitrare”, ndaj punonjësit të Komisarariatit të Policisë Lezhë, A.B për ushtrim dhune fizike të pajustificuar ndaj qytetarit B.K më datë 20.08.2016, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.”

- Mbjajtje dhe trajtim i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-30 ditore, në disa prej ambienteve të sigurisë në strukturat e Policisë së Shtetit.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultojn të pakta në numër dhe nuk krijojnë ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe “Manualit të Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”. Përgjithësisht, në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisarariatet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisarariatet që duhej të rezultojn me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, vijon të konstatohet se nuk ishin të mbyllura sipas procedurave përkatëse, me dylllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.
- Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave, në disa drejtori mjeku mungon. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryeshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.
- Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.

▪ ***Niveli i respektimit të të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike.***⁴

Vizitat monitoruese në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër, Spitalin Psikiatrik Vlorë, dhe në Spitalin Psikiatrik Elbasan, përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor, në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshëm; masat shtrënguese e kufizimin fizik; kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme. Nga vizitat monitoruese të kryera për vitin 2016, në spitalet psikiatrike të lartpërmendura u konstatua:

- Mosrespektimi i hapësirës jetike, kushte të papërshtatshme në dhomat e personave të shtruar, dhe mbajtja e tyre për një kohë të gjatë/kthimi në rezidentë të Spitalit Psikiatrik Elbasan dhe për pavijonet me pacientë kronikë në Spitalin Psikiatrik Vlorë.

⁴ Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike janë hartuar 4 rekomandime.

- Mbajtja e personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mungesa e dhomës të veçimit në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër. Mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë, në të tre institucionet e lart përmendura, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe pjesërisht aplikimit të kufizimit fizik.
- Mungesa e posterave të afishuar me të drejtat e pacientit në ambientet e këtyre institucioneve.
- Mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Shkodër, dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në atë të Elbasanit.
- Mungesa e mjeteve të kufizimit fizik në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shkodër.
- Vonesa në revokimin e masës “mjekim i detyruar”, për personat të cilët trajtoheshin me këtë masë në Spitalin Psikiatrik Shkodër.
- Mungesa e një kabineti stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së, në Spitalin Psikiatrik, Elbasan.
- Kushtet higjieno-sanitare, thuajse në të gjitha ambientet e këtyre institucioneve ishin jashtë standardit e me lagështirë, kryesisht e gjetur kjo në spitalin Psikiatrik Elbasan dhe në pavijonet e “kronikëve” në Spitalin Psikiatrik Vlorë, pasi ky i fundit është ndërtuar së fundmi dhe pavijonet e urgjencës, ai akut dhe sub-akut përmbushnin standardet.
- Mungesa e një sistemi qendror të ngrohjes në Spitalin Psikiatrik Elbasan.
 - **Niveli i respektimit të të drejtave të personave në Qendra.**⁵

Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve

MKPT, bazuar në ligjin nr. 121/2014, datë 18.09.2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, inspektoi Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, me objekt vlerësimin e trajtimit të shtetasve të huaj që marrin shërbime në këtë qendër, në përputhje me të drejtat e tyre për trajtim dinjitoz dhe rehabilitues. Gjatë vizitës monitoruese në këtë qendër, u konstatuan zbatime të një pjese të rekomandimeve të bëra më parë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Problematikat që vazhdonin të ishin të pranishme, paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një juristi, i cili duhet të merret kryesisht me pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i nevojitet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj.
- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf , për edukatorë, kujdestarë dhe staf mjekësor.
- Mungonte afishimi i të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve të kësaj qendre.

Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për të Huajt, Kareç, të ngritur me VKM nr.1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83, të ligjit Nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe

⁵ Mbi inspektimet e MKPT-së në Qendra janë hartuar 4 rekomandime.

Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendëshme. Gjatë vizitave të shpeshta monitoruese dhe hetuese në këtë Qendër, si rrjedhojë e ankesave të shumta mbi trajtimin e shtetasve të huaj në të gjatë vitit 2015, u konstatua se flukset migratore janë të çrregullta dhe ka raste në periudha të caktuara të vitit që kjo qendër nuk ka prani për strehim për të huajt ndaj të cilëve është marrë masë ndalimi. Ka raste të tjera që në periudha të caktuara të vitit ka mbipopullim. Përgjithësisht vijnë po të njëjtat problematika të konstatuara në vitin 2015:

- Organika e parashikuar nuk i plotëson nevojat me staf për, komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.
- Mungojnë pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive. I vetmi aktivitet sportiv ishte ai i lojës me top, në një fushë të papërshtatshme për lojërë me këmbë.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.

2.2. Roli Parandalues i Institucionit të Avokatit të Popullit në shkeljen e të drejtave të njeriut në fusha të tjera të veprimtarisë së tij

Duke synuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer përgjatë gjithë vitit 2016 inspektime lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve. Kushtetuta e Shqipërisë i kushton një vëmendje të veçantë fëmijëve dhe të drejtave të tyre; zhvillimet pozitive ligjore të cilat konsistojnë në ndryshimet ligjore të realizuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar (ligji nr. 155/2014) në krijimin e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve mundësuan ngritjen dhe fuqizimin e mekanizmave për identifikimin dhe nxjerrjen në pah të veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të parregullta nga ana e organeve shtetërore, të cilat ndikojnë drejtëpërsëdrejti tek fëmijët. Ky Seksion ka filluar funksionimin e tij, pas rekrutimit në stafin e Avokatit të Popullit të dy Nd/Komisionerëve.

Gjatë këtij viti, puna e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është fokusuar në realizimin e inspektimeve për mbrojtjen e shkeljes së të drejtave të fëmijëve në institucionet e përkujdesit social që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijët në nevojë dhe institucionet e privimit të lirisë për fëmijët në konflikt me ligjin. Gjatë këtij viti janë realizuar **21 inspektime në total** ku *12 inspektime* në institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë dhe *9 inspektime* në institucionet e privimit të lirisë dhe komisarartet e policisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Qarkun Tiranë.

Në rezultatet përfundimtare të raporteve të inspektimeve për trajtimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesit social rezidencial dhe institucionet e privimit të lirisë, Avokati i Popullit ka nxjerrë një sërë rekomandimesh drejtuar Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Shkodër dhe për dijeni Prokurorisë së Përgjithshme për hetim të mëtejshëm të çështjeve për të cilat është kryer hetim i pavarur administrativ nga ana e Nd/Komisionerëve të institucionit. dhe për fëmijët në konflikt me ligjin drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP, Lezhë për mbylljen e seksionit të vecantë të të miturve pranë kësaj IEVP-je.

KREU 3

Roli mbrojtës i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut dhe objektivat sociale

3.1 Respektimi i të drejtës së pronës dhe procedurat e legalizimeve

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, edhe gjatë vitit 2016 i ka kushtuar vëmendje trajtimit të çështjes së pronave. Çështja e së drejtës të pronës për kategorinë e subjekteve, prona e të cilëve është shpronësuar pa shpërblim, shtetëzuar apo konfiskuar pas Vitit 1944, ka pësuar ndryshime thelbësore me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*.

Situata juridike e parashikuar në këtë ligj, lidhur me trajtimin e së drejtës të pronës është vlerësuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit jo në përputhje me disa parime kushtetuese, vlerësim i cili është pranuar prej Gjykatës Kushtetuese me rastin e dhënies së Vendimit datë 09.11.2016, sipas të cilit është vendosur për shfuqizimin e pikës 3 dhe 5 të nenit 6 të këtij Ligji. Përmirësimi i situatës ligjore në favor të subjektit pronar, me rastin e shfuqizimit të pikës 3 dhe 5 të nenit 6 të Ligjit në fjalë, e vlerësojmë të pamjaftueshme në respektim të së drejtës të pronësisë për kategorinë e subjekteve, prona e të cilëve është shpronësuar pa shpërblim, shtetëzuar apo konfiskuar pas vitit 1944, për shkak se, parashikimi i kompensimit në të holla i pronës së njohur në pronësi sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, konfiskimit apo shtetëzimit, mbetet një çështje e kontestueshme jo vetëm prej subjekteve të interesuara, por dhe prej Institucionit të Avokatit të Popullit.

Zgjidhja e çështjes së njohjes të pronës me të drejtë kompesimi sipas këtij ligji, duke u mbështetur kryesisht tek kompensimi në të holla, sipas vlerësimit financiar të dhënë në këtë ligj, përveçse respekton të drejtën e pronësisë së subjektit pronar në mënyrë jo konkurruese me personat që e kanë përfituar atë sipas Ligjit nr.7501/1991 *“Për tokën”*, Ligjin nr.8053/1995 *“Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”*, VKM nr.452/1992 *“Për ristrukturimin e ndërmarryeve bujqësore”*, etj, ka dëmtuar dhe dëmton interesin e taksapaguesit shqiptar, i cili, nuk është subjekt i kësaj së drejte dhe do të duhet të vijoj të paguaj fatura financiare në vlera qindra million apo miliard euro, në emër të balancës së *“Interesit publik”* me të drejtën e pronës, sipas justifikimit të dhënë në relacionin bashkëlidhur këtij ligji në fazën e projektligjit.

Edhe pse ka pasur mundësi, me fillimin e viteve 90, të zgjidhjes së çështjes të njohjes së pronësisë jashtë formës së kompesimit në të holla, dhe në një afat të arsyeshëm, çështja e respektimit të kësaj së drejte mbetet e pazgjidhur për një numër të konsiderueshëm individësh prej më shumë se 25 vjetëve. Edhe pse sipërfaqja e tokës bujqësore në Vitin 1945, rezulton pronë private në masën 343.353 mijë ha, pra afro 1/8 e territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe se në zbatim të ligjeve të lartpërmendura u është ndarë familjeve bujqësore në masën 560.000 mijë ha në pronësi, dhe 43.7 mijë ha në përdorim, çështja e njohjes së pronës subjektit pronar sipas Ligjit nr.133/2015, është adresuar për t’u zgjidhur duke detyruar taksapaguesit shqiptar të paguanjë fatura financiare tepër të rënda, ndërkohë që ekziston tokë në gjendjen juridike *“Shtet”*, e cila është e mjaftueshme për zgjidhjen e së drejtës të pronës në natyrë. Burim kryesor për zgjidhjen e së drejtës të pronës me anë të kompesimit në të holla mund dhe duhet të adresohet tek ato familje bujqësore të cilat me rastin e ndryshimit të zërit kadastral të sipërfaqes së tokës bujqësore në tokë truall dhe ndërtimit mbi to të objekteve të cilat kanë passjell dhe sjellin në vijimësi përfitime tejet të konsiderueshme, të pakonkurueshme në vlerën në të holla që subjekti pronar përfiton sipas Ligjit nr.133/2015. Po kështu, burim tjetër kryesor për zgjidhjen e së drejtës të pronës, me anë të kompesimit në të holla, mund dhe duhet të jetë pagimi nga ana e subjekteve që kanë kryer ndërtime informale, i vlerës aktuale të truallit funksional (parcelës ndërtimore) objekt shitblerjeje në zbatim të Ligjit nr. 9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, të ndryshuar.

Përkeqësimi i qëndrueshmërisë së sistemit normativ, jo vetëm përsa i përket vlerësimit financiar të pronës dhe shtrirjes së efekteve të tij, konstatohet me rastin e mohimit të së drejtës të njohjes

dhe kompesimit të pasurisë së luajtshme, sikurse garantuar nga legjislacioni i mëparshëm, por i pazbatuar për kategorinë e subjekteve pronar. Gjithashtu, parashikimi i detyrimit të ATP për të mos trajtuar me vendim kërkesat që mbështeten vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës, neni 27/3 i Ligjit 133/2015, nuk e gjejmë në përputhje me parashikimet e kryera në Kodin e Procedurës Administrative apo konform parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe respektimit të së drejtës së pronës.

Mosekzekutimi deri më sot i 26 mijë vendimeve të dhëna në vite, me të drejtë kompesimi të pronës së njohur, si dhe mospërfundimi i shqyrtimit të 11 mijë kërkesave të administruara, gjithashtu në vite, nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës (ATP), është tregues i cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe mosrespektim i së drejtës të pronësisë së individit në një afat të arsyeshëm.

Vendosja e afatit prekluziv lidhur me të drejtën e kërimit të njohjes së pronës, sikurse parashikuar në nenin 27/1 të Ligjit nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, vlerësohet nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në kuptim dhe zbatim të nenit 113 të K.C, neni 41 të Kushtetutës, nenit 6/1 të KEDNJ, si cenim i së drejtës së pronësisë së individit apo parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, për shkak të mosekzistencës së arsyes, e cila do të mund të legjitimonte vendosjen e një kufizimi të tillë.

Tjetër çështje e konstatuar në veprimtarinë e organit, i cili vendos për njohjen e së drejtës së pronës, është mosrespektimi prej KKKP, AKKP, sot ATP, i detyrimit ligjor sikundër parashikuar në nenin 196 të Kodit Civil, nenin 38 të Ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar, për dërgimin pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të aktit, vendimit, brenda 30 ditëve nga marrja formë të prerë të tij, sipas të cilit është vendosur për njohjen e pronës qoftë me të drejtë kthimi në natyrë apo kompesimit me një nga format e parashikuara në ligj. Kjo situatë kostatohet dhe në rastin e nxjerrjes së akteve, vendimeve prej gjykatave, noterëve, përmbauesve gjyqësor dhe organet e tjera shtetërore, që përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë.

Për ato raste kur ATP ka lëshuar aktin, vendimin për njohjen e pronës, njohjen e pronës me të drejtë kompesimi në një nga format e parashikuara në ligj, është konstatuar se zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrim refuzues për regjistrimin e tyre, qëndrim i cili ka qenë dhe është në kundërshtim me parashikimin e kryer në nenin 196 të Kodit Civil. Për ndërprerjen e kësaj shtate e cila nuk vjen në përputhje me parashikimin e kryer në nenin 196 të K.C. apo nenin 38, të Ligjit nr.33/2012, Institucioni i Avokatit të Popullit, me Shkresën nr.K3/I51-2 prot, Datë 18.10.2016, ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë ;

“Zbatimin e detyrimit të dërgimit nga ana e gjykatave, noterëve, përmbauesve gjyqësor dhe organeve të tjera shtetërore, sidomos prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës, të kopjes së vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e cila administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme”.

Mosdërgimi i akteve, vendimeve të prodhuara në vite prej, Agjencisë së Trajtimit të Pronës, dhe jo vetëm, pranë Zyrës vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas të cilave është vendosur për fitimin njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose

një të drejte reale mbi atë, ka bërë që procesi i regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku ndodhen ato, të mos ketë përfundur ende sot e kësaj dite. Edhe në ato raste kur është bërë e mundur regjistrimi fillestar sistematik i titujve të pronësisë, konstatohen probleme lidhur me vërtetësinë e hedhjes së tyre në hartat kadastrale, duke prodhuar në këtë mënyrë konflikte civile, të cilat, do të mund të shmangeshin apo shmangen, në rast të ushtrimit të funksioneve nga ana e regjistruarëve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sikundër parashikuar në nenin 30 dhe 31 të Ligjit nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Mosdërgimi për regjistrim i titujve të pronësisë nga ana e gjykatave, noterëve, përmbauesve gjyqësor, dhe organeve të tjera shtetërore, brenda 30 ditëve nga data e marrjes formë të prerë të aktit, apo redaktimit dhe nënshkrimit të tij, pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ka krijuar problem lidhur me subjektin, i cili, ka detyrimin e kryerjes së pagimit të kamatëvonesës me rastin e paraqitjes me vonesë të dokumentacionit për regjistrimin e titullit të pronësisë.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të depozituara nga ana e individëve të ndryshëm pranë Institucionit të Avokatit të Popullit konstatohet se ZVRPP, Tiranë, Fier, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Shkodër, Korçë, nuk kryejnë procedurat për regjistrimin e titujve të pronësisë, vendimeve të dhëna prej Komisionit të Kthimit Kompesimit të Pronave, Komisionit të Ndarjes së Tokës në Fshat, gjykatat, si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë, edhe pse pasuritë e fituara në pronësi janë transkriptuar ose jo në favor të subjektit pronar.

Mosdorëzimi i vlerës së shpronësimit të pronës, me rastin e daljes së aktit për shpronësim nga ana e pushtetit vendor, Bashkisë Tiranë, si dhe kryerja e veprimeve për prishjen e objektit në funksion të zbatimit të projektit të miratuar pa u dorëzuar më parë vlera e shpronësimit, është qëndrim i cili nuk vjen në përputhje me respektimin e së drejtës të pronësisë apo parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Mosushtrimi i autoritetit ose kontrollit për zbatimin e legjislacionit prej Kryeregjistruarëve të ZQRPP, apo Ministrisë së Drejtësisë, ndaj qëndrimeve të parregullta, e në shkelje të së drejtës të pronësisë së individit, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të drejtës së informimit, prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në çështje konkrete të bëra me dije nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mospërfundimi në afatin ligjor të përcaktuar i shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të akteve të marrjes së tokës në pronësi prej Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, Qarku, Tiranë.

Moszhvillimi i procedurave prej institucioneve përgjegjëse, si; njësitë e qeverisjes vendore, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendëshme, ALUIZNI, Zyrat vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kryeregjistruarë i ZQRPP, ATP, për zbatimin e VKM nr.608, datë 05.09.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", të ndryshuar, kjo dhe për shkak të mosmiratimit të aktit për caktimin e tarifave të shërbimit në procesin e pajisjes me titull pronësie, të poseduesve të ndërtimeve të kryera para datës 10.08.1991, etj.

Mosmarrja e masave dhe kryerja e veprimeve nga ana e organeve të ngarkuara për zbatimin e VKM Nr.716, Datë 18.12.1995, "Për sistemimin e familjeve të Fshatit Fajzë të Rrethit Has në tokat disponibël të Kurorës së Tiranës", ndryshuar me VKM Nr.531, Datë 27.01.1997, "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.716, datë 18.12.1995", dhe VKM Nr.413, Datë

27.07.2000, “Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që u janë përmbytur tokat nga Ujëmbledhësi i Hidrocentralit të Fierzës”, etj, në favor të familjeve, tokat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”.

Çështje të tjera të cilat janë përmendur në vite dhe nuk kanë gjetur ende zgjidhje, janë:

- Mospërfundimi i procesit të regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku është vendosur për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pasurive të paluajtshme.
- Tejzgjatësia e procesit të shqyrtimit të vetdeklarimeve të kryera prej subjekteve të cilët kanë kryer ndërtimin e objekteve informale.
- Tejzgjatësia e procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohjen e pronës me të drejtë kompesimi fizik, etj.
- Tejzgjatësia e procesit të shqyrtimit të titujve të pronësisë të nxjerra në zbatim të Ligjit Nr.7501, Datë 19.07.1991 “Për tokën”, etj.
- Mosbashkëpunimi dhe mosndërveprimi i institucioneve publike në procesin e krijimit dhe regjistrimit të titujve të pronësisë.
- Mosrespektimi i afateve prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në dhënien e shërbimeve ndaj qytetarit.
- Mosregjistrimi dhe “vënia në diskutim” prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i vendimeve gjyqësore të administruara.
- Mos krijimi i një harte të vetme unike, dixhitale, që mund të japë informacion mbi pronën.
- Mosgarantimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të vendit, si dhe atyre të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që lidhen me të drejtën e pronësisë.

3.2 Respektimi i të drejtave të shtetasve nga organet e qeverisjes vendore

Qeverisja Vendore është një nga fushat kryesore të angazhimit publik të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur rol proaktiv si një element thelbësor për një qeverisje të mirë, në mbrojtjen e individit kundër abuzimeve administrative, si dhe forcimin e besimit të publikut në shërbimet që ofron pushteti në nivel vendor dhe rajonal.

Avokati i Popullit në funksion të mirëqeverisjes dhe mbrojtjes efektive të individëve kundër abuzimeve administrative, ka përdorur instrumente institucionale dhe mekanizmat e tij ligjorë, të koordinuara njëkohësisht dhe me zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si, Auditoriumet ku janë diskutuar dhe debatuar me aktorë publik dhe jo publik për tema të rëndësishme që shqetësojnë komunitete të veçanta, por dhe shoqërinë shqiptare në tërësi. Trajnimet me përfaqësues të administratave vendore, etj., me qëllim krijimin e një fryme të ngushtë bashkëpunimi në zgjidhjen e ankesave të shtetasve, rritjen e performacës etiko-profesionale të punonjësve të administratës vendore, si dhe përmirësimin e standarteve dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve nga ana e saj.

Aspekt i rëndësishëm në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, ka qenë ndjekja nga afër e zbatimit të reformës së re administrative dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit nga organet e qeverisjes vendore. Forcimi i demokracisë lokale dhe rajonale nënkupton thellimin e procesit të decentralizimit dhe rritjen e autonomisë të organeve të qeverisjes vendore, shoqëruar këto me një mbështetje më të madhe buxhetore nga qeverisja qendrore, sidomos tani kur jemi në hapat e para të implementimit të reformës administrativo-territoriale.

Pavarësisht disa përparimeve që janë bërë vitet e fundit në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se, zbatimi i kësaj reforme sipas parimeve kushtetuese dhe ligjore, është ende larg standarteve dhe kërkesave më të përparuara të organizimit të një shteti demokratik, në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore.

Ndaj ecja me ritme më të shpejta, në rrugën e thellimit të procesit të decentralizimit të pushtetit vendor, duhet të shoqërohet jo vetëm me delegimin e numrit të kompetencave, siç ka ndodhur deri më tani, por dhe me rritjen e autonomisë të organeve të qeverisjes vendore dhe domosdoshmërisht të shoqëruara me mbështetje financiare dhe njerëzore nga qeverisja qendrore, pa cenuar parimet mbi të cilat funksionon qeverisja vendore.

Ky proces gjithashtu, nuk mund të realizohet i plotë pa miratimin dhe zbatimin e një kuadri ligjor, pasi përveç miratimit të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mungojnë një sërë aktesh të tjerë ligjorë dhe nënligjorë që kanë të bëjnë me ushtrimin në mënyrë më të plotë të këtyre kompetencave, si në fushën administrative, menaxheriale dhe financiare, por dhe për zbatimin e një sërë detyrave dhe përgjegjësisive që ju ngarkohen me ligje të veçanta si njësi të qeverisjes vendore.

Avokati i Popullit në studimin e akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionojnë organet e qeverisjes vendore, nga kontaktet me drejtues dhe administratorë të pushtetit vendor, si dhe shoqatat dhe grupet e interesit që veprojnë në këtë fushë, konstaton se, për mirëfunksionimin e këtyre organeve dhe realizimin e një procesi transparent dhe përfshirjen e publikut në vendimarrje, me të cilat janë të lidhura ngushtësisht ecuria e reformave, ngritja e institucioneve, cilësia e shërbimeve të qytetarëve, kërkohet miratimi sa më parë i një pakete të plotë me akte ligjore dhe nënligjore.

Pas miratimit të reformës së re administrative-territoriale, në kuadër dhe të thellimit të procesit të decentralizimit, pushtetit vendor i janë shtuar dhe një sërë kompetencash të reja që kanë të bëjnë me shërbimin social në nivel lokal dhe ndihmën ekonomike, politikat sociale në fushën e strehimit, reformimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve, të shërbimit zjarrëfikës në fushën e administrimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimin e mbetjeve urbane, etj.

Por, vihet re se krahas decentralizimit dhe delegimit të këtyre shërbimeve, kompetencat e reja ende nuk janë shoqëruar me financimet e nevojshme përkatëse, si dhe me rishikimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesin shoqëror, në fushën e strehimit social, funksionimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, shërbimit zjarrëfikës, etj, legjislacionit i cili vazhdon të jetë i mangët dhe i paplotësuar.

Gjatë periudhës 2-vjeçare të zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe të decentralizimit, janë evidentuar disa fusha në të cilat kërkohet ndërhyrje nga institucionet politikbërëse dhe vendimmarrëse në nivelin e legjislacionit, për sa i përket zbatimit të funksioneve të përbashkëta, ku legjislacioni është i paqartë, kontradiktor ose paraqet një situatë të mbivendosjes së funksioneve midis strukturave qendrore dhe strukturave të pushtetit vendor (*akte të tilla ligjore ekzistojnë në fushat e shërbimeve sociale, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore, roli i prefektit, etj*).

Në fokusin e punës dhe veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, sigurisht ka qenë trajtimi dhe roli ndërmjetësues në zgjidhjen e ankesave të individëve dhe subjekteve, sipas

problematikave që lidhen me veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike në nivel qendror, lokal dhe atë vendor.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të rregjistruara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit prej 2565 ankesa, rezultojnë se, 555 ankesa janë adresuar ndaj instiucioneve në nivel qarku dhe organeve të Njësisë të Qeverisjes Vendore, të ndara sipas numrit më të madh dhe të drejtave ato paraqiten: 137 ankesa për të drejtën e pronësisë; 133 ankesa për zgjidhjen e problemit të strehimit; 43 ankesa për papunësinë, zgjidhjen e mardhënieve të punës të punonjësve të administratës të pushtetit vendor; 42 ankesa për ndërprerjen e ndihmës ekonomike; 20 ankesa për mjedis të shëndetshëm; 21 ankesa për të drejtat e fëmijëve; 20 ankesa për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë personat me aftësi të kufizuara, si dhe një numër i konsiderueshëm i ankesave që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve publike nga bashkitë, mungesën e investimeve në infrastrukturë etj, të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar sipas fushave dhe të drejtave në kapitujt e këtij Raporti.

Por, nisur nga numri i madh i ankesave prej 137 ankesa, të cilat janë për çështjen e pronësisë, objekti i tyre ka të bëjë me veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të qeverisjes vendore, si dhe KV pranë Prekstit të Qarkut, në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për vlefshmëri të ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Në këtë kuadër, duke vlerësuar rëndësinë kushtetuese dhe ligjore që ka kjo e drejtë në raport me kushtet familjare të individëve dhe subjekteve që ju është mohuar e drejta për t'u pajisur me tokë bujqësore dhe me aktin e titullit të pronësisë, por dhe si një kusht bazë për zhvillimin ekonomik të vendit, mendojmë të trajtojmë disa nga problematikat e ndeshura më së shumti gjatë trajtimit të këtyre ankesave.

1. Efektet e moszbatimit në kohë të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për Tokën", të ndryshuar, sipas kriteve për krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga ish-komisionet e ndarjes së tokës bujqësore në njësitë e qeverisjes vendore, kanë sjellë për pasojë që shumë individë (subjekte) të mos jenë pajisur me AMTP përkatëse. Kjo e drejtë nuk mund të rivendoset në vend me procedura administrative, për shkak të ndryshime që ka pësuar legjislacioni, konkretisht Ligji nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" në nenin 17 thuhet shprehimisht se:

"1. Procedura e ndarjes së tokës bujqësore në pronësi.....si dhe krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore përfundojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 8 të këtij ligji.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, komisionet e tokës, të krijuara në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 7501 "Për tokën", të ndryshuar, mbarojnë funksionimin dhe veprimtarinë e tyre për ndarjen e tokës..".

Nisur nga ankesat e depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, rezultojnë një numër jo i vogël i individëve, të cilët për arsye të ndryshme nuk janë të pajisur me AMTP. Por, mund të përmendim dhe ankesa të dërguara nga grup banorësh si, ajo e **banorëve të Fshatit Boriç i Madh, Gruemirë, Malësia e Madhe**, të cilët për shkak të moszbatimit të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", kanë mbetur pa tokë bujqësore mbi 50% e familjeve të këtij fshati, **banorët e fshatit Cërrnicë, Njësia Administrative Llugaj, Tropojë**, që jetojnë aty nuk kanë përfituar sipërfaqe të tokës bujqësore dhe nuk disponojnë dokumentacion pronësie, në bazë të Ligjit Nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, etj.

2. Mosushtrim i detyrave dhe përgjegjësi që ju jep ligji KV pranë Prefektit të Qarkut, lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të evidentuara ndërmjet individëve dhe ish-komisioneve të tokave në fshat, si dhe për kufijtë e tokës bujqësore, ndërmjet fshatrave (subjekteve), që kanë qenë në përbërje të së njëjtës ish-kooperativë bujqësore. Konkretisht, mund të përmendim **ankesën e 14 familjeve bujqësore të ardhura nga Kukësi para vitit 1993** dhe të vendosura në Fshatin Gjazë, Njësia Administrative Krutje, Bashkia Lushnje, lidhur me mosmarrëveshjet dhe konfliktin për pronësinë e një parcele bujqësore në fshatin Gjazë dhe disa familjeve të punonjësve të shtetit banorë të fshatit “Fieri i Ri”, për të cilën Prefekti i Qarkut Fier ende nuk ka kthyer përgjigje Avokatit të Popullit për mënyrën e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje.

3. Zvarritje të procedurave për konfirmimin tekniko-ligjor dhe plotësimin në kohë të mangësive të konstatuara nga ZVRPP në dosjet e subjekteve që janë të pajisura me AMTP, si dhe mungesë informacioni nga njësitet e qeverisjes vendore për detyrimet që ato kanë në procesin e regjistrimit fillestar të fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, për subjektet e pajisura me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

4. Zvarritje të kërkesave të individëve (subjekteve) nga organet e qeverisjes vendore për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, sipas kompetencave që jep Ligji nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”. Kryesisht, bëhet fjalë për tokat bujqësore të cilat shtrihen në zonat me përparësi turizmi, të parashikuara në Ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe VKM-së nr.88, datë 1.03.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, ndërkohë që ky vendim nuk është shoqëruar me hartë treguese, duke lënë akoma dyshime mbi zonat që përfshihen në të.

Në përfundim të trajtimit të kësaj çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit do të vijojë angazhimin e tij publik, si dhe të kryejë me përgjegjësi të plotë dhe të pavarur rolin e tij Kushtetues dhe ligjor, në funksion të miqëverisjes të organeve të pushtetit vendor, duke patur në qendër të vëmëndjes mbrojtjen e të drejtave të individëve (subjekteve) nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, përmirësimin e jetës së tyre sipas standarteve ndërkombëtare, si dhe rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim që ato të jenë sa më efikente si dhe në përputhje me interesat e komunitetit

3.3 Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar në njësitet policore dhe çështje të tjera që lidhen me këto institucione

Gjatë vitit 2016 në Institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 163 ankesa, ndaj organit të Policisë së Shtetit. Njëpërmjet ankesave qytetarët kanë paraqitur pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat, ose punonjësit e Policisë së Shtetit. Objekti i ankesave ka qenë i ndryshëm sikurse mund të përmendim: për torturë dhe keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë; për trajtim jo human në mjediset ku mbahen, ruhen dhe trajtohen të shoqëruarit ose të arrestuarit; për arrestime, ndalime apo shoqërim të paligjshme; për kontrole të paligjshme të banesave; për mosmarrje, mosadministrim ose mosndjekje të kallëzimeve apo të kërkesave të bëra prej tyre; për pengim në ushtrimin e aktivitetit të ligjshëm ekonomik; për pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; për mosmbështetjen me forca të përmbareshme gjyqësor gjatë kryerjes së detyrës ligjore; për vendosje të masave administrative të padrejta; për bllokime të paligjshme të sendeve personale; për mosmbajtje dhe mosdhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë, etj.

Nga shqyrtimi i ankesave të administruara ka rezultuar se disa prej tyre kanë qenë të bazuara dhe konkretisht për ushtrim dhune fizike, për trajtim jo human, për arrestime ose shoqërimë të paligjshme, për mosdhënie të kopjeve të procesverbaleve të kontrollit të banesave, të bllokimit të sendeve apo të dokumentacionit të shoqërimit, si dhe për mosmarrjen e kallëzimeve të bëra nga shtetasit.

Dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, të Ligjit Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” dhe të akteve nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e tij parashikojnë detyrimin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore për të marrë dhe administruar kallëzimet e bëra nga shtetasit, për të mbajtur procesverbalin përkatës për kryerjen e kontrollit dhe për sekuestrimin ose bllokimin e sendeve të ndryshme, si dhe dhënien e kopjes së tyre personit, ndaj të cilit janë kryer këto veprime procedurale apo policore. Gjithashtu, këto akte normative parashikojnë edhe detyrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit për të respektuar të drejtat ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar ose ndaluar dhe trajtimin e tyre human dhe me dinjitet.

Nga hetimi administrativ i rasteve për të cilat nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë provuar shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve kemi konstatuar se disa nga shkaqet e kryerjes së këtyre shkeljeve nga punonjësit e policisë janë mosnjohja e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit, si dhe neglizhenca për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës dhe misionit ligjor. Gjithashtu, një shkak tjetër është edhe mungesa e kontrollit nga strukturat eprorë të organeve vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.

Shkeljet dhe cenimet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të Policisë së Shtetit, ndikojnë drejtpërdrejtë në cenimin e imazhit të këtij organi në publik dhe për rrjedhojë cenojnë rëndë besimin e publikut tek Policia e Shtetit.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve, nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të qytetarëve, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen. Disa nga rastet ku janë konstatuar shkelje ligjore dhe janë bërë rekomandime mund të përmendim:

Ankesën e shtetas N.Q., regjistruar me nr. doc.201600076, pronare dhe administratore e një shoqërie ndërtuese, e cila pretendonte se pengohej për të ushtruar aktivitetin e saj ligjor nga drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë. Gjithashtu, ajo pretendonte se organi i Policisë nuk lejonte ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të shoqërisë së saj, si dhe e kishin arrestuar atë padrejtësisht.⁶

⁶ Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për:

a. Fillimin e hetimeve ndaj shtetasit S. N., me detyrë Zv.Shef i Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë dhe Shefi për Krimet dhe të disa punonjësve të tjerë të policisë që kanë kryer veprime ndaj shoqërisë “B” shpk në datën 16.02.2016, për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe të “Pengimit për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.

b. Fillimin e hetimeve ndaj shtetasit T. L., me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Rekomandim drejtuar Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë për:

Ankesën e shtetasve A.M. etj, regjistruar me nr. doc. 201600595, të cilët pretendonin se, ndonëse kishin shkuar në Komisarariat e Policisë nr. 1 Tiranë për të bërë kallëzim ndaj punonjësve të Policisë Bashkiakë Tiranë për dhunimin fizik të koleges së tyre gjatë protestës së bërë kundër ndërtimit të këndit të lojrave tek Parku i Liqenit Artificial të Tiranë, jo vetëm që nuk iu ishte marrë kallëzimi, por ishin trajtuar si të shoqëruar dhe si persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime.⁷

Ankesa e familjarëve të shtetasve A. Ç., A. S. dhe F. M, regjistruar me nr. doc. 201601220, të cilët pretendonin se gjatë arrestimit dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan iu ishin sekuestruar me cilësinë e provës veshjet dhe ishin lënë për disa orë gjatë natës të zhveshur në pjesën e sipërme të trupit duke iu rrezikuar shëndetin. Ndërsa shtetasi A. Ç. pas arrestimit nga Policia, për shkak të gjendjes shëndetësore të rënduar, ishte dërguar për trajtim shëndetësor në QSUT “Nënë Tereza”, në reanimacion, por punonjësit e policisë që e ruanin atë e mbanin të lidhur me pranga pas krevatit.⁸

Ankesa e shtetasit B. Ll., regjistruar me nr. doc. 201502630, i cili pretendonte se punonjësit e Komisarariatit të Policisë Mirditë i kishin bërë kontroll banese pa patur vendim gjyqësor apo urdhër të organit të Prokurorisë dhe i kishin marrë e bllokuar për më shumë se 2 vjet e katër muaj

a. Ndërprejen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë ndaj shoqërisë tregtare “B” shpk dhe lejimin e saj për të ushtruar aktivitetin ndërtues në objektin e ndodhur në Rr. “F. Shiroka”, Tiranë

b. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e veprimeve jo korrekte dhe sjelljes pa etikë të punonjësve të policisë që kanë kryer veprimet me punonjësit e kësaj shoqërie dhe marrjen e masave të nevojshme ndaj personave përgjegjës.

⁷ Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë A. G. dhe S. D., me detyrë ndihmës specialist për hetimin e krimeve në Komisarariat e Policisë nr. 1 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal.

Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Policisë së Shtetit për:

a. Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj atyre punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje administrave (disiplinore).

b. Përgjithësimin e këtij rasti në organet vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen.

c. Nxjerrjen dhe dërgimin e një kujtese organeve vendore të policisë në lidhje me detyrimin ligjor të oficerëve të policisë gjyqësore për marrjen dhe administrimin e kallëzimeve të shtetasve, kur ata kërkojnë bërjen e tyre, konform neneve 283 dhe 303 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 17/1/i të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

ç. Organizimin e punës me efektivin e policisë për njohjen e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe sidomos të dispozitave që parashikojnë të drejtën e shoqërimit të shtetasve në ambientet e policisë, kriteret dhe rastet e shoqërimit të tyre, si dhe detyrat e punonjësve të policisë dhe të drejtat e personave të shoqëruar.

⁸ Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Policisë së Shtetit për:

a. Analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj atyre drejtuesve dhe punonjësve të policisë të Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, të cilët nuk e kanë zbatuar drejtë Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin & Sigurimi e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin nr. 736, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe konkretisht Kreun e VII-të, pika 5.2 të tij.

b. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim që të kuptohet e zbatohet drejtë Kreu i VII-të, pika 5.2 e këtij Manuali dhe të mospërsëriten raste të tilla (mbajtja lidhur me pranga pas krevatit të të arresturve) në të ardhmen.

c. Zbatimin e rregullave standarde nga punonjësit e policisë gjatë arrestimit të shtetasve të ndryshëm, qofshin ata edhe autorë të krimeve të rënda, duke ushtruar forcën konform nenit 133 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Rekomandimi drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për:

a. Analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj punonjësve të policisë që i kanë kryer këto veprime (trajtimin ju human të shtetasve A. Ç., A. S. dhe F. M.

b. Përgjithësimin e këtij rasti në organet dhe strukturat e policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet tuaja.

armën e gjahut të cilën e kishte me leje. Për veprimet e kryera ata nuk kishin mbajtur dhe dhënë ankuesit kopje të procesverbalit të kontrollit të banesës së tij dhe as kopje të procesverbalit për bllokimin e armës së gjahut.⁹

Rasti i filluar me iniciativë nga Avokati i Popullit, i regjistruar me nr. doc. 201600316, i cili u bë publik në media, për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë së nr.1 Tiranë, ndaj qytetarëve të cilët po protestonin tek kodrat e Liqenit Artificial Tiranë, më datë 21 Shkurt 2016, me qëllim që Bashkia Tiranë të mos ndërtonte këndin e lojrave për fëmijë. Nga hetimi administrativ i këtij rasti konstatoam se punonjësit e policisë kishin ushtruar dhunë fizike ndaj qytetarëve protestues gjatë kryerjes së detyrës, duke tejkaluar kompetencat dhe shkëlur parimin e proporcionalitetit.¹⁰

3.4 Respektim i të drejtave të personave të arrestuar, dënuar në Institucionet penitenciare

Gjatë vitit 2016 janë paraqitur gjithsej 254 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 203 janë mbyllur dhe 51 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e mbyllura 149 kanë rezultuar të pabazuara në ligj dhe 54 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit. Në krahasim me vitin 2015 ka një rritje të dukshme të numrit të ankesave.

Ankesat e marra në shqyrtim janë paraqitur si nga të burgosurit ashtu dhe nga familjarë të tyre. Të burgosurit mund të na njohin me ankesën e tyre duke na dërguar një letër nëpërmjet postës ose duke na telefonuar në numrin e institucionit. Shërbimi i kontaktit me anë të telefonit është kthyer në një mënyrë të parapëlqyer nga të burgosurit për të paraqitur ankesa. Gjatë bisedës telefonike me të burgosurin, punonjësi i Zyrës së Avokatit të Popullit do të sqarojë detajet e ankesës për të përcaktuar nëse ajo është ose jo kompetencë e institucionit. Nëse ankesa është jashtë kompetence, i burgosuri këshillohet për rrugën ligjore që ai duhet të ndjekë. Nëse ankesa pranohet, ajo regjistrohet dhe i burgosuri njoftohet me një shkresë për veprimet që po ndiqen dhe me numrin e punonjësit që po shqyrton rastin. Gjatë orarit zyrtar, i burgosuri mund të telefonojë në numrat e institucionit për t'u siguruar që ankesa e tyre ka mbërritur. Falë programit elektronik të regjistrimit të ankesave i burgosuri vihet në dijeni në një kohë të shkurtër.

Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzim i kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritje e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese;

⁹ Rekomandimi drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe Komisarariatit të Policisë Mirditë për:

a. Marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit B. Ll. konform dispozitave të akteve normative në fuqi.

b. Ushtrimin e të drejtës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore për të ushtruar kontrollin e mjedisëve (banesave) të shtetasve dhe dokumentimin e veprimeve të kryera konform neneve 202 e vijues dhe 303 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 117 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Hartimin e procesverbalit të kontrollit dhe dhënien e kopjes së tij të kontrolluarëve.

c. Zbatimin me korrektesë nga punonjësit e policisë të detyrimeve që rrjedhin nga neni 121 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me rastet dhe afatet kohore të bllokimit të sendeve, si dhe për hartimin e procesverbalit të bllokimit të sendeve dhe dhënien e kopjes së tyre poseduesve.

ç. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Lezhë, pavarësisht faktit që ai ka ndodhur para më shumë se dy vitesh, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet tuaja.

¹⁰ Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për:

“Fillimi i hetimit, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, për ushtrim dhune fizike të kryer në bashkëpunim, ndaj qytetarëve që protestonin në kodrat e liqenit artificial më datë 21 Shkurt 2016, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

zvarritje e procedurës për t'u transferuar në një I EVP tjetër; transferim i padrejtë në një I EVP tjetër.

Problematikat që kanë rezultuar nga shqyrtimi i ankesave:

Shërbimi shëndetësor në burgje duhet të sigurojë diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve me medikamente. Ankesat që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit shëndetësor vazhdojnë të jenë të shumta në numër. Gjykojmë se mbipopullimi i lartë ka bërë që administrata e burgjeve të mos i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të të burgosurve për trajtim mjekësor.

Gjithashtu, në disa I EVP është konstatuar mungesë e mjekut, pavarësisht se në organikë parashikohet të ofrojë shërbim mjeku, pasi ky vend pune nuk është i pëlqyer. Disa mjekë që fillojnë detyrën në I EVP, pas një farë kohe japin dorëheqjen.

Të burgosurit duhet të vuajnë dënimin në një institucion sa më afër vendbanimit të familjes. Ky është një nga kriteret kryesore ligjore për përcaktimin e I EVP-së ku i burgosuri duhet të vuajë dënimin. Nga hetimi i rasteve ku është pretenduar se, po zvarritej procedura për të dërguar të burgosurin në një I EVP më afër vendbanimit të familjes, ka rezultuar se shkak i vonësës ka qenë mbipopullimi. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, DPBurgjeve na ka kthyer përgjigje se arsyeja e transferimit të të burgosurit në një I EVP larg vendbanimit të familjes ka qenë siguria e tij për shkak të konflikteve me të burgosur të tjerë. Nga ana jonë është e vështirë të provohet nëse me të vërtetë arsyeja e transferimit ka qenë siguria e të burgosurit apo ndëshkim i tij për shkak të sjelljes në institucion.

Një pjesë e mirë e të dënuarve do të kthehen të lirë në shoqëri. Në dritën e këtij fakti është e domosdoshme të bëhen përpjekje për të siguruar që të dënuarit të kenë të lehtë rikthimin në liri. Gjatë vuajtjes së dënimit të burgosurit kanë humbur autoritetin e vendimarrjes për veprime të përditshme. Për një person që lirohet pas një periudhe të gjatë dënimi, dalja në shoqëri mund të jetë e vështirë sidomos kur nuk ke mbështetjen e familjes. Një rol të rëndësishëm në këtë kalim luan e drejta e të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese. Kjo leje disa ditore i jep mundësi të dënuarit të rikrijojë kontaktet e humbura. Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qenë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave të të dënuarve për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por vetëm për të verifikuar procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi i këtyre rasteve ka rezultuar se arsyeja e refuzimit të tyre ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka patur garanci nëse jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të çenohej gjatë lejes ose i dënuari mund të çenonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Për të vlerësuar këtë mundësi institucioni ka marrë informacion nga policia e shtetit dhe familjarët e të dënuarit.

Punësimi në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t'u integruar në shoqëri. Puna në burgje është më shumë sesa përfitimi i aftësive profesionale. Puna i jep të burgosurve një ndjenjë pavarësie pa të cilën ata plogështohen dhe krijojnë varësi nga të tjerët. Megjithatë puna e të burgosurve duhet të paguhet, kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Në lidhje me shpërbllimin e punës të të burgosurve, më datë 04.03.2013 i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt VKM-së për përcaktimin e kriterëve të shpërbllimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht, ky rekomandim nuk është zbatuar dhe puna e të burgosurve vazhdon të mospaguhet.

Institucionet penitenciare nuk janë vendi i duhur për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor. Nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Në vitin 2012 është punuar një rekomandim, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hapja e një institucioni të ri mjekësor për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjeksore “mjekim të detyruar”. Aktualisht ky rekomandim nuk ka gjetur zgjidhje.

Respektimi i të drejtave të burgosurve lidhet ngushtësisht me marrëdhëniet që krijohet ndërmjet tyre dhe personelit të burgjeve. Për të siguruar një administrim të mirë të IEVP-ve duhet të tregohet kujdes në rekrutimin e personelit. Paga e tyre duhet të jetë e kënaqshme për të tërhequr interesin e personave të duhur; kushtet e punës dhe kompesimet ekonomike duhet të jenë të përshtatshme me vështirësinë që paraqet puna në burgje. Në përfundim të hetimit të ankesave të punonjësve të policisë së burgjeve, të cilët pretendonin se nuk po respektoheshin disa të drejta të parashikuara nga legjislacioni, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Kryeministrit ndërhyrjen në organet kompetente për: respektimin e të drejtave të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në rastet kur ata nuk kryejnë lejen vjetore; rritjen e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të pajisur me uniformë punonjësit; trajtimin e barabartë financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit; rritjen e numrit të punonjësve të policisë së burgjeve. Ky rekomandim është pranuar por, nuk është zbatuar me arsyetimin se nuk ka fonde të mjaftueshme.

Në vitin 2016 janë marrë në shqyrtim sërish ankesat e disa punonjësve të Policisë së Burgjeve që janë larguar nga detyra për mospagim të energjisë elektrike. Pasi kemi marrë në shqyrtim këto ankesa kemi vlerësuar se largimi i tyre nga detyra ka qenë i pa bazuar në ligj dhe kemi rekomanduar për çdo rast revokimin dhe konstatimin të pavlefshëm të urdhërave të largimit nga detyra. Këto rekomandime janë pranuar nga DPBurgjeve por, në disa raste punonjësit e policisë së burgjeve nuk janë kthyer në vendin e tyre të punës dhe vazhdojnë procesin gjyqësor.

Një rast për t’u përmendur është ai i mjekëve specializantë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore në vitin 2015 për të kryer shërbim në burgje pas përfundimit të specializimit, të cilëve i ishte ndërprerë pagesa për periudhën e specializimit. Kjo situatë ishte krijuar nga mosmarrëveshja që kishte lindur ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për arsye të interpretimeve të ndryshme që i bëhej legjislacionit. Në përfundim të hetimit të këtij rasti, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Kryeministrit zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Rekomandimi u pranua dhe ankesa u zgjidh në favor të specializantëve.

3.5 Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare

Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, ankesave nga familjarët apo nga mediat MKPT ka bashkëpunuar në kryerjen e hetimeve ad hoc me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve

për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Duhet theksuar se kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për të mos ju nënshtuar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250).

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetarët për t’i denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.

Për vitin 2016, janë adresuar 11 rekomandime drejtuar organit të Prokurorisë, të cilat për këtë vit kanë një specifikë, e cila konsiston në kryerjen e hetimit të pavarur administrativ mbi shqetësimin e grupeve të caktuara të qytetarëve si, antarëve të Komunitetit Rome, organizatave të Shoqërisë Civile apo dhe banorëve të disa fshatrave në zonën e Lushnjës. Po ashtu ka disa raste të filluara me iniciativë, apo mbi bazë inspektimi në Qendrën Rezidenciale të Fëmijve Parashkollorë në Shkodër, në kuadër të bashkëpunimit mes Seksionit të Veçantë dhe Mekanizmit për parandalimin e Torturës, me grup ekspertësh të fushave si juristë, mjekë psikiatër dhe psikologë.

Në mënyrë të grupuar rekomandimet paraqiten si më poshtë:

1. Për veprat penale “Tortura” dhe “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, ndaj punonjësve të policisë së IEVPenale 313 Tiranë.
2. Për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, për ushtrim dhune fizike ndaj qytetarëve të cilët protestonin në kodrat e liqenit artificial Tiranë, për ndërtimin e parkut të lojrave.
3. Për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe konkretisht, rekomandim ndaj inspektorëve të IKMT-së Tiranë për shkelje të procedurave gjatë prishjes së banesave të antarëve të Komunitet Rome në Unazën e Madhe Tiranë; ndaj punonjësve të Qendrës Rezidenciale të Fëmijve Parashkollorë Shkodër; ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për mosarsyetim të vendimeve gjyqësore civile për një periudhë kohe prej tre vjetësh dhe ndaj punonjësës së ZVRP Sarandë, për mosrregjistrim të pronës së një shtetasi.

4. Për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit” ndaj punonjësve të Qendrës Rezidenciale të Fëmijëve Parashkollorë Shkodër.
5. Për kryerjen e ekzaminimit psikiatriko-ligjor të një anëtari të Komunitetit Rome në Tiranë, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” mbetur në tentativa, rast i cili është refuzuar nga organi i Prokurorisë Tiranë.
6. Marrjen e masave ligjore për zgjidhjen përfundimtare të problemit të personave me masë mjekësore dhënë nga gjykata “mjekim të detyruar” me qëllim nxjerrjen e tyre jashtë sistemit të burgjeve dhe kalimin në Institucione të Posaçme Psichiatrike.
7. Rekomandim legjislativ drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe për dijeni Kuvendit e Prokurorit të Përgjithshëm **“Propozime për shtesa dhe përmirësime të nenit 265 të Kodit Penal “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”.**
8. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për fillimin e hetimit për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” ndaj punonjësit të Komisarjati të Policisë Lezhë A.B, për ushtrim dhune fizike të kryer ndaj qytetarit B.K gjatë një konflikti ndodhur në kryqëzimin e rruges Shëngjin Lezhë më datë 20 Gusht 2016, parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal”.
9. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë për “Fillimi i hetimit të procedimit penal dhe për veprën penale “Tortura” parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, ndaj shtetasit Ferit Mici, me detyrë shëf i ruajtjes dhe sigurisë në IEVPenale 313 Tiranë, dhe për veprën penale “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 251 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të atij institucioni.
10. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier, për fillimin e hetimeve në ngarkim të Drejtorit të IEVP Fier, shtetasit A.H, Shefit të Sigurisë B.K etj., për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 235/2 dhe 25 të Kodit Penal.
11. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier, për fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të sigurisë së IEVP Fier E.S, B.S, etj., për veprën penale të “Torturës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të Kodit Penal.

3.7.Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor

Në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se liria, prona dhe të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe nga ligji nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, dhe lirive dhe të interesave të tij Kushtetues dhe ligjor, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Ky parim shfaqet si një garanci kushtetuese për individët ndaj çdo privimi që mund t’u bëhet të drejtave të tyre themelore, nga shteti ndërmjet organeve të tij vendimmarrëse. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për individët ndaj veprimeve të padrejta dhe të paligjshme të organeve të pushtetit shtetëror nga njëra anë, dhe si një detyrim i këtyre të fundit për të mos cenuar të drejtat dhe liritë e shtetasve pa siguruar respektimin dhe mbrojtjen e procedurave ligjore nga ana tjetër.

E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk është e drejta që mund të mbulojë të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese e ligjore të individit. Çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe që përbëjnë një ndër drejtimet kryesore të Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Në nenin 6 të KEDNJ e drejta për një proces të rregullt ligjor rezulton në formulimin më të gjerë se Kushtetuta e RSH.

Në këtë dispozitë të KEDNJ-s, krahas të drejtës për gjykim të drejtë dhe publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, përfshin edhe disa standarte të tjera të cilat në Kushtetutën e RSH gjenden të shpërndara në disa dispozita të tjera.

Kështu, e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet, e drejta e prezumimit të pafajësisë derisa nuk është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë, e drejta e të akuzuarit për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër në gjuhën e tij për akuzën që i bëhet, e drejta për t'u mbrojtur, përbëjnë sipas nenit 6 të KEDNJ thelbin e të drejtave procedurale të procesit të rregullt ligjor dhe nuk janë pjesë përbërëse e nenit 42 të Kushtetutës.

Një parim tjetër i rëndësishëm i shtetit të së drejtës nga Gjykata Kushtetuese vitet e fundit është pranuar edhe respektimi i parimit të sigurisë juridike, që presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmëria e ligjit në marrëdhëniet e rregulluara. Siguria juridike nënkupton ndërmjet të tjerave garantimin e besueshmërisë së individëve tek shteti dhe institucionet e tij, dhe aktet që ato nxjerrin. Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj e ka konsideruar me të drejtë ushtrimin e të drejtës për t'ju drejtuar Gjykatës apo për të ushtruar të drejtën e gjykimit, brenda një afati të arsyeshëm si një mjet i rëndësishëm i parimit të sigurisë juridike.

Gjatë vitit 2016 nga institucioni i Avokatit të Popullit, janë trajtuar **200 ankesa të paraqitura nga shtetasit për veprime ose mosveprime të padrejta dhe të paligjshme ndaj organit i akuzës dhe ndaj Gjykatave të të gjitha shkallëve**. Nga të dhënat rezultojnë se ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë gjatë këtij viti janë trajtuar 44 raste, ndaj Gjykatave të Apelit janë trajtuar 15 raste, dhe ndaj Gjykatës së Lartë janë trajtuar 17 raste.

Numri i ankesave ndaj organeve gjyqësore do të ishte edhe më i madh në rast se nuk do vepronte komisioni ad hoc që ngrihet çdo ditë në institucion nga Drejtoria e pritjes dhe që bën filtrimin e ankesave të ardhura ndaj gjykatave si ankesa që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencave të institucionit tone.

Problematika e ankesave të ardhura për shqyrtim në institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë e ndryshme kryesisht për shkelje të ndryshme të procesit të rregullt ligjor për **zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore** si për çështjet penale ashtu edhe për çështjet civile, në kundërshtim me parashikimet e nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH dhe të nenit 6 të KEDNJ ku thuhet se, Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjor, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Ankesa kanë ardhur edhe **ndaj vendimeve gjyqësore** duke ngritur pretendime të ndryshme dhe duke kërkuar nga institucioni ynë prishjen e tyre nga Gjykatat e Apelit apo Gjykata e Lartë, kërkohet që shtetasit të mbrohen nga institucioni ynë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë me arsyetim se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike për të zgjedhur vet një avokat privat për mbrojtje.

Duke analizuar rastet e trajtuara nga ana jonë rezultojnë se ankesa kanë ardhur gjithashtu nga persona të tjerë **të gjykuar dhe të dënuar penalisht në mungesë** nga Gjykata për vepra të ndryshme penale duke pretenduar se nga Gjykatat janë kryer dhe lejuar shkelje të ndryshme procedurale në lidhje me njoftimet nga organet e procedimit dhe të gjykimit, etj.

Në këto raste nga ana jonë janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore se ndaj tyre në bazë të kërkesave të nenit 410/2 të Kodit Procedurës Penale, ato mund të ankimohen në shkallën e dytë

në Gjykatën e Apelit me anën e një avokati mbrojtës privat, brenda një afati 10 ditor, dhe në rastet kur ka kaluar afati i ankimit në bazë të kërkesave të nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë i pandehuri mund të kërkojë rivendosje në afat për të bërë ankim kundra tij kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

Gjatë këtij viti vazhdojnë të vijnë ankesa nga të dënuar me burgim nga Gjykatat e Shkallës së pare në rastet kur *koha e paraburgimit të vuajtur në fakt është më e madhe se masa e dënimit caktuar nga Gjykata.*

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë ka rezultuar se personat e dënuar ankohen ndaj vendimit gjyqësor në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit të cilat kanë ngarkesë të madhe pune dhe dosja e tyre ndjek radhën e gjykimit dhe mbaron masa e dënimit të dhënë nga gjykata dhe ato i drejtohen Gjykatës në bazë të kërkesave të nenit 261 të Kodit të Procedurës Penale, për shuarje të masës sigurimit. Për zgjidhjen e këtij problemi tepër shqetësues nga ana jonë janë bërë rekomandimet e nevojshme ligjore të cilat janë pranuar nga Ministria e Drejtësisë dhe pritet që këto rekomandime të pasqyrohen e plotësohen me rastin e zbatimit të reformës në drejtësi në ndryshimet në legjislacionin përkatës penal.

Ankesa ndaj vendimit gjyqësor në një rast ka lidhje me një dënim penal të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Fier ndaj shtetasit E.B. i gjykuar dhe dënuar me burgim të përjetshëm, në bazë të nenit 141-25-22 dhe 278/2 të Kodit Penal vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë. Ankuesi ankohet për kohën e gjatë që i duhet të presë gjykimi në Gjykatë të Lartë dhe për këtë arsye ai dhe të afërmit e tij kërkojnë ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për shpejtimin e këtij gjykimi. Nga verifikimi ynë rezulton se ai në Gjykatën e Lartë Tiranë mbrohet nga dy avokat privat dhe rekomandimi ynë për shpejtim gjykim është pranuar dhe gjykimi do zhvillohet së shpejti.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë duke pretenduar se këto vendime janë të formës së prerë dhe ***atyre u mohohet e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*** Këto ankesa kanë lidhje me shkeljet në fushën e qarkullimit rrugor në lidhje me masat administrative që jepen nga Komisionet përkatëse ndaj subjekteve private ku parashikohet se ndaj disa vendimeve gjyqësore nuk lejohet të bëhet ankim. Në rastin konkret nga ana jonë janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore se ato duke qënë vendime të formës së prerë, ndaj tyre mund të kërkohe vetëm kërkesë me objekt rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë dhe nuk lejohet të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ankesa të ndryshme vijnë edhe për shkak të mungesës së të ardhurave ekonomike për përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Lartë ashtu si dhe për shpejtimin e gjykimit. Nga ana jonë janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore se në bazë të nenit 36/3 të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se :” Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”. Po kështu kemi sqaruar edhe parashikimet e nenit 145 të Kushtetutës së RSH ku thuhet se:”*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve sjell përgjegjësi ligjore*”.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj ***gjyqtarëve të veçantë për gjykime jo të drejta*** dhe ndonëse ndaj vendimeve ankuesit kanë paraqitur ankim në Gjykatat më të larta ata ankohen ndaj tyre për veprime korruptive në zgjidhjen e çështjes konkrete dhe nga ana jonë në lidhje me këto denoncime janë njoftuar organet kompetente si Ministria e Drejtësisë apo Inspektoriat i KLD-së, për t’u analizuar dhe me qëllim që ndaj tyre të marrë masa disiplinore sipas ligjës.

Gjatë këtij viti ne kemi trajtuar disa ankesa në lidhje me **dënimin e shtetasve për veprat penale të armëmbajtjes pa leje**, parashikuar nga neni 278/5,6 të Kodit Penal, dhe ndaj tyre ishin aplikuar nga Gjykata masa të rënda dënimi. Duke patur parasysh faktin se Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj Nr.9 datë 26.02.2016 ka vendosur pranimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe shfuqizimin e nenit 55/2 dhe të nenit 278/5,6 të Kodit Penal, në praktikën gjyqësore u krijua një boshllëk ligjor dhe lindte nevoja për t'u bërë përmirësimet e nevojshme ligjore nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kështu bazuar në kërkesat e nenit 76 pika 2 germa "a" të Ligjit nr.8577 datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në RSH", ku parashikohet se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese, vetëm ndaj një vendimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e ligjit ose të aktit të shfuqizuar, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga Gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Në rastin konkret duke patur parasysh se në Gjykatat e ndryshme ndodhen akoma në shqyrtim disa raste si për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë ashtu edhe në Gjykatën e Lartë pasi u studiuva vendimi i Gjykatës Kushtetuese nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit u adresua menjëherë në Kuvendin e Shqipërisë një rekomandim për të bërë plotësimet në boshllëkun ligjor të krijuar. Me Ligjin Nr.82 datë 25.07.2016 Kuvendi i Shqipërisë, bëri ndryshimet e nevojshme që parashikonin marshe më të buta dënimi për veprat penale të parashikuara nga nenet 55/2 dhe 278/5,6 të K.Penal.

Në rastin konkret ky rekomandim nga ana jonë ju dërgua për kompetencë Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Presidentit të Republikës dhe nga ana e tyre u morën masa për plotësimet e nevojshme ku përfituan ulje të masave të dënimit një numër i madh personash.

Në nenin 3 të Ligjit me Nr.49/2012 një ndër parimet e gjykimit administrativ është parashikuar edhe sigurimi i një **procesi të rregullt ligjor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme**. Ligji vet synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me qëllim garantimin e mbrojtjes së të drejtave të subjekteve të interesuara të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme por të përcaktuara nga vet ligji. Kujtojmë gjithashtu se shkelja e të drejtave të shtetasve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Administrative e Apelit është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj me vendimet me Nr.69/2015, Nr.81/2015 dhe 14/2016 ku ajo ka theksuar në mënyrë të qartë dhe të prerë se përfundimi i gjykimeve në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të bëhen brenda afatit 30 ditor. Ajo ka deklaruar se mosgjykimi i çështjes brenda këtij afati ligjor përbën shkelje të parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

Ankesa ndaj Gjykatave kanë paraqitur edhe nga persona të tjerë në **lidhje me problemet e pronësisë mbi tokën** duke kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të institucionin tonë duke kërkuar prishjen e vendimeve të KKKP të Rretheve apo të Bashkive, të marra para disa vitesh dhe që ato sot çënojnë në vetvete të drejtat e tyre të pronësisë, si një e drejtë themelore kushtetuese kryesore.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë ka rezultuar se ato i janë drejtuar Gjykatës Rrethit Gjyqësor me padi civile duke kërkuar anulimin e tyre dhe zgjidhjen e këtyre problemeve por gjatë gjykimeve dalin të dhëna dhe fakte se këto vendime janë marrë me dokumenta të fallsifikuar dhe nga ana jonë janë sqaruar personat që ato t'i drejtohen organeve të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor për ndjekje penale sipas kërkesave të nenit 186 të Kodit Penal.

Në një rast tjetër shtetasi I.S. nga Tirana ankohej ndaj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke parashtruar se nga viti 2010 i është pezulluar marrja e pensionit të plotë padrejtësisht nga DRSSH Tiranë, dhe me vendimin Nr.591 datë 05.11.2015 Gjykata e Lartë Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit me Nr.628 datë 13.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e kësaj çështje gjyqësore për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Megjithëse kanë kaluar disa muaj kjo gjykatë nuk e kishte gjykuar çështjen duke cënuar kështu zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe duke shkelur të drejtat ligjore të garantuara nga dispozitat Kushtetuese dhe ligjore të legjislacionit në fuqi.

Duke analizuar kushtet dhe rrethanat e këtij rasti, dhe duke e konsideruar këtë rast si rast të veçantë, nga ana jonë ju dërgua rekomandim Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për marrjen e masave për planifikimin dhe gjykimin sa më shpejtë të kësaj çështje. Me vendimin Nr.3326 datë 20.10.2016 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pranoi rekomandimin tone dhe vendosi lënien në fuqi të vendimit Nr.4733 datë 10.05.2012 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke analizuar numrin e madh të ankesave të ardhura në institucionin tonë ndaj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si dhe praktikave të Gjykatës Kushtetuese, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar një rekomandim Ministrit të Drejtësisë, Kryetarit të KLD-së dhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit për marrjen e masave për shtimin e organikës edhe me 5 gjyqtar të tjerë për zgjidhjen e ngarkesës së punës së grumbulluar në këtë Gjykatë, edhe me vendimet unifikuese të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë me Nr.3 datë 06.12.2013, dhe Nr.4 dt.10.12.2013, duke arsyetuar se: situata e krijuar vjen në kundërshtim edhe me qëllimin e ligjvënësit me rastin e miratimit të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", i cili ka qenë shpejtimi i gjykimit të çështjeve administrative dhe jo zvarritja e tyre.

Në vendin tonë ka një perceptim të gjerë se ***sistemi i drejtësisë është prekur nga fenomeni i korrupsionit dhe ndikimi politik në dhënien e drejtësisë***. Fenomeni i korrupsionit, mungesa e praktikave transparente, tejzgjatja e proceseve gjyqësore, apo mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kanë ndikuar negativisht në perceptimin negativ të publikut ndaj transparencës së gjyqësorit, si dhe ndaj dhënies së drejtësisë në mënyrë profesionale dhe në kohë.

Duke mbajtur në konsideratë të gjitha problematikat e trajtuara, është e nevojshme fillimi sa më shpejt i zbatimit të reformës në Drejtësi, duke filluar që nga krijimi i organeve të reja kushtetuese për vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për pastrimin e këtij sistemi nga personat e paafte dhe të korruptuar dhe për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe profesional.

▪ ***Ndihma juridike falas***

Në lidhje me dhënien e ndihmës juridike falas shtetasve në nevojë që nuk kanë mjete ekonomike dhe financiare për të zgjidhur vet një avokat mbrojtës privat, në vendin tonë rregullimi i këtij problemi shqetësues është zgjidhur me daljen e Ligjit me Nr.10039 datë 22.12.2018 "Për Ndihmën Juridike". Ky ligj megjithëse kanë kaluar rreth 8 vjet nuk njihet sa duhet dhe shtetasit të cilët mendojnë se ndihma juridike falas jepet vetëm nga institucioni i Avokatit të Popullit vazhdojnë t'i drejtohen këtij institucioni me kërkesë për plotësimin e nevojave të tyre duke ju caktuar një avokat falas nga shteti sipas parashikimeve ligjore.

Rastet e kërkesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2016 kanë qënë në 17 raste, ato i janë dërguar për kompetencë trajtimi menjëherë Komisionit Shtetëror të

Nd/Juridike në Ministrinë e Drejtësisë, duke vënë në dijeni edhe vet kërkuesin për veprimin e kryer me qëllim që nga ana e tyre, të paraqiteshin në Komisionin përkatës për të plotësuar formularët përkatës dhe të përfitojnë mbrojtje falas nga shteti.

Duke mbajtur në konsideratë, se një projektligj i ri për ndihmën juridike është në proces hartimi, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë dhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, që në nenin 13 të Ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, “Për Ndihmë Juridike” ku parashikohen kriteret e dhënies së Ndihmës Juridike, të përfshihen si përfitues të kësaj të drejte ligjore edhe viktimat e diskriminimit, bazuar kjo në rekomandimet e ECRI-t.

Po kështu i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që të bëhet shtimi i Buxhetit për shërbimet e Komisionit Shtetëror të Nd/Juridike me qëllim që të përfitojnë më shumë persona ndihmë ligjore falas dhe për garantimin e aksesit më efektiv në sistemin e drejtësisë në të ardhmen.

3.8 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale, civile dhe administrative

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, civile dhe administrative si pjesë përbërëse e procesit të gjykimit, ka mbartur pothuaj të njëjtat problematika sikurse pasqyruar në raportin edhe të një viti më parë, të Avokatit të Popullit, për shkak se, autoritetet e ngarkuara me ligj për ekzekutimin e tyre nuk kanë kryer apo nuk kryejnë në afatin e përcaktuar apo të arsyeshëm, veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e tyre.

Gjatë vitit 2016, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ankesa kanë ardhur edhe në lidhje me problemet që ndeshen në praktikën e përditshme që ndeshen në ***fazën e ekzekutimit të vendimeve penale*** duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjet e institucionit të Avokatit të Popullit për ndërhyrje dhe zgjidhje të problemit me anë të rekomandimit në riparimin e gabimeve të bëra nga organet e ndryshme shtetërore. Në rastin konkret bazuar në kërkesat e nenit 28/4 të Kushtetutës ku parashikohet se në të gjitha rastet e tjera personi të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohe gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

Po kështu në bazë të kërkesave të nenit 480 të Kodit Procedurës Penale, ku thuhet se:” Në fazën e ekzekutimit, Gjykata është kompetente të vendos për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, si dhe për çdo rast tjetër të parashikuar në ligj,” ankuesit janë sqaruar se me anën e një avokati privat, ato mund t’i drejtohen rrugës gjyqësore në Gjykatë si organi kompetent shtetëror për zgjidhje ligjore të këtyre problemeve.

Procesi i ***ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor***, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, ka qenë objekt shqyrtimi gjatë vitit 2016 prej Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në 11 prej çështjeve të paraqitura për shqyrtim ka pranuar kërkesën e subjekteve kërkues, duke vendosur me këtë rast, për; ***Konstatimin e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor nga ana e gjykatës në dy raste në procesin e gjykimit të çështjeve civile, si dhe në 9 raste për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në 9 raste***. Në ndryshim nga Viti 2015, konstatohet se, numri i çështjeve në të cilat është vendosur nga ana e Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor është gati dyfishuar.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë apo Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në një afat të arsyeshëm, mbetet një çështje me rëndësi thelbësore për shtetin, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm për të gjithë. Tejzgjatja e ekzekutimit, “Vënia në diskutim” e drejtësisë së dhënë nga gjykata, ka bërë që të rritet numri i çështjeve të paekzekutuara si dhe kohëzgjatja e ekzekutimit të tyre. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve të gjykatave është një nga hallkat kryesore të shoqërisë demokratike.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të Administratës Publike, në cilësinë e debitorit, mbetet një çështje e cila nuk vjen në përputhje me sanksionimin e kryer në nenin 142/3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike. Mungesa e fondeve financiare për përmbushjen e detyrimeve në të holla prej organeve debitore të administratës publike, nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Kjo është e mirëpërcaktuar si në vendimet e dhëna prej Gjykatës Kushtetuese, ashtu dhe Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2016, me objekt mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, Avokati i Popullit, gjykon se, shkaku i cili ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor është dhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Për përmirësimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijoj ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj.

Edhe pse objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është, moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, rezulton se ky objektivi nuk është arritur.

Organet apo institucionet debitore, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata, nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012, të Ministrit të Financave, *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, (neni 62), apo në Udhëzimin nr.1 datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit, i cili ka pas sjellë dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile, kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura, ka sjellë dhe do të sjellë cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.

Tjetër shkak i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë edhe një sërë shkaqesh, si: 1. Mungesa e cilësisë profesionale e përmbaruesve gjyqësor, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv. 2. Mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbaruesve gjyqësor. 3. Kryerje veprimesh përmbarimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor. 4. Mungesa e vullnetit prej përmbaruesve gjyqësor për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është vendosur.

Ashtu sikurse edhe një vit më parë, Avokati i Popullit ka konstatuar se çështja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit vijon të mbetet e pandryshuar, edhe pse i është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë me Shkresën Nr.K2/I40-9 Prot, Datë 22.02.2016, *“Marrja e nismës për ndryshim legjislativ”*. Edhe pse është pranuar në parim rekomandimi prej Ministrit të Drejtësisë, nuk është bërë e mundur ende përmirësimi i kuadrit ligjor që lidhet me procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë sipas të cilëve është vendosur për dënimin me gjobë të personit.

Gjithashtu, problematik e trashëguar është procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt; detyrimin e subjektit debitor privat të paguaj shumën të caktuar në të holla. Në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tij mbi të ardhurat mujore të debitorit, krijohen situata në cenim të interesave jetike të tij. Fakti që deri më sot nuk është mundur caktimi i minimumit jetik, ka bërë që parashikimi i kryer në nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile të jetë i pazbatueshëm, prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

Sipas kësaj dispozite, vendosja e masës së sekuestrës mbi pagën e debitorit kryhet pa cënuar minimumin jetik, i cili deri më sot është i papërcaktuar. Në procesin e shqyrtimit të ankesave, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Privat, ka kryer veprime për vjeljen e detyrueshme të detyrimit në të holla nga të ardhurat e debitorit, që merret si ndihmë ekonomike apo ndihmës për trajtimin shëndetësor të debitorit. Për të mundur ndërprerjen e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm mbi ndihmën ekonomike apo ndihmën për trajtimin shëndetësor të debitorit është mundur dërgimi i rekomandimeve përkatëse Ministrit të Drejtësisë për amendimin e nenit 529 të K.Pr.C. lidhur me përfshirjen e ndihmës ekonomike si dhe ndihmës për trajtimin shëndetësor si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës në zbatim të titullit ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Edhe pse janë pranuar në parim rekomandimet prej Ministrit të Drejtësisë, nuk është bërë e mundur ende përmirësimi i kuadrit ligjor, amendimi i nenit 529 të K.Pr.C-së.

3.9 Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës

Reforma në Administratë Publike vijon të mbetet një prej prioriteteve të punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Përmirësimi dhe thellimi i demokracisë në shoqërinë shqiptare, forcimi i demokracisë institucionale, rritja e nivelit të qeverisjes, kërkon që të gjitha institucionet e shtetit të marrin masat e nevojshme, të domosdoshme, institucionale e legjislative, të cilat do të garantojnë në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme liritë, të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Sikundër është cituar edhe në Progres-Raportin për Shqipërinë në muajin Nëntor 2016 nga Komisioni Europian, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në drejtim të reformës në administratën publike, në veçanti për sa ka të bëjë me procedurat më transparente të rekrutimit të nëpunësve civilë.

Avokati i Popullit përgjatë vitit 2016, ka vijuar monitorimin e Administratës Publike, jo vetëm në drejtim të largimeve nga puna, por edhe në drejtim të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020, si dhe monitorimit të Pushtetit Vendor pas miratimit të Reformës Territoriale-Administrative.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 kemi trajtuar në total **174 ankesa** me objekt largimet e padrejta nga puna, nga të cilat 44 raste kanë gjetur një zgjidhje pozitive në drejtim të pagesës së efekteve financiare për largime të padrejta nga puna apo në disa raste edhe në drejtim të rikthimit në vendin e mëparshëm të punës. Në 13 raste kemi hartuar edhe rekomandime për marrjen e masave dhe vënien në vend të të drejtës së shkelur ndaj kërkuesve.

- Nga një numër ankesash ashtu sikundër kemi evidentuar edhe në raportet vjetore të mëparshme, ka vijuar të ketë ankesa lidhur me vendimet gjyqësore të dhëna në favor të ish-punonjësve, të cilat kanë vështirësi ekzekutimi veçanërisht në rastet kur gjykata është shprehur me vendim për rikthim në detyrë të nëpunësit. Në disa raste kemi hartuar rekomandime konkrete në drejtim të institucioneve që janë bërë pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pasi në gjykim të Avokatit të Popullit mosekzekutimi i vendimeve gjyqësor të formës së prerë, me justifikimin prej vitesh të mungesës së një pozicioni pune të njëjtë për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës apo në pozicione pune të ngjashme ka ndikuar në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë. Duke qenë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar ai pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, do të vijojmë të mbajmë në vëmendje monitorimin e Urdhërit nr. 5151/1 datë 28.10.2015 të Ministres së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil.

- Reformimi i sistemit të Shëndetësisë përgjatë vitit 2016, ka sjellë një numër të konsiderueshëm ankesash lidhur me largimet nga puna, kryesisht në personelin mbështetës, sanitarë, sektori hotelieri e mbështetës dhe më pak në sektor ndihmës mjekësor nëpër Spitalet Rajonale në vend. Pavarësisht nxjerrjes së një Udhëzimi nga ana e Ministrit të Shëndetësisë, për vendosjen e disa kriterëve prioritarë për largimet nga puna, ka rezultuar se në shumë raste, këto largime kanë qenë të menjëhershme dhe pa respektuar një procedurë ligjore. Nisur nga problematikat e ankesave Avokati i Popullit ka rekomanduar ndaj Ministrisë së Shëndetësisë¹¹:

1. Marrjen e masave për zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit të Punës si pasojë e ristrukturimeve të ndërmarra.

2. Mbajtjen në konsideratë të kriterëve që lidhen me vjetërsinë në punës.

3. Mbajtjen në konsideratë të kushteve sociale dhe ekonomike për punonjësit e larguar nga puna si dhe gjetjen e mundësive për ri- sistemimin e tyre në vende pune të njëjta apo të ngjashme që përputhen edhe me profilin e tyre arsimor.

Lidhur me këtë rekomandim, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka marrë ende një përgjigje zyrtare nga institucioni përkatës.

- Pas ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të miratuara në datë 18.12.2014, në kreun XI "Vlerësimi i nëpunësit", nenit 62 të tij "Vlerësimi në punë" është shtuar pika 1.1 në të cilën citohet se: "Përveç vlerësimit, sipas nenit 2 të këtij neni, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas vlerësimeve me vendimin e Këshillit të Ministrave, edhe për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë. Në çdo rast, procesi i vlerësimit të kryer sipas kësaj pike, duhet të garantojë anonimatën e nëpunësit civil të vlerësuar.

¹¹ Rekomandimi me nr. 201502394 datë 19.05.2016, drejtuar Ministrit të Shëndetësisë

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore në datë 16.12.2015 është miratuar nga Këshilli i Ministrave Vendimi nr.1037 "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë". Ky vendim synon aftësimin e nëpunësve civilë, pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve/të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil si dhe përfshin testimin paraprak dhe kur është i nevojshëm, trajnimin e nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre. Në përfundim të trajnimit bëhet testimi me shkrim dhe intervistimi i tyre me gojë, në lidhje me njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.

Në gjykimin e institucionit tonë, testimi nuk është mënyra e vetme për fotografimin dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave që ka sot administrata publike. Të gjithë punonjësit e administratës publike kanë për detyrë dhe duhet të kenë fokus qytetarët, me qëllim sigurimin e efektshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë tek çdo nëpunës pjesë e administratës publike. Një proces i tillë i testimit do të ishte i kundraligjshëm dhe në shkelje të të drejtave të njeriut dhe bie ndesh me një ndër parimet kryesore sikundër është ai i "sigurisë juridike", **fakt për të cilën në muajin Mars 2016, kemi paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në të cilën kemi kërkuar:**

1- Pezullimi i zbatimit të pikës 1/1 dhe pikës 2/1, të nenit 62, dhe gjurmës e/3, të pikës 1, të nenit 66, të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, me Ligjin 178/2014.

2- Pezullimi i zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037 datë 16.12.2015 "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë".

3- Shpallja si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i pikës 1/1 dhe pikës 2/1, të nenit 62, dhe gjurmës e/3, të pikës 1, të nenit 66, të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, me Ligjin 178/2014.

4- Shpallja si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1037 datë 16.12.2015 "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë".

Kjo kërkesë, është rrëzuar me Vendimin nr. 70 datë 07.07.2016 nga Gjykata Kushtetuese e cila i ka konsideruar kushtetuese ndryshimet ligjore.

- Duke patur si pikë referimi Progres-Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë, dhe angazhimin për një administratë të orientuar drejt qytetarit, me synimin për të ofruar qasje të barabartë në shërbimet publike, kemi gjykuar se këto parime themelore duhen përshtatur me Kodin Evropian të Sjelljes së Mirë Administrative, të parashikuara edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të çdo vendi të Bashkimit Evropian.

Kodi Europian i Sjelljes së Mirë Administrative vendos një theks të vecantë tek e drejta e çdo personi për të patur akses në dosjen e tij/saj duke respektuar interesat legjitime të konfidencialitetit dhe e sekretit profesional, si dhe detyrimin e administratës për të dhënë arsye për vendimet e marra. Përfshirja e të drejtës së administrimit të mirë edhe për vendin tonë do të thotë që individit t'i jepet një mjet efektiv ligjor për të ushtruar këtë të drejtë duke i bërë autoritetin publik përgjegjës për veprimet e tyre.

Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar një rekomandim në muajin Mars 2016, pranë Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike¹² lidhur me:

- *Marrjen e inisiativës ligjore për hartimin dhe miratimin e një ligji të veçantë mbi sjellen e mirë administrative të adoptuar dhe përshtatur me “Kodin Europian të Sjelles së Mirë Administrative*
- *Përfshirjen në një nen të veçantë të Institucionit të Avokatit të Popullit si një kujdestar për respektimin dhe garantimin e kësaj të drejtë nga çdo Institucion i Administratës Publike.*

Ky rekomandim është refuzuar nga ana e kësaj Ministrie.

▪ Duke u nisur nga numri i lartë i ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit për largime nga puna në Pushtetin Vendor pas reformës territorial-administrative si dhe problematikave të konstatuara mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës për këta punonjës, kemi ndërmarrë një monitorim si dhe kemi hartuar një **Raport të veçantë**¹³ me të gjithë problematikat që lidhen me zbatimin e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës dhe në mënyrë të veçantë për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve nga çdo organ i Njësive të Qeverisjes Vendore.

Në përgjigjet e ardhura nga Bashkitë, në 61 shkresa të adresuara për pushtetin vendor, janë përgjigjur vetëm 51 Bashki, në të cilat na ka rezultuar se janë larguar në total 3059 punonjës, prej të cilëve 319 janë nëpunës civil ose 11% e punonjësve dhe 2740 janë punonjës marrëdhëniet e punës të të cilëve janë rregulluar sipas Kodit të Punës ose në total 89% e punonjësve.

● Në pjesën më të madhe të bashkive, problematikë mbetet mungesa e buxhetit, pasi me burimet financiare aktuale nuk arrijnë të përballojnë kostot financiare të riskstrukturimeve ndaj punonjësve që janë larguar apo që do të preken nga largimet nga puna pas miratimit të strukturave përfundimtare të njësive vendore.

● Një pjesë e bashkive në vend kanë kryer likuidimin e detyrimeve financiare sipas një grafiku mujor për të gjithë punonjësit e larguar nga puna, ndërkohë që një numër tjetër i bashkive nuk kanë përlogaritur asnjë kosto financiare ndaj punonjësve të prekur nga ristrukturimi për shkak se punonjësit e larguar nga puna, kanë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor aktet e largimit të tyre nga puna.

Si konkluzion i problematikave të konstatuara më lart, problem shqetësues mbetet ngritja dhe funksionimi i komisioneve të ristrukturimit për nëpunësit pjesë e shërbimit civil për transferimet e tyre në pozicione pune të njëjta apo të ngjashme, si dhe zbatimi sa më i drejtë i dispozitave të Kodit të Punës si pasojë e ristrukturimeve të ndërmarra, duke mos mbajtur në konsideratë edhe kritere që lidhen me vjetërsinë në punës apo dhe kushtet sociale dhe ekonomike për punonjësit e larguar nga puna.

Reforma në Administratën Publike duke përfshirë edhe pushtetin vendor do të vijojë të mbetet një nga pikat kyçe për punën e Avokatit të Popullit me qëllimin e vetëm për dhënieve e kontributeve në përmirësimin e punës dhe krijimin e një administrate publike model, e cila duhet të funksionojë sipas parimeve evropiane.

¹² Rekomandimi me nr. doc. 201600175/2 datë 01.03.2016, drejtuar Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike

¹³ Raport i Veçantë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë në muajin Korrik 2016.

3.10. E drejta për informim

E drejta për informim është një e drejtë themelore e individit, e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe e afirmuar në një sërë aktesh ndërkombëtare të ratifikuara në përgjithësi nga vendi ynë. Regjimi juridik bazë i së drejtës për informim është përcaktuar nga Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe nga Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, i Republikës së Shqipërisë”. Megjithatë ai plotësohet nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të tjera në fuqi, të cilat plotësojnë dhe saktësojnë aspekte specifike të këtij regjimi juridik.

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 30 ankesa për shkelje të pretenduara të së drejtës për informim, si dhe kërkesa për informim për veprimtarinë tonë institucionale. Nga numri i ankesave të marra në total, 9 janë ende në shqyrtim, ndërsa për 21 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 2 prej tyre janë jashtë kompetencës, 12 ankesa të zgjidhura pozitivisht dhe 5 ankesa të pabazuara, ndërkohë që për 2 ankesa është hequr dorë për ndjekjen e tyre të mëtejshme, nga ana e vetë ankuesve.

Problematika të hasura nga trajtimi i ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2016, kanë të bëjnë me:

- Mostrajtim të kërkesave për informim nga ana e organeve të administrates publike, sipas regjimit juridik të përcaktuar nga Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Mosrespektim të afateve kohore të përcaktuara nga Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për refuzimin, apo plotësimin e kërkesës së paraqitur nga subjektet e interesuara, për informim.
- Mungesë transparence mbi ecurinë e procedurave specifike ligjore, nga ana e organeve përgjegjëse, për mbarëvajtjen dhe përfundimin e tyre. Këto ankesa janë të bazuara në regjimin juridik të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Reagimi i institucioneve shtetërore pas marrjes në shqyrtim dhe ndërhyrjes nga ana jonë për ankesat e paraqitura për mosveprime, apo zvarritje të konstatuara në trajtimin e kërkesave për informim, sipas Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka qenë i kënaqshëm dhe kjo pasqyrohet në numrin e çështjeve të zgjidhura pozitivisht.

Sikurse kemi theksuar edhe në Raportin Vjetor të vitit 2015, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, veç disa çështjeve të tjera mbetet problem çështja e përcaktimit të rolit kompetencial që Avokati i Popullit ka në monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Është e paqartë kompetenca që i lihet Avokatit të Popullit, në pikën 7, të nenit 24, të ligjit ku thuhet shprehimisht se: “Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cenon kompetenca të Avokatit të Popullit, lidhur me mbikqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”. Ky lloj dyzimi nxjerr në pah përplasje kompetencash dhe pasoja të mundshme për ndjekjen e rrugës së ankimit administrativ dhe atij gjyqësor në një kohë të dytë nga ana e personave të interesuar, në varësi të institucionit ku ata paraqiten me ankesë fillestare për shkelje të së drejtës së tyre për informim.

Edhe këtë vit, numri më i madh i ankesave të pranuar për shqyrtim, lidhet me zbatimin e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ndërkohë, ankesat që i referohen mosrespektimit të regjimit juridik të së drejtës për informim, sipas Kodit të Procedurave Administrative janë më pak. Problematika e së drejtës për informim, realisht është trajtuar shumë më gjerë sesa numri i ankesave të dhëna në këtë raport, por në kuadër të ankesave të tjera që si objekt kryesor kanë patur një problematikë të ndryshme nga ajo e së drejtës për informim.

3.11 E drejta e sigurimeve shoqërore

Gjatë vitit 2016 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë depozituar dhe trajtuar 152 ankesa lidhur me të drejtën e përfitimit nga sigurimet shoqërore. Kanë përfunduar shqyrtimin 122 ankesa, ndërkohë që janë në proces shqyrtimi 32 ankesa.

Qytetarët janë ankuar për mosllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, mosnjohjen si periudhë sigurimi të viteve të dënimit me burg ordiner, mospërfitim të kompensimit financiar të energjisë elektrike, mosmarrje përgjigje për kërkesat për pension pleqërie, ulje të masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, mosdhënie të pensionit të posaçëm shtetëror, kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit etj.

Një nga problematikat e shqyrtuara, që ka patur një numër ankesash si individualisht ashtu edhe në grup, ka qenë ajo e ndërprerjes së pensionit të pleqërisë të punonjësve që kanë punuar në miniera dhe nxjerrjen debitorë të tyre. Ankesa e tyre ka një objekt: ndërprerjen e padrejtë të pensionit të pleqërisë gjatë kohës së punësimit në subjekte private dhe nxjerrjen debitor.

Sipas shpjegimeve të tyre, ata shprehen se pa paragjykuar profesionet e tjera, puna në miniera ka qenë dhe mbetet një ndër punët më të vështira, pasi puna në miniera ishte në kushte skandaloze, pa sigurim teknik dhe mund të mos dilje i gjallë nga galeria. Puna e kryer në ndërmarrjet minerare dhe minierat e gjellogjisë u ka shkurtuar jetën dhe u ka krijuar shumë sëmundje profesionale të gjithë punonjësve që kanë punuar në to. Kësaj i shtohet edhe fakti që gjendja e tyre ekonomike është tepër e vështirë dhe duke qenë se nuk mund të përballojnë jetën e përditshme, janë punësuar në subjekte private, me qëllim që të rriten të ardhurat në familje, si dhe të kenë mundësi për blerjen e medikamenteve të ndryshme, të domosdoshëm për ta. Ata janë punësuar me kontratë pune dhe kanë derdhur rregullisht kontributet shoqërore.

Ligji nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, në nenin 5, E drejta për përfitim, ka përcaktuar se: “...Personi, i cili ka përfituar pension sipas këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve për periudhën/periudhat, gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetpunësuar apo punëdhënës, me përjashtim kur vetpunësohet në bujqësi”.

Gjithashtu ata shprehen se kur i kanë dorëzuar të gjitha dokumentat për përfitim të pensionit të pleqërisë pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku e kanë vendbanimin, dhe nga ana e punonjësve nuk u është kërkuar asnjë dokument tjetër nëse ata ishin në marrëdhënie pune ose jo.

Institucioni ynë, pas shqyrtimit të ankesave, më datë 29.12.2016 i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për dërgimin e një infomacioni të detajuar lidhur me trajtimin e kësaj problematike tepër imediate dhe kemi sugjeruar faljen e detyrimeve për to, për vetë kushtet specifike në të cilat ndodhet kjo kategori.¹⁴ Jemi në pritje të përgjigjes.

¹⁴ Doculive nr 201602413, nr.201602392

Një problematike tjetër, që ka të bëjë me një grupim tjetër të kategorive të pensionistëve, është edhe ai i nxjerrjes debitorë të invalidëve të punës, të cilët kanë qenë të punësuar gjatë kohës që kanë qenë përfitues të pensionit të invaliditetit. Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga rasti i publikuar në Gazetën Telegraf më datë 05.12.2016, me titull “*ISSH po zhvat sigurimet e 7600 invalidëve, të paguara nga privatët*”, filloi me iniciativën e tij këtë çështje.

Nëpërmjet këtij artikulli, jemi vënë në dijeni se sipas Kryetarit të Invalidëve të Punës së Shqipërisë, të drejtat e invalidëve po çenohen dhe mohohen dhe asnjë premtim i mbajtur. Sipas tij, pas kontrolleve të ushtruara në dosjet e invalidëve të punës, AUDITI pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ka pezulluar 7600 pensione invaliditeti, duke i mbajtur padrejtësisht shumata e lekëve, me pretendimin së janë dhënë tepër. Në rastet e ngritura, bëhet fjalë për invalidë pune, të cilët janë deklaruar nga KMCAP-i “*me 6 orë ose 8 orë, me punë të lehtë*”.

Këta invalidë me mënyrat e tyre kanë gjetur mundësi punësimi dhe janë punësuar si në institucione shtetërore apo private. Ata nuk janë riaftësuar, por janë munduar për t’u integruar në shoqëri, por njëkohësisht për të ndihmuar edhe familjen, duke eliminuar njëkohësisht edhe përfitimin e ndihmës ekonomike. Gjithashtu, mbajtja e shumave të lekëve të invalidëve të punës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi i gjithë dokumentacioni i dorëzuar pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore është plotësuar sipas kërkeve të tyre, dokumenta, të cilat administrohen nga ato drejtori. Këtë çështje Kryetari i Invalidëve të Punës së Shqipërisë e quan një diskriminim që u bëhet invalidëve të punës, të cilët kanë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe përfitojnë më pak të ardhura se pjesa tjetër e invalidëve, të cilët nuk kanë kontribuar në skemë.

Institucioni i Avokatit të Popullit më datë 20.12.2016, i është drejtuar Drejtorit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Jemi në pritje të përgjigjes.

Si në vitet e mëparshme, edhe gjatë vitit 2016, ka patur një numër të konsiderueshëm të ankesave që kanë patur si objekt masën e ulët të pensioneve të pleqërisë dhe kanë kërkuar ndërhyrjen tonë institucionale për rilogaritjen e masave të pensioneve. Pas shqyrtimit të ankesave, u kemi rekomanduar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rilogaritje të masave të pensioneve. Rekomandimet tona janë marrë në konsideratë, duke u bërë rilogaritjet e përkatëse të pensioneve. Disa ankues kanë përfituar rritje të masës së pensionit si dhe u janë dhënë diferencat përkatëse.¹⁵

Për t’u pajisur me aktet e ndodhura në dosjen e tyre të pensionit, ankuesit kanë kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për vënien në dispozicion të tyre. Pas ndërhyrjeve tona institucionale, ankuesve ju është bërë e mundur pajisja me dokumentat e kërkuara.¹⁶

Pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr.409 datë 01.06.2016 “Për ngushtimin e diferencave masën e pensioneve”, janë paraqitur një numër ankesash. Ankues, të cilët kanë dalë në pension pleqërie gjatë periudhës 1993-1996, nuk kanë përfituar nga ky vendim. Me marrjet e ankesave, u jemi drejtuar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku ankuesit kanë vendbanimin. Nga përgjigjet e ardhura, ka rezultuar, se pavarësisht se vendimi i sipërcituar shton masat e pensioneve për ata pensionistë që e drejta e përfitimit të pensionit të pleqërisë u ka lindur gjatë

¹⁵ Doculive nr.201600229, nr.201600273, nr.201600306, nr.201600373, nr.201600463, nr.201600520, nr.201600593, nr. 2016001018, nr.201602097, nr.201601488, nr.201602268....

¹⁶ Doculive nr.201600605, nr.201601104, nr.201600660

periudhës 1.10.1993 deri në 31.12.1996, ata nuk kanë qenë në kushtet për të përfituar shtesë në masën e pensioneve.

Problematika, të cilat janë prezantuar në raportin vjetor 2015 dhe ende kanë mbetur pa u zgjidhur, po i paraqesim si më poshtë:

- Ulja e moshës për përfitim të pensionit të pleqërisë për kategorinë e ish-punëtorëve tipografë.
- Për mosdhënien e së drejtës për të përfituar pensionin e invaliditetit për personat që në 5-vjeçarin e fundit para lindjes së të drejtës nuk janë në marrëdhënie pune.
- Ende nuk ka një marrëveshje në fushën e sigurimeve shoqërore me shtetet fqinj, Itali dhe Greqi, për njohjen e viteve të punës.

3.12 E drejta për kujdes shëndetësor

E drejta për kujdes shëndetësor, është një e drejtë e cila bën pjesë në kategorinë e të drejtave të pacënueshme ka një natyrë të dyfishtë. Së pari krijon një të drejtë themelore të njeriut dhe ka si qëllim përqasjen e integritetit fizik dhe psikik të njeriut. Nga ana tjetër e drejta për kujdes shëndetësor përcakton dhe një interes kolektiv të shoqërisë për të mos pasur pasoja negative në shëndetin e çdokujt. “Të drejtat e njeriut” nuk është vetëm një term i përgjithshëm që përfaqëson një simbol të shoqërisë sonë bashkëkohore, por edhe reflektim i një perceptimi të përbashkët mbi vlerat njerëzore. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut njih “dinjitetin e lindur” dhe “të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore”. Është pikërisht në bazë të këtij koncepti për personin, dinjitetin dhe barazinë e të gjitha qenieve njerëzore, mbi të cilin u zhvillua nocioni i “të drejtave të pacientëve”. Kuptimi i të drejtave bazë të individit ndihmoi që të merrnin formë e të njiheshin e respektoheshin, si nga shtetit ashtu dhe nga mjekët, të drejtat e pacientëve si qenie njerëzore.

Qëllimi final i shërbimit shëndetësor parësor është shërbim shëndetësor më i mirë për të gjithë (OBSH, 2014), kështu në lidhje me këtë OBSH (2014) ka identifikuar pesë elemente kyç për të arritur këtë qëllim:

- Të ulë ndjeshëm pabarazitë sociale dhe përjashtimin e grupeve të marxhinalizuara (reformat e mbulimit universal në shëndetësi);
- Organizimi i shërbimeve shëndetësore rreth njerëzve në nevojë dhe sipas pritshmërive (reformat në dhënieën e shërbimit);
- Integrimi i shëndetit në të gjithë sektorët (reforma për politika publike);
- Ndjekja e modeleve bashkëpunuese për politika dialoguese (reformat drejtuese); dhe
- Rritja e pjesëmarrjes së palëve të interesuara.

Funksionimi i Kujdesit Shëndetësor rregullohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10138 datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, Ligji nr.7870 datë 13.10 1994 “Per sigurimet shendetësore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.8092, datë 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, Ligjin nr.7870, date.13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore ne Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 neni 97, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” etj. Konventa e Këshillit të Europës “Për të drejtat e njeriut dhe biomjeksinë” (ratifikuar me ligj Nr. 10339, date 28.10.2010),

Konventa kuadër e Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit"¹⁷, Konventa e ILO në lidhje me "Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës" (ratifikuar me ligj Nr. 9147, datë 30.10.2003), Konventa e ILO në lidhje me "Sigurimin dhe shëndetin në miniera"¹⁸, Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Kombet e Bashkuara, 1965. Ligji nr. 7580 datë 29.07.1994 "Kodi Civil" etj.

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim **92 ankesa në fushën e shëndetësisë në përgjithësi**. Objekti i ankesave kanë qënë zvarritje trajtimi mjekësor për shkak të fluksit në QSUT, kërkesa për kurim jashtë vendit, ankesa për mungesa në medikamente kryesisht në spitalin onkologjik në QSUT, ankesa për mospërfshirje në listat e rimbursimit të medikamenteve kryesisht të moshës së tretë, largime nga puna për shkak të reformës në shëndetësi etj. Nga numri i ankesave të marra në total për 85 ankesa ka përfunduar shqyrtimi, ndërsa 7 të tjera janë në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara 40 ankesa janë zgjidhur në favor të qytetarit .

Vështrim i përgjithshëm i problematikave të konstatuara në sistemin shëndetësor dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës:

Në kuadër të veprimtarisë së tij, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit veç trajtimit të ankesave apo dhe rolit proaktiv të rasteve me inisiativë ka kryer gjatë vitit 2016 edhe inspektime në Spitalet Rajonale dhe konkretisht Krujë, Laç, Tiranë.

Një çështje e cila paraqitet problematike në shumë prej spitaleve rajonale të inspektuara është infrastruktura e disa prej godinave ku ushtrojnë aktivitetin ato. Shumë prej këtyre godinave nuk janë rikonstruktuar fare ose kanë pasur ndërhyrje të pjesshme në vite por aktualisht paraqesin problem. Problematikë në spitalet rajonale vazhdon të mbetet e mbartur mungesa e mjekëve specialist, personel mjekësor ndihmës, aparatura mjekësore të amortizuara. Gjithashtu problematike megjithëse vit pas viti ka rritje buxheti mbetet furnizimi me medikamente kryesisht citostatikë në spitalin onkologjik në QSUT, Tiranë si dhe mungesës së disa medikamenteve shumë të kushtueshme në spitalin pediatrik (fëmijë me sëmundje të rënda) për shkak të dështimit të procedurave të tenderimit.

Ministria e Shëndetësisë si institucion përgjegjës ka pranuar përgjegjësitë për rekomandimet tona dhe problematikat e konstatuara duke u angazhuar se do i ketë përparësi për zgjidhje të mëtejshme dhe planifikime fondesh në buxhetet pasardhëse. Sa i takon mungesës permanente të mjekëve specialist në spitale rajonale MSH informon se po zhvillohen dy kurse specializimi afatgjatë në mjekësi të cilat do plotësojnë në masë të mirë, nevojat për mjek specialist.

Rastet e trajtuara me inisiativë kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive që lidhen me trajtimin shëndetësor të pacientëve të ndryshëm, kushtet e ofrimit të shërbimit apo mungesa e ofrimit të këtij shërbimi. Ndër rastet me inisiativë më të rëndësishme të trajtuara nga ana jonë për vitin 2016 ka qënë *Shkurtimi i numrit të shtretërve në spitalin onkologjik* . Drejtorja e QSUT-së ka urdhëruar shkurtimin e shtretërve duke e reduktuar në 64 shtretër. Gjithashtu në këtë shkrim ka disa intervista me pacientë të këtij shërbimi, të cilët ankohen për mungesa të medikamenteve dhe sorollatje nga java në javë, duke mos marrë

¹⁷ Ratifikuar me ligj Nr. 9474, datë 9.2.2006.

¹⁸ Ratifikuar me ligj Nr. 8938, datë 12.9.2002.

parasysh largësinë dhe shpenzimet financiare të tyre, pasi vijnë nga shumë rrethe të vendit.¹⁹

Rast tjetër i trajtuar me iniciativë ka qënë edhe mungesa e skemave të mjekimit për pacientët me HIV-AIDS. Numri i të sëmurëve është i lartë, mbi 700 pacientë të cilët rrezikojnë edhe jetën nga mungesa e paketës së medikamenteve “Antri Rentro Viraleve”.²⁰

Një problematikë tjetër ka qënë ajo e Shoqatës së Fëmijëve dhe të rinjve me diabet, të cilët kanë kërkuar: Rimbursim të fishave për matjen e nivelit të sheqerit (glicemisë) dhe ageve të aparateve matës (lancetave) dhe ageve për injeksionin e insulinës. Rimbursim i plotë i analizës së HbA1c në të gjithë Shqipërinë ose të paktën në spitalet rajonale. Lehtësimin e procedurave në marrjen e insulinës dhe ndryshimin e dozave. Dalja në KEMP, për personat me diabet të tipit 1, të kryhet një herë në tre vjet dhe jo çdo vit.²¹

Avokati i Popullit përmes ngritjes së këtyre problematikave, ka si qëllim sensibilizimin e punonjësve të administratës shëndetësore për një shërbim shëndetësor cilësor dhe gjithpërfshirës. Vlen të theksojmë bashkëpunimin dhe korrektësinë që kemi me QSUT-në, në trajtimin e problematikave që ne adresojmë.

3.13 E drejta për arsimim

Arsimimi është çelësi i zhvillimit ekonomik dhe të gëzimit të shumë të drejtave të tjera të njeriut. Është e rëndësishme që shteti të garantojë mundësinë e frekuentimit të shkollës për të gjithë fëmijët, pavarësisht shtresave sociale të cilës ata i përkasin.

Një numër i të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore, sikurse e drejta për zgjedhjen e punës, për të marrë pagë të njëjtë për punë të njëjtë, për të gëzuar të mirat e përparimit shkencor e teknik dhe për të marrë arsimim të lartë në bazë të aftësive, mund të ushtrohet në mënyrë kuptimplotë nëse është arritur një shkallë minimale e arsimimit. Për minoritetet etnike dhe gjuhësore, e drejta për arsimim është një mjet thelbësor për ta ruajtur dhe forcuar identitetin kulturor.

E drejta për Arsimim ka bazë solide në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo ishte e shtruar me kujdes në disa akte ndërkombëtare dhe në legjislacionin e brendshëm, në Kushtetutën e RSh-së, Ligjin Nr 69/2012, datë 21.06.2012 “Për Arsimin Parauniversitar”, (i ndryshuar), Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë nr.80/2015.

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 97 ankesa në fushën e arsimit në përgjithësi. Nga këto, 7 kanë qënë raste me iniciativë të trajtuara nga ana jonë. Nga numri i ankesave të marra në total, për 90 ankesa ka përfunduar shqyrtimi dhe 7 janë ende në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 35 ankesa janë të zgjidhura pozitivisht.

Nje vështrim i përgjithshëm i problematikave të konstatuara në sistemin arsimor si vijon:

¹⁹ Ne e trajtuam këtë rast me drejtorinë e QSUT-së të cilët në përgjigjen e tyre e justifikojnë këtë riorganizim me përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve duke synuar përmirësimin e indikatorëve spitalorë dhe investimet në drejtim të përmirësimit të diagnostikës dhe trajtimit klinik.

²⁰ Në përgjigjen e saj drejtoria e QSUT-së sqaron se në bashkëpunim me UNICEF ka filluar furnizimi duke pritur ne vijimësi zgjidhje përfundimtare.

²¹ Në përgjigjen e saj MSH ja delegoj për zgjidhje Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor si organ kompetent për zgjidhjen e kësaj problematike.

Problematikat kryesore që ka trajtuar institucioni ynë lidhur me fushën e arsimit kanë qënë të ndryshme por ato që kanë spikatur më shumë kanë qënë mungesa e mësuesve ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta, kërkesat për punësim, largimet e padrejta, emërimet pa transparencë, segregimi i fëmijëve romë në shkolla të posaçme në Elbasan, mungesa ose pamjaftueshmëria e psikologëve në shkolla etj.

Përfshirja sociale në arsim është një çështje e të gjithë shoqërisë dhe jo vetëm e sistemit arsimor. Arsimi gjithpërfshirës, si një hap i parë drejt përfshirjes sociale, është në dobi të të gjithë shoqërisë. Përvoja e shekullit të kaluar i dha një mësim të çmuar shoqërisë se veçimi i një pjese të nxënësve në shkolla të veçanta ka efekte negative në jetën e tyre të mëtejme por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Përmirësimi i qasjes në arsimim për të gjithë, në bazë të parimit të barazisë dhe jodiskriminimit dhe lirisë për të zgjedhur llojin dhe përmbajtjen e shkollës, paraqet shpirtin dhe thelbin kryesor të të drejtës për arsimim.

Një nga ankesat dhe problematike e rëndësishme e një komuniteti të madh fëmijësh është çështja e ngritur nga Koalicioni Shqiptar Aftësi e Kufizuar dhe Zhvillimi të cilët ngritën problematikën që: MAS duhet të marrë masa më efikase për zbatimin e Ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, e më konkretisht të nenit 64 pikat 3, 4 dhe 6 sepse ende: komisionet nuk arrijnë të vlerësojnë gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në rajonin që mbulon njësi arsimore vendore, për shkak të kohës së kufizuar që kanë për këtë qëllim; mungon një marrëveshje midis MAS dhe MSH dhe për pasojë në këto komisione mungon mjeku në mënyrë të përherëshme; numri i mësuesëve ndihmës të vendosur është shumë herë më i vogël, në karahasim me nevojat e fëmijëve që vazhdojnë arsimin e detyruar; mungojnë mësuesit interpretet të gjuhës së shenjave për fëmijët me aftësi të kufizuara në dëgjim si dhe mësuesit që njohin alfabetin në brail për fëmijët me aftësi të kufizuara në shikim; fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat rurale kanë akses të kufizuar për të marrë pjesë direkt në mësim, megjithëse shpesh herë ata janë të regjistruar në shkolla; për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara mungon transporti falas dhe i aksesueshëm për ta; ka një numër të madh të fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk frekuentojnë shkollën dhe arsimin parashkollor. Institucioni ynë për rastin e mësipërm hartoi rekomandimin përkatës për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit²².

Ndërsa, ndër faktorët pengues për zbatimin e arsimit gjithpërfshirës dhe mbajtjen në këmbë të shkollave speciale renditen: mungesa e akteve nënligjore për arsimin gjithpërfshirës, mungesa e fondeve të mjaftueshme për reformimin e shkollave të rregullta, mungesa e bashkëpunimit dhe izolimi i shkollave speciale nga shkollat e rregullta, mospërshtatja e kurrikulës së përbashkët ndaj nevojave të veçanta në të nxënë. Nxënësit me vështirësi në të mësuar përbëjnë edhe numrin më të madh të nxënësve me nevoja të veçanta. Arsimimi i tyre varet shumë nga aftësitë profesionale të mësuesve dhe nga burimet, dhe koha në dispozicion e mësuesve. Jo më pak rëndësi ka edhe pjesëmarrja e mësuesve në hartimin e politikave arsimore dhe në zbatimin e strategjisë së arsimit gjithpërfshirës.

Rast tjetër i evidentuar është edhe ankesa e Qendrës Evropiane për të Drejtat Rome, organizatë që punon për emancipimin e komunitetit rom në Shqipëri. Ankesa e tyre ka të bëjë mbi cenimin

²² Ngritjen dhe funksionimin pranë drejtorisë së arsimit parauniversitar, në MAS të një departamenti për të planifikuar, buxhetuar dhe monitoruar zbatimin e arsimit gjithpërfshirës me qëllim që të realizohet e drejta për arsim për gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar. Shqyrtimin, analizimin dhe zgjidhjen e shpejtë të 7 problematikave të konstatuara nga ana e KShAKZh, dhe të detajuara sa më sipër, në zbatimin e Ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

e të drejtës kushtetuese për një arsim të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor të fëmijëve të komunitetit egjiptian dhe rom, nxënës të programit të shansit të dytë, në shkollën “ Ptoleme Xhuvani” dhe “Qemal Haxhihasani 2”, DAR Elbasan. Nëpërmjet këtij informacioni, ata sjellim në vëmendjen tonë situatën e fëmijës F.M., fëmijë i komunitetit egjiptian që studion në klasat e ngritura në kuadrin e programit të shansit të dytë në Elbasan dhe përmes këtij rasti synojmë ndërmarrjen e masave më qëllim që këto klasa të mos kthehen në klasa geto për shkak të racës dhe etnisë, në kuadrin e një programi me synime integruese, por në një mundësi për t’u kthyer sa më shpejt në programin e zakonshëm të mësimin.

Situata e fëmijëve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, duke ndjekur klasat e shansit të dytë përbën një shkelje të të drejtës së tyre për tu arsimuar, në një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor. Për këtë rast ne i dërguam rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ²³.

Rastet e trajtuara me inisiativë nga ana jonë kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive dhe konkretisht Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje situatat aspak normale të shfaqura në portalet on line të dhunës mes nxënësve të moshave të ndryshme. Bullizmi është një fenomen i shpeshtë në shkollat shqiptare dhe pothuaj se çdo klasë ka një tip që do të dale mbi të tjerët dhe mundohet t’i ulë ata. Mungesa e njohjes së thelluar ndaj fenomenit , i bën mësuesit dhe drejtuesit të mbajnë qëndrime rastësore dhe kryesisht ekstreme (indiferentizëm, ose masa ekstreme për ndërprerjen e fenomenit).Sa më sipër ne i kemi drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit rekomandimin përkatës, kjo bazuar edhe në zbatimin e planit të masave për zbatimin e Rekomandimeve të ECRI-t .²⁴

Rast tjetër me inisiativë ka qënë edhe mungesa e psikologëve në shkolla apo pamjaftueshmëria e tyre për përballimin e situatave jo normale.

Arsimi është edhe një nga fushat që jo vetëm i prin shoqërisë, por edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Fakti që sistemet e arsimit janë në ndryshim të përhershëm, nuk tregon paqendrueshmëri, përkundrazi, ato shërbejnë për t’iu përshtatur sa më mirë ndryshimit të shoqërisë. Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto 20 vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mundë me ndryshimet sociale në vendin tonë, por edhe me ato globale. Këto ndryshime duan kohë vullnet dhe bashkëpunim shumpalësh për t’u realizuar në interes të arsimit të fëmijëve dhe brezit të ri. Angazhimi i gjithsecilit prej nesh si prindër, mësues, komunitet, administratë, institucione të pavarura, shoqëri civile, etj do sjellë më shumë mirëqenie.

²³ Marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur të fëmijëve egjiptian dhe rom që studiojnë në programin e shansit të dytë, ndalimin e diskriminimit dhe ndryshimin e kësaj situatë në shkollat 9-vjecare “Ptoleme Xhuvani” dhe “Qemal Haxhihasani 2”, Elbasan.

²⁴ Marrjen në analizë të gjithë sygjërimeve tona sa analizuam më sipër, dhe angazhimin tuaj për përfshirjen në kurikulat mësimore, trajnime apo programe të ndryshme mësimore, për njohjen e termit “Bulizëm” dhe luftimin e tij nga mësuesit dhe nxënësit e shkollave. Rekomandimi u pranua nga MAS dhe angazhimi i tyre do vazhdojë për luftën e këtij fenomeni.

3.14. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim

E drejta për strehim duhet të sigurohet për të gjithë njerëzit pavarësisht të ardhurave të tyre dhe të zbatohet në një mënyrë që përputhet me burimet e tyre. Sfida më e madhe nga këndvështrimi i institucionit të Avokatit të Popullit, është aftësia për të përmbushur objektivat sociale, të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, veçanërisht ato objektiva që lidhet me strehimin social, mungesa e të cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe cënon të drejtën për të jetuar me dinjitet.

Edhe axhenda e miratuar në samitin e Kombeve të Bashkuara në muajin Shtator 2015, “*Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2015 - 2030*”, i kushton rëndësi objektivës²⁵ që lidhet me strehimin e përshtatshëm, të sigurtë dhe të përballueshëm për të gjithë.

Aktualisht, megjithëse ka një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë objektivë sociale, realiteti tregon se strehimi mbetet një nga çështjet më të mprehta sociale për vendin tonë, për shkak se zbatimi i ligjit dhe përfitimi nga kjo objektivë, shpesh lidhet me kapacitete financiare që kanë në dispozicion njësitë e qeverisjes vendore për aplikimin e programeve të tilla sociale.

Përgjatë vitit 2016, institucioni i Avokatit të Popullit, ka luajtur rol proaktiv në përcjelljen e mendimeve dhe komenteve për draft-ligjin e ri “*Për Strehimin Social të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe përfshirjen institucionale në të gjithë procesin e konsultimit me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe me aktorë të tjerë në këtë proces duke filluar që në muajin Shkurt 2016. Vlen për t'u përmendur fakti që të gjithë mendimet dhe komentet e institucionit të Avokatit të Popullit janë përfshirë tashmë në draft-ligjin e ri, i cili së fundi u miratua në Këshillin e Ministrave dhe shpresojmë sa më shpejt finalizimin e tij edhe nga Parlamenti i Shqipërisë.

Dëshirojmë të përmendim përfshirjen në këtë draft-ligj të rekomandimit për njësitë e qeverisjeve vendore që duhet të parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre që, jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit Rom, si dhe hartimin e programeve të reja të strehimit, nëpërmjet dhënies së një bonusi qiraje të financuara 100% nga njësitë përkatëse, për të gjitha familjet përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe pa të ardhura financiare.

Përgjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar në total **144 ankesa** individuale, me objekt mospërmbushjen nga ana e organeve përgjegjëse, të objektivës sociale të strehimit, kundrejt familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehit. Në 11 raste kemi adresuar rekomandime drejtuar njësite të qeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për realizimin e objektivës së strehimit, me qëllim përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave, apo vendstrehimeve alternative, veçanërisht për grupet e cënueshme dhe në pamundësi ekonomike.

- Individët, të cilët gëzojnë statusin e të pastrehit, apo përfshihen në kategorinë e më të “varfërve”, pa asnjë mundësi financiare, nuk arrijnë të gjejnë zgjidhje dhe nuk përfitojnë nga programet sociale të strehimit. Kjo për shkak se ata janë me ndihmë ekonomike minimale dhe nuk kanë mundësi financiare të paguajnë pjesën tjetër të qirasë kur bëhen pjesë e programit social për strehimin me qera të subvencionuar nga njësitë e pushtetit vendor. Kjo kategori, gjithashtu nuk përfiton as nga programet sociale të strehimit të kredive të buta me vlerë të banesës në kosto, për shkak të mos plotësimit të kriterit të të ardhurave me qëllim pagimin e kredisë mujore.

²⁵ Goal 11: Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable

- Ashtu sikundër edhe në vitet e mëparshme, janë konstatuar se ka një numër të konsiderueshëm familjesh (*kryesisht familje të komunitetit Rom*), të cilët përballen me nevoja ekstreme për të siguruar një vendstrehim, si dhe në disa raste me zhvendosjen e tyre me forcë nga qendrat e vendbanimeve, sikundër ka qenë edhe rasti i 16 familjeve në lagjen 10, të qytetit të Korçës, njohur ndryshe si ish “Poligoni i sportit”, të cilët janë njoftuar verbalisht nga punonjës të Bashkisë Korçë, për të liruar banesat në të cilat ata jetojnë.

Këto familje janë strehuar me një autorizim që prej vitit 1992, nga ish lagjia, për t’u strehuar në këto banesa. Që në momentin e hyrjes të tyre në këto banesa ata kanë paguar qira banese, por kjo pagesë ka rreth 6-7 vjet që nuk paguhet, pasi kanë marrë urdhër që nuk do ta paguajnë për shkak se Bashkia Korçë, do t’u gjente mundësi tjetër strehimi.

Nga hetimet administrative që kemi ndërmarrë për trajtimin e këtij rasti pavarësisht shpjegimeve që na janë përcjellë nga Bashkia Korçë, kemi konstatuar se mungon një plan i detajuar për strehimin e këtyre familjeve pas zhvendosjes së tyre, si dhe një akti zyrtar mbi bazën e të cilit ka filluar ky proces dhe hapave që do të ndiqen për zgjidhjen përfundimtare të strehimit të familjeve të këtij komuniteti. Po kështu, nuk na janë dërguar kopjet e akteve zyrtare të mundshme, të nxjerra për trajtimin e këtij procesi nga ana e Bashkisë Korçë.

Duhet të theksojmë faktin se ky nuk përbën një rast sporadik apo të vetëm që ne kemi konstatuar nga ana jonë, pasi këto janë problematika dhe situata të përsëritura në vend për komunitetin Rome/Egjiptian, të cilat bazuar edhe në standardet ndërkombëtare përbëjnë një ndërhyrje në kushtet e dëbimit me forcë. Rekomandimet tona kanë patur për objekt gjetjen e zgjidhjeve të situatave në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që këtij komuniteti t’i ofrohen zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synojnë dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në vend.

- Problematikë tjetër e konstatuar përgjatë vitit 2016 është zvarritja e procedurave nga ana e strukturave shtetërore për zbatimin e Akt-Marrëveshjeve të lidhura me subjekte të ndryshme për strehimin e këtyre qytetarëve. Aktualisht, rreth 30 familje vuajnë pasojat e moszbatimit të Akt-Marrëveshjeve për strehimin e tyre në banesa të ndryshme, të zëna tashmë nga subjekte të tjera.

Duke mbajtur në konsideratë problematikën e mësipërme, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Zhvillimit Urban parashikimin në ligjin e ri të strehimit, dispozita kalimtare që do të rregullojnë përfundimisht problemin e mbartur ndër vite të familjeve që disponojnë Akt-Marrëveshje për strehimin e tyre, pasi kjo përbën jo vetëm sfidë për institucionet ndaj këtyre familjeve, por edhe detyrim për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre, të shkelura ndër vite. Efektivisht, mospërmbushja e nismave të tilla përbën shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve, apo përfaqësues të këtyre kategorive, për t’u trajtuar me strehim sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Në rastin konkret, ndonëse ligji i njeh të drejtën e trajtimit këtyre familjeve, të pajisur edhe me Akt-Marrëveshjet respektive, ai nuk po gjen zbatim, në kushtet kur nuk janë propozuar dhe miratuar ndryshimet respektive ligjore, mbi bazën e të cilave rregullohet kjo situatë, me qëllim që individët apo përfaqësues të kësaj kategorie, të trajtohen në mënyrë të barabartë, si pjesa tjetër e përfituesve të parashikuar nga ligji.

- Duke ju referuar situatës emergjente me të cilat është përballur vendi ynë nga temperaturat ekstremisht të ftohta, kemi adresuar rekomandime drejtuar 61 njësisive të pushtetit vendor dhe kemi bërë thirrje për marrjen e masave emergjente në ndihmë të kategorive të

popullsisë, të cilët realisht janë në pamundësi për sigurimin e një vendstrehimi të përkohshëm apo për ofrimin e ndihmave shëndetësore.

Është për t'u përgëzuar fakti se një pjesë e Bashkive në vend, sikundër kanë qenë Bashkia Tiranë, Pogradec, Skrapar, Librazhd, Kurbin, Vau i Dejës, kanë reaguuar në mënyrë të menjëhershme duke krijuar "strehëza të përkohshme" për të gjithë personat "endacakë", por fatkeqësisht janë konstatuar edhe disa raste të cilat kanë rezultuar fatale me humbje jetësh njerëzore për shkak të të ftohtit ekstrem.

Avokati i Popullit, megjithë problematikat e konstatuara vit pas viti është i vetëdijshëm se një pjesë e njësive të pushtetit vendor kanë vështirësi financiare për ndërtimin e banesave sociale, apo edhe për ofrimin e programeve të tjera sikundër mund të jetë bonusi i qirasë sociale, por referuar edhe standarteve ndërkombëtare tashmë, strehimi nuk duhet parë thjesht si një objektivë sociale, por si një e drejtë e cila lidhet me dinjitetin njerëzor.

Duke mbajtur në konsideratë se tashmë ka kaluar mbi një vit që nga miratimi i reformës administrative-territoriale si dhe faktin e draftimit të një ligji të ri për strehimin në vendin tonë, ne do të ndërmarrim monitorime të vazhdueshme ndaj njësive të pushtetit vendor në drejtim të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe në veçanti për strehimin social, jo vetëm nëpërmjet ofrimit të programeve sociale të strehimit, por edhe në drejtim të ofrimit të vendstrehimeve alternative për të gjithë grupet vulnerabël dhe të pamundur.

3.15. Ndihma ekonomike

Programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre. Ndihma ekonomike si përcaktim ligjor parashikohet në Ligjin nr.9355 datë.10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Sistemi digital, që filloi të zbatohet në muajin Qershor 2014 nga MMSR në bashkëpunim me njësitet e qeverisjes vendore, me anë të një formule të pikëzuar, të përgatitur nga një studim i Bankës Botërore në përputhje me mundësitë e ofruara nga Qeveria Shqiptare, ka patur si qëllim identifikimin e familjeve në nevojë, përmirësimin e vlerësimit të përfituesve për familjet aplikante, përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2016 ka trajtuar 48 ankesa, përsa i përket ndihmës ekonomike, të cilat kanë qënë si individuale dhe familje.

Disa nga problematikat kryesore të adresuara nëpërmjet ankesave gjatë vitit 2016 janë:

1. Mungesa e informacionit ligjor të qytetarëve mbi procedurat dhe kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike.
2. Përjashtimi, ose mos përfshirja si përfitues të familjeve me pak anëtarë, ose një personi të vetëm.
3. Ndërprerje e ndihmës ekonomike pas trajtimit për një kohe relativisht të gjatë me ndihmë ekonomike.
4. Mospërfitim të ndihmës ekonomike.
5. Rritje të masës së ndihmës ekonomike.
6. Pamundësia e kryerjes të vizitave në familje për evidentimin e gjëndjes, sipas mënyrës së

parashikuar, nga administratorët shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore.

7. Në disa raste vonesë në mosdhënien në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike. Kjo, më së shumti ka ndodhur pas zgjedhjeve të pushtetit vendor si pasojë e vënies në zbatim të reformës administrative.

8. Mos parashikime Fondesh në buxhetet e njësive të qeverisjes vendore ashtu si parashikohet në legjislationin në fuqi.

Nga ankesat e trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit nga zbatimi i projektit pilot, rezulton se nga përgjigjet e ardhura nga njësitë e pushtetit vendor, shumë familje nuk kishin marrë pikët e mjaftueshme pas verifikimit automatik nga sistemi dixhital i pikëzimit. Gjatë trajtimit të ankesave në këtë fushë, kemi konstatuar se shumë shtetas, apo familje janë trajtuar për një periudhë të gjatë me ndihmë ekonomike, deri në momentin kur kjo ndihmë i është refuzuar ose ndërprerë, ashtu si dhe megjithëse kanë aplikuar për vite me rradhë përsëri kanë rezultuar jo përfitues të ndihmës ekonomike.

Pas verifikimeve të këtyre rasteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit pranë institucioneve përgjegjëse si Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror apo Njësive Administrative rezultuan, se shkak i mos-përfitimit të ndihmës ekonomike kanë qënë se anëtarë të familjeve aplikuese nuk kanë bërë deklaratimin tre-mujor pranë njësive administrative, apo paraqitjen e dokumentacionit përkatës nga individë të ndryshëm të cilët kanë ri-aplikuar pranë njësive administrative, ose janë trajtuar me pension pleqerie apo invaliditeti, dhe kur një ose dy anëtarë të familjes kanë qënë në marrëdhënie pune, gjë e cila kundërshtonte vendimin nr. 787 datë 14.12.2005, “Për përcaktimin e kriteve të përcaktuara dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike.

Gjithashtu janë trajtuar me iniciativën e Institucionit dhe raste të bëra publike në media, të cilat subjekt kanë patur familjet në nevojë. Mund të përmendim një nga rastet e marra me iniciativë ku bëhet fjalë për një familje ku dy fëmijë të mitur, jetonin mes skamjes dhe varfërisë në një fshat të Laçit me babain e tyre. Nga Shërbimi Social ai mernte vetëm 3400 lekë, dhe se kishte punuar 12 vjet dhe nuk përfitonte dot pension as për vete e as për të vegjlit.

Nisur nga kjo panoramë e trishtë e kësaj familjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit i kërkoi një informacion (*Bashkisë Laç dhe DR të SHSSH Lezhë*) lidhur me trajtimin e kësaj familjeje, nga ana e pushtetit vendor dhe strukturave, përkatësisht lidhur me:

1-Trajtimin e problemit të strehimit të kësaj familjeje.

2-Problemin e përfitimit nga skema e ndihmës ekonomike, mundësimin e trajtimit financiar si rast i veçantë, dhe cila është ndihma që mund t'i ketë dhënë dy të miturve të familjes kësaj familjeje në kushte ekstremisht të vështira për mbijetesën.

Referuar përgjigjes me shkresën nr.3680/1 prot., të dt.18.11.2016 të Kryetarit të Bashkisë Kurbin rezultoi se Bashkia Kurbin kishte ngritur grup pune për verifikimin e situatës, dhe nga ky verifikim kishte rezultuar se kjo familje jetonte në fshatin Shën Meri të Mamurrasit, ku banesa ishte në kushte të vështira, por jo e pabanueshme.

Në muajin Prill-Dhjetor 2016 ai ishte ndihmuar nga Këshilli Bashkiak me ndihmë financiare dhe po ashtu po ndihmohej nga sektori i mirëqënies sociale për tek sigurimet shoqërore, për mbledhjen dhe plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e pensionit social.

Nga ankesat e trajtuara mund të përmendim dhe rastin e një qytetari nga Pogradec, i cili ankohej për mospërfitimin e ndihmës ekonomike.

Për shqyrtimin e kësaj ankese, Avokati i Popullit iu drejtua Bashkisë Pogradec, e cila në përgjigjen e saj me shkresën nr.777/1 Prot, datë 26.04.2016 informon se qytetarit i ishte refuzuar

kërkesa për trajtim me ndihmë ekonomike për arsye të mos-dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga Zyra e Ndihmës Ekonomike siç ishte Çertifikata e Pronësisë së Tokës nga Zyra e Pasurive të Paluajtshme ose Aktin e Marrjes në Pronësi të Tokës për zonat ku rregjistrimi i pasurisë nuk kishte përfunduar.

Gjithashtu kjo bashki i sugjeronte qytetarit se pasi të kishte dorëzuar të gjitha dokumentat duhet ti paraqiste ato pranë Sektorit të Ndihmës dhe Kujdesit Social Bashkia Pogradec dhe pasi të bëhej llogaritja e të ardhurave nga toka do të përfitonte ndihmë ekonomike të pjesshme.

3.16. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Shqipëria ka legjislacion të konsoliduar mjedisor, por situatë aktuale e mjedisit dëshmon për një zbatim të dobët të kuadrit ligjor të miratuar për këtë fushë. Institucioni i Avokatit i Popullit gjatë veprimtarisë së tij i ka kushtuar edhe gjatë vitit 2016 një fokus të veçantë zbatimi me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim që të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standarteve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.

Avokati i Popullit konstaton në vijimësi faktin se problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është edhe mungesa e ndëshkimit apo edhe gjobat mjaft të ulëta për ata individë apo subjekte që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2016 ka trajtuar një sërë ankesash të paraqitura ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, si edhe promovimin e një ambienti e mjedisi sa më të pastër dhe të shëndetshëm.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është treguar mjaft aktiv në trajtimin e rasteve të ndryshme me iniciativën e tij, me qëllim hetimin dhe verifikimin e çështjeve të ndjeshme në këtë fushë, kur janë konstatuar veprime apo mosveprime në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, të cilat çenojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Avokati i Popullit konstaton sërish faktin se ka një sensibilizim në rritje të individëve për të kërkuar reagimin e institucioneve shtetërore përsa u përket çështjeve mjedisore.

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 49 çështje me iniciativë dhe ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë shprehur shqetësimin e tyre për cënime të së drejtës së tyre të ligjshme për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Nga çështjet e sipërcituara, rezulton se pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur për shqyrtim 33 ankesa nga individë apo grupe individësh të ndryshëm, ndërkohë që për 16 çështje Avokati i Popullit ka filluar shqyrtimin me iniciativë.

Në këtë kuadër mund të theksojmë çështjet e iniciuara lidhur me ndotjen alarmante për shkak të hedhjes së mbetjeve urbane dhe inerteve në lumin e Osunit, mungesën e infrastrukturës dhe ndikimit në mjedis për banorët e ish-Kënetës në Durrës, ndotja e mjedist në fshatin Tapi/Ura Vajgurore, ndotjen e mjedisit nga ujërat e zeza në qytetin e Pogradecit, ndotja e liqenit të Fierzës nga mbetjet e ndryshme urbane, si edhe rrezikimi i shëndetit të banorëve të komunitetit rom në Shkodër, në afërsi të Urës së Bunës, si edhe ndotja e mjedisit në kampin e romëve në Shkozë, si pasojë e ndotjes së mjedisit përrreth zonës ku banojnë.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit ka ndjekur me interes dhe përparësi edhe veprimet e ndërmara nga Ministria e Mjedisit në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të Shtetit Shqiptar në zbatim të Marrëveshjes së Parisit, si një akt ndërkombëtar që parashikon ulje të niveleve të ndotjeve nga shtetet palë të saj, me qëllim garantimin dhe respektimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, jo

vetëm për popullsinë aktuale të botës, por edhe për brezat e ardhshëm, duke e vlerësuar si një e drejtë themelore e njeriut.

Shqetësimet dhe pretendimet e ndotjes së mjedisit janë evidentuar dhe iniciuar në kuadër edhe të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile nëpër rrethe, të cilat përcjellin apo delegojnë pranë institucionit tonë shqetësimet e komuniteteve lokale në qytetet e tyre, si edhe aktivitetit dhe veprimtarisë së përfaqësuesve lokalë të Avokatit të Popullit në Zyrat Rajonale të ngritura nëpër rrethe të caktuara në mbarë Shqipërinë.

Duhet theksuar fakti se shkak i burimit ndotës është pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktojnë ndotjen mjedisore.

Nga çështjet e shqyrtuara, 36 raste të regjistruara në vitin 2016 janë mbyllur gjatë kësaj periudhe raportimi, 30 raste janë zgjidhur në favor të ankuesve, në tre raste ankuesit kanë hequr dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i pretendimeve të tyre, ndërkohë që për tre dy çështje janë hartuar pesë rekomandime drejtuar Kryetarit të një njësie të qeverisjes vendore, si edhe strukturave të tjera shtetërore të mbrojtjes dhe monitorimit të gjendjes së mjedisit, të cilat janë pranuar nga këto struktura. Ndërsa dhjetë ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2017.

Konkretisht objekti i ankesave kanë qenë ndotjet e ambientit nga hedhja e mbeturinave në vende publike, ndotja e ajrit nga djegiet e mbetjeve urbane si në zonë e Fierit apo Dropullit, aktivitetet e subjekteve që veprojnë shpesh në tejkalim të lejeve me të cilat janë pajisur, si edhe ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në zonat e banuara të prekura nga këto ndotje.

Shqetësuese paraqitet ende edhe situata gjatë vijës bregdetare përsa i përket largimit të ujërave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit, si në zonën e Durrësit apo edhe plazhet e jugut, kryesisht gjatë stinës së verës. Situata në plazhet publike paraqitet në kundërshtim me synimin për një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm për kryerjen e pushimeve. Gjithashtu gjatë vitit 2016 janë konstatuar raste të ndotjes flagrante edhe të liqenit të Fierzës nga mbetje të ndryshme urbane, të cilat janë evituar me angazhimin e strukturave të ndryshme të pushtetit qendror dhe lokal, por që mbetet akoma një problem ekzistues, për shkak edhe të shtrirjes së Liqenit në hapësirat mes shteteve, duke bërë që burimi i ndotjes të mbetet në mjaft raste i painedentifikueshëm.

Lidhur me ushtrimin dhe përmbushjen brenda standardeve ligjore të së drejtës për ambient të shëndetshëm, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij të iniciativës për monitorimin e respektimit të standardeve mjedisore në 16 raste të ndryshme, duke konfirmuar në vijim rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së individit nëpërmjet fokusimit në çështjet e mjedisit në të cilin ata jetojnë. Në kuadër të procedurave administrative të shqyrtimit dhe verifikimit të qëndrimeve zyrtare të organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për kryerjen e funksioneve dhe detyrave konkrete në fushën e mjedisit, Avokati i Popullit ka hartuar dhe dërguar pesë rekomandime me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në zonën respektive, si edhe shmangien e mosveprimeve të cilat kanë shkakton një situatë të tillë ndotjeje. Në vijim të rekomandimeve të dërguara, Avokati i Popullit ka konstatuar se ka patur reagime dhe qëndrime pozitive të organeve të administratës publike të cilave u jemi drejtuar, duke ndërmarrë masa konkrete për shmangien e problemeve të konstatuara.

Problematikat në fushën e mjedisit në Shqipëri sërish mbeten të përqendruar si më poshtë:

- - Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore mjedisore në qytetet e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë, që vjen si pasojë e rritjes së numrit të makinave në qarkullim dhe pakësimin

të hapësirave të gjelbërimit, pavarësisht projekteve modeste të njësive të caktuara të qeverisjes vendore apo edhe strukturave të pushtetit qendror, për mbjelljen e fidanëve të rinj në zona që veçohen për nivele të larta të ndotjes.

- Ndotja e ujërave në Shqipëri vjen si pasojë e hedhjeve të mbeturinave në lumenj e liqene, si dhe derdhjes së ujërave të zeza të papërpunuara.
- Mbledhja e mbeturinave në Shqipëri dhe riciklimi i tyre bëhet në nivele primitive.
- Mbeturinat nuk mblidhen pothuajse fare nëpër fshatra. Por një fenomen i tillë vihet re edhe nëpër qytete të tjera në mbarë vendin. Në këtë kuadër duhet theksuar edhe fakti se ka nisma lidhur me procesin e ndarjes dhe veçimit të mbeturinave, si në qytetin e Tiranës dhe Shkodrës, si një nga fazat që do të shërbente jo vetëm në mbledhjen sa më të shpejtë të mbeturinave nga vendet e tyre të grumbullimit, por edhe në trajtimin e tyre të mëtejshëm të specializuar në impiantet e posaçme të riciklimit. Avokati i Popullit beson dhe shpreson se këto nisma do të jenë revolucionare dhe eficiente në trajtimin dhe zgjidhjen përfundimtare të problemit të trajtimit të mbetjeve në Shqipëri, me synimin që ato të shtrihen edhe nëpër rrethe të tjera.
- Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë një nga burimet e vlefshme të ruajtjes së parametrave të pranueshëm të mjedisit.

Avokati i Popullit konfirmon rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunim të të gjithë faktorëve, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe rritet cilësia e jetës.

3.17. Mbrojtja e konsumatorit

Sipas ligjit nr.9902, datë 17.04.2008, “*Për mbrojtjen e konsumatorit*”, i ndryshuar, në të drejtat bazë të konsumatorit përfshihen e drejta e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës; e drejta e mbrojtjes së interesave ekonomike; e drejta e ankimit; e drejta për dëmshpërblim; e drejta e edukimit; e drejta e marrjes së informacionit; e drejta e përdorimit të shërbimeve publike; e drejta e mbrojtjes ligjore; e drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe e drejta e përfaqësimit në organet e tyre vendimmarrëse. Referuar edhe numrit të lartë të ankesave që adresohen pranë Avokatit të Popullit lidhur me fushën e mbrojtjes së konsumatorit, realiteti tregon se shumë pak konsumatorë janë të mirëinformuar lidhur me të drejtat e tyre, ndaj në gjykimin tonë nevojitet më shumë sensibilizim në këtë drejtim.

Për vitin 2016, pranë institucionit tonë janë adresuar ***në total 249 ankesa***, të cilat lidhen kryesisht me mbifaturime nga operatorë që ofrojnë shërbime publike (*OSHEE apo Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizime sh.a*) ose edhe me cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre.

Vlen të përmendet fakti që megjithëse është një nga fushat që ka edhe numrin më të lartë të ankesave që paraqiten pranë institucionit tonë, ka edhe numrin më të lartë të zgjidhjeve pozitive për ankesat individuale të qytetarëve. Nga statistikat rezulton se gati 50% e ankesave me objekt “*shkeljen e të drejtës së konsumatorit*”, kanë gjetur një zgjidhje, kjo edhe për faktin e një bashkëpunimi të ngushtë institucional që ne kemi me këta operatorë.

Sikundër kemi evidentuar edhe vitin e kaluar një fokus të veçantë kanë marrë ankesat e konsumatorëve familjarë në vështirësi dhe pamundësi ekonomike për pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike, familje të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie, familjet me anëtarë të moshuar pensionistë; familje të komunitetit rome, apo familjet e tjera me individë të papunë, punëkërkues, dhe të përjashtuar edhe nga skema e ndihmës ekonomike.

Si vijon disa nga problematikat që janë evidentuar gjatë vitit 2016:

Pas ndryshimeve që pësoi çmimi i energjisë elektrike, me heqjen e fashës për konsumin e energjisë elektrike në muajin Janar 2015, u miratua VKM nr. 8, datë 14.01.2015, “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj si dhe në zbatim të tij*, Udhëzimi nr 1 datë 02.02.2015 “*Mbi zbatimin e vendimit nr. 8 datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 këh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike*”, ndryshuar më tej edhe me Udhëzimin nr. 15 datë 08.04.2015.

Neni 1 i VKM-së së mësipërme përcakton edhe kategoritë që përfitojnë nga kompensimi i diferencës së çmimit të energjisë elektrike, një prej të cilave janë edhe familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Nisur nga një grup ankesash pranë Avokatit të Popullit, punonjës të institucioneve arsimore në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale Elbasan, me të ardhura nga paga bruto nën 35.000 lekë për ndërprerje të kompensimit të energjisë elektrike pasi nuk plotësojnë kriterin e të qenit kryefamiljarë, ndërkohë që kryefamiljarët e tyre janë të gjithë punë-kërkues të papunë, duke mbajtur në konsideratë faktin se mbrojtja sociale dhe ekonomike e shtresave të cënueshme duhet të jetë prioritet, kemi gjykuar se është shumë e nevojshme marrja e masave për ndryshimin e VKM-së nr. 8 datë 1.01.2015, “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj*”, duke shtuar në pikën 1 të saj edhe kategorinë e punonjësve buxhetorë me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi nuk është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtarë të familjes/kryefamiljarë të punësuar ose të vetëpunësuar.

Por pavarësisht sa më sipër, ky rekomandim është refuzuar nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Problematikë tjetër e konstatuar lidhet me situatat alarmante në fshatin Shamoll të Korçës, si dhe qytetin e Delvinës për ndotjen e ujit të pijshëm, evidentuar edhe nga përgjigjet e ardhura nga Instituti i Shëndetit Publik, problematika tepër të rënda dhe serioze në drejtim të shëndetit të konsumatorëve.

Duke mbajtur në konsideratë standardet ndërkombëtare sikundër janë Direktiva e Ujit të Pijshëm 98/83/KE datë 03.11.1998, që ka të bëjë me një kompleks normash që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut duke vendosur kriteret për shëndetin dhe pastërtinë; Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e konsumatorit në të cilën citohet se: “*Qeveritë duhet që brenda objektivave dhe synimeve të përcaktuara në Dekadën Ndërkombëtare për furnizimin me Ujë të pijshëm dhe për higjenën, të formulojnë, të mbajnë dhe fuqizojnë politikat kombëtare për të përmirësuar furnizimin, shpërndarjen dhe cilësinë e ujit të pijshëm.....*”. ligji nr. 8849/2001, “*Për ratifikimin e protokollit për ujin dhe shëndetin, sipas Konventës të vitit 1992, Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujrave ndërkufitarë dhe liqeneve ndërkombëtare*”, kemi adresuar rekomandime të menjëhershme për marrja e masave nga institucionet përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm brenda standarteve të kërkuara si një nevojë emergjente për të mos cënuar në asnjë rast shëndetin e qytetarëve.

Një problematikë e mbartur ndër vite lidhet me mosrespektimin e Kontratës Tip të Energjisë Elektrike, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, apo edhe Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime lidhur me mbifaturim e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm. Mbi këtë problematikë Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar disa rekomandime në mënyrë të vazhdueshme ndër vite duke i trajtuar ankesat rast pas rasti, ku edhe kemi kërkuar nga drejtuesit

përkatës marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimeve dhe korrektimin e tyre në përputhje me treguesit përkatës.

Përgjatë vitit 2016, Avokati i Popullit i ka kushtur një rëndësi edhe përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjen e sigurisë rrugore në aksin kombëtar Shkodër-Lezhë.

Në vijim të monitorimit të zbatimit dhe garantimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve nga organet e administratës publike, duke marrë shkas nga aksidenti tragjik në kryqëzimin e Blinishtit në muajin shtator 2016 ku humbën dy shtetas shqiptarë, kemi ndërmarrë me iniciativë shqyrtimin e kësaj çështje, duke synuar në sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e organeve shtetërore për ushtrimin sa më korrekt të përgjegjësisë ligjore si dhe garantimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, të cilëve u shërbejnë.

Problematika që kemi evidentuar lidhet me mungesën absolute të korsive të ngadalësimit dhe të shpejtësisë në rrugët dytësore që lidhin këtë aks kombëtar me fshatrat që shtrihen përgjatë tij. Në rastin konkret është evidentuar nga policia se automjeti që ka tentuar të hyjë në rrugën e fshatit ka ngadalësuar deri në shpejtësinë prej 40 km/orë, por është goditur më pas nga një automjet tjetër, që ka patur destinacion tjetër, por që ka nxjerrë nga rruga automjetin që po hynte në rrugën e fshatit Blinisht.

Një problem shumë i madh në këtë segment është mungesa apo edhe përditësimi i sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale, duke përbërë shkak për anarshinë në rrugë dhe numrin e lartë të aksidenteve. Aktualisht në vendin e aksidentit janë shtuar sinjalet e rrezikut të kalimit në këtë pikë të rrezikshme, por sërish automjetet që lëvizin në këtë segment kombëtar detyrohen të ngadalësojnë apo të rrisin shpejtësinë, duke penguar kryesisht përdoruesit e tjerë të qarkullimit rrugor, pasi ndërprerja e rrugës kryesore me atë dytësore është në një kënd prej 90°.

Sa më sipër, Avokati i Popullit ka rekomanduar ngritjen e grupeve të kontrollit dhe verifikimit të pikave dhe zonave problematike në segmentin rrugor kombëtar Shkodër-Lezhë, si një prej akteve me një fluks të lartë qarkullimi.

Planifikimin dhe kryerjen e investimeve konkrete në zona apo vende ku kanë ndodhur aksidente të shumta rrugore, me qëllim reduktimin maksimal të tyre.

Evidentimin e problematikave të parashtruara dhe marrjen e masave administrative lidhur me përmirësimin e standarteve të qarkullimit rrugor dhe garantimit të jetës së qytetarëve.

Në vijim të problematikave dhe rekomandimeve që Avokatit të Popullit ka adresuar në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, do të vijojmë të kemi një rol proaktiv në monitorim të strategjisë së konsumatorit apo në ndryshime të mundshme ligjore, jo vetëm si shkak për garancinë që i ngarkohet në ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, por edhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së konsumatorit në vendin tonë.

KREU 4

Roli i Avokatit të Popullit tek grupet në nevojë

4.1 Gjendja e të drejtave të minoriteteve në vend

Në kuadër të punës së institucionit të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e minoriteteve krahas punës në investigimet e kryera “ex-officio”, ritheksojmë rekomandimin drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, në fund të vitit 2013, nga ana e Avokatit të Popullit mbi nevojën e plotësimin të kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”.

Aktualisht mbas punës të grupit ndërinstitucional të ngritur për këtë qëllim, është arritur në hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të bazuar në kontributet e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të sipërcituar, me konsulencën përkatëse edhe të ekspertëve të Këshillit të Europës.

Ky projektligj është një zhvillim pozitiv dhe përfaqëson ndërmarrjen e një nismë të domosdoshme për plotësimin e kuadrit rregullativ ligjor, për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji dhe nisur nga përmbajtja e dispozitave të draftit të paraqitur për të, Avokati i Popullit ka dhënë mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

Së pari, sot në Shqipëri njihen zyrtarisht dy lloje minoritetesh, *minoritetet etnike* kombëtare ku përfshihet minoriteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazez, si dhe *minoritetet etno gjuhësore*, ku përfshihen minoriteti Vllah dhe minoriteti Rome. Pavarësisht kësaj, realiteti i shoqërisë sonë njihet “de facto” edhe disa komunitete të tjera të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare, siç janë komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian, apo edhe komuniteti Goran. Në fakt, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 20 të saj, shprehet vetëm për personat që u përkasin pakicave kombëtare gjë që krijon edhe një debat në lidhje me njohjen e zgjeruar nga ana e shtetit tonë edhe të kategorisë së minoriteteve etno gjuhësore. Në këtë kontekst edhe titulli i projekt-ligjit flet vetëm për pakicat (minoritetet) kombëtare.

Pyetja e parë që shtyrohet në këtë kontekst është nëse parashikimet e këtij ligji pas miratimit dhe hyrjes së tij në fuqi, do të kenë efekt edhe për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve etno gjuhësore? Projekt ligji nuk lë vend për këtë gjë pasi, që në nenin 1 të tij flitet vetëm për të drejta të personave që i përkasin minoriteteve kombëtare. Ky moment krijon një boshllëk ligjor që duhet konsideruar në kohë.

Së dyti, jemi të gjithë të vetëdijshëm se, mungesa e një përkufizimi të përgjithshëm mbi minoritetet nuk ka penguar shtetet e ndryshme, sikurse edhe Shqipërinë të njohin kategori të caktuara minoritetesh bazuar në tregues të natyrës objektive dhe subjektive të komuniteteve të caktuara në vend. Për këtë arsye ne kemi rekomanduar nevojën e realizimit të iniciativës legjislativë për miratimin e një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999.

Në nenin 3 të projektligjit jepet një përkufizim për minoritetet, ku në mënyrë të përgjithshme përcaktohen disa tregues që dallojnë një minoritet kombëtar nga pjesa mazhoritare e popullsisë. Megjithatë çështja që ngrejmë është se, si do të mund të njëjhej “de jure” një komunitet ekzistues, si minoritet kombëtar në Shqipëri, apo edhe si minoritet etno-gjuhësor? A e ezauron ky definicion pjesën e rekomanduar prej nesh të kriterëve të njohjes “de jure” të minoriteteve? Mendojmë se jo dhe se kjo pjesë duhet parashikuar në dispozitat e këtij projektligji.

Së treti, meqë ekziston si praktikë nga ana e shtetit tonë, a duhet të ketë një definicion dhe kritere njohjeje “de jure” edhe për minoritetet etno-linguistike? Mendojmë që po dhe kjo duhet të jetë e pasqyruar në përmbajtjen e dispozitave të këtij projektligji.

Risjellim në vëmendje faktin se, një ndër raportet e posaçme që Avokati i Popullit ka depozituar pranë Parlamentit Shqiptar, në muajt e parë të vitit 2015 (ende i padiskutuar), është raporti që ka të bëjë me të drejtat e minoriteteve në vend. Çështjet e trajtuara në këtë raport vazhdojnë të mbeten aktuale edhe gjatë vitit 2016²⁶. Ato kanë të bëjnë me:

1. Miratimin e një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin Nr.8496 datë 3.06.1999.
2. Përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin I, të Ligjit Nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.
3. Fillimin dhe përfundimin e procesit për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose Minoritare.
4. Marrjen e masave konkrete ligjore dhe administrative për përmirësimin e aksesit në strehim, shërbimet e arsimit, shërbimet sociale dhe pjesëmarrjen në jetën publike veçanërisht të minoritetit romë, por edhe të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend. Integrimin real të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditëshme, veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qëndror.
5. Krijimin e kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe komunitetet e tjera, përfshirë këtu edhe financimin me një buxhet më adekuat për njësitë e qeverisjes vendore, ku ka komunitete minoritare dhe komunitete të tjera në një masë dalluese me pjesën tjetër të popullsisë mazhoritare.
6. Zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kritereve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku minoritetet do të gjenin veten për t’u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre.

Bazuar në këto konstatime theksojmë se, vizioni i Avokatit të Popullit bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.

4.2 Të drejtat e grave në Shqipëri

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit ka patur në vëmendje të veçantë të drejtat e grave, të cilave i ka kushtuar vëmendje jo vetëm në trajtimin e ankesave dhe problematikave të paraqitura por gjithashtu edhe në përgatitjen e një raporti hije për respektimin e të drejtave të grave.

Në Sesionin e 64 të Komitetit të Eleminimit të Diskriminimit ndaj Grave të OKB u shqyrtua raporti i 4 periodik i Shqipërisë. Avokati i Popullit paraqiti për herë të parë raportin hije për Konventën CEDAË²⁷. Komiteti i ka rekomanduar Shtetit Shqiptar të vijojë forcimin e mbështetjes për Avokatin e Popullit, duke i siguruar burimet e nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare me qëllimin e forcimit të vazhdueshëm të funksionit të monitorimit të pavarur, si dhe

²⁶ Në Dhjetor 2016, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka organizuar në Gjirokastër, një auditorium mbi të drejtat e minoriteteve, ku edhe janë ringritur si çështje nga ana e vet përfaqësuesve të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend, pikërisht këto çështje.

²⁷ I vlefshëm në linkun

http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAË/Shared%20Documents/ALB/INT_CEDAË_IFN_ALB_21837_E.pdf

të sigurimit që rekomandimet e veçanërisht ato që synojnë nxitjen e barazisë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit mbi bazë seksi ose me bazë gjinore, kanë dhënë efektin e duhur²⁸. Një numër i madh i problemeve e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit në Raportin e tij për CEDAË, janë përfshirë në “Vërejtjet përmbyllëse” që ky komitet ka lënë për Shqipërinë, e që do të përbëjnë prioritete strategjike të punës edhe për Institucionin tonë.

Pjesë e veprimtarisë promovuese për të drejtat e grave ishte organizimi në bashkëpunim me UNËOMEN i ëorkshopit²⁹ “*Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit CEDAË për Shqipërinë. Plan pune për institucionin e Avokatit të Popullit në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse dhe institucionet shtetërore*”. Komiteti CEDAË kërkon realizimin e barazisë gjinore thelbësore në përputhje me dispozitat e Konventës, gjatë gjithë procesit të zbatimit të Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, dhe kjo ishte një nga temat e përfshira në Konferencën vjetore të institucionit. Në kuadrin e veprimtarisë promovuese për të drejtat e grave, në bashkëpunim me shoqërinë civile u organizua aktiviteti “*Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Çelësi i suksesit në politikat e ndërmarra, si dhe e përfshirja e të rinjve*”³⁰ Po ashtu pjesëmarrja në aktivitetet promovuese të Shoqatës së Grave me probleme sociale mbi respektimin e të drejtave të grave, si dhe qasja në kuadër të “Rezolutës 1325”, e cila synon të sigurojë që të drejtat e grave, veçanërisht ato në fushën e paqes dhe sigurisë në Shqipëri. Zgjidhja e konflikteve dhe siguria e gruas në kushtet e faktorëve të brishtë politike, sociale e ekonomike në Shqipëri, ka qenë fokus kryesor i këtyre aktiviteteve.

Në këtë kuadër vlen të ritheksojmë rekomandimin e një viti më parë “Për marrjen e iniciativës për përmirësimet në Kodin Zgjedhor të RSH”, mbi garantimin e barazisë gjinore (50%) në përbërjen e Kuvendit të Shqipërisë, ende i pazbatuar.

Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara (*ankesa, kërkesa, njoftime, inspektime dhe raste me iniciativë*) për vitin 2016 **rezultojnë 652 gra**. Këtu nuk përfshihen rastet të cilat janë këshilluar e që kanë marrë përgjigje drejtëpërdrejt nga Drejtoria e Marëdhënieve me qytetarin. Dhe objekti i tyre është i shumëllojhtë, duke përfshirë qoftë ato të ankesë/kërkesave me karakter social e ekonomik, ashtu dhe për marrëdhënie pune, aksesit në drejtësi, etj. Ndihma aktuale ekonomike është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat e grave kryefamiljare, grave rome apo atyre nga grupe të tjera vulnerabël, si viktimat të dhunës në familje apo viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë arsye kemi kërkuar llogaritjen dhe shpalljen e nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Mungesa e këtij minimumi jetik mbetet një pengesë shumë e madhe, në përcaktimin e politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, përfshirë këtu edhe gratë. Aktualisht rezultojnë në rritje numri i bashkive në të cilat është ngritur Mekanizmi i Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje, por, ky Mekanizëm është e domosdoshme të ngrihet në 61 bashkitë e vendit.

Në disa nga bashkitë e vendit ku janë ngritur këto mekanizma, qasja multidisiplinare nuk rezultojnë e shpejtë dhe efektive. Koordinatorët kundër dhunës në familje janë ngarkuar edhe me përgjegjësi të tjera, gjë që ka ulur efektivitetin në punën e tyre në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

Në nivel vendor mungojnë shërbime si akomodimi, linja telefonike 24 orëshe, programe rehabilitimi, etj., duke vështirësuar përmbylljen e përgjegjësisë nga anëtarët e MKR.

²⁸ Pika 17.

²⁹ 27 Tetor 2016

³⁰ 1 Korrik 2016, me Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve.

Mungesa e klinikave ligjore vendore duke filluar në rang qarqesh e më pas edhe më tej, dhe ofrimit të shërbimeve prej tyre ka sjellë efekte në aksesin e grave nga qarqe të ndryshme në sistemin e drejtësisë. Megjithëse, është një nga objektivat sociale të garantuar nga Kushtetuta e RSH-së, strehimi përbën një nga çështjet më të mprehta me të cilën përballen gratë, në mënyrë të veçantë gratë në nevojë.

Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar institucioneve përkatëse të pushtetit qendror dhe vendor të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet për të shtuar programet e strehimit që ofrohen, gjë që do të rriste numrin e përfitueseve, ndër të cilët edhe përfitueset gra.

Duhet rritur ndërgjegjësimi i njësive të pushtetit vendor mbi buxhetimin e prioriteteve gjinore. Bashkitë duhet të parashikojnë dhe aplikojnë për fonde, me qëllim mbështetjen për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje, strehëzave të posaçme, shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për viktimat, programeve rehabilituese për dhunuesit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

4.3 Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve.

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve funksionon tashmë, pas rekrutimit të dy ndihmëskomisionerëve, por meqënëse ende nuk është zgjedhur Komisioneri përkatës, puna e tij është drejtuar nga Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm. Fokusi ka qenë:

- **Studimi i legjislacionit lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim përmirësimet e mëtejshme në interesin më të lartë të fëmijëve.**
 1. Rekomandimet dhe sugjerimet e dërguara pranë Komisionit të Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për draft-ligjin “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.SH”, miratuar nga Kuvendi në datën 24.11.2016.
 2. Rekomandimet dhe sugjerimet e dërguara pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me projektVKM “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2016-2020”.
 3. Propozimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve konkrete për draft-ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” në takimin e realizuar nga organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto sugjerime dhe rekomandime do të dërgohen edhe pranë Komisionit të Ligjeve, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
- **Promovimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe të gjithë aktorëve për respektimin e të drejtave të fëmijëve.**

Institucioni i Avokatit të Popullit në Dhjetor të vitit 2016, nënshkroi një marrëveshje mirëkuptimi me organizatën ndërkombëtare “Save the Children” në Shqipëri për zbatimin e projektit “*Children Keeping Children Safe*”. Qëllimi kryesor është mbështetja dhe fuqizimi i Seksionit të Promovimit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve për të rritur efikasitetin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në monitorimin e të drejtave të tyre, si dhe të sigurojë iniciativat për ngritjen e kapaciteteve në monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe dhuna, politika e mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimi i një baze të dhënash në lidhje me dokumentimin e ankesave të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2016, ka inspektuar 9 institucione publike të përkujdesit rezidencial për fëmijë. Nga inspektimet e bëra në këto qendra rezultoi se ndaj fëmijëve të institucionalizuar ka pasur raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga

stafi dhe zyrtarët përgjegjës për mirëqenien e tyre. Ndaj nga ana e institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore është e nevojshme kryerja e reformave institucionale për përmirësimin e situatës së trajtimit të fëmijëve që rriten nën mbrojtjen e shtetit. Është domosdoshmëri që në këtë proces të përfshihen edhe organizata të shoqërisë civile që kanë mjaftueshëm eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Gjatë vitit 2016, janë kryer një sërë inspektimesh në Institucionet Publike të Përkujdesjes Rezidenciale për Fëmijët në Shtëpi Fëmije dhe Shtëpi Foshnje, në rezultat të të cilave Avokati i Popullit ka nxjerrë dhe rekomandim drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, për hetim të mëtejshëm të çështjeve për të cilat është kryer hetim i pavarur administrativ nga ana e institucionit.

Rekomandimet përkatëse për këto institucione janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë me Raportin e Veçantë “Mbi Nivelin e Respektimit të të Drejtave të Fëmijëve në Institucionet Publike të Përkujdesjes Rezidenciale për Fëmijët në Shtëpi Fëmije dhe Shtëpi Foshnje”³¹. Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara nga institucioni gjatë vitit 2016 janë 61 raste të trajtuara me iniciativën e Avokatit të Popullit me objekt të drejtat e fëmijëve. Pavarësisht numrit të ankesë/kërkesave të trajtuara, theksojmë se shumë nga ankesat e trajtuara kanë patur si objekt një numër të caktuar individësh-fëmijë, ndaj mund të themi se nga trajtimi i tyre mund të kenë përfituar një numër më i madh ankues/kërkuesish. Në kuadrin e statistikave, afro 30 prej rasteve të trajtuara janë përfunduar me rekomandime, drejtuar organeve të ndryshme dhe këtu përfshihen dhe rastet e trajtuara me iniciativë.

Gjatë vitit 2016, lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve, Avokati i Popullit ka qënë përfitues i projektit “Juvenile Justice”, me financues UNICEF dhe zbatues Observatori për të Drejtat e Fëmijëve. Ky projekt ka patur për qëllim monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin në institucionet e privimit të lirisë (*institucione policore dhe penitenciare*). Në zbatim të këtij projekti janë kryer 9 inspektime si në IEVP Shën Koll, Lezhë, IVM Kavajë, dhe në pesë Komisariate të Policisë Vendore Tiranë si dhe në DVP Tiranë. Gjetjet kryesore janë bërë publike në Raportin “Me zërin e fëmijëve të privuar nga liria”, si dhe në ëorkshopin për lancimin e tij, organizuar në Dhjetor 2016. Qëllimi kryesor ishte rritja e ndërgjegjësimit publik dhe inkurajimi i marrjes së masave të nevojshme për të ndaluar trajtimin e papërshtatshëm si dhe për t’i dhënë mundësinë të miturve në konflikt me ligjin për të folur për shkeljet e mundshme ndaj të drejtave të tyre.

Gjithashtu, ka patur angazhime gjatë gjithë vitit 2016 në një sërë aktivitete të organizuara nga MMSR, për Agjendën e Fëmijëve dhe aktivitete të tjera të organizuara nga OJF që mbulojnë fushën e të drejtave të fëmijëve. Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, si pjesë aktive e rrjetit CRONSEE, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Republikën e Maqedonisë, në datat 14-15 Dhjetor 2016, takim me temën “*Roli i Ombudsmanëve në mbrojtjen e fëmijëve migrantë dhe refugjatë*”.

4.4 Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Gjatë vitit 2016 janë depozituar dhe trajtuar 72 ankesa për këtë kategori. Kanë përfundur 61 ankesa dhe janë në shqyrtim 11.

Më poshtë parashtrohen disa nga problematikat e trajtuara gjatë këtij viti.

³¹ Prill-Qershor 2016.

▪ **Mungesa e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara.** Ndërtesat publike dhe private duhet të jenë të aksesueshme për këto kategori personash, me qëllim që të mos çënohen të drejtat e tyre dhe të ndihen të barabartë me pjesën tjetër të popullsisë. Godinat e reja ose ato të konstruara nuk janë përshtatur, duke shkelur në mënyrë flagrante ligjet e posacme, urdhërat dhe udhëzimet për përshtatshmërinë si dhe kushtet ligjore të dhënies së lejes së ndërtimit. E njëjtja situatë është edhe me rrugët urbane dhe rurale.

Infrastruktura rrugore duhet të jetë e përshtatur, me qëllim që të sigurojë lëvizje të pavarur për ta: sinjalistikën rrugore të perceptueshme nga personat me probleme shikimi, transport publik të aksesueshëm, institucione arsimore të përshtatura dhe të aksesueshëm, qendra rehabilitimi etj, të cilat do të ofronin mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët. Lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuara është një parakusht i mundshëm drejt përfshirjes së plotë në shoqëri. Në këtë kuadër vihet theksi në rëndësinë e aksesit në ambientet fizike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Respektimi dhe zbatimi në praktikë i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është një tregues emancipimi dhe zhvillimi i shoqërisë shqiptare.

Me qëllim marrjen e shërbimeve dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, Avokati i Popullit, në muajin Korrik 2016, u është drejtuar me rekomandim 61 Kryetarëve të Bashkisë *për marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë së ambienteve publike*.³²

Për qëndrimin e mbajtur ndaj rekomandimit tonë, kanë kthyer përgjigje vetëm 21 Kryetarë të Bashkive, të cilët shprehen se janë angazhuar për zbatimin e rekomandimeve, duke marrë masat e nevojshme për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, me qëllim eliminimin e barrierave fizike për personat me aftësi të kufizuara.

▪ Një problematike e ngritur nga disa studentë, të cilët gëzojnë Statusin e të Verbërit dhe ndjekin arsimin e lartë, është **mospërrjashtimi nga pagesa e tarifës shkollore**. Sipas shpjegimeve të tyre, ata vazhdojnë studimet në nivelin “*master shkencor*”, me kohë të plotë apo të pjesshme në fakultete të ndryshme të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Nga Drejtoritë e Financës pranë fakulteteve, u është thënë se duhet të paguajnë 50% të tarifës së shkollimit. Pas marrjes në shqyrtim të ankesave, u kemi rekomanduar Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, përjashtimin nga tarifa shkollore të studentëve. Në përgjigjen e ardhur nga Rektori i Universitetit të Tiranës, theksohet fakti se këto kategori me Vendimet e Këshillit të Ministrave, do të favorizohen me 50% zbritje të tarifës së shkollimit.

▪ Në analizë të akteve ligjore dhe nënligjore për arsimimin e personave me aftësi të kufizuar që gëzojnë “Statusin e të Verbërit”, sipas ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*”, në pika 2, 3 dhe 4 të neni 4, është përcaktuar se:
“2. Shteti garanton arsimimin edhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato.
3. Arsimi u garantohej në këto programe studimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.
4. Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, sipas pikës 2 të këtij neni. .”

³² Doculive nr.201601289, nr. 201602398

Pra, sipas pikës 3 të nenit 4, u njihen të drejtat sipas Ligjit nr. 8098, dt.28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar. Në nenin 8 të këtij ligji, thuhet shprehimisht se: “ ..Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas...”

Ndodhur në këto rrethana, ne gjykojmë se ligji prevalon mbi çdo akt tjetër qoftë edhe Vendim i Këshillit të Ministrave, dhe si i tillë ai duhet zbatuar për rastin e studentëve, të cilët ndjekin arsimin e lartë, me qëllim përjashtimin nga pagesa e tarifës së studimit në nivelin “master shkencor” me kohë të plotë apo të pjesshme.

Gjithashtu, kemi vërejtur se ka pasaktësira në terminologjinë e përdorur në përcaktimin e kategorive përfituese. Konkretisht, janë përcatuar kategoritë:a) *personat që nuk shikojnë/dëgjojnë*, b) *invalidët e punës dhe fëmijët e tyre*, c) *invalidët*, d) *invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre*, c) *jetimët.....*

Terminologjia e përdorur për personat e përcaktuar në pikën “a” dhe “c”, nuk është e saktë, pasi nuk është konform përkufizimeve të përcaktuara në Ligjin 8098 datë .28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” si dhe në Ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” . Duhet të përdoret terminologjia e saktë sipas statuseve të personave me aftësi të kufizuar. Konkretisht “*persona që gëzojnë Statusin e të Verbërit*”, “*persona që gëzojnë Statusin e Invalidëve të Punës*”, “*persona që gëzojnë statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*” dhe “*personat, që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar*”,

Sa më lart, iu drejtuam me rekomandim Ministres së Arsimit dhe Sportit për përjashtimin nga tarifa shkollore të studentëve që ndjekin arsimin e lartë, cikli i dytë, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, të cilët gëzojnë “Statusin e të Verbërit” si dhe saktësimin e terminologjisë për statuset e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e akteve të tjera nënligjore.³³

Ky rekomandim është marrë në konsideratë, duke na kthyer përgjigje se:

“Ministria e Arsimit dhe Sportit në zbatim të ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, është duke përgatitur dhe miratuar paketën e akteve nënligjore dhe kategoritë e personave me aftësi të kufizuar apo me aftësi të veçanta, janë parashikuar që të përfitojnë tarifa shkollimi zero, si dhe mbështetje financiare me bursë”.

Gjithashtu, sipas shkresës së MAS-it, sqarohet se *sugjerimet që Avokati i Popullit ka dhënë për saktësimin e terminologjisë për statuset e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, do të konsiderohen në të gjitha aktet nënligjore që përfshijnë këto kategori sociale.*

▪ Një nga problematikat e shqyrtuara ka të bëjë me **kompensimin financiar të personave me aftësi të kufizuar** sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431 datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot .

Sipas këtij vendimi, pagesa e aftësisë së kufizuar do t’i hiqet të gjithë atyre që kanë pensione invaliditeti ose pleqërie apo kanë të ardhura të tjera. Gjithashtu ai vendim i heq pagesën e invaliditetit personave nën 2 vjeç. Nga data 1 Shtator 2016, pagesat e personave me aftësi të kufizuara do t’i referohen pensionit social, 67 mijë lekë në muaj. Nga studimi i vendimit të sipërcituar konstatuam se:

-Në Kapitullin II, Kriteret e përfitimit dhe dokumentacioni i pranimit , thuhet shprehimisht se:
1. Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:...d)

³³ Doculivve nr.201600165

Personi të jetë mbi moshën 2 vjeç; dh) Personit nuk i ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, para datës së intervistës së vlerësimit.; e) Personi nuk ka qenë në marrëdhënie pune, para lindjes së të drejtës për komisionim dhe nuk përfiton nga ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pra, ky akt nënligjor, në pikat e kësaj dispozite cënon të drejtën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar që me lindjen e së drejtës, duke e kufizuar atë në moshë si dhe cënon pagesën e aftësisë së kufizuar.

Së pari, kriteri i lindjes së të drejtës për përfitim, mbi moshën 2 vjeç, bie ndesh me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, i cili në nenin 4, pika 3 ka përcaktuar se: “3. Person me aftësi të kufizuar” është individ, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin”. Pra, një person, i cili lind dhe bëhet i tillë deri në moshën 2 vjeç, sipas këtij akti, nuk mund të jetë përfitues i pagesës së aftësisë së kufizuar.

Së dyti, pagesa e aftësisë së kufizuar nuk ka pse të lidhet me përfitime nga të ardhura të tjera, pasi ajo jepet për shkak të aftësisë së kufizuar dhe kriteri i vendosur në pikat “dh” dhe “e”, i penalizon ata persona që mund të kenë edhe të ardhura të tjera. Kjo bie ndesh me standartet e përcaktuara për personat me aftësi të kufizuara sipas Ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, ku në nenin 4, pika 13, është përcaktuar se: “..”Të ardhurat të familjes”, kuptohen të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, nga çdo lloj burimi, duke përfshirë edhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes më aftësi të kufizuara ” si dhe të ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, ku në nenin 15, thuhet se: “Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për afekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore”.

▪ **Në Kapitulli IV, Përfitimet në pagesa dhe shërbime,** janë përcaktuar kategoritë përfituese të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe masa e kësaj pagese sipas grup moshave, duke u marrë për bazë pensioni social. Sipas pikës 2 : “ *Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet sa herë indeksohet pensioni social/në bazë të indeksit të konsumit”*

Gjykojmë se nuk ka pse të lidhet llogaritja e pagesës së aftësisë së kufizuar duke marrë për bazë masën e pensionit social. Masa e pensionit social nuk ka të bëjë me minimumin jetik, pasi ende nuk është e deklaruar, që të merret për bazë edhe për këtë pagesë.

Në pikën 9 të këtij Kapitulli janë përcaktuar masat e pagesave të personave me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë, ku rezulton se janë cënuar pagesat e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë, të fituara më parë me ligjet e tyre specifike si dhe me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar. Gjithashtu u kufizohet e drejta e tyre për të ndjekur një program të dytë studimi, pasi nuk do e përfitojnë më këtë pagesë.

Cënimi i pagesës së aftësisë së kufizuar bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, i cili është një element esencial i parimit të shtetit të së drejtës. Për këtë çështje, më datë 29.07.2016 iu drejtuam

me rekomandim Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për përmirësim e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431 datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot.³⁴ Këto rekomanime nuk janë marrë në konsideratë nga ana e asaj ministrie.

Mbeten ende si problematika të pazgjidhura çështjet e mëposhtme, të prezantuara ne Raportin Vjetor 2015:

- Pasaktësia në terminologjinë e përkthyer të Konventës së OKB-së “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”. Duke qenë se mospërkthimi korrekt në gjuhën shqipe, sjell si pasojë kuptim jo të duhur të Konventës, konceptim jo të saktë të akteve që dalin pas ratifikimit të saj, perceptim të gabuar të detyrimeve, por edhe më tej, në raportimin e shtetit shqiptar për zbatimin e kësaj Konvente, Avokati i Popullit më datë 12.05.2015 i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, *ndërmarrjen e iniciativës ligjore për saktësimin e përkthimit të neneve 29 dhe 32 të ligjit nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Ende nuk ka përgjigje për qëndrimin e mbajtur ndaj këtij rekomandimi.
- Mospërfitimi i indeksimit të masës së personave që gëzojnë Statusin e të Verbërve për periudhën 2005-2010.
- Rinovimi i Librezës së Invaliditetit pranë QSUT-së për personat me aftësi të kufizuara, të cilët jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë në një kohë që prej vitesh janë përfitues të grupit të invaliditetit (persona paraplegjike e tetraplegjike), kur vendimi nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë në Punë është dhënë “*Përgjithmonë*”.
- Mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë.
- Mungesa e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës,
- Moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin,
- Mungesa e aksesit në arsimin publik të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Mungesa e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore,
- Mosngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore.

4.5 Të moshuarit

Institucioni ynë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë të drejtave të moshës së tretë. Për të garantuar të drejtat e të moshuarve, kemi kërkuar ndër vite me insistim miratimin e Statusit të Moshës së Tretë.

Siç jemi shprehur edhe në raportet e mëparshme, kjo çështje është trajtuar që në vitin 2012. Kërkesat tona të njëpasnjëshme u përballën me përgjigjen se projektligji do shqyrtohej dhe do të shkonte për miratim në Këshillin e Ministrave në vitin 2013, në 2014 dhe në 2015. Në muajin Shkurt dhe Shtator 2015 i kemi dërguar rekomanduam Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë të propozonte për miratim projektligjin “*Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë*”.

Në përgjigjen e saj, në muajin Janar 2016, ajo ministri i referohet përfshirjes së të moshuarve në akteve të tjera ligjore si: Ligjit kuadër nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Ligjit nr.104/2014 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

³⁴ Doculive nr.201601544

nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, etj. Do të vazhdojmë ndërhyrjen tonë institucionale për këtë çështje.

Problematikat, me të cilat ndeshen në jetesën e përditshme të moshuarit, i kemi adresuar pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë lidhur me përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Planit të Veprimit 2012-2016, mbi rekomandimet MIPAA/RIS për moshimin:

- Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, i çon të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Ata ndeshen shpesh me barriera shoqërore që ndikojnë në jetët e tyre.
- Të moshuarit mund të mos marrin shërbimin e duhur shëndetësor, pra nuk kanë aksesueshmëri në shërbimet e kujdesit shëndetësor, përgjithësisht të moshuarit që banojnë në zonat rurale të Shqipërisë.
- Të moshuarit, gëzojnë masa shumë të ulëta të pensioneve të pleqërisë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për jetesën e përditshme.
- Të ketë më shumë qendra rezidenciale dhe ditore për të moshuarit.

4.6 Të drejtat e Komunitetit LGBTI (Interseks)

Të drejtat e personave LGBTI-(interseks) konsiderohen si pjesë të pandashme e tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBTI në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij për vitin 2016, ka patur dhe respektimin e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Institucioni i Avokatit të Popullit po monitoron në vazhdimësi respektimin e të drejtave dhe lirive të personave LGBTI në Shqipëri, apo masat që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore përgjegjëse, për garantimin e plotë të tyre.

Meqenëse personat që i përkasin komunitetit LGBTI vazhdojnë të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, nevojiten masa me specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut për këtë kategori personash. Këto të drejta fillojnë që nga e drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna, liria e shprehjes, punësimi, shëndeti, strehimi, mosdiskriminimi etj.

Gjatë vitit 2016, Organizatat Kombëtare të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI, në takimet me Avokatin e Popullit ndër problematikat e tjera ngritën dhe shqetësimin në lidhje me çështjen e njohjes së identitetit gjinor. Kjo çështje është diskutuar disa herë në takimet midis Institucioni i Avokatit të Popullit, Këshillit e Evropës dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë .

Konkluzionet që dolën në këto takime u finalizuan nga Avokati i Popullit me rekomandimet e datës 25.05.2016, dërguar Ministrinë të Drejtësisë dhe Ministrinë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e saj, të datës 20.06.2016, është shprehur se ekziston mundësia e realizimit të së drejtës për njohje ligjore si dhe ekzistojnë mundësitë e materializimit të procedurës së njohjes së kësaj të drejte nepërmjet ndërhyrjes në ligjin për gjendjen civile. Ndërsa përsa i përket rekomandimit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ende nuk kemi një përgjigje.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar në dhënien e mendimeve për Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave në datën 25 Maj 2016. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Europës, organizoi aktivitetin lidhur me lançimin e Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020, më 21 Tetor 2016. Në këtë aktivitet u diskutua plani i punës dhe kalendari i takimeve pasuese të Grupit Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit për të monitoruar zbatueshmërinë dhe ecurinë e Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI për vitin 2016-2020, ku pjesë e këtij grupi ishte dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë pjesë në dhënies së mendimeve të rekomandimeve të ECRIT, si dhe një ndër institucionet kryesore që ka kontribuar me mendimet e tij në diskutimet e disa problematikave që shqetësojnë Komunitetin LGBTI.

Avokati i Popullit ka marrë pjesë në disa ëorshope të organizuara nga organizatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare, ku mund të përmëndim, ëorkshopin që Këshilli i Evropës (KiE) organizoi në dt. 22-23 Nëntor 2016, në kuadër të Projektit të Përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit”, Ambasada Pink dt.17 Mars 2016 me Temën “Perceptimet e punonjësve vendore mbi shërbimet miqësore përkundrejtë personave LGBTI”, një ëorkshop tjetër me temë “Eksperiencat e Diskriminimit të Adoleshenteve në Shkollë”, në ëorkshopin e organizatës OMSA me temën “LGBTI në Axfordën Politike në Shqipëri” etj.

Në takimet e organizuara nga Avokati i Popullit me Organizatat Ndërkombëtare është vënë në dukje se pavarësisht disa zhvillimeve pozitive të tilla si Rezoluta Parlamentare e 7 Majit 2015, përgatitja dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet publike, Shqipëria vazhdon të ketë sfida të mëdha për të cilat Qeveria e saj duhet të angazhohet shumë seriozisht. Këtu veçohen çështje si mungesa e vullnetit politik për të punuar aktivisht kundër diskriminimit dhe në ofrimin e një mbrojtje dhe avancimi efektiv të të drejtave LGBTI, mungesa e aksesit në shërbime lokale çka reflektohet nga raste të shumta të raportuara nga komunitetit LGBTI, mungesa e avancimit ligjor sidomos në lidhje me njohjen e së drejtës së bashkëjetesës, njohjen ligjore të identitetit gjinor, dhe njohjen e personave interseks, zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen nga dhuna si dhe rritja e ndjeshme të numrit të personave LGBTI që kërkojnë azil në vende të ndryshme të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe Kanada.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se ndërkohë që Shqipëria po i përshtatet gjithmonë e më shumë standarteve ndërkombëtare në aspektin ligjor dhe normative, është e rëndësishme që këto arritje të mos ngelen vetëm në letër, por të ketë një angazhim serioz nga ana e institucioneve publike dhe e qeverisë sidomos në lidhje me miratimin dhe zbatimin efektiv të Planit të Veprimit, duke alokuar buxhet, burime njerëzore, duke promovuar bashkëpunim më të ngushtë midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike dhe duke ngritur një mekanizëm ndërdisiplinar monitorues dhe vlerësues që të shohe impaktin e vërtetë të masave të marra.

KREU 5

Roli promovues/proaktiv i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut

5.1. Shërbimet ndaj qytetarëve nëpërmjet rritjes së rolit proaktiv të institucionit dhe funksionimit të zyrave rajonale

Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon me zyrën e pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve jo vetëm në Tiranë, por përfaqësohet me zyrat rajonale edhe në shtatë prej qendrave më të mëdha administrative nga Veriu në Jug të vendit dhe konkretisht në bashkitë Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Pogradec, Sarandë dhe Dropull. Zyrat rajonale janë pjesë e vizionit të Institucionit të Avokatit të Popullit që ka patur në fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve, përmes kultivimit të një kulture të re dhe standarteve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve për të adresuar në kohë ankesat e tyre ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit janë pika të rëndësishme kontakti me qytetarët për marrjen e ankesave por njëkohësisht prania e tyre në këto rajone, ka ngushtuar distancën dhe ka afruar institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve. Zyra rajonale e Dropullit është e një rëndësie edhe specifike të veçantë për Avokatin e Popullit. Në fokusin e saj, përfshihet marrja e ankesave dhe informacionit rreth problemeve që shqetësojnë popullsinë minoritare që jeton aty. Por njëkohësisht ajo është dhe një simbol i garantimit të të drejtave kushtetuese të minoriteteve në Shqipëri dhe prezencës të shtetit me mekanizma që ju vijnë sa më parë në ndihmë kësaj popullate.

Ngritja dhe funksionimi i zyrave rajonale, është kontribut i një bashkëpunimi institucional të Avokatit të Popullit me drejtuesit e njërive të qeverisjes vendore për sigurimin e zyrave, mbështetjen financiare të Qeverisë të Danimarkës për kompletimin e zyrave me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme të punës, si dhe një bashkëpunimi efikas me organizatat e shoqërisë civile të cilat bënë të mundur sigurimin e personave që sot janë përfaqësues të Avokatit të Popullit në këto rajone, të cilët fillimisht kontribuan me përkushtim ndaj kësaj detyre në mënyrë tërësisht vullnetare.

Me qëllim që të bëhej e mundur vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e zyrave rajonale edhe pas përfundimit të projektit danez, Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë diskutimit të buxhetit të vitit 2016, kërkoi mbështetjen e zyrave rajonale nga buxheti i shtetit, të cilat u miratuan edhe pas seancës dëgjimore të realizuar në Komisionet e përhershme në të cilat diskutoheshin buxheti.

Në shkurt 2016 u nënshkruan për herë të parë kontratat individuale të punës me secilin përfaqësues rajonal të Avokatit të Popullit të vlefshme deri në fund të vitit të cilat legjitimonin kohën e pjesshme të punës, respektivisht 6 orë punë në ditë si dhe pagesën mujore për secilin përfaqësues. Gjatë vitit 2016 zyrat rajonale kanë sjellë një prezencë të vlerësueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve, nëpërmjet prezencës së përfaqësuesve në terren, duke ju mundësuar qytetarëve informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brënda një kohe të shkurtër dhe optimale.

Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë kanë qenë pjesë të rëndësishme të aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit jo vetëm si një objektiv për t'u arritur, por edhe si sadsfaksion dhe përgjegjësi. Puna në terren është bazuar në një planifikim paraprak të gjithësecilit, nëpërmjet

hartimit dhe realizimit të plotë të planeve mujore, duke evidentuar aktivitetin dhe problematikat e hasura me relacione konkrete dhe fotografi.

Duke konsideruar se komunikimi në grup është mjet thelbësor i efektivitetit që ndikon në rritjen e cilësisë së punës, është shumë i vlerësueshëm fakti që kemi bërë të mundur të funksionojë më së miri Rrjeti i Zyrave Rajonale on-line, dhe për rrjedhojë janë arritur nivele shumë të mira komunikimi, ndarje eksperiencash apo idesh mes përfaqësuesve të zyrave rajonale me njeri tjetrin dhe me Drejtorinë e Shërbimeve ndaj Qytetarëve.

Duke parë interesin në rritje të publikut për shërbimet që ofron Avokati i Popullit, zyra rajonale e Sarandës, e ndjekur më pas edhe nga zyrat e tjera rajonale, inicioi ngritjen e këndit të Avokatit të Popullit kryesisht në disa shkolla të ndryshme të rajonit, pas bisedave promovuese me nxënës dhe mësues në këto institucione arsimore si dhe falë bashkëpunimit dhe gatishmërisë të drejtorive të shkollave, mësuesve dhe vetë nxënësve. Kënde të tilla të Avokatit të Popullit ofrojnë informacion njohës për rolin e Avokatit të Popullit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rubrikën pyetje-pergjigje si dhe shërbime të tjera.

Gjatë vitit 2016, u parashikuan 6 programe raportimi dhe praktikë pune të përfaqësuesve rajonalë pranë Drejtorisë së Shërbimeve ndaj Qytetarëve në Tiranë të cilat u realizuan çdo dy muaj. Synimi i programeve të raportimit i shprehur në hartimin e kujdesshëm të programit të çdo rradhe ishte jo vetëm raportimi mbi rezultatet e arritura por evidentimi i problematikave të hasura gjatë kryerjes së detyrave si dhe përpjekjet për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të performancës së përfaqësuesve rajonalë.

Programet e raportimit në thelb kanë nënkuptuar edhe përkujdesje institucionale për përfaqësuesit rajonalë, për t'i bërë ata të ndjehen pjesë e vlerësuar e këtij institucioni si dhe dhënie e mundësisë për ta, për tu takuar e biseduar personalisht me ndihmës-komisionerët e seksioneve të ndryshme, për t'i pyetur ata dhe marrë përgjigje apo këshilla të vlefshme profesionale për problematikat dhe raste konkrete ankesash gjatë kryerjes së detyrës. Përfaqësuesit rajonalë kanë patur fatin të përfitojnë nga përvojat e ndihmës-komisionerëve të institucionit sikunder dhe nga sugjerimet me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së performancës të përfaqësuesve të zyrave rajonale.

Gjithashtu, përfaqësuesit e zyrave rajonale kanë marrë pjesë në trajnime, seminare si dhe në konferenca, pasi forcimi i kapaciteteve të punonjësve në zyrën e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarëve në Tiranë dhe në zyrat rajonale, ka qenë dhe mbetet në fokusin e punës të Avokatit të Popullit. Këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen profesionale, rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, në forcimi i një komunikimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për t'ju përgjigjur interesimit të tyre rreth objektit të ankesave dhe rrugët që duhet të ndjekin për zgjidhjen e të drejtës të pretenduar prej tyre.

Gjatë vitit 2016, zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar efikasitet, dhe në plotësim të pritshmërive të Institucionit të Avokatit të Popullit, referuar promovimit të këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë. Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit si dhe për rrjedhojë edhe rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra, është numri i ankesave gjithmonë në rritje që në fund të vitit 2016 rezulton të përbëjë rreth **35%** të gjithë totalit të ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit këtë vit. Këto rezultate na bëjnë optimist për vitin në vijim dhe na forcojnë besimin për vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e mëtejshëm të synuar të zyrave rajonale.

Referuar objektit të ankesave brenda juridiksionit/kompetencës së Avokatit të Popullit të ardhura nga zyrat rajonale, për të cilat ankohen qytetarët më së shumti në këto zona, të pranuar dhe trajtuara nga specialistët e fushave përkatëse të Institucionit të Avokatit të Popullit, do të veçonim: a) ankesat mbi mosdhënien e certifikatave të pronësisë nga Hipoteka; b) mbifaturim i energjisë elektrike nga OSHEE; c) mosllogaritja e viteve të punës nga Sigurimet Shoqërore; d) shërbimet e munguara nga pushteti vendor.

Ndër objekte të njejta të ankesave jashtë juridiksionit/kompetencës të Avokatit të Popullit për të cilat përfaqësuesit e Zyrave Rajonale kanë mundësuar për qytetarët këshillimin ligjor dhe orientimin mbi rrugët që duhet të ndjekin për të kërkuar zgjidhjen e problemeve të tyre, do të veçonim: a) ankesat për largime të padrejta nga puna; b) kërkesë për punësim c) mungesë e shërbimeve nga pushteti vendor d) çështje në proces gjyqësor.

Në kushtet që ofron zhvillimi i teknologjisë dhe informacionit, Avokati i Popullit ka hapur gjithashtu dhe një *sërë shërbimesh online* në interes të qytetarëve që kanë mundësi aksesit në internet, për të kryer plotësimin e ankesave on-line. Kështu në faqen zyrtare të Eëb-it të institucionit tashmë funksionon Portali i veçantë, ku qytetarët mund të bëjnë ankesat e tyre dhe në çdo kohë mund të kontrollojnë se kush nga ekspertët e institucionit e trajton ankesën, njihet me përgjigjet e institucioneve me të cilët lidhet objekti i ankesës, si dhe mund të marrë përgjigjen përfundimtare të ankesës, pa pritur afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Aplikimin e ankesës on-line përmes Portalit, ne e konsiderojmë si një mundësi mjaft efektive për qytetarët dhe njëkohësisht kjo mënyrë rrit së tepërmi dhe transparencën e institucionit përballë qytetarëve.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve kanë adresuar ankesat e tyre edhe nëpërmjet adresave zyrtare të email-it të Avokatit të Popullit, adresave zyrtare në rrjetet sociale Facebook dhe Tëiter, si dhe numrit të telefonit të publikut **0689034648** i cili qëndron hapur gjatë 24 orëve, si dhe numrit jeshil **0800 1111**.

Në të gjitha rastet kur qytetari dërgon ankesën e tij on-line apo me telefon, specialistët e zyrës së pritjes bëjnë verifikimin e objektit të ankesave, identifikimin e të dhënave personale të ankuesit, si dhe adresat me kontaktet e tyre, me qëllim që ankesa të mos konsiderohet pa objekt dhe anonime. Këto alternativa ne i konsiderojmë si një mundësi për të marrë sa më shumë ankesa nga qytetarët, por njëkohësisht dhe si një mënyrë komunikimi me miqtë e Avokatit të Popullit, rreth temave dhe debateve në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Organizimi i “Ditëve të Hapura” nga Avokati i Popullit, komisionerët dhe stafi i institucionit, janë kthyer në një traditë të suksesshme në marrëdhëniet e Institucionit të Avokatit të Popullit me qytetarët, me administratën e pushtetit vendor, drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, si dhe me përfaqësuesit dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel lokal.

Në takime, qytetarët janë informuar mbi objektin e punës të Institucionit, është komunikuar me ta mbi rrugën e ndjekur për zgjidhjen e ankesave, si dhe janë pranuar për shqyrtim ankesat që kanë si objekt kundërshtimin e veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike. Më tej, trajtimi i ankesave i është nënshtruar një hetimi dhe ekspertizë më të gjërë nga ana e ndihmës/komisionerëve, duke konsideruar qytetarin jo vetëm një subjekt të së drejtës dhe detyrimet që ka administrata publike për plotësimin e tyre, por si janë zbatuar këto detyrime në raport me standartet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e së drejtës.

Gjithashtu në kushtet e mungesës të informacionit, një pjesë e qytetarëve janë këshilluar dhe orientuar, për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për të kërkuar dhe vendosur në vend të drejtën e pretenduar prej tyre.

Gjatë vitit 2016, “Ditët e Hapura” janë zhvilluar në një pjesë të bashkive dhe njësive administrative të vendit. Problematikat e adresuara nga qytetarët ju janë bërë prezent drejtuesve të njësive vendore për t’i konsideruar në punën me administratat e tyre, si dhe trajtimin e tyre në takimet me grupet e shoqërisë civile dhe median lokale.

Për periudhën e vitit 2016, në zyrën e pritjes së qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit, atij postar dhe on-line, janë paraqitur **5512** ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat **2566 ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së Institucionit** të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe 2946 ankesa janë trajtuar në formën e “këshillimeve dhe orientimeve”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen.

Për vitin 2016, situata e përgjithshme e ankesave të hyra dhe të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit paraqitet si më poshtë:

- Ankesa pranë Zyrës së Pritjes të Qytetarëve	-	2123
- Ankesa nga Zyrat Rajonale	-	1928
- Ankesa në rrugë postare	-	1008
- Ankesa on-line (<i>Portali, e-mail dhe rrjete sociale</i>)	-	146
- Ankesa me telefon (<i>telefon fix, mobil dhe numrin jeshil</i>)	-	139
- Ankesa nga Ditët e Hapura	-	168

Rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe ngritjen e cilësisë së punës të stafit të institucionit, ka luajtur Zyra e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit. Nisur nga përmbajtja e ankesave të prezantuara nga qytetarët, të cilat nuk janë objekt i punës të Avokatit të Popullit, specialistët ju kanë ofruar qytetarëve këshillimin ligjor, mbi rrugët që duhet të ndjekin për rivendosjen e së drejtës së pretenduar prej tyre.

Krahas detyrës për pritjen e qytetarëve dhe dhënien e informacionit të nevojshëm mbi procedurat e marrjes të ankesave, zyra e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarit ka shërbyer dhe si një “filtër” për ndarjen e ankesave me objekt “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe në “këshillime dhe orientime”, mbi bazën e kërkesave të ligjit për “Avokatin e Popullit”.

Numrin më të madh të ankesave të vlerësuara jashtë objektit të punës të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2016 e përbëjnë ankesat e qytetarëve që kundërshtojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave si dhe vendimet e prokurorive për pushim të çështjeve të caktuara. Këtyre ankuesve u është dhënë këshilla ligjore për të ndjekur shkallët e ankimimit sipas shkallëve të sistemit gjyqësor. Gjithashtu, në lidhje me ankesat me objekt kundërshtimin e vendimeve për pushim të çështjeve në prokuroritë e rretheve gjyqësore, qytetarët janë këshilluar t’u drejtohen me ankesë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Konflikti brenda familjes ngelet shqetësues për shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Në rastet e këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar të parandalojnë ngjarjet e rënda duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e policisë dhe të prokurorisë dhe në rastet e konstatimit të vonesave dhe zvarritjeve nga ana e këtyre organeve, t’i drejtohen menjëherë Avokatit të Popullit për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese dhe ligjore. Në lidhje me ankesat për mbrojtjen

e fëmijëve dhe të grave nga dhuna e ushtruar nga persona brenda dhe jashtë familjes, personat e ankuar janë këshilluar t'u drejtohen organeve të policisë dhe më tej gjykatës për t'u pajisur me urdhëra mbrojtje sipas ligjit.

Një grup i konsiderueshëm qytetarësh janë drejtuar tek Avokati i Popullit me ankesa që kanë objekte të ndryshme si, probleme punësimi, mos përfitim të tokës bujqësore, kundërshtim të vendimeve të marra nga ana e KMCAP-it rajonal dhe qëndror në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar etj, për të cilat qytetarët janë këshilluar t'u drejtohen institucioneve përkatëse ligjzbatuese, apo t'u drejtohen edhe gjykatave në rastet kur e përmban dhe ligji.

5.2. Nxitja e të drejtave të njeriut në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raporteve të Veçanta

Institucioni i Avokatit të popullit gjatë vitit 2016 ka vijuar për sensibilizimi dhe ngritjen e çështjeve lidhur me të drejtat e njeriut nëpërmjet raporteve të veçanta.

Gjatë vitit 2016, janë përgatitur disa raporte, ku disa prej tyre jo vetëm janë diskutuar me grupet e interesit, aktorët e shoqërisë civile dhe aktorët ndërkombëtare, por njëkohësisht janë depozituar në Kuvend.

I. Raporti i veçantë “Mbi nivelin e Respektimit të të drejtave të fëmijëve në Institucionet publike të përkujdesjes rezidenciale për fëmijët në shtëpi fëmije dhe shtëpi foshnje”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në Qershor 2016 në faqen zyrtare të institucionit është publikuar **Raporti i Veçantë “Mbi Nivelin e Respektimit të të Drejtave të Fëmijëve në Institucionet Publike të Përkujdesjes Rezidenciale për Fëmijët në Shtëpi Fëmije dhe Shtëpi Foshnje”** mbi inspektimet e realizuara. Në zbatim të legjislacionit në fuqi raporti është dërguar edhe në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

II. Raport i veçantë “Për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve nga çdo organ i Njësive të Qeverisjes Vendore”

Institucioni i Avokatit të Popullit, në korrik 2016, depozitoi në Kuvendin e Shqipërisë, Reportin e veçantë me të gjithë problematikat që lidhen me zbatimin e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës dhe në mënyrë të veçantë për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve nga çdo organ i Njësive të Qeverisjes Vendore. Në raport, rezultojnë të dhënat nga përgjigjet e ardhura nga 6 Bashkitë, pas 61 shkresave të dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në total u përgjigjën vetëm 51 Bashki, në të cilat rezultoi se janë larguar në total 3059 punonjës, prej të cilëve 319 janë nëpunës civil ose 11% e punonjësve dhe 2740 janë punonjës marrëdhëniet e punës të të cilëve janë rregulluar sipas Kodit të Punës ose në total 89% e punonjësve.

Në pjesën më të madhe të bashkive, problematikë mbetet mungesa e buxhetit, pasi me burimet financiare aktuale nuk arrijnë të përballojnë kostot financiare të riskstrukturimeve ndaj punonjësve që janë larguar apo që do të preken nga largimet nga puna pas miratimit të strukturave përfundimtare të njësive vendore.

Si konkluzion i problematikave të konstatuara më lart, problem shqetësues mbetet ngritja dhe funksionimi i komisioneve të ristrukturimit për nëpunësit pjesë e shërbimit civil për transferimet e tyre në pozicione pune të njëjta apo të ngjashme, si dhe zbatimi sa më i drejtë i dispozitave të Kodit të Punës si pasojë e ristrukturimeve të ndërmarra, duke mos mbajtur në konsideratë edhe kritere që

lidhen me vjetërsinë në punës apo dhe kushtet sociale dhe ekonomike për punonjësit e larguar nga puna.

III. Raporti “Me zërin e fëmijëve të privuar nga liria”

Në Dhjetor 2016 Avokati i Popullit lancoi në mediat vizive dhe publike i **Raportin “Me zërin e fëmijëve të privuar nga liria”** në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare Observatori Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe me mbështetjen financiare të UNICEF-it ku një ndër qëllimet kryesor ishte për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi çështjen dhe për të inkurajuar presionin e shoqërisë civile mbi marrjen e masave të nevojshme për të ndaluar trajtimin e papërshtatshme si dhe për t’i dhënë mundësinë të miturve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve për të folur për shkeljet e mundshme të drejtave të njeriut ndaj tyre, për të ekspozuar këtë çështje në Parlament (përmes zhvillimit të një raporti tematik të Avokatit të Popullit në Parlament).

IV. Raporti i veçantë për “Aktivitetin e MKPT-së”

Gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit, publikoi raportin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në të cilën paraqiteshin të dhëna mbi funksionimin e MKPT-së, bashkëpunimet dhe përfaqësimet institucionale, përmbledhjet me gjetje për komisaritet e drejtoritë e qarqeve, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, repartet ushtarake, qendrat rezidenciale, e spitalet psikiatrike në vend, si dhe raportet e detajuara të nisura në formë rekomandimesh mbi secilin institucion të inspektuar.

V. Raporti i veçantë për “Mbi rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit për çështjen e emigracionit”

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2016, ka patur në fokus jo vetëm në nivel kombëtar por edhe si pjesë e axhendës të aktiviteteve ndërkombëtare, çështjet e emigrantëve, të drejtat e azilkërkuesve, refugjatëve, etj.

Pas kryerjes së një sërë misionet monitorimi në pikat e kalim kufirit, në komisariate, në qendrat pritëve dhe atë të mbyllur, u hartua një raport i veçantë në të cilën trajtoheshin të gjitha problematikat e konstatuara si dhe një sërë rekomandimesh për përmirësimin e situatës, të depozituara në datë 11.07.2016.

5.3. Investimi i Gjykatës Kushtetuese nga Avokati i Popullit për rivendosjen në vënd të të drejtave të shkelura

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2016 ka **investuar 3 herë Gjykatën Kushtetuese**, me kërkesa për shfuqizim të dispozitave të ndryshme ligjore.

I.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, në muajin Mars 2016 një kërkesë me objekt:

- 1- Pezullimi i zbatimit të pikës 1/1 dhe pikës 2/1, të nenit 62, dhe germës e/3, të pikës 1, të nenit 66, të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Ligjin 178/2014.
- 2- Pezullimi i zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037 datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

- 3- Shpallja si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i pikës 1/1 dhe pikës 2/1, të nenit 62, dhe gërmës e/3, të pikës 1, të nenit 66, të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Ligjin 178/2014.
- 4- Shpallja si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1037 datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

Në mendimin e Avokatit të Popullit ndryshimet që janë bërë ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, lidhur me testimin e nëpunësve për njohuri shtesë si dhe miratimi i VKM-së nr. nr. 1037 datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”, jo vetëm që përbëjnë shkelje të të drejtave të nëpunësve, por edhe shkelin një sërë parimesh kushtetuese.

1- Lidhur me parimin e sigurisë juridike

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka të përcaktuar në objektin dhe qëllimin e tij, krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në merita, integritet moral dhe paañesi politike. Efektivisht pra, ligji referon një normë e cila rregullon marrëdhënien e punës, ndërmjet shtetit në cilësinë e punëdhënësit dhe nëpunësit civil, pra individit, në cilësinë e punëmarrësit. Nga ndryshimet që kanë pësuar dispozitat e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.178/2014, të referuara në kërkesë, kemi gjykuar se ka cenim të parimit të sigurisë juridike për arsye se ka krijuar dy sisteme paralele të vlerësimit të performancës së nëpunësit civil, që në thelb kanë të bëjnë me vlerësimin në punë, por që efektivisht dhe në aspektin rregullator janë kontradiktorë dhe përjashtues për njëri-tjetrin.

Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t’i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe ma pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike. Është kërkesë e parimit të sigurisë juridike fakti që një ligj në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Ligji pra duhet të përcaktojë qartë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm, dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij.³⁵

Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohej që, nga njëra anë, ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe nga ana tjetër, të mos qëndrojnë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi.³⁶

2. Lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor

E drejta për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në nenin 42 dhe 33 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 (ankimi efektiv) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe nenit 2 të Protokollit nr.7 (shtesë), të saj, është një e drejtë garanci që garanton të drejtën e çdo personi që, për mbrojtjen e interesave të tij, t’i drejtohet gjykatës, apo organeve kompetente.

³⁵ Shih vendimit nr.34 datë 20.12.2005 dhe nr.31 datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁶ Shih vendimin nr.36 datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

Në të gjithë përmbajtjen e VKM nr.1037 datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”, nuk gjejmë asnjë dispozitë e cila përcakton të drejtën e ankimit të nëpunësit civil, ndaj rezultatit të shpallur të testimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit Paraparak. Megjithëse ky akt nënligjor përmban detaje të organizimit të testimit paraparak, përmbajtjes së njohurive që do të testohen, strukturës që zhvillon testimin, pikëzimit dhe shpalljes së rezultateve, trajnimit të detyrueshëm në rast vlerësimi “jokënaqshëm” dhe deri tek deklarimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, përsëri mungon parashikimi për garantimin e së drejtës për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit Paraparak, organit të cilit i drejtohet ky ankimim deri tek procedura e ankimit në gjykatë, afatet e nevojshme të zhvillimit të kësaj procedure etj.

Nuk mund të ekzistojë e drejta e mbrojtjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil, dhe ajo e formimit profesional në këtë kuadër, pa patur garancinë e ankimit ndaj atyre akteve të nxjerra nga organet përkatëse në ecurinë e kësaj marrëdhënieje, që çënojnë këto të drejta. Në mënyrën e formulimit të VKM nr.1037 datë 16.12.2015, duket sikur rezultati i shpallur nga Komisioni i Vlerësimit Paraparak është i padiskutueshëm dhe i pakontestueshëm dhe ai thjesht duhet të merret i mirëqënë, duke vazhduar me procedurat e mëtejshme.

Mungesa e parashikimit të kësaj të drejte çënon në thelb të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi mbrojtja e interesave të ligjshme të nëpunësit civil nga një rezultat i pabazuar i shpallur si i tillë nga Komisioni përkatës i Testimit Paraparak, nuk garantohet shprehimisht me garancinë e dhënë në VKM nr.1037 datë 16.12.2015, për t’iu drejtuar me ankim organit kompetent administrativ që duhet dhe mund të shqyrtojë këtë ankim.

Kërkesa e mësipërme është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 70 datë 24.11.2016.

II.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke marrë në konsideratë që ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme çështjen e ligjit për trajtimin e pronës, në datën 02.03.2016 u bë palë në gjykimin kushtetues në Gjykatën Kushtetuese në të cilën kërkoi shfuqizimin e *Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, si të papajtuësishëm me Kushtetutën. Argumentat ligjore, të ngritura dhe në kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit i ka bërë prezent edhe në Komisionin e përhershëm të ligjeve, të përfshira si raportim në raportin vjetor 2015. Në përfundim të shqyrtimi Gjykata Kushtetuese ka vendosur për pranimin pjesërisht të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit.

III.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka investuar Gjykatën Kushtetuese, duke e vlerësuar të nevojshme mundësimin e interpretimit të dispozitës kushtetuese, neni 41/4 i Kushtetutës, në aspektin e kufizimit të së drejtës së pronësisë referuar parashikimeve të nenit 8/a të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private, për interes publik”, si dhe Aktit Ndërkombëtar “Traktatin e mirëkuptimit dhe fqinjësisë së mirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë”, nënshkruar më 11 Maj 1994, dhe ratifikuar prej Kuvendit me Ligjin nr.7856, datë 21.09.1994. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës Datë 02.03.2016, Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr.97, datë 17.05.2016, ka vendosur për; “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në *séance plenary*”, për shkak të moslegjitimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në ngritjen e kërkesës me objekt si më lartpërmendur.

5.4.Roli i institucionit të Avokatit të Popullit në dhënien e mendimeve dhe komenteve për draft-ligjet për vitin 2016 në mënyrë proaktive, ose me kërkesë të institucioneve përkatëse

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2016 ka ndjekur me vëmendje ndryshimet legjislative në vend, sidomos ato që ishin pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi, duke dhënë komentet dhe sugjerimet për draft- ligje të ndryshme sa herë është kërkuar nga institucionet ligjvënese ashtu si dhe me iniciativë të vetë institucionit.

Sa më poshtë disa nga projekt-ligjet më të rëndësishme për të cilat është dhënë mendim dhe sugjerime konkrete.

- Rekomandimet dhe sugjerimet e dërguara pranë Komisionit të Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për draft-ligjin “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.SH”, miratuar nga Kuvendi në datën 24.11.2016.
- Rekomandimet dhe sugjerimet e dërguara pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me për projektvendimin “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2016-2020”.
- Propozimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve konkrete për draft-ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” në takimin e realizuar nga organizatat e shoqërisë civile të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Keto sygjerrime dhe rekomandime do të dergohen edhe zyrtarisht pranë Komisionit të Ligjeve, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë kur caktohet në kalendarin e punimeve ky projektligj.
- Sugjerime dhe komente lidhur me *“Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016-2020”*, drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Kemi sugjeruar llogaritjen e kostove dhe një buxheti të planifikuar për arritjen e objektivave të përcaktuara; *rishikimin e Kodit Rrugor për njohjen e shkopit të bardhë dhe sinjalistika për të verbërit si pjesë e sinjalistikës për drejtuesit e automjeteve motorrike. Në fushën e barazisë, saktësimin e përkthimit të neneve 29 dhe 32 të ligjit nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”;* përmirësime legjislative në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjit “Mbi noterinë”, *hartimin e kurrikulave të posaçme dhe realizimi i posaçëm i edukimit dhe i formimit profesional, përcaktimi i objektivave sipas nivelit të formimit profesional, rishikimin e Ligjit nr.9355/2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar.*
- Sugjerime dhe komente për projekt-ligji *“Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Është sugjeruar përfshirja e *“fëmijëve në lëvizje”* dhe të gjitha kategoritë në nevojë; të ketë një definicion të përcaktimit të mjeteve monetare; përfitimi i të gjitha kategorive në nevojë për përfitime të shërbimeve të kujdesit shoqëror; shërbimi i mbikqyrjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror; përfshirja e kategorisë së personave mbi 21 vjeç për marrjen e shërbimeve komunitare; përfshirja e të moshuarve në përfitimet e shërbimit në streha; shtimi i formave të tjera të kujdesit alternativ për fëmijët si psh: kujdesi në shtëpi-familje të përfshihen të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për shërbimet publike të ofruara; heqja e dispozitës që ka të bëjë me pagesat e anëtarve të Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm, pasi në relacionin e projekt-ligjit thuhej se nuk ka efekte financiare me hyrjen në fuqi të ti.

- Mendime për përgatitjen e *Raportit kombëtar për zbatimin e Planit të Veprimit për moshimin 2012-2016*, drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Kemi sugjeruar si një domosdoshmëri hartimin e një ligji specifik të të drejtat e moshës së tretë; rritjen e masave të pensioneve të pleqërisë; lidhja e marrëveshjeve në fushën e sigurimeve shoqërore me shtetet fqinj, Itali dhe Greqi, për njohjen e viteve të punës; zbatimin e standardeve të përkujdesit social për ata të moshuar, të cilët janë të sistemuar në Qendrat Rezidenciale dhe Ditore Përkujdesjes Sociale; ngritja e qendrave të reja rezidenciale dhe ditore për të moshuarit.
- Institucioni i Avokatit të Popullit prej muajit Shkurt 2016, është përfshirë në një proces konsultimi me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe me aktorë të tjerë lidhur me draft-ligjin e ri **“Programet e Strehimit Social”**. Është për t’u vlerësuar fakti se nga Ministria e Zhvillimit Urban në draft ligj janë përfshirë në masën 100% përqind të gjitha mendimet dhe sugjerimet e institucioni i Avokatit të Popullit, të cilat u miratuan së fundi edhe në Këshillin e Ministrave.

1- Risi është përfshirja e programeve të reja të strehimit për familjet/individët pa të ardhura, familjet me ndihmë ekonomike ose ato që janë në kushtet e përfitimit nga ndihma, pavarësisht se nuk e kanë përfituar, duke përfituar subvencion qiraje në masën 100%.

2- Përfshirja e kategorive të reja sikundër janë:

- a) Familjet e komunitetit Rom;
- b) Familjet e komunitetit Egjiptian;
- c) Viktima të dhunës në familje;
- d) Prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijët
- e) Personat endacakë, dhe ofrimi i programeve për krijimin e strehave të përkohëshme.
- f) Familje që kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i: prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë; zhvendosjeve/dëbimeve me forcë për shkak të investimeve publike dhe për objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve; nga zbatimin e vendimeve dhe/ose akteve administrative dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore;

3- Risi në draft ligjin e ri për strehimin është përfshirja e *“Parimit të Sigurisë së Qendrimit”* në të cilën ndalon rastet e dëbimit me forcë/zhvendosjen e individëve nga vendbanimet e tyre, si dhe e drejta e ankimit nga personat që preken nga dëbimi për të kundërshtuar zhvendosjen e tyre nga Gjykata Administrative.

4- Përfshirjen në dispozitat tranzitore të drejtën e njësisë të pushtetit vendor të parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre, që jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të komunitetit Rom. Me përfundimin e afatit të përcaktuar, ai do të rivlerësohet në përputhje me politikën qeveritare të përfshirjes sociale ndaj minoritetit Rom.

5- Përfshirjen në dispozita tranzitore trajtimin e familjeve me statusin e qiramarrësit në banesë ish pronë private, të përfitojnë kredi me interes 0 për qind dhe në rastet kur nuk kualifikohen për kredi, ato të trajtohen me banesë sociale ose subvencionohen. Në përfundim shpresojmë që këto sugjerime dhe rekomandime të Avokatit të Popullit të gjejnë pasqyrim deri në miratimin përfundimtar të këtij ligji në Parlament.

5.5 Auditoriumet ose tryezat e organizuara dhe aktivitete të tjera promovuese për vitin 2016

Përgjatë vitit 2016 institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi një veprimtari intensive me aktivitete promovuese në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit rreth institucionit dhe adresimit të problemeve që

shqetësojnë qytetarët. Këto aktivitete u mbështetën financiarisht nga Projekti Danez në zbatim të planit vjetor të aktiviteteve të miratuara me vendim të Komitetit Drejtues duke zbatuar me rigorozitet legjislativonin në fuqi.

Disa prej aktiviteteve kryesore të mbështetura nga Projekti Danez tregohen më poshte:

- Në kuadër të komponentit të pushtetit vendor, në 2016 institucioni i Avokatit të Popullit organizoi me sukses një **numër të konsiderueshëm auditoriumesh** për disa nga temat më të rëndësishme që shqetësojnë qytetarët e vendit. Tematika e auditoriumeve është përcaktuar duke u bazuar në diskutimet me grupet e interesit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, shoqëri të civile, etj. Këto tema u diskutuan në diskutime të moderuara midis ekspertëve të fushave përkatëse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme shtetërore, shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe komunitetit. Në këto debate publike një kujdes i veçantë i është kushtuar dhënies së mundësisë publikut për tu dëgjuar dhe për ti bërë pyetje përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të pranishëm në panel. Qëllimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka qënë rritja e ndërgjegjësimit për shqetësimet që kanë qytetarët, identifikimi i zgjidhjeve dhe eksplorimi i mundësive për bashkëpunim dhe bashkërendim më të ngushtë midis strukturave përgjegjëse për adresimin e këtyre problemeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit realizoi shtatë auditoriume përgjatë vitit 2016:

1. Prezantimi i raportit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit - gjendja e lirisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, në Tiranë;
2. Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Avokatin e Popullit dhe marrëdhëniet ndërkufitare, në bashkëpunim dhe me kontributin e institucioneve të Ombudsmanëve të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile nga vendet respektive, në qytetin e Pogradecit;
3. Gjendja e të drejtave kolektive të minoriteteve në Shqipëri, organizuar në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së dhe Këshillin e Evropës, në qytetin e Gjirokastrës;
4. E ardhmja e fëmijëve jetimë në Shqipëri, decentralizim-deinstitucionalizim, sfida për të ardhmen, organizuar në bashkëpunim me organizatat që veprojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si Unicef, Save the Children, Terre des Hommes, në Tiranë;
5. Tryezë e rrumbullakët mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në institucionet shtetërore gjatë vitit 2015, organizuar në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë;
6. E drejta e punësimit për personat me aftësi të kufizuara;
7. Gjendja e të drejtave kolektive të minoriteteve në Shqipëri, me fokus kryesor diskutime dhe komente lidhur me draft-ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përgatitur nga grupi i punës ngritur me urdhër të Kryeministrit.

- Gjatë vitit 2016 institucioni i Avokatit të Popullit në vijim të eksperiencës së suksesshme përgjatë viteve 2014 dhe 2015 duke organizuar 24 trajnime për pushtetin vendor, **realizoi edhe katër trajnime të tjera me përfaqësuesit e njësisë vendore në bashkitë Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Gramsh** me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut. Numri i të trajnuarve në këto trajnime ishte rreth 120 persona.

- Është bërë i mundur hartimi dhe prezantimi i gjetjeve të **raportit studimor lidhur me përcaktimin e nivelit të minimumit jetik në Shqipëri.**

- Në kuadër të komponentit të shoqërisë civile dhe medias, janë zhvilluar tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupet e ndryshme të interesit në qytete të ndryshme të vendit.

Tryezat e rrumbullakta me shoqërinë civile që janë mbështetur financiarisht nga Projekti Danez janë zhvilluar në qytetet Shkodër, Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Vlorë.

- Në bashkëpunim me zyrën e Kombeve të Bashkuara në Tiranë është organizuar **konferenca vjetore e institucionit** me temë “Ndërthurja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të drejtave të njeriut – synimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe roli i institucioneve të të drejtave të njeriut në implementimin e tyre”.
- Institucioni i Avokatit të Popullit dhe zyra e Projektit Danez janë kujdesur që për aq sa ka qënë e mundur të kombinojë dhe bashkërendojë aktivitete të tilla jashtë qytetit të Tiranës si **organizimi i Ditëve të Hapura, mbajtja e tryezave të rrumbullakta me shoqërinë civile, takimet me gazetarët**, kjo me qëllim që të mirëmenaxhohen si burimet njerëzore ashtu edhe ato financiare.
- Një aktivitet tjetër i komponentit të shoqërisë civile është evidentimi dhe gjetja e elementëve të të drejtave të njeriut lidhur me ushtrimin e tyre, zhvillimin e mësimin, trajnimin e mësuesve, njohurive që ata kanë, perceptimin dhe mendimin e tyre mbi të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve që nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Për të identifikuar këto elemente mbi të drejtat e njeriut dhe të të drejtave të fëmijës në të gjitha programet lëndore u hartua një instrument, pyetësor, i cili përmban 28 pyetje, me specifikime të ndryshme mbi aspekte të të drejtave të njeriut/fëmijës drejtuar mësuesve të shkollave të arsimit 9-vjeçar të Tiranës. Gjetjet e këtij pyetësori janë prezantuar në dy tryeza të rrumbullakta për mësuesit e arsimit 9-vjeçar në disa prej shkollave të qytetit të Tiranës.
- Krahas aktiviteteve të mësipërme, janë mbështetur si nga ana financiare ashtu edhe nga ana organizative dhe logjistike nga Projekti Danez edhe **prodhimi i materialeve të ndryshme promovuese**, ku një vend të rëndësishëm zë revista mujore e institucionit, inspektive si në qendrat penitenciare ashtu edhe ato rezidenciale që ofrojnë shërbime publike, është mbështetur dhe trajnuar stafi i institucionit nëpërmjet organizimit të vizitave studimore, etj.

5.6 Forcimi dhe bashkëpunimi me median dhe median sociale; Revista e institucionit

Institucionet shtetërore kanë hyrë në një epokë të re komunikimi. Një epokë bashkëbisedimi, pjesëmarrjeje dhe shkëmbimi demokratik. Mediat sociale tashmë janë thujse pjesë integrale e çdo platforme komunikimi institucional, për të realizuar një dialog transparent, të mirë të informuar dhe më shumë të përfaqësuar me qytetarët.

Prej vitit 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit është prezent në Facebook me një profil zyrtar të institucionit, nga ku komunikojmë me qytetarët mbi ankesat e reja dhe mbarëvajtjen e ankesave që ata kanë kryer. Po nga ky vit, duke publikuar aktivitetet dhe qëndrimet tona institucionale ne komunikojmë me qytetarët, mbi atë çka ne përfaqësojmë dhe punën tonë.

Të qenurit në rrjetet sociale, për institucionin e Avokatit të Popullit do të thotë të përballesh me një ndryshim kulturor të thellë që nuk përfshin vetëm mënyrën e shërbimeve, apo komunikimit, por dhe mënyrën e marrëdhënieve me qytetarin dhe rolin e tij.

Nëpërmjet pasqyrimin të aktiviteteve në profilin tonë në Facebook, kemi arritur të bëjmë të njohur për qytetarët:

- Pasqyrimin e aktiviteteve në kohë reale me foto e video, njoftime për media, etj.
- Përcjelljen e shqetësimeve dhe ankesave të tyre nëpërmjet mënyrës elektronike (kjo duke marrë në konsideratë që përdoruesit e internetit, numri i zotëruesve të një smartphone dhe një tablet rritet çdo ditë e më shumë, një numër i madh ankesash dhe shqetësimesh qytetarësh mbërrin në institucionin e Avokatit të Popullit nëpërmjet profilit të facebook-ut.)

- Përfshirjen e qytetarëve në vendosjen e prioriteteve dhe vëmendjes, duke kërkuar mendimet e tyre herë pas here;
 - Gjatë vitit 2016 institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet profilit të tij në Facebook ka bërë gjithësej 336 këshillime dhe orientime dhe ankesa.
- Këshillime dhe orientime *(jo të gjitha ankesat e bëra në profilin e institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë brenda juridiksionit. Në këtë rast qytetarëve ju është dhënë ndihma e duhur duke i këshilluar si duhet të veprojnë dhe duke u orientuar se në çfarë institucioni duhet të depozitohen shqetësimin, apo ankesën e tyre).*

Me qëllim krijimin e një ure të re komunikimi, u mendua një mënyrë e re, një revistë, por edhe si parathënie e një kontrate të re bashkëpunimi mes institucionit dhe qytetarëve. Ideja e kësaj reviste, siç e dëshmon edhe përmbajtja e saj, nuk është thjesht një botim ku flitet vetëm për institucionin tonë, por është një revistë e të gjithëve, e qytetarëve dhe për qytetarët, e punonjësve të Administratës Publike dhe për punonjësit e Administratës Publike, e shoqërisë civile dhe për shoqërinë civile. Pra publiku ka revistën e tij, ku mund të shprehë lirshëm opinionet mbi çeshtje të ndryshme.

Në 12 numrat e botuar gjatë vitit 2016, çdo numër ka trajtuar një problematikë të lidhur ngushtë me të drejtat e njeriut dhe problemet që prekin qytetarët.

Revista e Avokatit të Popullit këtë vit shënon vitin e saj të dytë të botimit, duke u bërë kështu një mjet komunikimi me qytetarët, punonjësit e administratës publike dhe vetë ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit.

Revista e Avokatit të Popullit ka ngritur çeshtje të mprehta, të cilat shpesh herë kanë qenë kronika kryesore në agjendën e lajmeve në vend.

Shqetësimet e qytetarëve, rekomandimet, sugjerimet drejtuar institucioneve qeveritare për zgjidhjen e tyre, kanë zënë një hapësirë të konsiderueshme, duke ju dhënë zë problemeve me të cilat përballen çdo ditë qytetarët.

Në numrat e këtij viti, janë trajtuar një sërë temash sensitive dhe aktuale:

- Minimumi Jetik, studimi mbi percaktimin e nivelit të minimumit jetik, i cili mungon në vendin tonë. Minimumi jetik është përlllogaritur mbi bazën e shportës ushqimore. Nga përlllogaritjet e kryera minimumi jetik për frymë në vitin 2015 rezulton të jetë përafërsisht 16.000 lekë në muaj.
- Konferenca e nivelit të lartë “Sfidat e institucioneve të Ombudsmanit përballë flukseve të përziera migratore”, për herë të parë, katër organizatat përfaqësuese ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut mblidhen në një konferencë të përbashkët, për të dalë me një zë unik mbi një nga krizat më të dhimbshme njerëzore, atë të emigrantëve.
- Minoritetet, problematikat e konstatuara nga inspektimet e Avokatit të Popullit, në vendbanimet kryesore të minoriteteve në vend
- Problematikat e fëmijëve dhe trajtimi i tyre në qendrat e përkujdesit social;
- Në vitin e dytë të botimit të saj, revista ka arritur të përmbushë misionin për të cilin u ngrit: të përmbledhë në një të vetëm: interesin e medias, dhënien zë të problematikave të qytetarëve dhe problemet me të cilat ata përballen më administratën publike dhe gjithashtu të pasqyrojë aktivitetin dhe rolin e Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe arenën ndërkombëtare.

Janë trajtuar tema si: 1) Rekomandimet pa përgjigje (për rëndësinë e të cilave nuk po ndalemi pasi kësaj problematike i është kushtuar një pikë e veçantë në këtë Raport vjetor); 2) Minimumi jetik (Shqipëria është ndër të paktat vende në Europë që nuk e ka të deklaruar Minimumin Jetik); 3) Dhuna ndaj grave (fenomen që ende vazhdon të regjistrojë viktima në Shqipëri); 4) Shërbimi spitalor (kushtet, mungesat dhe konkluzionet jo optimiste të një raporti të veçantë për këtë temë drejtuar

Kuvendit); 5) Dhuna nga uniformat blu (ku veçohen 7 raste dhune në komisariate dhe jashtë tyre nga funksionarë të rëndësishëm të Policisë së Shtetit, për të cilët Avokati i Popullit ka kërkuar fillimin e procedimeve penale); 6) Problematikat e Azilkërkuësve (shkaqet që i shtynë shqiptarët të kërkojnë azil dhe masat që duhen marrë për parandalimin e këtij fenomeni); 7) Problematika e pronave; 8) Procesi i Lustracionit (rekomandimet për ndryshimin dhe miratimin e bazës së nevojshme ligjore); 9) Problematikat e nëpunësve civile të Administratës Publike dhe atyre të Pushtetit Vendor (veçanërisht largimet nga puna); 10) Të drejtat e njeriut për vitin 2015 (problematikat dhe aktiviteti i institucionit të Avokatit të Popullit në përmirësimin e kësaj gjendjeje); 11) Fenomeni i gjakmarrjes (bazuar mbi një raport të dytë mbi këtë fenomen dërguar Kuvendit); 12) Puna e fëmijëve në Shqipëri (përmirësimi i kuadrit ligjor dhe atij institucional në Shqipëri).

Revista e institucionit të Avokatit të Popullit ka një tirazh prej 1500 kopje, 1300 nga të cilat me anë të një agjencie shpërndarjeje dërgohen në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë dhe qytetarët mund ta marrin falas në pikat e shpërndarjes së gazetave, por njëkohësisht i shpërndahet edhe organizmave të huaja për të drejtat e njeriut që veprojnë në vendin tonë, si dhe trupit diplomatik.

Botimi i kësaj reviste mundësohet falë ndihmës financiare që institucioni ynë përfiton në kuadër të projektit Danez.

Përpjekjet kryesore të stafit të institucionit është dhe do të vazhdojnë të jenë që kjo revistë të jetë një mjet sa më efikas për ruajtjen dhe forcimin e komunikimit me publikun.

5.7. Roli proaktiv dhe bashkëpunues i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse

Institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2016 vazhdoi të luajë një rol proaktiv në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Si pjesë e planit vjetor të aktiviteteve në kuadër të Projektit Danez janë zhvilluar tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupet e ndryshme të interesit në qytete të ndryshme të vendit.

Fokusi i Avokatit të Popullit ka qënë që të zhvillojë takime jo vetëm me përfaqësuesit e shoqërisë civile që veprojnë në Tiranë, por sidomos organizimi i tryezave dhe forcimi i kontakteve me shoqërinë civile në qarqe të ndryshme të vendit.

Jo vetëm Avokati i Popullit ka shkuar dhe ka marrë kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit lokalë të shoqërisë civile, por edhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme janë takuar vazhdimisht në zyrën e Avokatit të Popullit duke qënë në kontakt të vazhdueshëm për problemet që shqetësojnë qytetarët dhe kauzat me rëndësi publike. Avokati i Popullit ka treguar kujdes që në daljet e tij në qytete të ndryshme të ketë takime të vazhdueshme posaçërisht me shoqërinë civile lokale dhe përfaqësuesit lokalë të medias.

Tryezat e rrumbullakta me shoqërinë civile që janë mbështetur financiarisht nga Projekti Danez në 2016 janë zhvilluar në qytetet Shkodër, Tiranë, Gjirokastër, Fier, Vlorë. Tryezat e rrumbullakta i kanë shërbyer zhvillimit të marrëdhënieve dhe forcimit të komunikimit midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile qoftë në Tiranë ashtu edhe në qarqe të ndryshme të vendit.

Edhe në 2016 kanë vazhduar takimet këshillimore- konsultative të Avokatit të Popullit me përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit në kuadër të Bordit Këshillimor të Shoqërisë civile për çështje të ndryshme që kanë shqetësuar qytetarët.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, sidomos ata që kanë qënë pjesë e skemës së granteve në kuadër të Projektit Danez kanë qënë të gatshëm të marrin pjesë në aktivitetet që Avokati i Popullit ka zhvilluar përgjatë vitit. Jo vetëm kaq, por para zhvillimit të një aktiviteti të caktuar përfaqësuesit e shoqërisë civile janë kontaktuar paraprakisht dhe është dakortësuar me ta lidhur me bërjen e aktiviteteve të përbashkëta, përcaktimin e temave dhe axhendave në disa raste auditoriumesh, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe grupet e ndryshme të interesit kanë qënë prezent pothuajse në çdo panel aktivitetesh që ka organizuar institucioni si auditoriume, konferenca, tryeza të rrumbullakta, etj.

Një pjesë të mirë të raporteve të veçanta Avokati i Popullit ja ka dërguar paraprakisht për mendim përfaqësuesve të shoqërisë civile apo i ka diskutuar në tryeza të rrumbullakta para se ato të marrin formën finale dhe të dërgohen në Parlament.

Në datë 12 dhjetor 2016, institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me zyrën e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri organizoi konferencën e tij vjetore në të cilën u ftuan organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të organizatave ndërkombëtare në Tiranë, autoritete shtetërore, etj.

Tema e konferencës kishte të bënte me ndërthurrjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të drejtave të njeriut, synimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në implementimin e tyre.

Konferenca u finalizua me miratimin e një deklaratë të përbashkët nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe zyra e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri me rekomandime të përbashkëta për zbatimin e axhendës 2030.

KREU 6

Disa nga çështjet kryesore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015 në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut

6.1 Çështja për shpërnguljen me forcë të komunitetit Rom

Një çështje shumë sensitive lidhur me problematikat që shqetësojnë komunitetet e ndryshme Rome në vend, është shpërngulja (dëbimet) me forcë nga vendqëndrimet e tyre komunitare, të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore, ku edhe kanë ndërtuar kryesisht baraka. Këto zhvendosje sikurse na rezultojnë janë situata të përsëritura që kanë ndodhur ndër vite.

Në raportin vjetor të punës së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, është trajtuar gjerësisht rasti i zhvendosjes me forcë të komunitetit Rom, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë. Vlen të theksohet që, Avokati i Popullit përmes qëndrimit të tij proaktiv lidhur me këtë rast ka konstatuar se ky është një rast i përsëritur që përpos mungesës së një legjislacioni të nevojshëm specifik vendas, për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve me dhunë, nxjerr nevojën imediate të implementimit të parimeve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, që rregullojnë këtë çështje dhe që janë të detyrueshme për shtetin shqiptar.

Të gjitha konstatimet e trajtimit të kësaj çështjeje nga ana jonë, janë përmbledhur në një raport të veçantë që i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë, në vitin 2016. Kjo çështje shqetësuese është pasqyruar edhe në një letër që Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, z. Nils Muiznieks, i ka dërguar në fillim të vitit 2016 disa shteteve europiane (*Shqipërisë, Bullgarisë, Francës, Hungarisë, Italisë, Serbisë dhe Suedisë*), midis të cilave edhe Shqipëria, në lidhje me dëbimet me dhunë të komuniteteve Rome nëpër këto vende, pa siguruar më parë kushte të përshatshme strehimi. Thirrja e përbashkët ndaj qeverive përkatëse, e drejtuar nga ana e Komisionerit

për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, është që të ndalohet shkatërrimi i vendbanimeve të Romëve dhe përzënia e tyre, pa u krijuar paraprakisht kushte të përshtatshme strehimi për to.

Gjatë vitit 2016, nëpërmjet ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit, jemi vënë në dijeni nga përfaqësues të komunitetit Rome të zonës së Sharrës, Tiranë, të vendosur në afërsi të vendit ku përpunohen mbetjet urbane të qytetit të Tiranës, për një paralajmërim verbal që, këtij komuniteti i është bërë për largimin nga ky vendqëndrim, nga punonjës të Bashkisë Tiranë. Sipas ankesave të paraqitura, ky komunitet kishte mbi 20 vjet që ishte vendosur me baraka, në afërsi të vendit ku përpunohen mbetjet urbane në zonën e Sharrës, Tiranë. Bëhet fjalë, sipas të dhënave që kemi marrë nga verifikimi në vend, për rreth 30 familje, që jetonin në të njëjtin numër barakash në këtë zonë. Shqetësimi i shprehur nga ky komunitet lidhej me faktin se, njoftimi verbal që ju ishte bërë nga ana e punonjësve të Bashkisë Tiranë, nuk iu jepte zgjidhje se çdo të ndodhte më pas me ta, sa i takon kushteve të tyre të jetesës dhe mundësisë për t'u strehuar qoftë edhe në një barakë si vendstrehim. Për më tepër, shqetësimi i tyre më i madh lidhej me faktin se, sipas paralajmërimit që ju ishte bërë, ata duhet të largoheshin nga vendi ku banonin brenda muajit Mars 2016, pasi në të kundërt do t'u prisheshin barakat nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Tiranë.

Nisur nga ky shqetësim i shprehur, ne kemi filluar hetimin administrativ lidhur me këtë çështje. Pas një monitorimi të kujdesshëm dhe kontakteve të vazhdueshme me banorë të komunitetit, si dhe me përfaqësues të Bashkisë Tiranë, rezultoi se çështja është në rrugën e zgjidhjes pas marrëveshjeve që Bashkia Tiranë ka bërë me këta të fundit, ose për trajtimin e tyre me një nga mënyrat e parashikuara nga ana e legjislacionit për trajtimin me bonuse për strehimin social, ose për rikthimin e tyre në vendbanimet e tyre “të origjinës”, duke konkluduar për këtë çështje me bashkitë e tjera në vend.

Një çështje tjetër e filluar me iniciativë është ajo e zhvendosjes së një komuniteti banorësh në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë, për shkak të zbatimit të një projekti për realizimin e një investimi publik, nga ana e Bashkisë Tiranë. Nga të dhënat paraprake të marra në terren nga ana jonë ka rezultuar se, ky komunitet ka patur rreth 72 familje Rome/Egjiptiane, me rreth 341 pjestarë, të cilat prekeshin nga zbatimi i projektit të sistemimit të shtratit të lumit, në zonën e Bregut të Lumit. Pjesa më e madhe e tyre jetonin prej shumë vitesh në këtë zonë në baraka, ndërsa pjesa tjetër jetonte në banesa një katëshe, pa cilësi ndërtimore. Për përditësimin e problematikës dhe dinamikës së saj, nga ana jonë janë marrë kontakte të vazhdueshme në terren me familjet e komunitetit Rom/Egjiptian dhe jo vetëm, të vendosur në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë, me organizata joqeveritare dhe me aktivistë Romë, që ushtrojnë aktivitet në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian në Shqipëri, si dhe me organizata ndërkombëtare, apo partnerë ndërkombëtarë në vend.

Duke qënë së çështja kishte të bënte me një zhvendosje të detyrueshme të këtij komuniteti, për shkak të zbatimit të një projekti për ndërtimin e një vepre publike kemi theksuar në dy rekomandimet tona për këtë rast³⁷, se, sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Po kështu, kemi sjellë në vëmendjen të Bashkisë Tiranë faktin se, çdo veprim i njëanshëm nga ana e këtij institucioni apo edhe nga ana e punonjësve të firmës së ndërtimit që po zbatonte projektin e rehabilitimit të lumit në këtë zonë, që qëllimonte zhvendosjen e këtij komuniteti, pa respektuar parimet dhe standardet ndërkombëtare në proceset e dëbimit me forcë, përbënte shkelje të rëndë të të drejtave themelore, të ligjshme, të individëve pjestarë të këtij komuniteti. Në përgjigje të rekomandimit tonë të parë, Bashkia Tiranë me shkresën nr.18389/1 datë 24.06.2016, është shprehur se:

³⁷ Nr.K1/I2-11 datë 14.06.2016

”Bashkia Tiranë po ndërton një plan ndërhyrjeje të detajuar, nisur nga vlerësimi socio-ekonomik i çdo familjeje Rome dhe jo vetëm, të realizuar në terren. Me angazhimin e 5 skuadrave të terrenit të shoqëruar nga aktivistë të komunitetit Rome, bazuar në diskutimet paraprake në komunitet është bërë vlerësimi i rreth 94 familjeve të komunitetit Rome dhe jo vetëm, ose rreth 390 individëve... Bazuar në instrumentat dhe mekanizmat ndërkombëtare që po udhëheqin zbatimin e një plani të detajuar ndërhyrjeje, nga ana e Bashkisë Tiranë, për sistemin e familjeve, më poshtë do të gjeni hapat e ndërhyrjes që garantojnë se askush nuk do të jetë produkt i të qenit vulnerabël dhe viktimë e dhunës e shkeljes së të drejtave të njeriut, si pasojë e projekteve të planifikimit dhe zhvillimit urban”.

Ajo që mbetet shqetësuese në këtë çështje dhe që është ngritur me forcë edhe në rekomandimet tona drejtuar Bashkisë Tiranë është se, ky institucion nuk ka patur një plan veprimi të detajuar dhe të finalizuar për zhvendosjen e këtij komuniteti, në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të zhvillimit të situatave të dëbimeve me forcë. Megjithatë kemi konstatuar se, si pasojë e monitorimit tonë të kujdesshëm dhe analitik të çështjes, Bashkia Tiranë është treguar më e kujdesshme në trajtimin e këtij rasti. Kryefjala e rekomandimeve tona në këto raste mbetet zgjidhja përfundimtare në përputhje të plotë me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që komuniteteve Rome dhe jo vetëm, t’i ofrohen zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synojnë dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

Në ndjekje të problematikave që shqetësojnë komunitetet Rome/Egjiptiane në vend, jemi vënë në dijeni nga veprimtarë të shoqërisë civile se, në lagjen 10, të qytetit të Korçës, njohur ndryshe si ish “Poligoni i sportit”, 16 familje nga të cilat, 14 të komunitetit Egjiptian dhe 2 të komunitetit Rom, janë njoftuar verbalisht nga punonjës të Bashkisë Korçë, për të liruar banesat në të cilat ata jetojnë. Këto familje janë strehuar me një autorizim që prej vitit 1992, nga ish lagjia, për t’u strehuar në këto banesa. Ky rast është trajtuar nga ana jonë me iniciativë. Pas shpjegime të kërkuara nga ana e Bashkisë Korçë, është sqaruar se bëhej fjalë për 17 familje që banonin në zonën e sipërcituar, që është pjesë e kompleksit sportiv “Skënderbeu”. Ky kompleks, është planifikuar sipas përgjigjes, si një projekt i madh sportiv nga ana e Bashkisë Korçë. Zgjidhja e parashikuar dhe propozuar nga ana e këtij institucioni konsiston në, bonusin e strehimit, gjë që shihet edhe nga ana e Bashkisë Korçë si zgjidhja e vetme afatgjatë për jetesën e tyre në kushte normale. Edhe në këtë çështje nga ana jonë i është rekomanduar Bashkisë Korçë, zgjidhja përfundimtare në përputhje të plotë me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve të këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për ata vetë si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që ky minoritet të ndihet i diskriminuar, i pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Pavarësisht se zgjidhjet e ofruara apo edhe rezultatet e arritura si zgjidhje janë ende larg standardeve të kërkuara dhe të pritshme, konstatojmë se një nga rezultatet e prekshme në këto raste është hapja e një debati të shëndetshëm publik mbi çështjen, por edhe fenomenin që qëndron pas saj.

6.2 Çështja për të drejtat e emigrantëve, të huajve, të kthyerit

Në kontekstin e situatës së krizës të paprecedentë në hapësirën e gjerë të Mesdheut, si një situatë komplekse problematike dhe sfiduese në shumë aspekte, një rëndësi të veçantë merr trajtimi i funksionit të dyfishtë të Avokatit të Popullit, si mbrojtës dhe promotor i të drejtave të njeriut. Roli i tij i patjetërsueshëm për projektimin e të drejtave të njeriut në dialogun institucional dhe dialogun e

gjerë shoqëror, është i domosdoshëm dhe shërben si një vlerë e shtuar e të gjitha kontributeve, për tejkalimin e situatave serioze që kërcënojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Vizioni i Avokatit të Popullit kërkon që, korniza e politikave dhe aksioni konkret i shtetit shqiptar në qasjen ndaj krizës aktuale të migracionit, të respektojnë obligimet që burojnë nga legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe posaçërisht, për statusin e refugjatëve, përfshirë këtu Konventën e Gjenevës 1951 dhe Protokollin e saj të vitit 1967, si dhe Rekomandimin nr.16, të adoptuar nga ana e Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), në 16 Mars 2016.

Thelbi i punës dhe prioriteti përcaktues i aktivitetit të Avokatit të Popullit, në situatën e krizës së paprecedentë të migracionit, lidhet me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve të cënueshme dhe komuniteteve në risk. Angazhimi i Avokatit të Popullit është jetësor për monitorimin e situatës së të drejtave të njeriut, hetimin e praktikave abuzive dhe parandalimin e tyre, ndërgjegjësimin e autoriteteve për zbatimin e standarteve dhe obligimeve në fushën e të drejtave të njeriut, si edhe kontributin në dialogun ndër-institucional dhe ligjërimin publik për të ndërgjegjësuar dhe kundërvepruar gjuhën e urrejtjes, racizmit dhe ksenofobisë. Roli aktiv i ndërthurur me një proaktivitet të spikatur, ka të nevojshëm një shterim adekuat të mjeteve ligjore në funksion të mandatit dhe funksionit të Avokatit të Popullit dhe një bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, median, si dhe partnerët ndërkombëtarë.

Krizë e paprecedentë e migracionit paraqet sfida komplekse në kontekstin aktual për garantimin e të drejtave bazike të emigrantëve që mbërrijnë apo mund të mbërrijnë në territorin e Shqipërisë, ashtu dhe në planin afat-gjatë, për sfidën e integritit, qoftë ky integrimi i azilantëve në shtëpitë e tyre të reja në vendet që i mirëpresin, qoftë integrimi i shtetasve të kthyer në vendet e tyre të origjinës. Ky proces duhet të garantojë dinjitetin njerëzor, të drejtat bazike dhe respektimin e parimit “non refoulement”.

Avokati i Popullit, ndeshet edhe me sfidën e mbrojtjes së të drejtave të shtetasve të vendit amë, qoftë në pozicionin e mundshëm të shtetasve të tranzitit, apo edhe atyre të destinacionit. Krahas autoriteteve shtetërore, shoqërisë civile lokale dhe organizatave ndërkombëtare, institucioni i Avokatit të Popullit duhet të jetë i pranishëm dhe i arritshëm nga personat në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare.

Ndërkohë një sërë çështjesh mund të shfaqen si pengesë për Avokatin e Popullit, në trajtimin e kësaj situatë, të cilat lidhen me, mungesën e kapaciteteve njerëzore të mjaftueshme; mungesën e infrastrukturës lehtësuese dhe mjeteve financiare; shtrirjen gjeografike të përqendrimit të mundshëm të flukseve migratore; mungesën e aksesit të migrantëve dhe refugjatëve tek Avokati i Popullit; si dhe vështirësitë që pengojnë funksionalitetin efektiv të Avokatit të Popullit.

Kuadri normativ ekzistues vendas, garanton të drejtën për azil të të huajit, apo personit pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi, ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, si pasojë e këtyre ngjarjeve dhe për arsye të kësaj frike. Megjithatë, në kuadër të procesit të vlerësimit të plotësisht të kushteve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në BE, janë dhanë disa rekomandime në interes të përmirësimit të këtij legjislacioni.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në kuadër të monitorimit të masave dhe politikave që po ndërmerren për çështjet e emigracionit, kthimin e shtetasve shqiptarë pas emigrimit më të fundit në vendet e Evropës dhe të masave që, po ndërmerren

për riintegrimin e tyre, si dhe të masave të ndërmarra dhe procedurave të azilit, për azilkërkuesit potencialë nga shtetet e tjera zona aktuale të luftës në vendin tonë, ka zhvilluar një aktivitet intensiv. Më konkretisht nga monitorimi i kryer është arritur në konkluzionin se:

- a) Vendimet e Drejtorisë për Azilin, kanë marrë parasysh në mënyrë të kënaqshme mendimin e UNHCR, si agjenci e specializuar e OKB-së për refugjatët;
- b) Procedura e përzgjedhjes që zbatohet nga Policia e Kufirit, ka shpesh të meta që lidhen me kategorizimin e personave, mbajtjen e tyre dhe trajtimin gjatë intervistimit, mungesën e përkthyesve të sigurtë, sidomos për persona që vijnë nga vende ku fliten gjuhë pak të përhapura në botë, si edhe prirja e kahershme e Policisë së Kufirit për të interpretuar aty për aty, nëse personi ka shanse t'i njihet statusi i refugjatit apo jo, dhe si rrjedhim, prirjes për të mos ta kategorizuar dikë si azilkërkues, pavarësisht nga kërkesa e vetë personit mbi rreziqet në vendin e origjinës, apo refuzimit të tij kategorik për t'u kthyer atje.
- c) Drejtoria për Azilin ka kufizime të shumta në aftësinë e saj për të mbledhur informacion nga vendet nga vijnë azilkërkuesit e rrjedhimisht njohja e gjendjes në këto vende mbetet e cekët dhe vendimet çalojnë në arsyetime.
- d) Pavarësisht nga parashikimi ligjor, mbledhja për përcaktimin nëse një person është apo jo refugjat, nuk bëhet në mënyrë kolegjiale e rrjedhimisht, as UNHCR nuk ftohet të marrë pjesë në to.
- e) Kapaciteti pritesë i Shqipërisë për refugjatët përfaqësohet nga Qendra e Karreçit, e cila nuk i kalon 170 shtretër (nuk ka kapacitet zyrtar që merr në konsideratë standardet e kubaturës). Ndaj sistemi është shumë i cënueshëm në rast fluksesh refugjatësh, si ai i personave nga Siria, që Evropa ka përjetuar së fundmi.

Nga monitorimi i planit të masave të miratuara nga Qeveria, për trajtimin gjatë kthimit në territorin tonë të azilkërkuesve shqiptarë në vendet e tjera të Europës dhe riintegrimin e tyre, konstatohet se për periudhën, gjashtë mujori i dytë i vitit 2015 dhe tre mujori i parë i vitit 2016, numri i shtesave shqiptarë të kthyer në vend, është *29397 persona*.

Mbi bazën e monitorimeve dhe informacionit të autoriteteteve përgjegjëse shtetërore, kemi konstatuar mungesën e një strategjie kombëtare për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera të Europës, si dhe të një Plan-Vepri zbatues.

Ndërkohë, aktiviteti i Avokatit të Popullit në kontekstin ndërkombëtar me institucionet homologë ka përfshirë:

- Komunikimin dinamik lidhur me zhvillimet në terren dhe situatën emergjente, ndarjen e informacionit/statistikave dhe analizave mbi flukset mikse migratore;
- Promovimin e praktikave të mira dhe rezultateve pozitive të arritura nga angazhimet institucionale individuale dhe ato në nivel dypalësh dhe shumëpalësh;
- Dhënien e vizibilitetit për problematikat dhe vështirësitë e hasura nga institucionet e Ombudsmanit, me synim trysnim efektiv të aktorëve qeveritarë dhe ndër-qeveritarë për marrjen e masave të duhura për garantimin e të drejtave të emigrantëve, në përputhje me obligimet që burojnë nga legjislacioni vendas dhe ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut;
- Informimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e emigrantëve dhe specifikat e krizës së migracionit, në funksion të kundërveprimit të gjuhës së urretjes, racizmit dhe ksenofobisë;
- Optimizimin e burimeve në dispozicion dhe krijimin e sinergjive përmes nismave dhe veprimtarive të përbashkëta në nivel dypalësh ndër-kufitar, si edhe në nivel shumëpalësh rajonal dhe ndërkombëtar;

- Lehtësimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit të institucioneve të Ombudsmanit me shoqërinë civile lokale dhe organizatat ndërkombëtare jo-qeveritare që janë prezente në vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit;
- Vlerësimin dhe faktorizimin e perspektivës së institucioneve të Ombudsmanit dhe NHRI-ve në diskursin dhe axhendat e aktorëve të rëndësishëm qeveritarë dhe ndër-qeveritarë/supranacionalë, me synim avancimin e qasjes së bazuar tek të drejtat e njeriut;
- Përgatitjen e studimeve, manualëve të praktikave të mira dhe analizave të cilat u vijnë në ndihmë aktorëve qeveritarë, ndër-qeveritarë dhe jo-qeveritarë në trajtimin e sfidave afat-shkurtra dhe afat-gjata të krizës së migracionit;
- Organizimin dhe pjesëmarrjen/përfaqësimin në aktivitetet me karakter ndër-kufitar, rajonal dhe ndërkombëtar, të formateve të ndryshme me fokus problematikat, sfidat dhe oportunitetet që ndërliken me flukset mikse migratore.

Në tërësinë e rekomandimeve të përgatitura për një qasje adekuate ndaj flukseve migratore veçojmë rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme dhe të nevojshme për trajtimin në përputhje me instrumentet kombëtare e ndërkombëtare të flukseve ekzistuese dhe atyre të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri. Ky rekomandim synon të përafrojë maskimalisht frymën ndërkombëtare të solidaritetit dhe standardeve të të drejtave të njeriut në trajtimin e situatës së krizës, me pritshmërinë e trajtimit të gjendjes potencialisht të ndodhshme në Shqipëri. Efektivisht, Shqipëria mbetet në një gjendje ende të papërgatitur në mënyrën e duhur. Ndërsa idetë e hedhura për qendra të mundshme pritje apo regjistrimi e ndihme për kalim tranzit janë të shumta, në terren nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për të pasur mjedise të tilla pritjeje.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), ka monitoruar në vijëmbesi Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe ka parë nga afër pikat të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin transit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nga inspektimet në qendrat e pritjes e të ndalimit, është vënë re që kapaciteti i tyre në hapësirë dhe në burime financiare e njerëzore është i pamjaftueshëm, jo vetëm për raste të flukseve masive, por edhe për raste të rritjes graduale të numrit të azilkërkuesve, apo të migrantëve të parregullt në një kohë të shkurtër.

Nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, si dhe në pikat e mundshme – kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin tranzit të migrantëve është konstatuar se ka shumë sfida që duhen tejkaluar – qoftë edhe në një kuadër emergjence, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to.

E gjithë veprimtaria institucionale e Avokatit të Popullit në këtë fushë është pasqyruar krahas aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare edhe në Raportin e Veçantë, “*Mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit për çështjen e migracionit*”, dërguar Kuvendit të Shqipërisë, në datë 11.07.2016.

6.3 Minimumi jetik

Avokati i Popullit qysh prej vitit 2012 ka kryer një praktikë të gjatë ndër-institucionale mbi çështjen e llogaritje së minimumit jetik, por ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje për fillimin e procesit të

studimit dhe shpalljes së nivelit minimal të standartit të jetesës në Shqipëri ,³⁸ pavarësisht gadishmërisë së shprehur për të filluar punën për këtë çështje.

Trajtimi i të "drejtave ekonomike dhe sociale" si pjesë e të Drejtave të Njeriut është thelbësore si në përpjekjet për të eliminuar varfërinë ekstreme, por edhe për të siguruar një qendrim të balancuar dhe të besueshëm në fushën e të drejtave të njeriut.

Sipas treguesve të nxjerrë nga INSTAT rreth 14.3% e popullsisë në vendin tonë jetojnë në varfëri absolute me konsum mujor real nën 4891 lekë, ndërkohë që rreth 2.2% e popullsisë jetojnë në varfëri ekstreme.

Nisur nga situata aktuale, kur edhe pranë institucionit të Avokatit të Popullit numri më i lartë i ankesave lidhet me objektivat sociale sikundër janë: punësimi, ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar, masat e pensioneve të pleqërisë etj. mbi pamundësinë e kategorive më vulnerabel të shoqërisë në përballimin e kushteve me minimale të një jetese me dinjitet, prej vitesh kemi kërkuar nëpërmjet rekomandimeve të përsëritura llogaritjen dhe deklarimin e minimumit jetik në vend.

Duke qenë se kërkesa për përcaktimin e minimumit jetik është një domosdoshmëri jetike për shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare, aq më tepër kur vendi ynë synon respektimin e të drejtave të njeriut dhe përfaqsimin me standardet më të mira ndërkombëtare, gjykojmë si të nevojshëm kryerjen e një raport-studimi mbi këtë çështje shumë sensitive, pasi bazuar edhe në standartet ndërkombëtare, llogaritja e minimumit jetik, nuk është vetëm një tregues që lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por edhe për të përcaktuar nivelet e përfitimeve në skema si: -Mbrojtja sociale; - Sigurimet shoqërore; - Sistemi i pagave.

Sipas Raportit të Studimit "*Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri*"³⁹, minimumi jetik është llogaritur në vlerën prej **16.000/muaj për frymë në Shqipëri** me të dhënat e vitit 2015. Metodologjia që është përdorur lidhet me të dhënat sasiore të disponueshme, statistikave dhe informacionet nga burime dytësore si dhe të dhënat cilësore të përfituara nga konsultat me ekspertë të nivelit të lartë.

Minimumi jetik është një tregues që ka karakter dinamik dhe që ndryshon në varësi të zhvillimeve të ndryshme sociale dhe ekonomike. Avokati i Popullit vlerëson si shumë të rëndësishëm identifikimin e të gjitha ndërhyrjeve dhe politikave sociale për kalimin nga nevoja e përcaktimit të minimumit jetik drejt një standardi jetese të arsyeshme dhe me dinjitet njerëzor.

Axhenda e miratuar në samitin e Kombeve të Bashkuara në muajin Shtator 2015, "*Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2015 - 2030*", objektivin nr.1 e lidh me zhdukjen e varfërisë duke theksuar ndër të tjera marrjen e masave për zbatimin e sistemeve të përshtatshme për mbrojtjen sociale, zbatimin e programe dhe politika për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj.

Për zbatimin e rekomandimeve të dalta nga studimi, të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen e përcaktimit të minimumit jetik në kuadrin ligjor, përllogaritjen e madhësisë së minimumit jetik; lëvrimin dhe publikimin e të dhënave, sigurimin e të dhënave shkencore periodike (mbi baza vjetore) i nevojës për kalori në ditë, përdorimin i minimumit jetik si bazë për llogaritjen e përfitimeve, kërkohet një bashkëveprim ndërmjet institucioneve publike.

Në këtë kuadër, më datë 21.12.2016, i kemi rekomanduar Minsitrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë marrjen e masave të menjëhershme për përcaktimin e minimumit jetik dhe mbajtjen në konsideratë të ndryshimeve ligjore përkatëse që lidhen me objektivat sociale si dhe Ministrit të Shëndetësisë rishikimin e ligjit nr.10138/2009 "*Për Shëndetin Publik*", i ndryshuar, për një shtesë në nenin 15 mbi funksionet e Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim publikimin e nevojës energjetike për kalori në ditë / frymë.⁴⁰ Për të cilën ende nuk kemi marrë një përgjigje.

³⁸ Përgjigje e ardhur nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me nr. 474/2 prot; datë 09.03.2015

³⁹ "Raport i studimit nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike, "Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri"

⁴⁰ Doculive nr.201602528

KREU 7

Sfidat dhe arritjet në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues i vetëm në llojin e tij, vazhdon ende të përballet me një sërë sfidash ashtu si dhe arritje gjatë veprimtarisë së tij në vitin 2016.

Arritjet e institucionit të Avokatit të Popullit janë shënuar në ***bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtare*** jo vetëm në aktivitete të përbashkëta por njëkohësisht edhe aksione të tilla me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu një bashkëpunim të rëndësishëm, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur me rrjetet në të cilat bëjnë pjesë Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, Ombudsmanët, etj.

Arritjet janë shënuar edhe në ***rritjen e besimit dhe aksesit të qytetarit*** tek institucioni i Avokatit të Popullit duke e parë si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre, kjo falë edhe mirëfunksionimit të zyrave rajonale.

Arritjet janë shënuar në ***bashkëpunimin me median***, duke e konsideruar median si një aleat i rëndësishëm, e cila jo vetëm ndihmon në publikimin e aktiviteteve dhe rritjes së vizibilitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit por njëkohësisht edhe si një burim informacioni.

Marrëdhëniet me institucionet shtetërore gjithashtu këtë vit kanë shënuar përmirësim, por sfidë mbetet zbatimi i rekomandimeve të pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Për këtë duhet gjithashtu të zbatohet plani i veprimit të hartuar nga Ministria për çështjet e Parlamentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit.

7.1. Vështirësitë e hasura në marrëdhënien me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Sikundër Avokati i Popullit ka evidentuar në mënyrë të vazhdueshme, sfidat në punën e tij, kundrejt institucioneve të Administratës Publike, lidhen me tre momente kryesore:

- 1- Moskthimi i përgjigjeve për kërkesat për shpjegime;
- 2- Moskthim të përgjigjeve ndaj rekomandimeve;
- 3- Moszbatim të Rekomandimeve të pranuar paraprakisht nga Institucionet shtetërore.

Progres raportet e fundit (2014, 2015, 2016), kanë ngritur si shqetësimin dhe komentuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve kushtetuese sikundër është edhe Avokati i Popullit. Në kushtet kur në këto progres- raporte një rol specifik i është ngarkuar Kuvendit të Shqipërisë për të monitoruar në mënyrë sistematike nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucionit tonë, ky i fundit, në datë 24.10.2016, na ka njohur me një draft dokumenti të hartuar “*Për identifikimin dhe krijimin e mekanizmave institucionalë për ndjekjen dhe zbatimin efikas të rekomandimeve të institucioneve të pavarura*”.

Avokati i Popullit ka kërkuar dhe sugjeruar:

Së pari: Vendosjen e një detyrimi për ngritjen e mekanizmave të brendshëm përgjegjëse nga cdo institucion i Administratës Publike (qendrore dhe vendore), për evidentimin e problematikës në fjalë dhe zgjidhjen në rastet kur ajo ekziston në një kohë sa më të shpejtë rast pas rasti.

Ky sugjerim ka ardhur për shkak se, gjatë punës tonë kemi konstatuar mungesë bashkëpunimi jo vetëm nga institucionet në nivel qendror, por edhe institucionet në nivel vendor, dhe kjo do të ndihmonte edhe njësitë e pushtetit vendor për respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Së dyti: Shtimin e një objektivi me përmbajtje: **“Çdo gjashtë muaj, Qeveria duhet të raportojë në Kuvend mbi gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit”.**

Ky sugjerim, duhet të pasohet më tej dhe kërkon ndryshimet ligjore përkatëse, dhe do të shërbejë si një instrument për forcimin e nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit si dhe mirëqeverisjes.

Aktualisht, këto sugjerime janë përfshirë në këtë draft-dokument, pasi pritet të kalojë për votim në Kuvendin e Shqipërisë.

Avokati i Popullit në punën e tij është i ndërgjegjshëm se veprimtaria këtij institucioni e ka shumë të nevojshme që të ketë një mekanizëm eficient dhe sistematik të ndjekjes dhe përmbushjes së rekomandimeve që ne i drejtojmë administratës publike.

Pavarësisht përmirësimeve të bëra, vazhdon të mbetet shqetësuese, moskthimi i përgjigjeve të kërkesave për shpjegime dhe maskthimi i përgjigjeve rekomandimeve të adresuara, duke refuzuar kështu bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit është një fenomen tashmë i përsëritur dhe nuk po gjen ende zgjidhje. Në kundërshtim me sa parashikohet në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet detyrimi i *organeve të administratës për t’ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit*, sipas të cilit: *“Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”*, organet e administratës publike, nuk kthejnë përgjigje edhe pas kërkesave të përsëritura.

Për zgjidhjen e kësaj problematike, e cila duhet thënë se është shfaqur edhe në vitet e mëparshme, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë përpjekje në rrugë administrative si duke ridërguar kërkesat për kthimin e përgjigjeve të munguara, ashtu edhe duke ju drejtuar organit epror, por edhe këto përpjekje nuk e kane zgjidhur problemin.

Një mekanizëm tjetër shumë i rëndësishëm që ligjvënësi ka parashikuar për institucionin tonë, janë edhe Raportet e Veçanta. Ky mekanizëm do të ishte më efikas në rast se do të përmirësoheshin dy momente. Momenti i parë është ai i kohës ndërmjet dërgimit të një Raporti të Veçantë nga institucioni ynë dhe shqyrtimit të këtij Raporti nga Komisionet përkatëse të Kuvendit. Pasi në mjaft raste Raportet tona të Veçanta janë diskutuar disa vite pas dërgimit të tyre, duke humbur kështu aktualitetin. Po kështu kujtojmë se ka ende një sërë raportesh të Veçanta të cilat nuk janë shqyrtuar ende nga Kuvendi

Duke pasur parasysh statusin e veçantë kushtetues që ka institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe faktin që rekomandimet e institucionit tonë lidhen me shkëlqe të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga institucionet shtetërore, mosmarrja e masave në rastet e moskthimit të përgjigjeve, apo moszbatimi i rekomandimeve të institucionit tonë, prek ekuilibrat institucional të një shtetit demokratik.

Një bashkëpunim jo i mirë me institucionin e Avokatit të Popullit cënon dhe ul nivelin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të parashikuara si në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, ashtu edhe nga legjislacioni vendas.

7.2. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e Administratës Publike

Sikundër rezulton edhe nga statistikat përmbledhëse të pasqyruara në Raportin Vjeto të Avokatit të Popullit për vitin 2016, janë adresuar në total 319 rekomandime drejtuar institucioneve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.

Nga numri total i rekomandimeve të adresuara janë pranuar 197 rekomandime, nga të cilat rezulton se vetëm 93 prej rekomandimeve të pranuar, kanë gjetur zbatim të plotë. Pra, referuar raportit të rekomandimeve të pranuar me rekomandimet e zbatuara, rezulton se 47.2% e rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim nga institucionet përkatëse.

Në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, shtojmë se ka edhe një detyrim tjetër ligjor, i cili do të ndihmonte në kuptimin dhe zbatimin e rekomandimeve të institucionit tonë, por që si gjatë vitit 2015, ashtu edhe më parë, rezulton të mos jetë zbatuar asnjëherë. Më konkretisht neni 22 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”, parashikon se: *“Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij”*, por me perjashtim të rasteve kur diskutohen raportet e veçanta të institucionit tonë nga Kuvendi, në asnjë rast tjetër institucioni ynë nuk është thirrur për të marrë pjesë në rastet kur shqyrtohen rekomandimet, kërkesat, apo propozimet tona.

Lidhur me rekomandimet pa përgjigje, evidentojmë se 70 rekomandime për vitin 2016, rezultojnë pa përgjigje. Pra, në përputhje me raportin midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit rezulton se 21.9 % e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje.

Lidhur me numrin e kërkesave për informacion, rezulton se për vitin 2016, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 3053 kërkesa për informacion, prej të cilave 158 prej tyre rezultojnë pa përgjigje, ose 5.1% e kërkesave për informacion të adresuara nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

Në konkluzion të statistikave të mësipërme, nëse do të bëjmë një analizë krahasimore me nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve për vitin 2015 dhe 2016, na rezulton se ka një rritje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike për vitin 2016, por është ulur përqindja e rekomandimeve të zbatuara duke e krahasuar me vitin 2015. Ndërkohë edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2016 janë më shumë rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2015.

Nisur nga organizimi i brendshëm i punës në institucion, në varësi të rëndësisë së rekomandimit, apo në varësi të subjektit që i drejtohet, rekomandimet edhe gjatë vitit 2016 janë dërguar si nga Avokati i Popullit, ashtu edhe nga Komisionerët sipas kompetencës lëndore.

7.3. Vështirësitë dhe arritjet në marrëdhëniet me qytetarin

Cilësia në rritje e shërbimeve dhe e performances me etikë profesionale dhe qytetare, ofruar nga Zyra e Pritjes së Popullit që prezanton Institucionin dhe krijon impaktin e parë të komunikimit me qytetarin, sigurisht ka dhënë kontributin e saj në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit e për rrjedhojë në rritjen e numrit të ankesave apo kërkesave nga viti në vit. Në këtë zyrë, në çdo orë të ditës gjatë orarit zyrtar, qytetarët vijnë për të sjellë ankesat apo kërkesat e tyre dhe ndjehen të mirëpritur e përfitojnë gjithë çfarë mund t'ju ofrojë Institucioni i Avokatit të Popullit që i ka kushtuar në vijimësi rëndësi kryesore funksionimit në çdo kohë, pa pengesë, me kulturë e profesionalizëm Zyrës së Pritjes së Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse është e sanksionuar dhe në Kushtetutën e Shqipërisë, luan një rol parandalues, mbrojtës e proaktiv në kuadër të të drejtave dhe lirive të njeriut. Rekomandimi është mjeti ligjor kryesor i Avokatit të Popullit, me qëllim vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi i administratës publike. Por qytetari që e mbështet besimin e tij tek Institucioni i Avokatit të Popullit për zgjidhjen e problemit për të cilin ankohet, shpesh shqetësohet që Avokati i Popullit është thjesht rekomandues dhe jo detyrues ndaj organeve të administratës publike. Detyra e Zyrës së Pritjes së Popullit është që në këto raste të njohë qytetarin me vlerën dhe forcën rekomanduese që mbart rekomandimi i Avokatit të Popullit për zbatueshmëri nga ana e organeve të administratës publike.

Zyra e Pritjes së Popullit has shpesh vështirësi në punën e përditshme në raport me qytetarët, për shkak të mos njohjes nga ana e tyre të ligjit për Avokatin e Popullit.

Një vështirësi e përhershme e prezantuar pranë Zyrë e Pritjes së Popullit është kërkesa e qytetarëve që janë në proces gjyqësorë, që në mosdije të moskompetencës së Institucionit të Avokatit të Popullit për përfaqësim të asnjë pale në gjykatë, ngulmojnë pikërisht për përfaqësim në gjykatë nga ky Institucion me shpresën dhe besimin se vendimi i gjykatës do të jetë më i drejtë. Në rastet e këtyre kërkesave, qytetarët janë orientuar për tu kontaktuar me avokatë privatë dhe kur qytetari ankohet për mospasjen e mundësive financiare për të kontraktuar një avokat privat, kërkesat e tyre i janë deleguar për kompetencë Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike Falas, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit.

Të gjitha ankesat (2946) objekti i të cilave kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, janë kategorizuar si “këshillime dhe orientime verbale ose shkresore” që u janë dhënë qytetarëve nga ana e specialistëve të Zyrës së Pritjes së Popullit. Një pjesë e këtyre ankesave vijnë në Institucionin e Avokatit të Popullit nëpërmjet postës, adresës elektronike dhe rrjeteve sociale. Kur ato vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të ankesave “jashtë juridiksionit apo kompetencave”, qytetarët këshillohen mbi rrugën ligjore që duhet të ndjekin, si dhe orientohen drejt institucioneve publike për të kërkuar të drejtën e pretenduar prej tyre.

Në rastet e këshillimeve dhe orientimeve verbale në komunikimin e drejtë perdrejtë me qytetarin, specialistët e Zyrës së Pritjes së Popullit shpesh përballen me rezistencën nga ana e qytetarëve të cilët nuk duan të pranojnë se ankesa e tyre është jashtë objektit të punës së Avokatit të Popullit edhe pasi ju citohet specifikisht ligji për Avokatin e Popullit, dhe këmbëngulin me skepticizëm për të takuar titullarin e institucionit me shpresën e një mundësie tjetër për shqyrtimin e ankesës.

Jo rrallë herë ndodh që specialistët e Zyrës së Pritjes së Popullit të përballen me qytetarë të cilët për shkak të humbjes së besimit ndaj institucioneve shtetërore dhe publike, e tejkalojnë etikën e komunikimit qytetar në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit. Me durim dhe etikë institucionale bëhen përpjekje që qytetari të bëjë një arsyetim të situatës dhe të vlerësojë këshillën ligjore që i është ofruar.

Shpesh qytetarët i drejtohen Zyrove Rajonale të Avokatit të Popullit pa asnjë dokument shkresor dhe shpesh herë edhe informacionin verbal e kanë të paplotë dhe të paqartë. Me shumë durim ata orientohen drejt institucioneve përkatëse për plotësimin e dokumentacioneve të mungura por ka edhe raste kur përfaqësuesit e zyrove rajonale ndihmojnë në komunimkimin më institucionet përkatëse për të qartësuar situatën e tyre.

Një vështirësi tjetër e përfaqësuesve të zyrove rajonale të Avokatit të Popullit lidhet me transportin drejt zonave rurale për realizimin e planifikimeve paraprake për takimet e tyre në terren me banorët e këtyre zonave. Ky ka qenë një nga shqetësimet e shumë diskutuara mes nesh, si dhe pjesë e përpjekjeve këmbëngulëse të tyre për mundësimin e shtrirjes së shërbimeve të Avokatit të Popullit edhe në këto zona.

Edhe këtë vit pranë institucionit tonë janë paraqitur një numër i madh ankesash me objekt “zgjidhjen e kontratës individuale” të punës, ku punëdhënësi ka qenë një subjekt privat. Qytetarët kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për shqyrtimin e ligjshmërisë së zgjidhjes së kontratës individuale të punës. Edhe në këto raste, bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar për t’iu drejtuar gjykatës e cila ka kompetencën lëndore dhe juridiksionin për të shqyrtuar këto ankesa, brenda afateve ligjore.

Gjithashtu, të pranishme janë edhe ankesat me objekt “konflikte civile midis individëve”, të cilat janë nga llojet më të ndryshme por kryesisht konsistojnë në zaptimin e tokës nga të tjerët, ose në mos lejimin e ushtrimit të së drejtës së posedimit nga ana e pronarit. Në të tilla raste nga ana e qytetarëve kërkohet me këmbëngulje ndërhyrja e Institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhjen e konfliktit. Në përgjigjet e këtyre ankesave, në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, qytetarët janë këshilluar t’i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e të gjitha llojeve të konflikteve civile.

Ankesa të shumta janë edhe ato ndaj vendimeve të KMCAP Epror, ku qytetarët nuk janë dakort me vendimet e mara dhe shihet një rezistencë e tyre për të kuptuar karakterin e formës së prerë të vendimeve të KMCAP. Në këto raste ata janë orientuar nga specialistet e Zyrës së Pritjes së Popullit për t’iu drejtuar gjykatës për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të KMCAP Epror.

7.4. Sfidat në bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile

Avokati i Popullit i konsideron mediat dhe shoqërinë civile si aleatë shumë të rëndësishëm në punën e tij për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pavarësisht bashkëpunimit të frutshëm të vendosur ndërmjet tyre, edhe kjo marrëdhënie si çdo hallkë tjetër e jetës në vend, reflekton problemet që kalon shoqëria në përgjithësi dhe, mënyrë të vecantë, media dhe shoqëria civile si hapësira publike në arkitekturën e strukturave të shtetit nga njëra anë dhe qytetarit në anën tjetër. Kjo qasje e tyre ndaj misionit për të cilin ato janë krijuar, sigurisht që ndikon edhe në punën e AP duke ia vështirësuar komunikimin me qytetarët.

Në anën tjetër, shtimi i numrit të mediave tradicionale në vend bën të mundur që përpjekjet e AP në mbrojtje të qytetarit të gjejnë rrugën të publiku. Për të lehtësuar komunikimin e tij me publikun, Avokati i Popullit ka përdorur me shumë efikasitet mediat sociale, kryesisht facebook-un, pavarësisht se media sociale megjithë lehtësirat e mëdha që ofron, nuk është ende gjerësisht e përdorshme nga popullata, sepse mediumi më i ndjekur në Shqipëri vazhdon të jetë televizori.

Edhe hapësira për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri në media nuk është në nivelin e duhur. Kjo mbase edhe për arsye të pakësimit të burimeve të financimit, pasi mjaft donatorë të huaj ose kanë rrudhur buxhetet e tyre për Shqipërinë, ose janë tërhequr tërësisht. Në anën tjetër, fondet e qeverisë për mbështetjen e shoqërisë civile prej vitesh kanë mbetur në të njëjtat nivele. Pavarësisht sa më sipër edhe në 2016, AP bashkëpunoi dhe koordinoi punën e tij me organizatat e shoqërisë civile për problemet e grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar, minoriteteve përfshirë personat LGBTI, romëve, personave të moshuar, etj.

Një instrument shumë i rëndësishëm në tërheqjen e opinionit dhe ekspertizës së shoqërisë civile vazhdon të jetë Bordi Këshillimor i ngritur pranë Avokatit të Popullit, me anëtarësi të përzgjedhur nga vetë organizatat e shoqërisë civile, i cili i siguron Avokatit të Popullit këshilla dhe konsulencë për çështje të ndryshme që shqetësojnë qytetarët dhe opinionin publik.

Gjatë punës për përgatitjen e raporteve speciale, rekomandimeve, apo aksioneve publike të ndërmarra nga Avokati i Popullit, bashkëpunohet ngushtësisht me shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Një rol të rëndësishëm kanë patur disa organizata në seancat dëgjimore të zhvilluara me kandidatë për komisionerë për pozicionet vakante.

7.5 Konferenca ndërkombëtare e shtatorit

Për të diskutuar rreth problemit të flukseve të përziera të refugjatëve dhe migrantëve, të cilat në vitet e fundit kanë përjetuar një shtim të paprecedent për kohët moderne duke vënë në vështirësi një numër të madh vendesh europiane si dhe vetë Bashkimin Europian, Avokati i Popullit thirri në Tiranë për të diskutuar mbi rolin e ombudsmanëve dhe mediatorëve në këtë krizë, kolegë ombudsmanë dhe mediatorë nga vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit. Që në krye të herës, ky aktivitet u koordinua me zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-ë për të Drejtat e Njeriut, sepse në konceptin e tij, të drejtat e refugjatëve janë të drejtat e njeriut. Konferenca u mbajt datat 7-8 shtator në mënyrë që t'i paraprinte Samitit të Kombeve të Bashkuara për refugjatët dhe Migrantët të datës 19 shtator 2016 në Nju Jork. Të mbledhur në Tiranë, Ombudsmanët nga të katër anët e botës dhanë mesazhet e tyre, të cilat përmes Zëvendës Komisioneres së OKB-së për të Drejtat e Njeriut, znj. Kate Gilmore, e cila mori pjesë në Konferencë, iu përcollën Samitit të krerëve të shteteve anëtare të Asamblesë Parlamentare të OKB-së.

Në funksionin e tij edhe si President i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Mesdheut (AOM), zoti Totozani bëri bashkë në këtë Konferencë Shoqatën e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF), Federatën e Ombudsmanëve të Vendeve Ibero-Amerikane (FIO) dhe Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI) të cilët ndoqën për dy ditë me rradhë konferencën e nivelit të lartë **“Sfidat e Institucioneve të Ombudsmanit përballë flukseve të përziera migratore”** e cila u mbajt në Hotel “Tirana International” Tiranë, 7–8 Shtator 2016.

Znj. Kate Gilmore, Zv. Komisionere e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, solli në Konferencë mesazhet e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve, të cilat janë para së gjithash dhe mbi të gjitha të drejta të njeriut. Në konferencë mbizotëroi mendimi se të këto të drejta janë univiersale dhe të patjetërsueshme; ato nuk mund të pezullohen, të shtyhen apo të respektohen vetën në kohë të mira, sepse për nga vetë fryma dhe germa e instrumentave ndërkombëtare ku janë pasqyruar, ato janë bërë për të siguruar mbrojtje në kohë të vështira për individët dhe kombet prej nga vijnë.

Konferenca u mbajt në katër panele diskutimi, ku u trajtuan çështje si: Mbrojtja e emigrantëve të parregullt referuar shërbimeve publike dhe atyre private; Integrimi i diasporave të reja në vendet

pritëse: “Emigrantët jo si kërcënim, por si mundësi”; Asistenca ndaj grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të sëmurëve dhe të moshuarve. Në këto kohë krizash ekonomike dhe shtrëngesash financiare ku populizmi gjen terren të përshtatshëm, konferenca i kushtoi një sesion të posacëm gjuhës së urrejtjes dhe stereotipeve negative kundër migrantëve dhe refugjatëve. Ombudsmanët që morën fjalën vunë theksin tek nevoja për të kundërvepruar ndaj gjuhës së urrejtjes dhe ksenofobisë që gjejnë vend në ligjërimitin e përdorur nga qeveritë, por edhe në ligjërimitin e gjerë publik.

Për herë të parë, ombudsmanët dolën me një zë unik mbi një nga krizat më të dhimbshme njerëzore për shkak të së cilës përfundojnë në fund të detit jetë të pafajshme njerëzore, përfshirë edhe fëmijët. Presidentët e katër organizatave botërore të Ombudsmanëve, z. Marc Bertrand, President i AOMF-së (Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë), Prof. José Francisco De Faria Costa, President i FIO-s (Federata Ibero-Amerikane e Ombudsmanëve), z. John Ealters, President i IOI-së (Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve), si dhe z. Igli Totozani, Presidenti i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Mesdheut (AOM) u zotuan për një ndërveprim edhe më të madh në mbrojtje të të drejtave të personave në situata migratore, veçanërisht të atyre që detyrohen të lënë vendet e tyre për shkak të luftës.

Vlera e shtuar e këtij eventit qëndron në faktin se bëri bashkë përfaqësues të nivelit të lartë të organizatave ndërkombëtare, institucioneve të specializuara, institucioneve të ombudsmanit si dhe përfaqësues të qeverive, komunitetit diplomatik dhe shoqërisë civile në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut edhe kur njerëz të ndryshëm gjenden në situata migratore. Ndërsa, në përmbyllje të dy ditëve të punimeve të konferencës, konkluzionet u përfshinë në një deklaratë të përbashkët, e cila u bë e njohur me emrin **“Deklarata e Tiranës për Migracionin”**.

Duke mbajtur parasysh angazhimet ndërkombëtare të shteteve, Deklarata e Tiranës ve në dukje se shtetet kanë përgjegjësinë për promovimin, parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe refugjatëve, ashtu si dhe të sigurojnë kushtet e duhura për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në përmbushjen e mandatit të tyre në këtë fushë.

Ombudsmanët dhe Mediatorët morën angazhim të monitorojmë dhe ushtrojmë presion pozitiv dhe të vazhdueshëm ndaj shteteve respektive për përmbushjen e detyrimeve dhe standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e refugjatët; të intensifikojnë veprimet ex-officio dhe të forcojnë praninë në qendrat e pritjes dhe të ndalimit si dhe të përdorim të gjitha instrumentat e mundshëm në ushtrimin e mandatit të tyre. Ata gjithashtu u zotuan që të koordinohen ngushtësisht dhe të intensifikojnë ndërveprimet e tyre me të gjithë aktorët aktivë, veçanërisht me shoqërinë civile, me qëllim forcimin e garancive dhe burimeve që i adresohen nevojave të fëmijëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, LGBTI, si dhe të viktimave të torturës dhe viktimave të trafikimit.

Ne fund, ata u bëjnë thirrje qeverive të kenë një qasje thellësisht humane në vendimmarrjet politike ndaj krizës migratore, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të adresojnë të gjitha shkaqet e kësaj krize, përfshirë ato politike, ekonomike shoqërore dhe mjedisore.

7.6 Konferenca Kombëtare e Avokatit të Popullit

Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare organizon çdo vit një veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Kjo Konferencë është kthyer tashmë në një traditë që mirëpritet si nga shoqëria civile, ashtu edhe nga institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në zbatim të këtij detyrimi, në datën 14 dhjetor 2016, në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, u organizua Konferenca Kombëtare me temë “*Ndërthurja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Drejtave të Njeriut – Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në implementimin e tyre*”.

Sic mund të shihet nga titulli, Konferenca për vitin 2016 u përqëndrua në ndërthurjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm me të drejtat e njeriut, si dhe rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në arritjen e tyre. Diskutimet lidhur me eliminimin e varfërisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike, investimin tek njerëzit duke zgjeruar përfshirjen sociale dhe aspekte të të drejtave të njeriut që preken nga ndryshimet klimatike dhe mjedisore, u trajtuan përmes një diskutimi të moderuar mes ekspertëve të fushës, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar, si dhe atyre të shoqërisë civile

Përzgjedhja e kësaj temë u motivua në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga shteti shqiptar për zbatimin e Axhendës 2030, e miratuar më 25 shtator 2015 në një samit historik të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Kjo Axhendë përfaqëson një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe mirëqënien e fokusuar në forcimin e paqes universale në liri të plotë, eliminimin e varfërisë në të gjitha format dhe përmasat e saj, luftën kundër pabarazisë dhe padrejtësive, si dhe ndryshimeve klimatike. Zbatimi i kësaj Axhende nga Qeveria Shqipëtare dhe të gjithë aktorët, duke vepruar në partneritet të plotë, bazohet në përcaktimin e 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) që përfshijnë 169 tregues dhe 230 indikatorë.

Paneli i parë diskutoi mbi OZhQ-të 1 dhe 8 - *Ç’rrënjësja e varfërisë në të gjitha format e saj dhe promovimi i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës*.

U vu në dukje se një qasje e bazuar tek të drejtat e njeriut karshi politikëbërjes dhe alokimit të burimeve në nivel qendror dhe lokal përfaqëson një parakusht për arritjen e këtij synimi. Diskutimi u zhvillua mbi zbatimin e kësaj qasjeje në arritjen e objektivave me fokus rritjen që mbështet të varfërit, trajtimin e duhur të grupeve vulnerabël, vlerat e pjesëmarrjes dhe nevojën për progres në përpjekjet për barazi dhe mosdiskriminim. Politikat zhvillimore të cilat mbështesin veprimtaritë prodhuese dhe krijimin e vendeve të punës për burrat dhe gratë, të rinjtë dhe të marginalizuarit, si dhe bashkëpunimi i institucioneve të të drejtave të njeriut me institucionet qeveritare dhe të tjerë partnerë e aktorë, ishin gjithashtu pjesë e rëndësishme e diskutimeve në këtë panel.

Në panelin e dytë u diskutua lidhur me OZhQ-të 3, 4 dhe 5 - *Investimi tek njerëzit dhe tek rritja e kohezionit social, çfarë mundësish ofrojnë OZHQ-të për të drejtat e njeriut dhe anasjelltas*.

Aderimi i Shqipërisë në traktate dhe konventa ndërkombëtare të të drejtave të njeriut sjell detyrimin për të zbatuar normat dhe standartet ndërkombëtare përmes krijimit të sistemeve më gjithëpërfshirëse dhe mënyrave të punës të cilat ndihmojnë përfshirjen e grupeve vulnerabël, veçanërisht komunitetit Rom/Egjiptian dhe personave me aftësi të kufizuar, në fushat e përfshirjes sociale, edukimit dhe shëndetit. Diskutimi në këtë panel u fokusua në ndërlidhjen e Objektivave 3, 4 dhe 5 me aspekte të të drejtave të njeriut. Aksesin nga të gjitha grupet sociale, veçanërisht nga ato të marxhinalizuara, në gëzimin e të drejtave për shërbime cilësore të barabarta, ndërvlerësia e të të drejtave të njeriut me të drejtat e tij në fushat e përfshirjes sociale, edukimit dhe shëndetit si dhe përshkrimi i të gjitha politikave dhe strategjive zhvillimore nga parimet e barazisë gjinore dhe shanseve të barabarta për arritjen e një kohezioni më të madh social duhet të marrin vëmendjen maksimale nga politikëbërësit dhe ligjzbatuesit.

Në panelin e tretë u diskutua për OZhQ-të 7, 11, 12, 13, 14 dhe 15, me fokus kryesor të drejtat e njeriut dhe ndryshimet mjedisore e klimatike.

Mjedisi dhe ndryshimet klimatike përbëjnë dimensione thelbësore të secilit nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke nisur nga zhdukja e varfërisë tek mbështetja për shëndetin, garantimi i ekonomive dinamike dhe të drejtave në të gjithë rruzullin. U vu në dukje se analiza e synimeve dhe objektivave aktuale referuar mjedisit tregon se progresi më domethënës ka prirjen të arrihet në rastet kur ato integrohen në mënyrë thelbësore në një regjim efektiv qeverisjeje. Diskutimi në këtë panel u fokusua në punën e përbashkët të qeverisë shqiptare, parlamentit, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar, për mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe promovimin e “rritjes së gjelbërt”, duke garantuar edhe dëgjimin e zërit të atyre të cilët preken drejtpërsëdrejti.

Bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “*Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm*”, miratuar në Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC-Aktualisht GANNHRI), e mbajtur në Merida, Jukatán Meksikë, më 8-10 tetor 2015, si një nga aktorët e angazhuar në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhe duhet të luajë një rol specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Axhendës 2030.

Në këtë kuadër, sfidat për punën e institucionit të Avokati i Popullit, të evidentuara gjatë konferencës ishin si vijon:

- Monitorimin e vazhdueshëm të të drejtave të njeriut me fokus identifikimin e problematikave për grupet në nevojë, duke siguruar në çdo rast respektimin e të drejtave të njeriut nga çdo institucion, bazuar në 17 Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- Integrimin në mënyrë të qartë të 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në plane veprimi, raporte dhe dokumente të tjera, bazuar në referenca të qarta ndaj këtyre objektivave, të prodhuara nga zyra e Avokatit të Popullit. Publikimi i këtyre raporteve do të shërbejë për të nxitur shtetin në zbatimin e Axhendës 2030;
- Bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e Axhendës 2030;
- Hartimin e një metodologjie të qartë monitorimi mbi zbatimin e 17 Objektivave, e cila do të shërbejë si bazë për të monitoruar cilësinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të politikave nga ana e qeverisë. Ndihma e partnerëve ndërkombëtarë në ngritjen e kapaciteteve dhe metodologjisë për monitorimin e zbatimit të objektivave është kyçe.
- Bashkëpunimin me institucione të tjera që prodhojnë dhe grumbullojnë të dhëna statistikore përfshirë INSTAT, Akademinë e Shkencave dhe Organizata të shoqërisë civile.

Ndërkohë, Konferenca konkludoi në disa Rekomandime për zbatimin e Axhendës 2030:

- Inkurajimin e Qeverisë shqiptare në përgatitjen e një Plani Veprimi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në vend, ku të përshkruhet se si Shqipëria synon të arrijë 17 Objektivat në kuadër të realizimit konkret të Axhendës 2030.
- Plani i Veprimit duhet të identifikojë ndër të tjera:
- Krijimin e një Këshilli Kombëtar koordinimi të nivelit të lartë, i cili të monitorojë përpjekjet e Qeverisë dhe aktorevë të tjerë në përmbushjen e detyrimeve që parashtron Axhenda 2030. Ky këshill duhet të jetë gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen shoqërisë civile, parlamentit, autoriteteve lokale, komunitetit të donatorëve, sektorit privat, etj;
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen e pushtetit vendor si Bashkitë, Këshillat Bashkiakë, si dhe Shoqërinë Civile, në zbatimin e Objektivave dhe lidhjen me të drejtat e njeriut.

- Zbatimin sa më efikas të Axfordës 2030 në nivel qëndror dhe vendor, që kërkon bashkëpunim më të qëndrueshëm ndërsektorial, si dhe miratimin e perspektivave multidimensionale për zhvillim, të cilat përfshijnë zhvillimin njerëzor, mjedis të qëndrueshëm, si dhe investime për ngritjen e sistemeve, kapaciteteve zbatuese e monitoruese dhe të dhënave cilësore për monitorimin e progresit në arritjen e 17 Objektivave/zhvillim për të gjithë.
- Inkurajim i një roli efektiv të Parlamentit në procesin e zbatimit të Axfordës 2030, si një institucion kyç që garanton miratimin dhe monitorimin e kuadrit ligjor të nevojshëm.

Konferenca mbylli punimet me miratimin e një Deklarate të Përbashkët mes Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, aneks i këtij Raporti.

KREU 8

Avokati i Popullit dhe veprimtaria ndërkombëtare

Dimensioni ndërkombëtar i veprimtarisë së Avokatit të Popullit, në ndërveprim me faktorët brenda dhe jashtë vendit, përbën një aspekt thelbësor të angazhimeve institucionale në përmbushje të misionit kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Viti 2016 ka shënuar një veprimtari të ngjeshur diplomatike të institucionit si në rrafshin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh në kuadër të organizatave dhe mekanizmave rajonale dhe ndërkombëtare. Në mënyrë të detajuar disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë ndërkombëtare të Institucionit të Avokatit të Popullit si vijon:

8.1. Institucioni i Avokatit të Popullit në mbajtjen e Presidencës së AOM

Në 2016 z. Totozani u zgjodh President i Organizatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) edhe për një mandat të dytë. Kjo rizgjedhje erdhi si vlerësim i punës së z. Igli Totozani në mandatin e tij të parë. Në mbledhjen e AOM që u mbajt në Maltë, 9-10 Mars 2016 u konstatua se Presidenca e zotit Totozani kishte realizuar objektivat e ndërmarra në vitin 2014 dhe specifikisht atë të zgjerimit të bazës së anëtarësisë (në këtë mbledhje u bë edhe pranimi i Kosovës si anëtare e AOM), krijimi brenda organizatës i grupeve të punës të përhershme për tematika të caktuara sipas nevojave të anëtarëve; realizimi i ndryshimeve të kërkuara në statut, hartimi i një neësletter për anëtarësinë, caktimi i pikave fokale pranë çdo organizate, etj.

Në datat 21-23 shkurt 2016, me iniciativën e Avokatit të Popullit në cilësinë e Presidentit të AOM-it, një delegacion i nivelit të lartë (Presidenti i AOM z. Igli Totozani, zv. Presidentja e AOM njëkohësisht dhe Ombudsmani e Spanjës zj. Soledal Becerill, si edhe një përfaqësues nga Sekretariati i AOM atashuar pranë Ombudsmanit të Francës), zhvilloi një vizitë në terren në pikën e kalimit të migrantëve në Tabanovce (kufiri verior i Maqedonisë me Serbinë), në të cilën nga shtatori i vitit 2015 deri në momentin e vizitës kishin kaluar mbi 700.000 migrantë. Vizitës iu bashkua edhe Ombudsmani i Maqedonisë, i cili si anëtar i Këshillit Administrativ të AOM kishte bërë thirrje të vazhdueshme për mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve.

Më 28 tetor 2016, si President i AOM i shoqëruar edhe nga Ombudsmani i Maqedonisë, z. Igli Totozani pati një takim me homologun francez Jacques Toubon në kuadër të veprimeve për konkretizimin e Deklaratës së Tiranës. Takimi synoi diskutimin pa vonesë të hapave konkrete për vënien në zbatim të Deklaratës së Tiranës për Refugjatët (shih seksionin për Konferencën Ndërkombëtare në Tiranë), si gur i rëndësishëm themeli në veprimet e përbashkëta në favor të migrantëve. Në takim ishte ftuar edhe Ombudsmani i Maqedonisë z. Ixhet Mehmeti, anëtar i bordit të AOM, për të diskutuar mbi pista të ndryshme veprimi në rajonin e Ballkanit, i cili prej disa vitesh është kthyer në rrugë tranziti për migrantët në kërkim të mbrojtjes ndërkombëtare me vështirësi më të mëdha përballë rritjes së flukseve migratore.

8.2. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Institucioni i Avokatit të Popullit luan një rol aktiv dhe proaktiv me zyrat homologe dhe me organizatat ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përveçse është një ndër anëtarët themelues të Rrjetit Rajonal të Mekanizmave Kombëtarë të Parandalimit të Torturës, e cila është krijuar në Beograd në fillim të vitit 2013, Institucioni ynë ka vendosur dhe mban lidhje të drejtpërdrejta dypalëshe me Ombudsmanët në rajon, përfshirë këtu Ombudsmanin e Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Greqisë, Maqedonisë, Kroacisë, etj. Kontakte të drejtpërdrejta mbajnë edhe anëtarët e tjerë të stafit dhe në mënyrë të veçantë, punonjësit e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës të cilët ndërveprojnë aktivisht me homologët e Mekanizmave të vendeve të tjera.

Nga ana tjetër lidhje të drejtpërdrejta mbahen me Ombudsmanët në nivel europian, përfshirë këtu Ombudsmanin e BE-së, Danimarkës, Spanjës, dhe Francës.

Gjatë vitit 2016 është fuqizuar akoma dhe më tej bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me organizata të ndryshme ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, përfshirë këtu Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), OSBE, UNDP, UNICEF, Këshillin e Europës, etj.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar Zyra e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Avokati i Popullit janë zotuar të punojnë së bashku për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në dhjetor të vitit 2016, Avokati i Popullit dhe Zyra e Koordinatorit Rezident Kombeve të Bashkuara në Shqipëri organizuan Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit me temën: “Ndërthurja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Drejtave të Njeriut – Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në implementimin e tyre”. Theksi i diskutimeve në konferencë u vendos te nevoja për të luftuar varfërinë përmes një rritjeje të qëndrueshme të ekonomisë përmes ruajtjes së mjedisit dhe sigurimit të mbrojtjes së nevojshme për grupet në nevojë e ato të marginalizuara veçanërisht gratë, LGBT, anëtarët e komunitetit Rom dhe personat me aftësi të kufizuara.

Viti 2016 shënoi dhe një rritje të pranisë së Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të institucionit në arenën ndërkombëtare. (Per aktivitetet e detajuara lutem referojuni kreut 8.3) Përfaqësimi i institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitetet ndërkombëtare. Në këto aktivitete Avokati i Popullit apo përfaqësuesit e institucionit, përtërinë lidhjet jo vetëm me rrjetet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, por edhe me homologët në rrafshin dypalësh.

Duke pasur parasysh rëndësinë që Avokati i Popullit i kushton njohjes me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, stafi i institucionit i ka bërë këto dokumente si pjesë të pandashme të punës së përditshme. Për këtë qëllim, stafi i institucionit të Avokatit të Popullit jo vetëm analizon konventat dhe raportet ndërkombëtare, por dhe ndjek zbatimin e tyre nga ana e institucioneve të administratës publike në Shqipëri, duke i nxitur ato për zbatimin e rekomandimeve përkatëse për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut në përputhje me parimet dhe rekomandimet e shprehura në to. Në këtë linjë, në vazhdim të raportit hije të paraqitur pranë Komitetit për Zbatimin e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAË), në korrik 2016 z. Totozani ndoqi seancën për Shqipërinë ku u analizua puna e bërë nga Shqipëria për zbatimin e kësaj konvente. Vlen të përmendet fakti që një pjesë e madhe e rekomandimeve të Avokatit të Popullit gjetën vend në Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit për Shqipërinë.

Gjithashtu, stafi i Avokatit të Popullit bashkëpunon ngushtë me strukturat dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut në nivel evropian. Këtu mund të përmendim bashkëpunimin intensiv me Komitetin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). Avokati i Popullit ka vazhduar shkëmbimin e informacioneve me këtë strukturë dhe ka adoptuar rekomanimet e tij për mbrojtjen e të drejtave të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, të cilët kanë qenë në fokusin e Komitetit gjatë vitit 2016 për shkak të krizës së refugjatë që përfshiu Evropën.

Me Zyrën e UNICEF-it në Shqipëri Avokati ka vazhduar ndërveprimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me fokus të veçantë në nevojën e eliminimit të shfrytëzimit të punës së të miturve dhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të rrugës e atyre që gjenden në situata migratore. Bashkëpunimi në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vitin 2016 vijoi edhe me Save the Children.

Një komunikim të shpeshtë, Avokati i Popullit mban me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Falë këtij komunikimi, u bë e mundur mbajtja në Tiranë në datat 7-8 shtator e një Konferencë Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë për rolin e Ombudsmanëve në Mbrojtje të të Drejtave të Personave në situata Migratore. Kjo Konferencë bëri bashkë Ombudsmanët nga të gjitha anët e botës të përfaqësuar në IOI, AOMF, AOM dhe në Forumin e Ombudsmanëve Ibero-Amerikanë.

Avokati i Popullit gjithashtu është aktiv në ENNHRI (European Network of National Human Rights Institutions), duke dhënë kontribut konkret në këtë rrjet, pasi vitin e fundit ENNHRI ka ngritur Grupe Pune për çështje të veçanta (si psh Grupi i punës kundër Diskriminimit, Emigrimit, etj.), në të cilat anëtarët e stafit të Avokatit të Popullit janë mjaft aktivë, por në të njëjtën kohë shkëmbejnë edhe eksperiencën me kolegë të tyre të institucioneve homologe evropiane.

Në dhjetor 2016 u mbajt Konferenca Vjetore e Rrjetit të CRONSEE në Maqedoni ku institucioni ynë u përfaqësua nga ekspertët që mbulojnë problemet e fëmijëve. Duhet theksuar se në vitin 2016 Avokati i Popullit u zgjidh anëtar i ENOC (European Network of Children's Ombudsman). Pritet që marrëdhëniet me këtë organizatë të forcohen, veçanërisht pas plotësimit nga Parlamenti të pozicionit vakant Komisioneri i Seksionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në institucionit e Avokatit e Popullit.

8.3. Përfaqësimi i institucionit të Avokatit të Popullit në aktivete ndërkombëtare

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh të Institucionit, të renditura si vijon:

Në datat 21-23 mars 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC) sot GANHRI, që u mbajt në Gjenevë, Zvicër, me pjesëmarrjen e mbi 100 Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut nga e gjithë bota.

Kjo konferencë e organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) konkludoi me miratimin e një Deklarate të Përbashkët në të cilën Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut shprehën besimin se *“të drejtat e njeriut dhe parimet e tyre themelore si pjesëmarrja, llogaridhënia dhe mosdiskriminimi, transparenca dhe shteti ligjor, të jenë parësore në gjetjen e zgjidhjeve dhe ekuilibrin e duhur në situata krize”*. Konferenca konkludoi gjithashtu me ndryshimin e emrit nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i NHRI-ve (ICC/NHRI) në Aleanca Globale e Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (GANHRI).

Në datat 25-27 prill 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në simpoziumin ndërkombëtar me temë *“Sfidat aktuale dhe kërcënimet me të cilat përballen të drejtat e njeriut, dhe detyrat e Institucioneve*

të Ombudsmanit në këtë drejtim”, organizuar nga Ombudsmani i Katalonjës, në cilësinë e presidentit e Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI) për rajonin e Europës, që u zhvillua në Barcelonë, Spanjë.

Avokati i Popullit drejtoi panelin e dytë të simpoziumit kushtuar të drejtave të migrantëve dhe refugjatëve, në kontekstin e shtimit të ndjeshëm të çështjeve që lidhen me sigurinë në Europë dhe me gjerë, duke vënë në rrezik të drejtat themelore të njeriut. Politikat publike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të adresojnë këto fenomene në respekt të plotë të të drejtave të njeriut dhe zyrat e Ombudsmanëve duhet të jenë veçanërisht të kujdesshme ndaj legjislacionit dhe praktikave administrative që shkelin të drejtat e njeriut, ishin konkluzionet kryesore të simpoziumit.

Në datat 26-27 maj 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua në takimin vjetor të **Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës pranë Këshillit të Europës (ECRI)**, që u mbajt në Strasburg, Francë, me temë *“Roli i organeve të specializuara kombëtare në këshillimin e autoriteteve legjislative dhe ekzekutive dhe aktoreve të tjerë”*, me fokus kryesor fokus diskutimin mbi funksionet e organeve të specializuara kombëtare në drejtim të këshillimit të autoriteteve legjislative dhe ekzekutive për sa u përket politikave dhe ndryshimeve ligjore të nevojshme. Avokati i Popullit dha kontribut në panelin II me temë *“Organet e specializuara kombëtare në arritjen e ndryshimeve legjislative dhe politike”*.

Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (OIF) organizoi takimin e **5-të të Rrjeteve Institucionale të Frankofonisë** në Paris, Francë më 31 maj - 1 qershor 2016, ku Avokati i Popullit z. Igli Totozani referoi në panelin me temë *“Mbrojtja e të drejtave të migrantëve: sfidat dhe roli i institucioneve”*.

Në datat 13-14 qershor 2016, me ftesë të Ombudsmani Europian, Avokati i Popullit mori pjesë në **Takimin e Rrjetit Europian të Ombudsmanëve**, në Bruksel. Diskutimet e takimit u përqëndruan në tre çështje kryesore: kriza aktuale e refugjatëve, respektimi i shtetit ligjor në vendet anëtare të Bashkimit Europian (BE) dhe transparenca në lobingje.

Përveç diskutimeve dhe shkëmbimit të informacionit mes kolegëve/përfaqësuesve të Rrjetit Europian të Ombudsmanëve, në takim ishin të pranishëm edhe panelistë të nivelit të lartë të BE-së dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të fushës.

Në fund të muajit qershor, me ftesë të **Ombudsmanit francez**, Avokati i Popullit z. Igli Totozani mori pjesë si panelist në takimin me temë *“Fëmije, Europë, Urgjencë - Mbrojtje dhe e ardhmja e fëmijëve migrantë, një sfidë për Europën”*, që shërbeu për të bërë një bilanc të situatës së fëmijëve migrantë në Europë, ndarje e praktikave të mira për pritjen, mbrojtjen dhe trajtimin e çështjeve të tyre, si dhe për tu bërë thirrje autoriteteve kombëtare dhe europiane të ndërmarrin veprime konkrete për sigurinë dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Në datat 10-13 korrik 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në punimet e komitetit të 64-të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAË) në Gjenevë, duke prezantuar raportin e Institutit mbi gjendjen e zbatimit të kësaj Konvente në Shqipëri.

Në fund të muajit shtator 2016, Avokati i Popullit mori pjesë në mbledhjen e radhës të **Bordit Drejtues të Institutit Botëror të Ombudsmanit (IOI)** për rajonin e Europës, që u mbajt në Napoli, Itali, ndërsa në datat 19-21 tetor 2016 mori pjesë në mbledhjen e radhës të **Këshillit Administrativ të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë** që u zhvillua në Monako, me mbështetjen e Komisararit të Lartë të Monakos.

Në datat 3-4 nëntor me ftesë të Ombudsmanit të Maqedonisë, Avokati i Popullit z. Igli Totozani dhe drejtuesi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, morën pjesë në konferencën rajonale

me temë “Aksesi në të drejtën për azil dhe kthimi formal/informal i refugjatëve/migrantëve”, që u zhvillua në Ohër, Maqedoni.

8.4 Lista e anëtarësimeve

Institucioni i Avokatit të Popullit aktualisht është anëtar me të drejta të plota në 9 organizata/ rrjete rajonale dhe ndërkombëtare, si më poshtë:

- Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI), krijuar në 1978, anëtar që nga viti 2000.
- Instituti Europian i Ombudsmanit (EOI), krijuar në 1988, anëtar që nga viti 2000.
- Shoqata e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësueve Frankofonë (AOMF), krijuar në 1998, anëtar që nga viti 2000.
- Shoqata e Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USOA), krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2006.
- Shoqata e Ombudsmanit Ndërkombëtar (IOA), krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2007.
- Shoqata e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), krijuar në 2008, anëtar që nga viti 2009.
- Komiteti Koordinues Ndërkombëtar për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC), krijuar më 1993. Institucioni i Avokatit të Popullit është akredituar në ICC për herë të parë në vitin 2004 dhe është riakredituar në vitin 2008 dhe 2014 me Statusin A.
- Rrjeti Europian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), krijuar në 2012, anëtar që nga viti 2014.
- Rrjeti Europian i Ombudsmanëve për Fëmijët (ENOC), krijuar në 1997, anëtar që nga viti 2015.

8.5 Ngritja e kapaciteve të stafit dhe vizita studimore

Ngritja e kapaciteteve të stafit është një nga prioritetet e vazhdueshëm të institucionit të AP. Gjatë gjithë mandatit të tij pesëvjeçar, AP është kujdesur në mënyrë të pandërprerë për trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të anëtarëve të stafit të tij. Për këtë qëllim, ai ka përdorur të gjitha mundësitë në dispozicion, si ato të brendshme edhe ato që ofrohen nga donatorët dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në rrafshin e brendshëm AP ka përdorur ndërveprimin dhe partneritetin midis kolegëve në vendin e punës për këtë qëllim. Kështu kolegët më me përvojë kanë kualifikuar dhe trajnuar në punë e sipër kolegët më të rinj. Kjo metodë është ndjekur edhe në rastin e kualifikimit të punonjësve të zyrave rajonale.

Një ndihmesë shumë e madhe për kualifikimin e stafit kanë qenë burimet e huaja. Kështu gjatë vitit 2016 me fondet e projektit danez u mundësuan internshipe njëmujore për katër punonjës, të cilët punuan në institucionet homologe në Greqi, Francë, Maltë e Belgjikë, duke përfituar nga përvojat e homologëve të tyre në këto institucione. Vlen të theksohet se gjatë këtyre vizitave punonjësit tanë kanë punuar krahas punonjësve të zyrave përkatëse, duke bërë të mundur maksimizimin e përfitimeve nga burimet e donatorëve. Si gjithmonë, me kthimin në atdhe, punonjësit kanë ndarë me kolegët e tyre njohuritë e fituara.

Po bazuar në fondet e projektit danez u mundësuan edhe dy vizita studimore të ekspertëve të institucionit në Danimarkë dhe në Itali. E para, mundësoi vizitën e një grupi prej 5 personash nga Seksioni i Veçantë pranë Ombudsmanit të Danimarkës për të mësuar nga praktika e punës së këtij të fundit me institucionet e policisë, burgjeve dhe ato të zbatimit të ligjit në përgjithësi.

Vizita tjetër u realizua në muajin dhjetor 2016 pranë Mbrojtësit të të Drejtave në Itali, i cili është në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës, ku u mor përvoja e kolegëve italianë, si dhe u realizuan vizita në institucionet italiane të vuajtjes së dënimit.

Edhe në 2016, institucioni shfrytëzoi pozitivisht programin TAIEX për trajnimin e stafit. Me financimin e këtij programi tre punonjës kryen një vizitë pranë Ombudsmanit në Çeki për të mësuar nga përvoja e atjeshme në monitorimin e institucioneve të përkujdesjes sociale, trajtimin e ankesave të qytetarëve dhe komunikimin me publikun.

8.5 Mbështetja e Mbretërisë së Danimarkës për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit

Mbretëria e Danimarkës nëpërmjet një granti të akorduar që prej vitit 2012 është duke ndihmuar financiarisht institucionin e Avokatit të Popullit në drejtim të përmbushjes së rolit të tij kushtetues në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve.

Projekti “Mbështetja Daneze për Avokatin e Popullit të Shqipërisë – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2016)”, ishte planifikuar të përfundonte në fund të vitit 2015, por me miratimin e donatorit në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Projektit Danez (si organi më i lartë vendimmarrës i projektit) të datës 25.02.2016 me vendimin Nr. 1 u vendos që projekti në fjalë të shtyhej pa kosto shtesë edhe për një periudhë tjetër një vjeçare, deri në fund të vitit 2016. Ndërsa për mbylljen administrative të projektit u akordua një periudhë kohore prej tre muajsh. Ndërkohë në po të njëjtën mbledhje me vendimin Nr. 2 është vendosur që Plani Strategjik i institucionit të Avokatit të Popullit 2013-2015 të shtyhet deri në fund të vitit 2016. Në bazë të vendimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës si dhe atij të marrë në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Projektit Danez, institucioni i Avokatit të Popullit hartoi një plan aktivitetesh për vitin 2016, plan të cilin e realizoi me sukses përgjatë gjithë vitit duke zbatuar në çdo rast legjislacionin në fuqi lidhur me menaxhimin e grantit. Zgjatja e Projektit Danez edhe për një periudhë tjetër një vjeçare, kjo edhe falë mirëmenaxhimit të fondeve i dha mundësi institucionit që të ketë burimet e nevojshme financiare për të realizuar misionin e vet promovues dhe ndërgjegjësuës në të tre fushat kryesore ku vepron projekti si pushteti vendor, burgjet dhe qendrat e paraburgimit dhe lidhja me shoqërinë civile dhe median. Duke qënë se Qeveria e Mbretërisë së Danimarkës nuk do të mund të asistojë financiarisht institucionin e Avokatit të Popullit me një projekt tjetër, krahas realizimit të aktiviteteve të mbetura sipas planit të miratuar të aktiviteteve do të shihet mundësia e hartimit me fondet që kanë ngelur nga projekti ekzistues i një strategjie të re disavjeçare, në mënyrë që institucioni të ketë një plan veprimi apo qoftë edhe për marrjen e mundshme të donacioneve të tjera në të ardhmen.

Pushteti vendor është një nga komponentët kryesore të këtij projekti. Me ndihmën e projektit është bërë e mundur hapja dhe funksionimi i shtatë zyrave rajonale të Avokatit të Popullit duke mbuluar gjithë territorin e vendit. Bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe median ka qënë një aspekt tjetër i punës së projektit. Rritja e cilësisë së inspektimeve multidisiplinare në burgje dhe qendrat e paraburgimit falë mbulimit financiar të planeve të inspektimit të MKPT-së nga fondet e projektit i ka dhënë një shtysë më të madhe punës voluminoze të kësaj zyre.

Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Danimarkës ka miratuar zyrtarisht gjatë vitit 2016 kalimin e aseteve të financuara deri më tani nga Projekti Danez në pronësi të institucionit të Avokatit të Popullit për ti përdorur ato sipas nevojave për rritjen e kapaciteteve të zyrës qëndrore dhe zyrave rajonale.

Në zbatim të nenit 37, të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatit e Popullit”, i ndryshuar, në datë 01.04.2016 i është dërguar zyrtarisht Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat) një informacion i detajuar lidhur me ecurinë e zbatimit të Projektit Danez për vitin 2015.

Donatori është shprehur mjaft i kënaqur me mënyrën se si është zbatuar Projektit Danez dhe si janë shpenzuar fondet e vëna në dispozicion nëpërmjet financimit direkt.

Përgjatë vitit 2016 dy vlerësime të jashtme janë bërë për këtë qëllim. Vlerësimi i parë i iniciuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës u realizua nga një ekip vlerësuesish dhe synonte vlerësimin e projekteve të financuara nga DANIDA sipas Programeve të Fqinjësisë 2007-2013 kjo me qëllim për të parë arritjen e objektivave të planifikuara dhe që kanë të bëjnë me impaktin, efektivitetin, eficiencën, qëndrueshmërinë e rezultateve dhe vlerën e shtuar të programeve në rajonin e Ballkanit. Intervistat e vlerësimit me përfituesit në Shqipëri dhe Kosovë u realizuan në periudhën 19-27 Maj 2016. Ekipi i vlerësimit përbëhej nga këta anëtarë: Z. Eric Buhl-Nielsen (Danimarkë), Z. Armen Melkumyan (Armeni), Znj. Silvana Rusi (Shqipëri). Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës vlerësimi lidhur me zbatimin e Projektit Danez ka qënë tejet pozitiv.

Mënyra e zbatimit të Projektit Danez në veçanti dhe mbështetja që ai i ka dhënë rritjes së kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit në tërësi ka qënë objekt i një tjetër vlerësimi të jashtëm. Në periudhën Janar-Shkurt 2016 Z. Francesco Castellani Këshilltar i Lartë pranë Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut në një mision dy javor bëri vlerësimin e zbatimit të Projektit Danez. Raporti i vlerësimit bazohet si në dokumentacionin e disponueshëm të projektit ashtu edhe në gjetjet nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta që ai realizoi me të gjithë ata persona të cilët në një mënyrë ose një tjetër janë bërë pjesë e këtij projekti. Personat me të cilët eksperti realizoi intervista vlerësimi ishin përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe organizatat e huaja, përfaqësues nga ekzekutivi shqiptar dhe institucione të ndryshme shtetërore, deputetë të forcave të ndryshme politike, përfaqësues nga shoqëria civile, etj. Në përfundim të misionit të tij, eksperti hartoi një raport voluminoz vlerësimi ku një vend të rëndësishëm i kushtohet pjesës së rekomandimeve si për institucionin e Avokatit të Popullit ashtu edhe për institucione të tjera relevante që janë në fokusin e punës së këtij institucioni. Ashtu siç ka pohuar edhe një nga të intervistuarit gjatë misionit vlerësues të mbështetjes financiare daneze “Fondet e mbështetjes daneze për institucionin e Avokatit të Popullit janë fondet e taksapaguesve evropianë ndoshta të shpenzuara më mirë në Shqipëri”.

8.6 Ngritja e kapaciteteve të stafit dhe vizita studimore

KREU 9

Institucioni i Avokatit të Popullit në shifra për vitin 2016

9.1 Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Është gjerësisht e pranuar që menaxhimi i burimeve njerëzore luan një rol thelbësor në zhvillimin e një vendi dhe në veçanti, në zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme strategjike të administratës publike. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit të procesit të menaxhimit. Selektimi, trajnimi dhe vlerësimi i njësive dhe strukturave të institucionit është një mjet i rëndësishëm dhe strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese të institucionit dhe i shton vlerën asaj.

Raporti i Komisionit Evropian, për vitin 2016, në lidhje me punën e institucionit të Avokatit të Popullit, do të theksonte ndërmjet të tjerash se:

“... puna e Avokatit të Popullit mbetet e kufizuar nga mungesa e fondeve dhe personelit dhe zyrat e tij qendrore dhe vendore duhet të përmirësohen në mënyrë që stafi të mund të kryejë punën e tyre në mënyrë të kënaqshme. Në vitin 2016, është rritur alokimi i buxhetit për Avokatin e Popullit, duke mundësuar rekrutimin e Komisionerëve për të Drejtat e Fëmijëve dhe Parandalimin e Torturës, por mbeten për t’u emëruar zyrtarët...”

Më konkretisht, puna e institucionit të Avokatit të Popullit sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare ka konsistuar në:

Me miratimin e ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2016”, numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionin e Avokatit të Popullit shkoj nga 51 në 55, ku përfshihej shtimi i numrit të dy komisionerëve (1(një) Komisioner për Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe 1(një) Komisioner në Mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, si dhe miratimin e dy pozicioneve të reja si pjesë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve, dhe me konkretisht: 1(një) Punëtor Mirëmbajtje dhe 1(një) Sanitar.

Mbi bazën e këtyre ndryshimeve u miratua dhe Urdhri nr. 6, date 05.01.2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”.

Pavarësisht dështimeve të herëpashershme të procesit të përzgjedhjes, institucioni i Avokatit të Popullit, në respekt të nenit 31/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, me një ftesë të hapur publike, rinisi përsëri procesin e përzgjedhjes së kandidatave, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe shpërndarjes të njoftimit pranë rrjetit të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe institucioneve akademike (Fakulteteve të Drejtësisë).

Brenda afateve të përcaktuara, u paraqiten 12 (dymbëdhjetë) kandidatura të cilat u vlerësuan nga institucioni (faza e vlerësimit paraprak) nëse i plotësonin kriteret ligjore të përcaktuara. Kandidatët që nuk i plotësonin kriteret ligjore, u s’kualifikuan nga procesi i përzgjedhjes dhe u njoftuan zyrtarisht për arsyet e s’kualifikimit. Kandidatët që plotësonin kriteret ligjore, kaluan në fazën e dytë të procesit (10 kandidatë).

Të gjithë kandidatët që kaluan fazën e seleksionimit paraprak, u ftuan më datë **19.05.2016**, që t’i nënshtrohen seancës dëgjimore me Komisionin Ad-hoc, në përbërje të së cilës ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Seanca dëgjimore, që u zhvillua në ambientet e institucionit, ishte e hapur dhe publike dhe ku u ftuan të merrnin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare si dhe të mediave elektronike.

Në këtë seancë dëgjimore ishte i pranishëm edhe një përfaqësues nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve, në Kuvendin e Shqipërisë. Duhet të theksohet që 3 (tre) kandidatë të kualifikuar për në fazën e dytë të procesit, nuk u paraqitën në seancën dëgjimore.

Kandidatët pjesëmarrës u vlerësuan në bazë të një sistemi pikëzimi, duke u mbështetur në:

- a. **vlerësimin e jetëshkrimit** të kandidatëve, që konsistonte në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b. **vlerësimin e platformës** (prezantimi i kandidaturës, problematikat e fushës ku aplikohet, çështjet që duhet të trajtohen me përparësi, mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të seksionit/mekanizmit;
- c. **intervistën e strukturuar me gojë** (vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive, aftësive dhe formimit të kandidatëve).

Në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni, vetëm kandidatët që do të vlerësoheshin me mbi 70 pikë, do të listoheshin si kandidatë të përzgjedhur nga Komisioni Ad-Hoc, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë.

Në përfundim të këtij procesi, rezultoi që për *Komisioner në Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve*, vetëm 1(një) kandidaturë arriti të vlerësohej me mbi 70 (shtatëdhjetë) pikë, ndërkohë që nga kandidaturat e paraqitura për Komisioner në *Mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës*, vetëm 2 (dy) prej tyre arritën të vlerësoheshin mbi minimumin e përcaktuar.


Në nenin 33/1, pika 6, të ligjit të nr.8454, datë 04.02.1999, theksohet se: “Lista me katër kandidatët e përzgjedhur nga Avokati i Popullit për çdo vend vakant, së bashku me vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe renditjen e kandidaturave, sipas preferencës së tij i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore.....”.

Në një situatë të tillë, të ndodhur përpara pamundësisë të realizimit të plotë të procesit të përzgjedhjes, për shkaqe dhe arsye të pavarura nga institucioni, institucioni ishte i detyruar të rishpallte përsëri (siç dhe ka ndodhur) ftesën e hapur publike për të plotësuar numrin e nevojshëm të kandidatëve të përzgjedhur, sipas kriterëve të përcaktuara ligjore.

Duke respektuar detyrimin ligjor ka nisur disa herë procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për Komisioner për dy vende vakante, por për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të kandidaturave pjesëmarrëse, apo mosplotësimit të kriterëve ligjore, procesi i përzgjedhjes së kandidatëve nuk ka mundur të realizohej. Për këtë është njoftuar në mënyrë të përsëritur edhe Kuvendi i Shqipërisë.

Duhet të theksojmë, gjithashtu, se gjatë vitit 2016, nga institucioni janë shpallur dhe plotësuar pozicionet e lira që bien brenda ligjit për Shërbimin Civil, por ka qenë një proces i vazhdueshëm, duke pasur parasysh dorëheqjet dhe largimet e ndodhura largimet në detyra të tjera brenda administratës publike, situata të cilat sigurisht nuk mund të parashikohen nga institucioni.

Struktura e Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2016, e paraqitur sipas organigramës së mëposhtme



Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se “Avokati i Popullit miraton rregulloren e brendshme të institucionit, e cila hartohet në bashkëpunim me komisionerët”, me Urdhrin nr.182, datë 15.07.2016 është miratuar **rregullorja e re e brendshme**, e cila përbën një akt-normativ të Avokatit të Popullit, i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjitha strukturat e institucionit.

Kjo rregullore i shërben institucionit në realizimin e përpjekjeve të tij për të përmbushur prerogativat ligjore si edhe për të siguruar rregulla të qëndrueshme, demokratike dhe stimuluese mbi të cilat do të bazohen marrëdhëniet e përditshme të punës.

Rëndësia e miratimit të një rregulloreje u imponua nga ndryshimet e herëpashershme të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe nevojës për të patur një rregullim të detajuar që garanton efikasitetin, llogari-dhënien dhe transparencën, në punën e institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, qëllimi i saj mbetet zhvillimi i veprimtarisë së Institucionit mbi bazën e parimeve të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit, konfidencialitetit dhe fleksibilitetit në përmbushjen e qëllimeve të tij, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, të parashikuara nga Kushtetuta shqiptare, aktet ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe nga legjislacioni shqiptar.

Mbështetur në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe në përgjegjësitë dhe objektivat e vendosura në “Planin Strategjik 2013-2016, të institucionit të Avokatit të Popullit”, është hartuar dhe miratuar, me Urdhrin nr. 72/2, datë 15.07.2016, **Strategjia e Menaxhimit të Riskut** për institucionin e Avokatit të Popullit.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në institucionin e Avokatit të Popullit, metodë sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e institucionit me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të parashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Institucioni i Avokatit të Popullit konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së institucionit e integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës dhe nuk duhet parë si një program i shkëputur.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për institucionin e Avokatit të Popullit jep një qasje gjithë përfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e institucionit. Ajo synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Në zbatim të Urdhrit nr. 167, datë 12.09.2014 “Për rritjen e aftësive profesionale dhe trajnimin e punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit”, me urdhrin nr. 74, datë 10.03.2016, u miratua **Plani Vjetor i Trajnimeve** të punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit, mbi bazën e së cilit punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira.

Në këtë kontekst vlen të theksohet:

- vazhdimi i procesit të intershipeve (financuar nga Projekti Danez), me dërgimin e ekspertëve të institucionit (tre eksperteve) për trajnime *deri në 1 muaj*, pranë zyrave homologe të vende të ndryshme të Evropës, me qëllim marrjen e eksperiencës sipas fushave të përgjegjësive dhe të drejtave specifike që mbulojnë.
- realizimin e trajnimeve në kuadër të programit TAIEX, vizitave të ndryshme studimore (Danimarkë, Itali, Holandë), trajnime dhe seminare të ndryshme të realizuara nga homologët tanë apo nga organizata partnere që merren dhe trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut.
- trajnime të ndryshme të realizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ku janë përfshirë një numër i madh nëpunësish civile të institucionit, etj.

Një risi gjatë vitit 2016, është ngritja dhe funksionimi “**I Qendrës së Informimit për të Drejtat e Njeriut**”, në kuadër të projektit “DANIDA” të qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës. Qëllimi i ngritjes dhe funksionimit të qendrës së informimit është mbledhja dhe vënia në dispozicion e të gjitha dokumentacioneve të cilat përmbajnë informacion të rëndësishëm lidhur me të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit 2016, në këtë qendër u arkivuan materiale të ndryshme si foto, libra, revista, buletine, raporte, vendime etj. mbi të drejtat e njeriut kudo në botë dhe u krijua mundësia për përdorimin e këtyre materialeve online për të gjithë përdoruesit e interesuar.

Në 28 shtator 2016, u lancua dhe u publiku në mediat e shkruara dhe vizive ngritja dhe funksionimi i kësaj qendre në të cilën numërohen rreth 500 tituj, duke përfshirë libra, gazeta, artikuj, raporte, letra e konferencave etj. të cilat, janë të gjitha të kataloguar në detaje në bazat e të dhënave DC-së.

Keyords në anglisht janë shtuar për të gjithë dokumentacionin e disponueshem në bazat e të dhënave kryesore, te cilat janë në internet nëpërmjet faqes sonë të internetit www.avokatipopullit.gov.al **Qendra e Dokumentacionit për të Drejtat e Njeriut** (Biblioteka).

Siç ju kemi informuar edhe më parë, në bashkëpunim me pushtetin lokal janë hapur dhe **funksionojnë zyrat rajonale** në qytetet e Shkodrës, Fierit, Beratit, Sarandës, Kukësit, Pogradecit dhe Komunës Dropull. Me mbështetjen e këtij projekti të gjitha zyrat rajonale janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, pajisje zyre etj.), të cilat në vetvete lehtësojnë komunikimin e qytetarëve të këtyre zonave me institucionin e Avokatit të Popullit.

Gjatë diskutimeve për projekt buxhetin e vitit 2016 u ra dakord që menaxhimi i këtyre zyrave të realizohej nëpërmjet rekrutimit të personave me kontratë të përkohshme pune, që u kokludua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 20.01.2016, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”, sipas së cilës institucionit të Avokatit të Popullit, **ju mundësua rekrutimi i 7(shtatë) punonjësve me kontratë të përkohshme pune.**

Gjatë vitit 2016, Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar të jenë shumë efektive dhe në plotësim të pritshmërive të institucionit të Avokatit të Popullit, referuar promovimit të këtij institucioni dhe të të drejtave të njeriut në hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë. Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit, si dhe për rrjedhojë rritjen e besimit të qytetareve tek këto zyra, është numri i ankesave gjithmonë në rritje që në fund të vitit 2016 rezulton të përbëjë 30% të të gjithë totalit të ankesave të depozituara pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Avokati i Popullit ka miratuar Urdhrin nr. 91, datë 06.04.2016 **“Për plotësimin dhe depozitimin e formularit të vetë deklarimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”**, sipas të cilit të gjithë anëtarët e kabinetit dhe nëpunësit civil të administratës së institucionit duhet të dorëzojnë formularët e vet deklarimit, të cilat u plotësuan dhe u dorëzuan pranë strukturave përkatëse sipas kërkesave të përcaktuara ligjore.

Gjithashtu, me miratimin e Urdhrit nr. 163, datë 17.06.2016 “Për disiplinimin e zhvillimit të praktikave mësimore në institucionin e Avokatit të Popullit”, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, publik apo privat (brenda dhe jashtë vendit), do tu mundësohet personave të interesuar **zhvillimin e praktikave mësimore**, sipas periudhave të përcaktuara kohore, nëpërmjet ndjekjes dhe zbatimit të një programi i cili siguron rritjen profesionale dhe akademike të tyre. Programi i ofruar nga institucioni ka pasur për qëllim të ofrojë një këndvështrim praktik të fushës dhe veprimtarisë së institucionit në funksion të promovimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Zbatimi i **rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit**, në zbatim të shkresës së këtij institucioni nr. 785/7, datë 26.12.2015, “Mbi Auditimin dhe rekomandimet”, ka qene një nga prioritetet e punës së institucionit për vitin 2016, gjë që është reflektuar në masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, të cilat janë pasqyruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1115/33, datë 24.11.2016, “Projekt raporti i auditimit, Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, në institucionin e Avokatit të Popullit”.

9.2 Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2016

Në mbështetje të ligjit nr. 147/2015, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 15.01.2016, "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016", performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2016, paraqitet si më poshtë:

Programi - "Shërbimi Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2016-2018 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2016-2018).

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2016.

Me Ligjin Nr. 147/2015, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1


Nr. Llo g.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa & Pakësimi	Plani ndryshuar	Fakti
600	Paga	74.000.000		74.000.000	66.682.914
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	10.500.000		10.500.000	9.229.864
602	Mallra dhe shërbime të tjera	15.500.000		15.500.000	12.283.991
605	Transferta Korente të Huaja	1.500.000		1.500.000	1.422.403
606	Transferta për buxhetet familjare	78.000		78.000	78.000
231	Investimet	4.000.000		4.000.000	3.767.225
	TOTALI	105.578.000		105.578.000	93.464.397

Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2016

Tabela nr. 2

Nr	Emërtimi	Plani i	Fakti		Realizimi në
1	Paga	74.000.000	66.682.914	7.317.086	90,10
2	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	10.500.000	9.229.864	1.270.136	87,90
3	Mallra dhe shërbime të tjera	15.500.000	12.283.991	3.216.009	79,26
4	Transferta Korente të Huaja	1.500.000	1.422.403	77.597	94,80
5	Transf për buxhetet familjare	78.000	78.000	0	100
6	Investimet	4.000.000	3.767.225		95,00
	Totali	105.578.000	93.464.397		88,50

Struktura e Shpenzimeve 2016



1.-Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikë, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fondi i akorduar për vitin 2016, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 74.000.000 lekë, ndërsa realizimi është 66.682.914 lekë ose 90,10%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 10.500.000 lekë, ndërsa realizimi është 9.229.864 lekë ose në masën 87,90%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2016 janë realizuar në masën 89,80%. Gjatë vitit 2016, numri mesatar i punonjësve ka qenë 50,70 punonjës nga 55 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016 nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2016, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

Ka patur mungesa në 3/mujorin e parë:

- 1- Komisioner të MKPT^{së}
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- 1- Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës,
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve.

Gjatë tremujorit të dytë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Komisioner të MKPT^{së}
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- 1- Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës,
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve.

Gjatë tremujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Komisioner të MKPT^{së}
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- 1- Këshilltar

Gjatë tremujorit të fundit të vitit institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Komisioner të MKPT^{-së}
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- 1- Këshilltar
- 1- Ndhmëskomisioner të MKPT,

2.- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Shpenzimet operative të miratuara për institucionin tonë, me gjithë ndryshimet gjatë vitit ushtrimor, janë në vlerën prej 15.500.000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit, niveli i realizimit të shpenzimeve operative rezulton në vlerën prej 12.283.991 lekë ose 79,26% përkundrejt planit të ndryshuar. Për vitin 2016 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, abonime gazeta, shërbimi postar, kancelari, materiale pastrimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, siguracion automjetesh, dieta brenda dhe jashtë vendit, shërbime për automjetet, mirëmbajtjen e ambienteve, mirëmbajtje fotokopje e printer, si dhe shpenzime pritje-përcjellje të huajve.

Gjithashtu, duke qenë anëtare e organizatave ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsmen (AMO), International Ombudsman Institute (IOI), International Coordinating Committee (ICC), European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI), një pjesë e buxhetit është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me kuota anëtarësimi, të cilat janë kryer në kohën e duhur dhe që pasqyrohen sipas tabelës më sipër. Ky fondi për transferta korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2016, është 1.500.000 lekë. Realizimi i këtij artikulli është 1.422.403 lekë ose 94,80 % i buxhetit.

4.- Shpenzime në investime

90	201600359	26022016	Marrjen e masave për trajtimin me përparësi si rast i veçantë dhe familje në nevojë të familjes S. në fshatin Zogaj të Tropojës me 4 fëmijë të mitur, pas vdekjes së kryefamiljarit	Kryetarit të Bashkisë Tropojë Kryetarit të Këshillit Bashkiak TropojëDrejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Qarku KUKES	Pranuar	Zbatuar
91	201600932	21072016	Rekomandojmë zgjidhjen e problemit të shtetasit A.Q, për përjashtimin nga pagesa e taksës së regjistrimit të banesës, bazuar në statusin e të verbrit.	Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Regjistruetit, Kukës.	Pranuar	Zbatuar
92	201601361	22072016	Vlerësimin sa më shpejt të jetë e mundur i ankimimit ndaj Vendimit të KMCAP-it për shtetasen L.D., duke vlerësuar gjendjen e saj shëndetësore.	KMCAP-it Epror pranë Shërbimit Social Shtetëror	Pranuar	Zbatuar
93	201602202	10102016	Rekomandojmë pajisjen me çertifikatë të gjendjes civile të Zj.M.B dhe të së bijës së saj të mitur (banuese në Velabisht, Berat) në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.	Zyrës të Gjendjes Civile nr.3, Berat.	Pranuar	Zbatuar

Aneks 4: Lista e Rekomandimeve të Refuzuara sipas institucioneve gjatë vitit 2016

Nr.	Nr.Doculive	Data e nisjes	Objekti i Rekomandimit	Institucioni qe eshte derguar Rekomandimi	Refuzuar/Pa pergjigje
1	201502215	27052016	Marrjen e masave për ndryshimin e VKM-së nr. 8 datë 1.01.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të enegjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj”, duke shtuar në pikën 1 të saj edhe kategorinë e punonjësve buxhetorë me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi nuk është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtarë të familjes/kryefamiljarë të punësuar ose të vetëpunësuar.	Ministrise se Mireqenies Sociale dhe Rinise/ Ministrise se Financave	Refuzuar
2	201600175	2032016	1. Marrjen e inisiatives ligjore per hartimin dhe miratimin e një ligji të veçantë mbi sjellen e mirë administrative të adoptuar dhe përshtatur me “Kodin European të Sjelles së Mirë Administrative 2. Përfshirjen në një nen të vecantë të Institucionit të Avokatit të Popullit si një kujdestar për respektimin dhe garantimin e kësaj të drejtë nga cdo Institucion i Administratës Publike.	Ministrise se Inovacionit dhe Administrates Publike	Refuzuar
3	201600030	02.03.2016	Interpretim i dispozitës kushtetuese, neni 41/4 I Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë	Gjykata Kushtetuese	Refuzuar
4	201600181	24.02.2016	Marrjen e masave te menjehershme per regjistrimin dhe lëshimin e dokumentave të pronësisë në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr.1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Gjirokastër, me Vendimin nr. 449, datë 28.10.2014, dhe Ajo e Lartë me Vendimin nr. 3797, datë 13.11.2015.	Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Sarande	Refuzuar

5	201401351	18.04.2016	Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e çështjes së regjistrimit të titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, që I përketë familjes bujqësore të ankuesit F.C, sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 994, datë 09.12.2015, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.	Regjistruesit të ZVRPP, Pogradec	Refuzuar
6	201600020	25.05.2016	Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e kryer prej Përmbauesit Gjyqësor Privat, J.P, për zbatimin e legjislacioni, si dhe gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit A.V.	Përmbauesit Gjyqësor Privat, Julian Prifti	Refuzuar
7	201601330	01.08.2016	Marrja e masave për përbushjen e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit nr.70, date 11.03.2008, të KSHC, ndryshuar me Vendimin Gjyqësor Civil të forms së prere nr.11045, date 17.11.2014, të dhene në favor të gjyqfituesit A.P.	Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme	Refuzuar
8	201600734	20.09.2016	Nxjerrjen e aktit administrative për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhërit Nr.1776, Datë 22.12.2015, “Për pezullimin e regjistrimit dhe vendosjen e masës së kufizimit”. Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë Nr.607, Datë 02.05.2013, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë subjektit pronar.	Regjistruesit të ZVRPP, Sarandë	Refuzuar
9	201600173	8.07.2016	Rekomandim për trajtimin e ankesës së shtetasit I.Adhe ecurine e procesit të trajtimit të familjeve prona e të cilave është përmbatur nga ndertimi i Hidrocentralit të fierzes	Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit tregtise dhe Siper marrjes etj.	Refuzuar
10	201602308	9.12.2016	p[er perfundimin e procedures se nenshkrimit te kontrates administrative, me shoqerine "TIC International"	Kryetarit të AKEP	Refuzuar
11	201601226	04.08.2016	Gjetjen e mundësive financiare për sigurimin e pajisjeve mjekësore “Aparat Dëgjimi”, për veteranët dhe invalidët e luftës Sotir Budina dhe Stavri Trebicka, nga buxheti i shtetit ose nga donatorë grosistë	Ministrisë së Shëndetësisë, DSKDSH	Refuzuar

12	201601478	06.07.2016	Marrjen e masave të duhura administrative për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për studenten M.B referuar ligjit nr. 8098, dt.28.03.1996 “Për statusin e të Verbrit” neni 8, si studente e verbër	Universitetit A.Xhuvani, Elbasan	Refuzuar
13	201300987	18.08.2016	Rekomandohet dhënia e mendimeve nga ISSH për projektvendimin për ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995 ‘Për Statusin e LANÇ-it’	Instituti të Sigurimeve Shoqërore	Refuzuar
14	201600090	15.09.2016	Rekomandohet zbatimi i pikës 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006 nga administratori shoqëror i Bashkisë Lushnje për ti njoftuar qytetarëve datën e paraqitjes pranë KMCAP për të vlerësuar apo rivlerësuar aftësinë e tyre për punë	Kryetarit të Bashkisë Lushnje	Refuzuar
15	201501852	19.01.2016	Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Fier z. A.Ç.	Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor	Refuzuar
16	201501389	25.01.2016	Rekomandim për zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës nr. 1966 Prot., datë 03.04.2009, të lidhur ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke zgjidhur problemin e kuotizacionit që punonjësit e policisë paguajnë si anëtar të kësaj Sindikate.	Drejtorit të Policisë së Shtetit	Refuzuar
17	201601220	22.06.2016	Rekomandim për analizimin e veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë ndaj shtetasit Sh.M dhe familjarëve të tij, si dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj atyre punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje disiplinore	Drejtorit të Policisë së Shtetit	Refuzuar
18	201501475	03.02.2016	Rek.per transferim	MÇSociale	Refuzuar
19	201600251	09.03.2016	Rekomandim “Për kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjorm të personit në hetim S.K, antar i Komunitetit Rom, i akuzuar për veprën penale “Vjedhja “ e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134 e 22 të Kodit Penal”	Drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.	Refuzuar

20	20160316	02.03.2016	Rekomandim “Për fillimin e hetimit të procedimit penal, “Kryerja e veprimeve arbitrare” ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr.1 Tiranë, për ushtrim dhune fizike ndaj qytetarëve që protestonin tek kodrat e liqenit artificial, më datë 21 Shkurt 2016,parashikuar nga neni 250 e 25 i Kodit Penal”.	Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë Për djeni Prokurorit të Përgjithshëm	Refuzuar
21	201502716	19.01.2016	Per mosnderprerjen e marredheieve te punes per punonjesit e Institucioneve te Perkujudesit Social	Ministrit te Mireqenies Sociale dhe Rinise	Refuzuar
22	201502727	28.01.2016	Per dhenien e grupit te invaliditetit nga KMCAE Epror	Institutit te Sigurimeve Shoqerore	Refuzuar
23	201600165	10.02.2016	Perjashtimin nga tarifa e shkolles se larte.	Dekanit te Fakultetit te Shkencave Sociale	Refuzuar
24	201601544	29.07.2016	Përmirësim e VKMnr. 431 datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”.	Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Refuzuar
25	201601119	22072016	Marrjen e masave konkrete për rishikimin objektiv të aplikimit për tu përfshirë në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike të familjes së z.M.J.	Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror T I R A N E Bashkisë Kamëz	Refuzuar

Aneks 5: Lista e Rekomandimeve të Pazbatuara sipas institucioneve gjatë vitit 2016

Nr.	Nr.Doculive	Data e nisjes	Objekti i Rekomandimit	Institucioni qe eshte derguar Rekomandimi	Statusi i Rekomandimit	Zbatuar ose jo
1	201500258	6052016	Rekomandojmë alokimin e fondeve për shtetasin Y.S në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave 248 datë 18.05.2000 “Për akordim ndihme për disa familje, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i fatkeqësive”.	Ministrisë së Financave. Për dijeni Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Kryetarit të Bashkisë Poliçan dhe ankuesit	Pranuar/pjesërisht	Pa zbatuar
2	201600583	10.06.2016	Rekomandim për një ndryshim në listën e pronarëve bashkëngjitur VKM Nr.343, datë 22.04.2015 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së trasmetimit 110 KV, Uznovë–Çorovodë”.	1.Ministria e Energjise dhe Industrise; 2.Operatori Sistemit te Trasmetimit; 3.ZVRPP Skrapar	Pranuar/Pjesërisht	Pa zbatuar
3	201502725	19072016	Marrja e masave të menjëhershme për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhënë në favor të shtetases F.K	Ministrit të Shëndetësisë	Pranuar	Pa zbatuar
4	201601009	20052016	Marrjen e masave të nevojshme për përfshirjen në çdo ligj të ri ose në ligjet të cilat janë në proces rishikimi, të parimit për nxitjen e barazisë dhe parandalimin e diskriminimit	Ministrit te Drejtesise	Pranuar	Pa zbatuar
5	201302432	22.02.2016	“Marrjen e nismës për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve të cilat parashikojnë procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit pranë zyrës së përmbarimit”.	Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut	Pranuar	Pa zbatuar
6	201502389	02.03.2016	Shfuqizim si i papajftueshëm me Kushtetutën i Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.255, datë 08.02.2016	Gjykata Kushtetuese	Pranuar/pjesërisht	Pa zbatuar

7	201600164	02.03.2016	“Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të Kodit të Procedurës Civile, duke përfshirë në të dhe ndihmën që jepet për trajtimin shëndetësor si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës.	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar	Pa zbatuar
8	201502117	29.02.2016	“Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr.72, datë 14.10.2015. si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë ankueses L.S për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Shkodër”.	ZVRPP, Shkoder	Pranuar	Pa zbatuar
9	201402338	07.04.2016	Marrjen e masave për përfundimin sa më parë të procesit administrative të nisur mbi bazë të kërkesës datë 30.05.2014, për nxjerrjen e aktit për miratimin e kalimit të pronësisë së banesës dhe truallit funksional të saj të ndërtuar prej shtetasit K. H, ndodhur në Selitë e Vogël, Tiranë, pasuri e rregjistruar në rregjistrin e ZVRPP, Tiranë, me nr. 1/270.	Bashkia, Tirane	Pranuar	Pa zbatuar
10	201500222	30.06.2016	Përfshirjen në projekt buxhetin e rradhës të fondit për ndërtimin e infrastrukturës në parcelën e përcaktuar për ndërtimin e varrezave në Fshatin Povelç(Hoxharë), Fier.	Kryetarit të Bashkisë, Fier	Pranuar	Pa zbatuar
11	201502014	02.11.2016	Marrja e masave dhe kryerja e veprimeve sa më të shpejta të mundshme, për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet, tokat e të cilëve janë përmbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë.	Kryeministrit të RSH	Pranuar	Pa zbatuar
12	201502556	15.02.2016	“Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të Kodit të Procedurës Civile, duke përfshirë në të dhe ndihmën ekonomike si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës.	Ministri i Drejtësisë	Pranuar	Pa zbatuar

13	201500497	21.12.2016	Ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetases Safete Kërniqi	Ministrit te Drejtesise	Pranuar	Pa zbatuar
14	201301274	5.01.2016	rekomandim per trajtimin e ankeses se banoreve te pallatit nr.18/1 rruga "Shyqyri Berxolli", Tirane	IKMT, tirane	Pranuar	Pa zbatuar
15	201601288	25.08.2016	Rekomandim	Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit/Policisë Vendore Berat	Pranuar	Pa zbatuar
16	20160198/2	28.10.2016	Rekomandim	Zyra Arsimore Kamëz	Pranuar	Pa zbatuar
17	201500801	28.07.2016	Rekomandohet miratimi i ndihmës financiare në masën e katër pagave mujore për ushtarakun P.L	Ministria e Financave	Pranuar	Pa zbatuar
18	201500002	30.08.2016	Rekomandohet marrja e masave për respektimin e legjislacionit nga Shoqëria Përmbartimore "CORRECTOR" shpk për rastin e shtetasit Agron Sula	Ministria e Drejtësisë	Pranuar	Pa zbatuar
19	201601536	24.08.2016	Rekomandohet vendosja e kamerave në IEVP Peqin që të monitorojnë ambientin e qëndrimit të grupit të sigurisë dhe rrugën ndërmjet godinave të të burgosurve që çon në këtë ambient	Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	Pranuar	Pa zbatuar
20	201600970	13.05.2016	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, duke zgjeruar kriteret dhe rrethin e personave përfitues, me qëllim sigurimin e një aksesit efektiv në drejtësi nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike falas edhe për viktimat e diskriminimit.	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar	Pa zbatuar

Aneks 6: Lista e Rekomandimeve Legjislative të nisura gjatë vitit 2016

Nr.	Nr.Doculive	Data e nisjes	Objekti i Rekomandimit	Institucioni qe eshte derguar Rekomandimi	Statusi i Rekomandimit Pranuar/PranuarPjeserisht Refuzuar/Pa pergjigje
1	Në kuadër të Grupit të Punës për Migracionin	14062016	Rekomandim për hartimin dhe miratimin e Strategjisë së re Kombëtare për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer dhe të një Plani të detajuar Veprimi.	Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë	Pa përgjigje
2	201600744	1082016	Rekomandim për hartimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 9232 datë 13.05.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane", i ndryshuar	Ministria e Zhvillimit Urban	Pranuar(ndryshimet në Ligjin e ri)
3	201502556	15.02.2016	Marrjen e masave për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të K.Pr.C, duke përfshirë në të dhe ndihmën ekonomike si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestros.	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar por i pazbatuar
4	201402389	02.03.2016	Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të Ligjit nr.133, datë 05.12.2015.	Gjykata Kushtetuese	Pranuar pjesërisht
5	201501351	17.08.2016	Marrja e masave sa më parë e mundshme për nxjerrjen e udhëzimit për caktimin e tarifës së shërbimit nga ana e organeve të ngarkuara sipas pikës 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.	Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë	Pranuar por i pa zbatuar
6	201600164	02.03.2016	Marrjen e masave për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të K.Pr.C, duke përfshirë në të dhe ndihmën që jepet për trajtimin shëndetësor si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës.	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar por i pazbatuar
7	201302432	22.02.2016	Marrjen e nismës për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve të cilat parashikojnë procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit pranë Zyrës së Përmbarimit	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar por i pazbatuar

8	201501690	25.05.2016	marrja e inisiatives ligjore per shqyrtimin e dhe miratimit nga Keshilli I Ministrave te Projeklit "Per njohjen e identitetit ligjor"	Ministrin e Drejtësisë	Pranuar Pjeserisht
9	201501690	25.05.2016	Marrja e inisiatives ligjore per shqyrtimin e dhe miratimit nga Keshilli I Ministrave te Projeklit "Per njohjen e identitetit ligjor"	Ministrisë së Mireqenies Sociale dhe Rinisë	Pa pergjigje
10	20160972	20.05.2016	"Propozime per shtesa dhe permiresime te nenit 265 te Kodit Penal "Nxitja e urrejtjes ose grindjes ndermjet kombesive, racave dhe feve"	Ministrin e Drejtësisë	Pranuar/ me pergjigje
11	201601314	06.07.2016	Ndryshim Ligji neni 55/2 dhe 278/5,6	Ministrisë së Drejtësisë Kuvendit Prokurorit të Përgjithshëm	Ligji 82/2016 Pranuar,Zbatuar
12	201600483	15.04.2016	Ndryshim Ligji	Ministrin e Drejtësisë	Pranuar
13	201600165	30.06.2016	Përfundimin nga tarifa shkollore të studentëve që ndjekin arsimin e lartë, cikli i dytë, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, të cilët gëzojnë "Statusin e të Verbërit" dhe saktësimin e terminologjisë për statuset e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e akteve të tjera nënligjore	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Pranuar
14	201601544	29.07.2016	Përmirësim e VKMnr. 431 datë 08.06.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot".	Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Refuzuar
15	201602528	21.12.2016	Marrja e masave të menjëhershme për përcaktimin e minimumit jetik dhe mbajtjen në konsideratë të ndryshimeve ligjore përkatëse që lidhen me objektivat sociale	Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Në shqyrtim
16	201602528	21.12.2016	Rishikimi ligjit 1038/2009 "Për shëndetin publik".	Ministrin e Shëndetsisë	Në shqyrtim

17	201502424	23.02.2016	<p>1. Përgatitjen sa më shpejtë të projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit” dhe “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”.</p> <p>2. Marrjen e masave të nevojshme duke i kërkuar organeve përkatëse miratimin sa më shpejtë të të gjitha projektakteve nënligjore në zbatim të neneve 73/2; 68; 81/2;75; 67/c; 63; 69 70/2; 67/2 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.</p>	Drejtorit të Policisë së Shtetit	Pranuar
18	201600970	13.05.2016	<p>1. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projektligjit për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, duke zgjeruar kriteret dhe rrethin e personave përfitues, me qëllim sigurimin e një aksesit efektiv në drejtësi nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike falas edhe për viktimat e të gjitha llojeve të diskriminimit.</p> <p>2. Dërgimin e këtij projektligji për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvendin e Shqipërisë.</p> <p>3. Rritjen e buxhetit për Shërbimin e Ndihmës Juridike me qëllim garantimin e aksesit efektiv në sistemin e drejtësisë.</p>	Ministrit të Drejtësisë	Pranuar
19	201502215	27052016	<p>Marrjen e masave për ndryshimin e VKM-së nr. 8 datë 1.01.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të enegjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj”, duke shtuar në pikën 1 të saj edhe kategorinë e punonjësve buxhetorë me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi nuk është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtarë të familjes/kryefamiljarë të punësuar ose të vetëpunësuar.</p>	Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise/ Ministrise se Financae	Refuzuar

20	201600175	20.03.2016	<p>1. Marrjen e iniciativës ligjore për hartimin dhe miratimin e një ligji të veçantë mbi sjellen e mirë administrative të adoptuar dhe përshtatur me “Kodin European të Sjelles së Mirë Administrative</p> <p>2. Përfshirjen në një nen të vecantë të Institucionit të Avokatit të Popullit si një kujdestar për respektimin dhe garantimin e kësaj të drejtë nga cdo Institucion i Administratës Publike.</p>	Ministrise se Inovacionit dhe Administrates Publike	Refuzuar
21	nr.146	13.05.2016	Per disa permiresime ne Ligjin nr.10221 date 4.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi"	Ministri i Drejtesise	Pranuar

Aneks 7: Lista e Vizitave Studimore dhe Trajnimeve gjatë vitit 2016

Nr.	DATA	VIZITË STUDIMORE/TRAJNIM	OBJEKTI	INSTITUCIONI DHE VENDI KU ESHTË ZHVILLUAR VIZITA
1	24-28 Prill	Vizitë studimore e Sektorit të Administratës	Shkëmbim i eksperiencave midis institucioneve	Institucioni i Ombudsman-it, Hagë, Hollandë
2	28 Nëntor- 1 Dhjetor	Vizitë studimore e Seksionit të Veçantë	Shkëmbim i eksperiencave midis institucioneve	Institucioni i Ombudsman-it, Kopenhagen , Danimarkë
3	4- 8 Dhjetor	Vizitë studimore e Seksionit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës	Shkëmbim i eksperiencave midis institucioneve	Zyra e Garantit Kombëtar të të drejtave të personave të dënuar ose të privuar nga liria, Romë, Itali
4	03 dhe 09. .09.2016	Program trajnimi.	Zbatimi i Sistemit te Drejtësisë Administrative ne Shqiperi	Hotel "Sheraton". Organizuar nga Prezenca e OSBE-se në Shqipëri dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
5	09.06.2016	Pjesëmarrje ne trajnim	Regullimi ligjor i marrëdhënieve të punës dhe problemet që ndeshen në praktikën gjyqësore. Dallimi mes gjykimit administrativ dhe atij civil . Roli I gjykates civile dhe administrative ne keto gjykime dhe trajtimi i problemeve qe shfaqen aktualisht.	Shkolla e Magjistratures
6	24.10.2016	Pjesëmarrje në aktivitetin "Tavolinë e rumbullakët"	Kreditori dhe ekzekutimi i detyrueshem	Hotel "Rogner". Organizuar prej Dhomes Kombetare te Permbaruesve Gjyqesor Privat.
7	27.10.2016	Workshop	Verejtjet permbyllese te Komiteit CEDAU per Shqiperine	Avokati Popullit, UN Women dhe United Nations Albania.
8	16.12.2016	Pjesëmarrje në trajnim	"Monitorimi i gjykimeve administrative 2015"	Organizuar prej OSCE. Hotel "Tirana".
9	24Tetor-1 Nentor	Vizitë studimore/ Programi i Vizitorit Ndërkombëtar	Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar	Uashington DC dhe Boston, SHBA

10	6-7 Dhjetor	Trajnim	Monitorimi dhe mbledhja e fakteve për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut.	Stamboll / Turqi
11	20 Mars- 17 Prill	Internship	Shkëmbimi eksepriencave midis institucioneve	Institucioni I Ombudsma-it , Athinë, Greqi
12	23 Prill- 21 Maj	Internship	Shkëmbimi eksepriencave midis institucioneve	Institucioni I Ombudsman-it, Paris, Francë
13	6 Nëntor-3 Dhjetor	Internship	Shkëmbimi eksepriencave midis institucioneve	Institucioni I Ombudsman-it, Bruksel, Belgjikë
14	30 maj - 3 qershor 2016	Akademia e Rrjetit European te Institucioneve Kombetare te te Drejtave te Njeriut ENNHRI	Akademia, aktivitet i pervitshem, ka ne fokus trainimin e stafeve të NHRI-ve në vendet anëtare të OSBE-së duke u përqendruar në tema specifike të këtyre Institucioneve për të forcuar kapacitetet në drejtim të promovimit të të drejtave të njeriut, si dhe të krijojë një mjedis të përshtatshëm për ndarjen e eksperiencave të mira dhe një platformë për një koncept të përbashkët të punës së NHRI-ve.	ENNHRI / Ombudsmani Gjeorgjian, Tbilisi, Gjeorgji
15	18-22 korrik 2016	Seminar frankofon per Mekanizmat e Parandalimit te Tortures	Srategjite dhe metodologjite e monitorimit ne mjediset e paraburgimit	Shoqata per Parandalimin e Tortures (APT) dhe Instituti i te Drejtave te Njeriut i Lionit - Lion, France
16	6 nentor - 3 dhjetor 2016	Vizite studimore prane Ombudsmanit Federal dhe Ombudsmanit te Wallonie dhe Federates Wallonie-Bruxelles, president I AOMF	Njohja nga afer me institucionet respektive, kryesisht me punen ne sektoret e marredhenieve me jashte, shkembim i praktikave te mira, koordinim i projekteve te perbashketa dypaleshe dhe shumepaleshe, etj...	Ombudsmani Federal dhe Ombudsmani i Wallonie dhe Federates Wallonie-Bruxelles, President i AOMF
17	22-25 nentor 2016	Kursi trainimi AOM-AOMF	“Te drejtat e femijeve migrante” AOM/AOMF	AOM-AOMF / Rabat, Marok

Aneks 8: Lista e Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2016

Nr.	INSTITUCIONI I INSPEKTUAR	QËLLIMI I INSPEKTIMIT	DATA E INSPEKTIMIT
1	Zona e Sukthit	Monitorimi i gjendjes së banorëve pas përmbytjes	08.01.2016
2	Zona e Shkozës	Monitorimi i gjendjes së banorëve pas djegies së barakave të komunitetit rom në këtë zonë	28.01.2016
3	Zona e Shkozës	Monitorimi i masave të ndërmarra për riparimin e dëmeve të pësuar në barakat e komunitetit rom	01.02.2016
4	Zona e Prushit/Tiranë	Inspektim mbi gjendjen e ujësjellësit dhe furnizimit me ujë të banorëve	15.02.2016
5	Maminas	Monitorim mbi ndërhyrjen e forcave të policisë në një pikë karburanti në kuadër të ndërprerjes së hyrje-daljeve në autostradë	03.03.2016
6	Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë	Inspektim mbi procedurat e shoqërimit të disa protestuesve tek Liqeni Artificial/Tiranë	06.03.2016
7	Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë	Inspektim mbi procedurat e shoqërimit të disa protestuesve tek Liqeni Artificial	28.03.2016
8	Bregu i Lumit	Inspektim mbi procedurat e prishjes së banesave të komunitetit rom në këtë zonë	10.05.2016
9	Bregu i Lumit	Inspektim mbi procedurat e prishjes së banesave të komunitetit rom në këtë zonë	09.06.2016
10	Shkozë/Tiranë	Inspektim mbi kushtet e jetesës së komunitetit rom në kampin e Shkozës	22.06.2016
11	Komisariati i Policisë Elbasan	Inspektim mbi procedurat e shoqërimit të një të verbëri	11.07.2016
12	Selitë/Tiranë	Inspektim mbi masat për ndertimin e mbikalimeve në zonën e Selitës	27.09.2016
13	Himarë	Inspektim mbi procedurat për ndertimin e Bulevardit të ri në Himarë	08.11.2016
14	Babrru/Tiranë	Monitorim i grevës së urisë të banorëve të Paskuqanit në gjimnazin "Gramoz Palushi"	17.11.2016
15	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për të moshuarit.	23.09.2016
16	Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat", Tiranë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	25.02.2016
17	Shtëpi fëmije Tiranë 6-18 vjec	Niveli i respektimit të drejtave të fëmijeve	06.04.2016
18	Shtëpi Foshnje Tiranë 0-3 vjec	Niveli i respektimit të drejtave të fëmijeve	08.04.2016
19	Shtëpi fëmije Vlorë, 3-6 vjeç,	Niveli i respektimit të drejtave të fëmijeve	12.04.2016
20	Shtëpi fëmije Shkodër, 0-3 vjeç	Niveli i respektimit të drejtave të fëmijeve	18.04.2016

21	Shtëpi fëmije Shkodër, 3-6 vjeç	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	18.04.2016
22	Shtëpi fëmije Shkodër, 6-18 vjeç	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	19.04.2016
23	Shtëpi fëmije Sarandë,6-18 vjec	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	21.22.04.2016
24	Shtëpi fëmije Korçë, 3-6 vjec	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	28-29.04.2016
25	Shtëpi fëmije Durres, 0-3 vjec	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	04.05.2016
26	Shkolla Speciale e fëmijëve "Luigj Gurakuqi"	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	10.10.2016
27	Instituti i nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi"	Niveli i respektimit te te drejtave te femijeve	18.10.2016
28	IVM Kavaje	Inspektim	08.11.2016
29	IEVP Lezhe	Inspektim	18.11.2016
30	Komisariati 2	Inspektim	21.11.2016
31	Komisariati 6	Inspektim	21.11.2016
32	Komisariat 3	Inspektim	24.11.2016
33	DVP Tiranë	Inspektim	24.11.2016
34	Shtëpi fëmije Shkodër, 3-6 vjeç	Deinstitucionalizimi	21.12.2016

TABELA E INSPEKTIMEVE DHE VIZITAVE TË KRYERA GJATË VITIT 2016 në kuadrin e MKPT-së

Nr.	INSTITUCIONI I INSPEKTUAR	QËLLIMI I INSPEKTIMIT	DATA E INSPEKTIMIT
1.	DPKE dhe Frontex	Operacion Kthimi i Detyruar	02.02.2016
2.	IEVP Kruje	Vizite monitoruese	04.02.2016
3.	Spitali Burgut (IVSHB)	Hetim	06.02.2016
4.	Komisariati i Policisë Vendore Elbasan	Vizitë Monitoruese	23.02.2016
5.	Komisariati i Policisë Vendore Librazhd	Vizitë Monitoruese	23.02.2016
6.	Komisariati i Policisë Vendore Peqin	Vizitë Monitoruese	23.02.2016
7.	Komisariati i Policisë Vendore Gramsh	Vizitë Monitoruese	23.02.2016
8.	IEVP Peqin	Vizitë Monitoruese	26.02.2016
9.	IEVP 325	Vizite Monitoruese	01.03.2016
10.	I.E.V.P. Lezhë	Vizitë Monitoruese	24.03.2016
11.	Drejtoria Policise Kufitare Gjirokaster	Vizite Monitoruese	29.03.2016
12.	Stacioni i Kalimit Kufitar Kakavij	Vizite Monitoruese	29.03.2016
13.	Komisariati i Policisë Vendore Shijak	Vizitë Monitoruese	12.04.2016
14.	Komisariati i Policisë Vendore Krujë	Vizitë Monitoruese	12.04.2016
15.	Komisariati i Policisë n DPV Durrës	Vizitë Monitoruese	15.04.2016
16.	Drejtoria e policise Kufitare Durres	Vizite monitoruese	15.04.2016
17.	Stacioni i Policise Kufitare Port Durres	Vizite monitoruese	15.04.2016
18.	DPKE dhe Frontex	Operacion Monit Kthim i Detyruar	26.04.2016
19.	Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër	Vizite Monitoruese	04.05.2016
20.	Drejtoria e Policise Kufitare Shkoder	Vizite Monitoruese	04.05.2016
21.	Stacioni i Policise Kufitare Moriçan	Vizite Monitoruese	04.05.2016
22.	Komisariati i Policisë Shkodër	Vizitë Monitoruese	04.05.2016
23.	Komisariati i Policisë Malësi e Madhe	Vizitë Monitoruese	05.05.2016
24.	Stacioni i Pol Kuf Hani i Hoti	Vizite Monitoruese	05.05.2016
25.	Komisariati i Policisë Pukë	Vizitë Monitoruese	05.05.2016
26.	I.E.V.P. "Shën Kol", Lezhë	Hetim	06.05.2016
27.	Spitali Psikiatrik Shkoder	Vizite Monitoruese	06.05.2016
28.	IEVP Vaqarr	Vizite Monitoruese	19.05.2016
29.	IEVP Vlore	Vizite inspektuese me KSHH	22.05.2016
30.	I.E.V.P Burrel	Hetim	27.05.2016
31.	DPKE dhe Frontex	Operacion monit kthimi te detyruar	07.06.2016
32.	DPQ Lezhë, Komisarati Laç	Raport monitorimi, Rekomandim	14.06.2016
33.	DPQ Lezhë, Komisarati Rrëshen	Raport monitorimi, Rekomandim	14.06.2016
34.	DPB IEVP Kosovë	Raport monitorimi, Rekomandim	14.06.2016
35.	DPKE dhe Frontex	Operacion kthimi i detyruar	15.06.2016
36.	DPKE dhe Frontex	Operacion kthimi i detyruar	05.07.2016
37.	Komisariati Policise Kufitare Rinas	Monitorim Kthimi Vullnetar	07.07.2016
38.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Hetim, Rekomandim ndjekje penale	19.07.2016
39.	IEVP Vlore	Vizite inspektuese me KSHH	26.07.2016
40.	IEVP Lezhe	Hetim	03.08.2016
41.	DPQ Lezhë, Komisarati Lezhë	Vizite monitoruese	17.08.2016
42.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë	Hetim, Rekomandim ndjekje penale	17.08.2016
43.	IEVP 313	Vizite Monitoruese me OJF	28.08.2016
44.	Spitali Psikiatrik Elbasan	Vizite Monitoruese	30.08.2016
45.	IEVP Kruje	Vizite Verifikimi(follow up)	01.09.2016
46.	Qendra Emigracionit Babrru	Vizite Verifikimi (follow up)	07.09.2016
47..	I.E.V.P. Fier	Vizitë Monitoruese	13.09.2016
48.	Komisariati i Policise Kufitare Devoll	Vizite monitoruese	15.09.2016
49.	Stacioni i Policise kufitare Kapshtice	Vizite Monitoruese	15.09.2016
50.	Komisariati i Policisë Devoll	Vizitë Monitoruese	15.09.2016
51.	Komisariati i Policisë Ersekë	Vizitë Monitoruese	15.09.2016
52.	Drejtoria e Policisë Vendore Korçë	Vizitë Monitoruese	16.09.2016
53.	Komisariati i Policisë Korçë	Vizitë Monitoruese	16.09.2016
54.	Komisariati i Policisë Pogradec	Vizitë Monitoruese	16.09.2016
55.	Drejtoria e Policisë Vendore Dibër	Vizitë Monitoruese	20.09.2016
56.	Komisariati i Policisë Peshkopi	Vizitë Monitoruese	20.09.2016
57..	Komisariati i Policisë Burrel	Vizitë Monitoruese	20.09.2016
58.	Komisariati i Policisë Bulqizë	Vizitë Monitoruese	20.09.2016
59.	IEVP Kukes	Vizite Monitoruese	21.09.2016
60.	IEVP Tropoje	Vizite Monitoruese	22.09.2016

61.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier	Hetim, Rekomandim ndjekje penale	24.09.2016
62.	DPKE dhe Frontex	Operacion kthimi i detyruar	28.09.2016
63.	I.E.V.P Drenovë, Korçë	Vizitë Monitoruese	06.10.2016
64.	DPKE dhe Frontex	Operacion monit kthimi detyruar	18.10.2016
65.	Komisariati i Policisë Delvinë	Vizitë Monitoruese	08.11.2016
66.	Komisariati i Policisë Sarandë	Vizitë Monitoruese	09.11.2016
67.	I.E.V.P Sarandë	Vizitë Monitoruese	09.11.2016
68.	Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë	Vizitë Monitoruese	10.11.2016
69.	Komisariati i Policisë Vlorë	Vizitë Monitoruese	10.11.2016
70.	Qendra Kombetare Pritëse e Azilkërkesve	Vizitë Monitoruese	22.11.2016
71.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	24.11.2016
72.	Komisariati i Policisë në DVP Tiranë	Vizitë Monitoruese	12.12.2016
73.	Komisariati i Policisë Vendore Nr. 2, Tiranë	Vizitë Monitoruese	13.12.2016
74.	Komisariati i Policisë Vendore Nr.3, Tiranë	Vizitë Monitoruese	13.12.2016
75.	Komisariati i Policisë Vendore Nr.4, Tiranë	Vizitë Monitoruese	13.12.2016
76.	Komisariati i Policisë Vendore Nr.5, Tiranë	Vizitë Monitoruese	13.12.2016
77.	Komisariati i Policisë Vendore Nr.6, Tiranë	Vizitë Monitoruese	13.12.2016
78.	DPQ Gjirokastrë, Kom. Policisë Përmet	Vizite monitoruese	08.11.2016
79.	DPQ Gjirokastrë, Kom. Policisë Tepelenë	Vizite monitoruese	07.11.2016
80.	DPQ Gjirokastrë Kom. Policisë Gjirokastrë	Vizite monitoruese	08.11.2016
81.	DPQ Gjirokastrë	Vizite monitoruese	08.11.2016
82.	Spitali Psikiatrik Vlorë	Vizite monitoruese	11.11.2016
83.	DPB, IEVP Tepelenë	Vizite monitoruese	21.12.2016
84.	DPQ Tiranë, Komisarati Policisë Kavajë	Vizite monitoruese	23.12.2016
85.	DPQ Kukës, Komisarati Policisë Tropojë	Vizite monitoruese	23.12.2016
86.	DPQ Kukës, Komisarati Policisë Kukës	Vizite monitoruese	23.12.2016
87.	DPQ Kukes, Komisarati Policisë Has	Vizite monitoruese	23.12.2016
88.	DPQ Kukës	Vizite monitoruese	23.12.2016
89.	Komisariati i Policisë Vendore Nr. 1, Tiranë	Vizite monitoruese	27.12.2016
90.	Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Emigracion	Vizite Verifikimi (follow up)	28.12.2016

DEKLARATA E TIRANËS

8 shtator 2016

Ne, Ombudsmanët dhe Mediatorët e vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës, në cilësinë e anëtarëve të katër shoqatave të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve si më poshtë:

Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Mesdheut (AOM),
Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF),
Federata e Ombudsmanëve të vendeve Ibero-Amerikane (FIO), dhe
Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI),

Të mbledhur për Konferencën e Nivelit të Lartë “Sfidat e Institucioneve të Ombudsmanëve përballë flukseve të përziera migratore”, në datat 7–8 shtator 2016, në Tiranë, Shqipëri:

DUKE MBAJTUR NË KONSIDERATË ANGAZHIMET E MËPOSHTME NDËRKOMBËTARE TË SHTETEVE:

1. Ekzistojnë shumë instrumente ndërkombëtare dhe rajonale që trajtojnë nevojën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve dhe refugjatëve, pa asnjë diskriminim, përfshirë atë bazuar në arsye kombësie;
2. Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut parashikon se “Secili ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë azil në vende të tjera për shkak të përndjekjes. Këtë të drejtë nuk mund ta kërkojë askush në rast të përndjekjeve për shkak të veprimeve të rëndomta penale ose në veprimet që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara”.
3. Konventa për statusin e refugjatëve e nënshkruar në Gjenevë më 28 korrik 1951, dhe Protokollin për statusin e refugjatëve i nënshkruar në Nju Jork më 31 janar 1967;
4. Rekomandimi nr.16 i Komisionit Europian kundër Racizmit të Intolerancës (ECRI) i 16 marsit 2016 për mbrojtjen e migrantëve të parregullt në vendet anëtare të Këshillit të Europës;
5. Rezolutat nr.69/168 (18 dhjetor 2014), 67/163 (20 dhjetor 2012), 65/207 (21 dhjetor 2010) dhe 63/169 (18 dhjetor 2008), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi “Rolin e Ombudsmanit, Mediatorit dhe Institucioneve të tjera kombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”.

DUKE GJYKUAR SE:

1. Shtetet kanë përgjegjësinë për promovimin, parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe refugjatëve, ashtu si dhe të sigurojnë kushtet e duhura për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në përmbushjen e mandatit të tyre në këtë fushë;

2. Shtetet duhet të zbatojnë detyrimet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut, sidomos në ofrimin e procedurave të përshtatshme për kërkimin e azilit dhe gëzimin e kësaj të drejte, si dhe në përcaktimin e kushteve të përshtatshme për pritjen e migrantëve dhe refugjatëve në këto shtete, me qëllim sigurimin e zbatimit të parimit “non-refoulement”.
3. Ombudsmanët dhe Mediatorët janë institucione të demokracisë aktive në një shtet të së drejtës dhe se ato bashkëpunojnë ngushtë në nivel rajonal dhe global veçanërisht përmes katër shoqatave të Ombudsmaëve dhe Mediatorëve që nënshkruajnë këtë deklaratë;
4. Ombudsmanët dhe Mediatorët janë shprehur tashmë dhe janë angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në kushtet e flukseve migratore në Deklarata të mëparshme.

NDËRMARRIM ANGAZHIMET E MËPOSHTME:

Në përgjithësi:

1. Të monitorojmë dhe ushtrojmë presion pozitiv dhe të vazhdueshëm ndaj shteteve respektive për përmbushjen e detyrimeve dhe standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e refugjatët;
2. Të zhvillojmë bashkëpunim konkret midis vendeve anëtare të organizatave të cilat janë vende origjine, tranziti dhe destinacioni për forcimin e të drejtave të migrantëve përgjatë rrugëve migratore dhe deri në kthimin e tyre të mundshëm në vendet e origjinës.

Në veçanti:

3. Të kujdesemi, gjatë trajtimit të çështjeve që lidhen me të drejtat emigrantëve dhe refugjatëve, për respektimin e karakterit universal dhe të patjetërsueshëm të këtyre të drejtave, si dhe respektimin e normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me qëllim adoptimin e një qasjeje efikase duke dënuar në të njëjtën kohe pasojat çnjerëzore të krizës aktuale migratore.
4. Të intensifikojmë veprimet tona ex-officio dhe të forcojmë praninë tonë në qendrat e pritjes dhe të ndalimit si dhe të përdorim të gjitha instrumentat e mundshëm në ushtrimin e mandatit tonë.
5. Të ofrojmë dhe garantojmë migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve aksesin maksimal në procedurat e ankesave, dhe/ose trajtimin e çështjeve;
6. Të koordinojmë veprimet për transferimin e tyre juridiksional midis institucioneve tona, me qëllim sigurimin e një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj ankesave me dimension ndërkombëtar dhe ndërkufitar.
7. Të koordinohemi ngushtësisht dhe të intensifikojmë nderveprimin tonë me të gjithë aktorët aktivë, veçanërisht me shoqërinë civile, me qëllim forcimin e garancive dhe burimeve që i adresohen nevojave të fëmijëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, LGBTI, si dhe të viktimave të torturës dhe viktimave të trafikimit.
8. Të angazhohemi gjerësisht në fushata të rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve, duke dënuar me forcë fenomenin e ksenofobisë, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, duke promovuar dialogun ndërkulturor dhe tolerancën.

U BËJMË THIRRJE SHTETEVE:

1. Të mirëpresin me solidaritet dhe humanizëm çdo qytetar të huaj që ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.
2. Të kenë një qasje thellësisht humane në vendimmarrjet politike ndaj krizës migratore, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të adresojnë të gjitha shkaqet e kësaj krize, përfshirë ato politike, ekonomike shoqërore dhe mjdisore;
3. Të regjistrojnë migrantët dhe refugjatët për t'u krijuar atyre mundësinë të jenë ligjërisht të identifikueshëm dhe të kenë akses në procedurat administrative që lidhen me statusin e tyre në territorin e shteteve respektive.
4. T'u garantojnë refugjatëve dhe migrantëve individualisht nga shtetet, akses efektiv në procedurat e azilit, pa asnjë diskriminim dhe pavarësisht kostove financiare përkatëse, përfshirë informacionin e plotë dhe shërbime përkthimi.
5. Të respektojnë parimin e non-refoulement ndaj personave që vijnë nga vendet që konsiderohen të sigurta, por që mund të jenë konkretisht në situatë risku.
6. Të sigurojnë ndërveprim shumëplanësh kundër gjuhës së urrejtjes, racizmit dhe ksenofobisë, të cilat kanë pasoja negative për situatën e të drejtave të migrantëve dhe në të njëjtën kohë dëmtojnë vlerat dhe parimet themelore të diversitetit, tolerancës dhe bashkëjetesës në shoqëritë tona.
7. Të angazhohen për trajtimin e veçantë të të miturve të pashoqëruar në radhët e migrantëve, për garantimin e të drejtave të tyre themelore në përputhje me nevojat e tyre të veçanta dhe për të lehtësuar procesin e bashkimit familjar.
8. Të ngrenë nivelin e ndërjegjësimit në radhët e forcave të policisë dhe sigurisë në lidhje me situatën e personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe që gjenden në mënyre të parregullt në territoret e vendeve tona.
9. Të mundësojnë monitorimin dhe inspektimin e pavarur në qendrat e tranzitit nga ana e shoqërisë civile dhe organizatave të tjera pavarura nga pushteti ekzekutiv, përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
10. Të zhvillojnë politika që sigurojnë integrimin e migrantëve në jetën e vendeve pritëse përmes aksesit në strehim të përshtatshëm, arsimiminin e fëmijëve, shërbimin shëndetësor dhe tregun e punës, si dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për mësimin e gjuhës së vendeve pritëse dhe vlerave të tyre themelore.

Në cilësinë e anëtarëve të katër shoqatave rajonale dhe ndërkombëtare, ne Ombudsmanët dhe Mediatorët e vendeve të ndryshme të botës,

Miratojmë këtë deklaratë.

Tiranë, më 8 shtator 2016

DEKLARATË E PËRBASHKËT E
AVOKATIT TË POPULLIT DHE ZYRËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Tiranë, Dhjetor 2016

“Ndërthurja e Objektivave Për Zhvillim të Qëndrueshëm me të Drejtat e Njeriut –Roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në Zbatimin dhe Arritjen e Objektivave Për Zhvillim të Qëndrueshëm

Ne, Organizata e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe zyra e Avokatit të Popullit, të mbledhur në Konferencën Vjetore të këtij institucioni me temë: “*Ndërthurja e Objektivave Për Zhvillim të Qëndrueshëm me të Drejtat e Njeriut – Roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në Zbatimin dhe Arritjen e Objektivave Për Zhvillim të Qëndrueshëm*”.

MBAJME NË KONSIDERATË AXHENDËN 2030 PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM:

- Bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Axhenda 2030 është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe mirëqënien e fokusuar në forcimin e paqes universale në liri të plotë, eliminimin e varfërisë në të gjitha format dhe përmasat e saj, luftën kundër pabarazisë dhe padrejtësisve, dhe ndryshimet klimaterike. Arritja e kësaj Axhende nga Qeveria Shqipëtare dhe të gjithë aktorët, duke vepruar në partneritet të plotë, bazohet në zbatimin e 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) që përfshijnë 169 tregues dhe 230 indikatorë;
- Axhenda është gjithëpërfshirëse dhe vendos prioritete në çështjet që ndikojnë tek njerëzimi në nivel global, me qëllim dhënien fund të varfërisë (Objektivi 1) dhe urisë (Objektivi 2); Për të siguruar qasje në kujdesin shëndetësor (Objektivi 3), arsimin gjithëpërfshirës (Objektivi 4), Aksesin në burime si ujë i pijshëm dhe energji elektrike (Objektivi 6 dhe 7); Rritje ekonomike dhe punësim (Objektivi 8); Shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, qasje në drejtësi dhe institucionet e përgjegjshme dhe përfshirëse dhe pasqyron një sërë të drejtash civile dhe politike (Objektivi 16);
- Me aplikimin e saj universal dhe rëndësinë për formësimin e prioriteteve të zhvillimit, Axhenda 2030 do të hapë shtigje të reja për integrimin e të drejtave të njeriut në politikat globale dhe kombëtare përgjatë 15 viteve të ardhshme;
- Zbatimi i Axhendës 2030 “**të mos lëmë askënd prapa**” kërkon gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e aktorëve të rëndësishëm në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal, duke përfshirë në radhë të parë grupet në nevojë/të lëna pas - gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, etj – parlamentin, autoritetet qendrore dhe lokale, sektorin privat, institucionet akademike, organizata të shoqërisë civile e më gjerë.

AVOKATI I POPULLIT SI INSTITUCION KOMBËTAR GARANT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI DO TË LUAJË ROL:

- 1- Monitorimin e vazhdueshëm të të drejtave të njeriut me fokus identifikimin e problematikave për grupet në nevojë, duke siguruar në çdo rast respektimin e të drejtave të njeriut nga çdo institucion, bazuar në 17 objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- 2- Integrimin në mënyrë të qartë të 17 OZHQ-ve në plane veprimi, raporte dhe dokumente të tjera, bazuar në referenca të qarta ndaj këtyre objektivave, të prodhuara nga zyra e Avokatit të Popullit. Publikimi i këtyre raporteve do të shërbejë për të nxitur shtetin në zbatimin e kësaj Axhende;
- 3- Bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e Axhendës 2030;
- 4- Hartimin e një metodologji të qartë monitorimi mbi zbatimin e 17 OZHQ-ve. Kjo do të shërbejë si bazë për të monitoruar cilësinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të politikave nga ana e qeverisë. Ndihma e partnerëve ndërkombëtarë në ngritjen e kapaciteteve dhe metodologjisë për monitorimin e zbatimit të objektivave është kyce.
- 5- Bashkëpunimin me institucione të tjera që prodhojnë dhe grumbullojnë të dhëna statistikore përfshirë INSTAT, akademia dhe organizata të shoqërisë civile.

REKOMANDIME TË PËRBASHKËTA PËR ZBATIMIN E AXHENDËS 2030

- 1- Inkurajojmë Qeverinë në përgatitjen e një Plani Veprimi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në vend, i cili do të përshkruajë se si Shqipëria synon të arrijë 17 OZHQ-të në kuadër të realizimit konkret të Axhendës 2030. Ndër të tjera, Plani i Veprimit duhet të identifikojë:
- 2- Krijimin e një Këshilli Kombëtar koordinimi të nivelit të lartë, i cili të monitorojë përpjekjet e Qeverisë dhe aktoreve të tjerë në përmbushjen e detyrimeve që parashtrojnë Axhenda 2030. Ky këshill duhet të jetë gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen shoqërisë civile, parlamenti, autoritetet lokale, akademia, komuniteti i donatorëve, sektori privat, etj;
- 3- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen e pushtetit vendor përfshirë Bashkitë, Këshillat Bashkiakë si dhe Shoqërinë Civile në zbatimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe lidhjen me të drejtat e njeriut.
- 4- Zbatimin sa më efikas i Axhendës 2030 në nivel qëndror dhe lokal kërkon një bashkëpunim më të qëndrueshëm ndërsektorial si dhe miratimin e perspektivave multi-dimensionale për zhvillim, të cilat përfshijnë zhvillimin njerëzor dhe një mjedis të qëndrueshëm, si dhe investime për ngritjen e sistemeve, kapaciteteve zbatuese dhe monitoruese dhe të dhënave cilësore për të monitoruar progresin në arritjen e 17 OZHQ-ve/zhvillim për të gjithë.
- 5- Inkurajojmë një rol efektiv të Parlamentit në procesin e zbatimit të Axhendës 2030, si një institucion kyç që garanton miratimin dhe monitorimin e kuadrit ligjor të nevojshëm.